



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE



**EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM I VENDIMEVE GJYQËSORE DHE
PROBLEMATIKA E PRAKTIKËS GJYQËSORE**

DISERTACION

*PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
DOKTOR*

**Kandidati
MA. Ina BARJAMAJ**

**Udhëheqësi shkencor
Prof.Dr. Altin SHEGANI**

Tiranë, Tetor 2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE



Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe problematika e praktikës gjyqësore

DISERTACION

*PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
DOKTOR*

Kandidati
MA. Ina BARJAMAJ

Udhëheqësi shkencor
Prof.Dr. Altin SHEGANI

Mbrohet më dt. ____./____./ 2016

Juria e vlerësimit:

1. Kryetar Prof.Dr. Aurela Anastasi
2. Oponentë Prof.Dr. Kudret Çela
3. Oponentë Prof.Dr Skënder Kaçupi
4. Antarë Prof.Ass.Dr. Eva Hyskaj
5. Antarë Prof.Ass.Dr. Eriona Katro

DEKLARATA E AUTORËSISË

Në zbatim të VKM nr. 593, dt.18.08.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.864, dt.05.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoraturës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë kandidati për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor” të ndryshuar, si dhe në urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, nr. 105, dt.23.03.2012 “Për miratimin e rregullores për Etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese”:

Nën përgjegjësinë time personale deklaroj për origjinalitetin e plotë të punimit tim, përveç rasteve të cituara dhe të referuara sipas rregullave në fuqi. Punimi nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij.

MIRËNJOHJE

Do të dëshiroja tu shpreh mirënjohje të gjithë atyre që u bënë pjesë në realizimin e këtij studimi. Dua të falënderoj udhëheqësin e temës sime, Profesor Altin Sheganin, i cili më ka ndihmuar me sugjerimet, kritikrat dhe vërejtjet e tij.

Dëshiroj të falënderoj drejtuesit, pedagogët e Shkollës Doktorale të Institutit të Studimeve Europiane të Universitetit të Tiranës që me përkushtim dhe profesionalizëm e kanë lehtësuar më së miri këtë proces.

Një mirënjohje e veçantë shkon për Prof. Marjana Seminin dhe Dr. Erjon Hitaj, për kohën dhe vëmendjen që më kanë kushtuar gjatë këtij punimi.

Këtë punim ia dedikoj prindërve të mi të dashur, nënës sime dhe babait tim. Dashuria, sakrificat dhe mbështetja e madhe e tyre më ka ndihmuar dhe frymëzuar shumë në punën time. Shumë mirënjohje për ta!

Së fundi, por jo për nga rëndësia dua të falënderoj familjen time, bashkëshortin dhe vajzën time për mbështetjen e pakursyer që më ka dhënë, gjatë këtij udhëtimi të vështirë e të bukur.

PASQYRA E LËNDËS

Hyrje	x
Paraqitje e shkurtër e përmbajtjes së punimit	xiii

KAPITULLI I. DIMENSIONI HISTORIK I LINDJES DHE ZHVILLIMIT TË INSTITUTIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI

1.1. Zhvillimi historik i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri	16
1.2. Vështrim i përgjithshëm mbi rendin juridik shqiptar me fokus të veçantë aspektin procedural	16
1.3. Instituti i Ekzekutimit të vendimit gjyqësor para vitit 1912 .	17
1.4. Instituti i Ekzekutimit të vendimit gjyqësor për vitet 1912-1929	18
1.5. Instituti i Ekzekutimit të vendimit gjyqësor për vitet 1930-1958	19
1.6. Instituti i Ekzekutimit të vendimit gjyqësor për vitet 1958-1981	21

KAPITULLI II. KUADRI JURIDIK I MARRËDHËNIES JURIDIKO-PROCEDURIALE EKZEKUTIVE

2.1. Kuptimi i marrëdhënieve juridiko-procedurale-ekzekutive dhe elementet e saj	24
2.1.1. Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit dhe ndryshimet që ka pësuar praktika gjyqësore	26
2.2. Përgjegjësia e subjekteve në ekzekutim	29
2.3. Parashkrimi i së drejtës për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi gjyqësor	30
2.3.1. Kuptimi i institutit të parashkrimit në të drejtën procedurale civile	30
2.3.2. Parashkrimi i vënies në ekzekutim të titujve ekzekutiv: rëndësia e studimit të tij	32
2.3.3. Fillimi i afatit të parashkrimit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv	33
2.3.4. Plotësimi i afatit të parashkrimit dhe pasojat që sjell për palët	35
2.4. Titujt ekzekutiv	37
2.4.1. Koncepti i titullit ekzekutiv dhe elementet e tij sipas doktrinës shqiptare	37
2.5. Llojet e titujve ekzekutiv. Titujt ekzekutiv gjyqësor	37
2.5.1. Vendimet civile për sigurimin e padisë, si tituj ekzekutiv	39
2.5.2. Vendimet me ekzekutim të përkohshëm, si tituj ekzekutiv	42
2.5.3. Vendimet penale të formës së prerë, si tituj ekzekutiv	43
2.5.4. Vendimet e gjykatave dhe arbitrazheve të shteteve të huaja, si tituj ekzekutiv	44

2.5.5. Vendimet e gjykatës së arbitrazhit, si tituj ekzekutiv	45
2.6. Titujt ekzekutiv jogjyqësor	45
2.6.1. Akti noterial si titull ekzekutiv	45
2.6.2. Titujt dhe letrat me urdhër që barazohen me to	49
2.6.3. Aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre	50

KAPITULLI III. AKTORËT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN CIVILE

3.1. Vështrim i përgjithshëm	55
3.2. Shërbimi përmbarimor shtetëror dhe struktura e tij	56
3.2.1. Statusi i përmbaruesit shtetëror	57
3.2.2. Shërbimi përmbarimor shtetëror dhe problematikat e tij	59
3.3. Shërbimi përmbarimor privat	60
3.3.1 Kontrata e shërbimit dhe efektet që sjell për palët në procesin ekzekutiv	62
3.3.2 Tarifat për shërbimin e ofruar nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat dhe rregullat për caktimin e saj	63
3.3.3 Struktura organizative e shërbimit përmbarimor privat	66
3.3.4 Statusi i përmbaruesit gjyqësor privat	67
3.4. Rëndësia e përfshirjes së shërbimit përmbarimor në reformën në drejtësi	67
3.5. Organizimi i trupës përmbarimore në kuadër të veprimtarisë së tyre dhe iniciativat ligjore që duhen ndërmarrë	69
3.6. Ndryshimet që propozohen nga reforma në drejtësi në fushën e shërbimit përmbarimor dhe atë të ekzekutimit të vendimeve	70
3.7. Statusi i përmbaruesit gjyqësor ne Bashkimin Europian: krahasimi me atë shqiptar	75
3.8. Marrëdhëniet e shërbimit përmbarimor me institucionet e përfshira në procesin e ekzekutimit, kjo edhe në këndvështrimin e legjislacionit europian	77
3.9. Respektimi i Kodit të Etikës të përmbaruesve gjyqësor shtetëror dhe privat	78

KAPITULLI IV. REGJIMI JURIDIK I EKZEKUTIMEVE TË VEÇANTA TË VENDIMEVE GJYQËSORE

4.1. Kuptimi i ekzekutimit të detyrueshëm	80
4.2. Mënyra dhe kufijtë e realizimit të ekzekutimit të detyrueshëm	82
4.2.1. Ekzekutimi mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet që personat e tretë i detyrohen debitorit	82
4.3. Llojet e detyrimeve të ekzekutueshme dhe ekzekutimi i tyre. Ekzekutimi i një detyrimi në të holla	84

4.3.1.	Ekzekutimi i detyrimit në të holla ndaj insitucioneve buxhetore	84
4.3.2.	Ekzekutimi i një detyrimi në të holla në llogaritë bankare	88
4.3.3.	Ekzekutimi i detyrimit në të holla në fusha të veçanta	90
4.4.	Sekuestrimi i sendeve për efekt të ekzekutimit	91
4.4.1.	Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme	91
4.4.2.	Organizimi i ankandit për shitjen e sendit të luajtshëm të sekuestruar	93
4.4.3.	Ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme	95
4.4.4.	Zhvillimi i ankandit për shitjen e sendit të paluajtshëm të sekuestruar	97
4.4.5.	Ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme në bashkëpronësi	100
4.5.	Ekzekutimi i detyrimit për dorëzimin e një sendi	101
4.5.1.	Vënia në posedim e një sendi të luajtshëm	101
4.5.2.	Vënia në posedim e një sendi të paluajtshëm	102
4.6.	Ekzekutimi i detyrimit për kryerjen e një veprimi	103

KAPITULLI V. NATYRA E MJETEVE TË MBROJTJES NË FAZËN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT GJYQËSOR

5.1.	Vështrim i përgjithshëm	
5.2.	Padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv si mjet mbrojtës dhe praktika gjyqësore në lidhje me të.	105
5.2.1	Legjitimi i palëve për të ngritur padinë e pavlefshmërisë së titullit.	108
5.2.2	Gjykata kompetente për gjykimin e padisë së pavlefshmërisë.	109
5.2.3	Shkaku i padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv.	111
5.2.4	Dallimi i shkaqeve sipas llojit të titullit ekzekutiv.	113
5.2.5	Llojet e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv dhe dallimi midis tyre.	116
5.2.6	Kërkesa për pezullimi të veprimeve përmbarimore parashikuar në nenin 609 të K.Pr.Civile.	117
5.2.7	Afati i ankimit ndaj vendimit të Gjykatës me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv.	119
5.3.	Padia për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore si mjet tjetër për mbrojtjen gjatë fazës së ekzekutimit	119
5.3.1.	Vështrim i përgjithshëm	119
5.3.1.	Padia për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore.	121
5.3.2.	Legjitimi i palëve për të ngritur padinë e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore.	121
5.3.3.	Objekti dhe shkaku i padisë së kundërshtimit të veprimeve përmbarimore.	124
5.3.4.	Gjykata kompetente për gjykimin e padisë së kundërshtimit të veprimeve përmbarimore.	125

5.3.5.	Kërkesa për pezullimin e veprimeve përmbarimore parashikuar në nenin 610 të K.Pr.Civile.	127
5.3.6.	Afati i ankimit ndaj vendimit të gjykatës me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore.	128
5.4.	Padia për kërkimin e sendit nga personi i tretë.	129
5.5.	Rastet e pezullimit dhe pushimit të ekzekutimit.	131
5.5.1.	Rastet e pezullimit të ekzekutimit.	131
5.5.2.	Rastet e pushimit të ekzekutimit.	133

KAPITULLI VI. ZBATIMI I MODELIT TË PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR NË KËRKIMIN GJYQËSISHT TË SË DREJTËS

6.1.	Roli i Gjykatës Kushtetuese në mbrojtjen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në rastet që lidhen me ekzekutimin e detyrueshëm.	135
6.2.	Efektiviteti i ankimit në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor.	137
6.3.	Trajtime që i referohen fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.	141
6.4.	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.	144
6.5.	Sigurimi i ekzekutimit efikas dhe të efektshëm të vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.	145
6.5.1	Masat e përgjithshme që ndërmarrin shtetet për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të GjEDNj dhe praktika e shteteve në marrjen e këtyre masave.	146
6.5.2	Masat individuale që ndërmarrin shtetet për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të GjEDNj.	148
6.5.3	Roli mbikëqyrës i Komitetit të Ministrave në ekzekutimin e vendimeve të GjEDNj.	150
6.5.4	Qëndrimi i mbajtur nga Komitetit i Ministrave në ekzekutimin e vendimeve të GjEDNj ndaj shtetit shqiptar.	151
6.6.	Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut dhe rastet në lidhje me mosekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm ndaj shtetit shqiptar.	153
6.6.1.	Precedentët e vendosur nga jurisprudenca e GJEDNJ për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.	155
6.6.2.	Rastet e Shqipërisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.	156
		161-168

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

BIBLIOGRAFIA

169

ABSTRAKT

HYRJE

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një komponent i veçantë dhe shumë i rëndësishëm në përmbushjen e misionit të shtetit të së drejtës. Në këtë kontekst, forcimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore merr një rëndësi të veçantë dhe mendoj se studimi i këtij instituti do të kontribuojë sadopak në përmirësimin e situatës aktuale. Legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ka njohur rrugën e vet të zhvillimit dhe të transformimit në varësi të zhvillimeve ekonomike, shoqërore, politike. Një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike është detyrimi i autoriteteve publike për të vënë në zbatim urdhërimet e vendimet gjyqësore të formës së prerë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze, mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar.

Ky studim do të përqëndrohet në analizimin e kuadrit ligjor si material, ashtu edhe atij procedural, që lidhet me një fazë shumë të rëndësishme atë të ekzekutimit të së drejtës. Një drejtësi e vonuar është një drejtësi e mohuar. Punimi është realizuar në kuadrin e reformës që ka pësuar e drejta procedurale civile në këto 10 vitet e fundit, me një fokus të veçantë në institutin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe titujve ekzekutiv. Me ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Civile dhe me miratimin e ligjit nr.10031 datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor privat”, për herë të parë liberalizohet shërbimi përmbartimor, përveç shërbimit përmbartimor shtetëror fillon të ndërveprojë edhe shërbimi përmbartimor gjyqësor privat.

Ky punim do të shtrijë fushën e studimit në gjendjen aktuale të shërbimit përmbartimor. Në analizimin e reformave që janë ndërmarrë në këtë fushë duke nxjerrë në pah disavantazhet dhe vonesat në ekzekutimin e vendimeve si dhe të institucioneve, funksionimi i të cilave duhet të siguronte materializimin e së drejtës së fituar në procesin gjyqësor. Për mbarëvatjen dhe funksionimin e shtetit të së drejtës është shumë e qënësishme studimi i marrëdhënieve ekzekutivo-procedurale dhe vështirësitë që ajo has. Çdo individ ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura apo të mohuara. Dhënia e drejtësisë do të ishte një iluzion, nëse nuk do të garantohej zbatimi i saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, është pjesë thelbësore e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e cila garantohet nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane. Kjo pasi kur individëve u mungon besimi në zbatueshmërinë e vendimeve, ka gjasa që ata më pak të mbështeten në gjykata për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe si rezultat do të zbehë besimin në sistemin e drejtësisë dhe sundimin e ligjit.

Vetëm duke kuptuar shkaqet e moszbatimit, do të rregullojmë situatën problematike në fazën e ekzekutimit. Nëpërmjet mekanizmave, që do të propozohen do të silltet një këndvështrim i ri, i cili do të ndihmojë që faza e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të mos duket si një fazë e pamundur për t’u realizuar. Vetëm në këtë mënyrë, mund të përmirësohet standardi i jetesës dhe të rritet besimi i publikut në shtetin ligjor. Si çdo punim tjetër i këtij lloji, prezantimi i temës, objektivave dhe problematikave kryesore, fillon gjithmonë me “justifikimin” e arsyeve që kanë çuar në përzgjedhjen e temës së marrë në studim.

Arsyeja e parë, e cila ka shërbyer si pikënisje në zgjedhjen e trajtimit të institutit të ekzekutimit të vendimeve, padyshim ka qenë ushtrimi i detyrës si përmbarues gjyqësor, fillimisht si përmbarues gjyqësor shtetëror dhe më pas si përmbarues privat. Dëshira dhe nevoja për të sjellë një kontribut sado modest në doktrinën juridike, në trajtimin e një instituti të rëndësishëm për të drejtën procedurale civile në Shqipëri. Jurisprudenca shqiptare për një kohë relativisht të gjatë nuk ka njohur ekzekutimin si pjesë integrale të procesit gjyqësor. Nga ana tjetër, arsyeja e përzgjedhjes së temës së mësipërme, është karakteri ndërdisiplinor i institutit të ekzekutimit të vendimit dhe domosdoshmëria e trajtimit të tij, jo vetëm në kuadrin e së drejtës procedurale civile, por njëkohësisht analiza e ndërthurjes së tij, si pjesë e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt gjyqësor si dhe në kuadër të së drejtës europiane dhe jurisprudencës së saj. Karakteri ndërdisiplinor dhe ndërthurja e instituteve të mësipërme përfaqëson njëkohësisht edhe sfidën kryesore të këtij punimi.

(i) Pyetjet kërkimore dhe objektivat e punimit

Me qëllim kryerjen e një trajtimi sa më të plotë, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore do të studiohet në tre plane të ndërthurur njëri me tjetrin, të cilat janë: a) instituti i së drejtës procedurale civile b) pjesë e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt gjyqësor c) në kuadër të detyrimeve që ka marrë shteti shqiptar, si vend që synon anëtarësimin me të drejta të plota në Bashkimin Europian, pra në kuadër të së drejtës europiane:

a) Ekzekutimi i detyrueshëm, i cili përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të marrëdhënies juridiko-ekzekutive, kompetenca e përmbaruesit gjyqësor si një organ mjaft i rëndësishëm për ekzekutimin e vendimeve, sekuestrimi i pasurive të luajshme dhe të paluajtshme, i kredive që personat e tretë i detyrohen debitorit, mjetet e mbrojtjes të debitorit gjatë fazës së ekzekutimit.

b) Mënyra e organizimit të sistemit ekzekutim në vende të ndryshme të Bashkimit Europian. Në këtë punim është marrë përsipër analiza dhe paraqitja e zgjidhjeve të mundshme që sugjeron doktrina, dhe që ka përpunuar praktika gjyqësore në vende të tjera, të problemeve të mëposhtme:

1. Analiza e përmbajtjes së kuadrit ligjor mbi marrëdhënien juridiko-ekzekutive, mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve pjesëmarrëse, kompetencat dhe juridiksioni i përmbaruesve gjyqësor.

2. Studimi i risive që ka sjellë ligji për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat. Liberalizimi i tregut dhe pasojat që solli, duke rritur konkurrencën dhe efikencën e shërbimit përmbarimor, në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

3. Studimi i mundësive të gjetjes së instrumenteve efikase, që reformojnë dhe përmirësojnë situatën aktuale, duke e bërë më produktiv procesin e ekzekutimit. Implementimi i këtyre instrumentave do të kërkonte seriozitetin dhe prezencën e padiskutueshme të vetë shtetit.

4. Studimi i risive, që ka sjellë ligji Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në veçanti në fushën e ekzekutimit të vendimeve që jepen nga Gjykata Administrative.

5. Analiza e sanksioneve ligjore, që zbatohen ndaj çdo pengimi apo vonese në ekzekutimin e vendimeve. Aplikimi dhe vjelja e këtyre sanksioneve do t'i bëjë më të ndërgjegjshëm si individin ashtu edhe organet shtetërore. Mosndëshkueshmëria e palës debitoare lë shumë për të dëshiruar duke krijuar kështu indiferencë e mospërfillje ndaj ligjit, për më tepër ndaj atyre që kanë për detyrë zbatimin e tij. E një rëndësie të veçantë është edhe prania e forcës shtrënguese të shtetit ligjor dhe funksionimi i secilës hallkë në mëyrën e duhur. Kjo do të siguronte zbatimin efektiv të vendimeve të gjykatave dhe realizimin e së drejtës themelore të individit për një proces të rregullt ligjor.

6. Studimi i Rekomandimit (2003/17) i Këshillit të Europës për Përmbartimin dhe Udhëzimit të Komisionit European për Eficencën e Drejtësisë për një zbatim më të mirë të së drejtës ekzekutive në tëresi.

7. Analiza e kuadrit ligjor dhe e praktikës gjyqësore do të ndihmonte në përmirësimin e procesit të gjatë dhe të vështirë të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Ajo do të identifikonte barrierat e natyrës legislative, procedurale dhe praktike, të cilat pengojnë ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, për të siguruar zbatimin efektiv dhe në kohë të vendimeve të gjykatave.

8. Së fundi, krahasimi i modeleve të ndryshme europiane dhe më gjerë, në fushën e ekzekutimit të vendimeve ose në funksion të kuptimit të dallimeve që ekzistojnë ndërmjet sistemeve të ndryshme ligjore në këtë fushë.

(ii) Metodologjia

Siç e kemi përmendur dhe më sipër, objektivat kryesorë të këtij punimi janë hulumtimet e Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Gjyqësore, pasi janë shumë aktuale për mbarëvatjen dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Ekzekutimi është pjesa thelbësore e së drejtës në një proces të rregullt ligjor, i cili garantohet nga Kushtetuta dhe Konventa Europiane. Metodologjia në këtë studim lidhet ngushtësisht me fushën e zgjedhur për studim, pasi ajo i përshtatet fushës së studimit dhe rezultateve që kërkoj të arrij. Konkretisht, ajo përbëhet nga një kombinim midis metodës përshkruese, analitike dhe krahasuese.

Metoda përshkruese, që do të përdoret në këtë punim, ka si qëllim identifikimin e gjendjes aktuale të marrëdhënies juridiko-ekzekutive. Përshkrimi me hollësi i të drejtave dhe detyrimeve të palëve pjesëmarrëse, na tregon mjaftueshëm për tipologjinë e kësaj marrëdhënieje dhe problemet me të cilat përballlet. Identifikimi i problematikave nxjerr në pah problemet specifike, që hasen gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Procesit të interpretimit dhe analizës së legjislacionit, kryesisht në rastet mbi paqartësitë e normave, i vijnë në ndihmë faktorë të tjerë të jashtëm si analizimi i aspektit historik.

Analiza e legjislacionit, Në sistemin tonë juridik, normat ligjore gjenden në kode, ligje dhe akte të tjera. Meqenë se normat rregullojnë situata të përgjithshme, metoda e analizës ligjore shërben për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të teorisë dhe të praktikës, nëpërmjet interpretimit të këtyre normave. Kjo metodë shërben për të sqaruar paqartësinë e normave,

vendosjen e tyre në një rend logjik dhe koherent dhe për të analizuar ndërveprimin e tyre me norma e tjera.

Kërkimi doktrinar është një metodë tjetër në realizimin e këtij punimi, përmes mbledhjes dhe përpunimit të literaturës. Ky hap konsiston në rishikimin e literaturës në lidhje me objektin e studimit. Ai përfshin: identifikimin, mbledhjen dhe sistemimin e librave, monografive, artikujve shkencorë, kumtesave të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën ligjore. Përzgjedhja e literaturës mbështetëse të këtij punimi, është shtrirë mbi një numër të konsiderueshëm autorësh, vendas dhe të huaj dhe mbi një sërë çështjesh, të cilat janë gjykuar nga Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Metoda analitike e përdorur, ka synuar të shtjellojë legjislacionin ekzistues të vendit tonë, duke analizuar ato elemente që i përgjigjen qëllimit dhe objektivave të temës, si dhe duke u përpjekur t'u japë përgjigje pyetjeve të ngritura gjatë studimit.

Metoda krahasuese, Pavarësisht se, studimi nuk ka natyrë të mirëfilltë krahasuese, për një kuptim dhe interpretim më të mirë të normave të brendshme ligjore është menduar realizimi i analizës krahasuese. Kjo metodë përdoret në mënyrë që të sqarohen më mirë konceptet. Për arsye që lidhen kryesisht me proceset integruese të vendit tonë, është zgjedhur legjislacioni i vendeve europiane, si referencë bazë krahasimore. Për rrjedhojë, analizimi i legjislacionit shqiptar në këtë drejtim do të bëhet duke iu referuar legjislacionit të vendeve europiane. Studimi i kornizave ligjore të këtyre vendeve do t'i paraprijë dhe do të përmirësojë situatën aktuale të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore duke e bërë këtë të fundit më produktive.

Metoda e analizës së praktikës gjyqësore është gjithashtu një metodë mjaft e rëndësishme, e cila shërben për të parë mënyrën e interpretimit dhe zbatimit praktik, që gjykatat shqiptare dhe ato të huaja i kanë bërë ekzekutimit të vendimeve. Në këtë kuadër, është marrë parasysh fakti që praktika gjyqësore shqiptare në fushën e ekzekutimit të vendimeve është mjaft e pasur, kjo duke iu referuar jo vetëm praktikës së Gjykatës së Kushtetuese, por edhe Gjykatës Europiane. Përveç jurisprudencës kombëtare, janë analizuar edhe vendime të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Analiza e praktikës së këtyre gjykatave shërben për të kuptuar më mirë institutin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, si pjesë e së drejtës për proces të rregullt gjyqësor.

Për sa u tha më sipër, është e dukshme se, nevoja për kombinimin e metodologjive të kërkimeve shkencore në fushën e së drejtës tashmë përbën një domosdoshmëri. Në këtë kuptim, punimi është bazuar në një kombinim të metodave të mësipërme kërkimore, me qëllim arritjen e rezultateve të besueshme, të përforcuara përmes zbatimit të metodologjive të ndryshme.

PARAQITJE E SHKURTËR E PËRMBAJTJES SË PUNIMIT

Në kapitullin e parë, të emërtuar “Dimensioni historik i lindjes dhe zhvillimit të institutit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor në Shqipëri”, është marrë në analizë evoluimi në periudha të ndryshme i institutit procedural të ekzekutimit të vendimit gjyqësor. E drejta shqiptare bën pjesë në sistemin e të drejtës civil laë, pasi gëzon karakteristikat e këtij sistemi. Fazat ku është ndalur trajtimi historik janë disa: faza e para është para se të krijohet shteti shqiptar, më pas ndalemi tek

periudha nga viti 1912 deri në periudhën e mbretit Zogu I duke analizuar mënyrën sesi është zhvilluar ekzekutimi i vendimit gjyqësor. Faza tjerër është ajo nga viti 1930 deri në vitin 1958 dhe më pas nga ky vit deri në vitin 1981 kur hyri në fuqi edhe Kodi në fuqi i Procedurës Civile. Pasqyrimi i tablos historike, na ndihmon të kujtojmë më mirë dispozitat aktuale procedurale të ekzekutimit dhe për të kuptuar sesi kanë evoluar ato për shkak të kushteve ekonomike-politike.

Në kapitullin e dytë, të emërtuar “*Kuadri juridik i marrëdhënies juridiko-procedurale ekzekutive*”, pasqyrohet mënyra sesi legjislacioni procedural civil rregullon marrëdhënien ekzekutive me të gjithë elementet e saj përbërëse, siç janë: objekti, subjektet, përgjegjësia, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Kuptimi i parashkrimit të së drejtës për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi gjyqësor është i rëndësishëm, pasi ndodh shpesh në praktikën gjyqësore, që palët kërkojnë zbatimin e insitutit të parashkrimit edhe aty ku ai nuk ekziston. Në këtë kapitull një vend të veçantë zënë titujt ekzekutiv, qofshin ata gjyqësor ose jo. Jam përpjekur të pasqyroj të gjitha rastet e mundshme, që përbëjnë titull ekzekutiv sipas ligjit shqiptar, duke e shoqëruar me raste të praktikës gjyqësore dhe duke arsyetuar mendimin tim për çdo rast.

Në kapitullin e tretë, të emërtuar “*Aktorët e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në fushën civile*” trajtohet një subjekt i veçantë i marrëdhënies juridiko-ekzekutive. Duke sjell në vëmendje ndryshimet që kanë ndodhur në shërbimin përmbarimor, me hyrjen në fuqi të ligjit “Për shërbimin përmbarimor privat”. Avantazhet që ka sjellë shërbimi i ri në përmirësimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Si risi e ligjit është edhe kontrata e shërbimit si dhe efektet që sjell kjo për palët në procesin ekzekutiv, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e tyre. Pjesë të këtij kapitulli janë edhe risitë dhe ndryshimet ligjore, që propozohen nga reforma në drejtësi në fushën e shërbimit përmbarimor dhe atë të ekzekutimit të vendimeve. Studimi i modeleve të shërbimit përmbarimor gjyqësor në sistemet e ndryshme europiane, pasqyron mënyrën sesi funksionojnë në shtetet përkatëse dhe sesi mund të përmirësohet modeli shqiptar.

Në kapitullin e katërt, të emërtuar “*Regjimi juridik i ekzekutimeve të veçanta të vendimeve gjyqësore*”, trajtohet një institut i së drejtës procedurale civile, ai i ekzekutimit të detyrueshëm. Ky institut është një mjet juridik, që mundëson realizimin e të drejtave të kreditorit, nëse ato nuk janë përmbushur vullnetarisht sipas përcaktimeve ligjore. Studimi i llojeve të ekzekutimit të detyrueshëm na njeh me procedurën përmbarimore, që ndiqet në secilin rast. Në këtë kapitull trajtohet koncepti i ekzekutimit mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet që personat e tretë i detyrohen debitorit, ekzekutimi i detyrimit në të holla ndaj insitucioneve buxhetore, në llogaritë bankare dhe në fusha të veçanta. Ndërsa ekzekutimi mbi sendet e luajshme dhe të paluajtshme dhe rregullat për zhvillimin e ankandit zë një vend të veçantë, pasi janë ndër rastet që zbatohen më tepër në praktikën përmbarimore dhe paraqesin vështirësi në ekzekutim. Studimi i rasteve të praktikës gjyqësore në lidhje me llojet e ndryshme të ekzekutimit të detyrueshëm, na mundëson njohjen më mirë të nocioneve dhe procedurës ekzekutive që duhet ndjekur.

Në kapitullin e pestë, të emërtuar “*Zbatimi i modelit të procesit ligjor në përmbushjen gjyqësisht të së drejtës*”, është marrë në analizë instituti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor, parë në këndvështrimin e të drejtës kushtetuese. Faza e ekzekutimit të detyrueshëm është pjesë e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Ky fakt është afirmuar fillimisht nga jurisprudenca

ndërkombëtare dhe më pas edhe nga ajo kombëtare¹. Duke analizuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese kërkojmë të nxjerrim në pah rolin që ka luajtur kjo e fundit në mbrojtjen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në rastet që lidhen me ekzekutimin e detyrueshëm. Një çështje, po aq e rëndësishme, që shtrohet për diskutim, është edhe fakti nëse ankimi në Gjykatës Kushtetuese në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor përbën një mjet ankimi efektiv në këndvështrim të nenit 13 të KEDNJ-së. Studimi i rasteve të praktikës së Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane, në veçanti për çështjet kundër shtetit shqiptar, identifikon pengesat e natyrës legislative dhe praktike, të cilat nxjerrin në pah nevojën për përmirësim të kuadrit ligjor, me qëllim harmonizimin me legjislacionin europian.

Në kapitullin e gjashtë, të emërtuar “Natyra e mjeteve të mbrojtjes në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor”, trajtohen mjetet procedurale për mbrojtjen gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Duke analizuar padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe elementet e saj, dhe duke u ndalur tek subjektet që legjitimohen për të përdorur këtë padi. Shkaku dhe objekti i kësaj padie, gjykatën kompetente për shqyrtimin e saj, llojet e pavlefshmërisë dhe dallime midis tyre. Rregulla dhe kriteret që duhet të mbahen parasysh nga palët, për të kërkuar marrjen e masës së pezullimit të ekzekutimit të vendimit, si dhe afati i ankimit ndaj vendimit përfundimtar dhe atij të ndërmjetëm. Po ashtu në analizë të veçantë merren edhe mjetet e tjera si: padia e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore dhe padia për kërkimin e sendit nga i treti, duke nxjerrë në pah dallimin midis mjeteve të mbrojtjes, si dhe rastet kur ato mund të përdoren. Për secilin nga çështjet e mësipërme është sjellë një praktikë e pasur gjyqësore e Gjykatës së Lartë dhe jo vetëm, e cila ka shërbyer si burim i rëndësishëm për njohjen më të qartë të këtyre mjeteve procedurale.

¹Raisa M. Shipping LLP kundër Romanis, Sektioni i tretë, 8 Janar 2013, Nr. 37576/05

KAPITULLI I. DIMENSIONI HISTORIK I LINDJES DHE ZHVILLIMIT TË INSTITUTIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT GJYQËSOR NË SHQIPËRI

1.1. Zhvillimi historik i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri

Legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ka njohur rrugën e vet të zhvillimit dhe të transformimit. Kjo ka ndodhur për arsye të zhvillimeve ekonomike, shoqërore e politike. Në pjesën historike të këtij punimi jemi bazuar në katër ndarje të mëdha, në lidhje me procesin e ekzekutimit. *Periudha e parë* përfshin ekzekutimin e vendimeve para vitit 1912 deri kur u shpall Pavarësia e Shtetit Shqiptar. *Periudha e dytë* përfshin veprimtarinë ligjvënëse të Qeverisë së Vlorës, Statutet e Shtetit Shqiptar si dhe veprimtarinë ligjvënëse të Mbretërisë Shqiptare, deri në periudhën e pushtimit të huaj. *Periudha e tretë* përfshin periudhën e luftës si dhe procedurën socialiste të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore deri në vitin 1996, vit në të cilin hyri në fuqi Kodi aktual i Procedurës Civile. *Periudha e fundit* përfshin ndryshimet ligjore, që kanë ndodhur nga viti 1996 e deri në ditët tona, trajtohet në të gjithë temën.

1.2. Vështrim i përgjithshëm mbi rendin juridik shqiptar me fokus të veçantë aspektin procedural të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

Shteti shqiptar me zhvillimin e tij ka zhvilluar paralelisht edhe të drejtën që e ka disiplinuar atë. Shqipëria është Republikë parlamentare. Ky parim sanksionon supermacinë e parlamentit në Shqipëri, si organ qendror në të cilin sovraniteti i popullit shprehet nëpërmjet përfaqësuesve të tij. Në nenin 4, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet nocioni i shtetit të së drejtës. “E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”, pra asgjë nuk është mbi ligjin. Shteti i së drejtës është ai që bazohet në parimin thelbësor të respektimit të ligjit, të ndarjes së pushteteve, të respektimit të hierarkisë së normave dhe pavarësisë së gjyqësorit. Sistemi ligjor shqiptar, duke qënë pjesë e formacionit të së drejtës kontinentale, hyn në grupin e familjes së *Civil Law*, e cila karakterizohet nga kodifikimi i së drejtës.

Shteti i së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në zbatim urdhërimet ose vendimet gjyqësore të formës së prerë². Në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, përbën një element të rëndësishëm të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi. Një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë³. Prandaj reformimi i mëtejshëm i sistemit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ka një rëndësi të madhe për mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë.

² Shihni vendimin e GJEDNJ *Hasan dhe Chaus kundër Bullgarisë* Nr. 30985/96

³ Shihni vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.6, datë 31.03.2006

1.3. Instituti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor para vitit 1912

Në këtë periudhë nuk mund të flasim për ekzistencën e një sistemi procedural civil shqiptar dhe në veçanti për një procedurë ekzekutimi në zbatimin e tij. Kjo pasi territori shqiptar ka qenë i pushtuar nga pushtuesi osman dhe për rrjedhojë zbatohet ligji osman. Në kushte të tilla ka qenë i pamundur konsolidimi i shtetit të pavarur shqiptar dhe për rrjedhojë edhe i legjislacionit të shkruar shqiptar. Ajo që përbën karakteristikë të qëndresës së shqiptarëve ndaj pushtuesve, është rezistenca për t'iu nënshtruar administratës shtetërore të huaj. Më së shumti kanë qenë qytetet e mëdha ato që detyroheshin të zbatonin të drejtën e huaj dhe t'i nënshtroheshin juridiksionit të gjykatave të huaja. Krahas procedurave gjyqësore të huaja, më tepër në pjesën e qyteteve, në zonat rurale dhe në malësinë shqiptare ka vepruar kryesisht e drejta zakonore me normat e saj materiale dhe procedurale. Veprimi i kësaj të drejte shfaqet si një qëndresë e popullit shqiptar ndaj të huajve dhe sundimit të tyre, me qëllim mos asimilimin e tyre⁴.

Në tërësinë saj e drejta zakonore shqiptare, pasqyron treguesit e zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore e ekonomike shumëvjeçare të popullsisë shqiptare e cila në atë kohë ishte e organizuar në fise, bajraqe, pashallëqe, krahina e principata. "E drejta zakonore shqiptare është një e drejtë popullore e pashkruar, e transmetuar brez pas brezi nga traditat gojore, e cila ka shërbyer për rregullimin e marrëdhënieve juridike gjatë shekujve në vendin tonë". Madje shpeshherë zbatimi i kësaj të drejte është njohur ligjërisht edhe nga administrata e huaj. Mungesa e pushtetit qendror dhe e të drejtës së shkruar, për një kohë të gjatë ka kushtëzuar krijimin e normave të sjelljes apo normave zakonore (*dokeve*), të cilat në kushtet konkrete që kanë ekzistuar e funksionuar, kanë rregulluar marrëdhëniet shoqërore në atë kohë. Gjatë kësaj periudhe janë aplikuar sipas njësive të organizimit shoqëror e zonave të caktuara të banimit, norma zakonore. Këto norma janë emërtuar si kanune dhe si të tilla mund të përmendim: Kanuni i Lekë Dukagjinit, i Skënderbeut, i Labërisë. Organet që njiheshin nga kjo e drejtë kishin emërtime të ndryshme si Gjyqi i pleqve, Kuvendi, Pleqësia, Gjivari. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit njihet si organ gjyqësor *Këshilli i Pleqve* ose *Pleqësia*, e cila përbëhej nga krerët e fiseve si dhe njerëz të ndershëm të asaj zone, ose krahinës. Në Këshillin e pleqve merrnin pjesë vetëm burra në moshë madhore⁵, të cilët ishin njerëz të njohur për dije të thella mbi zakonet. Ata i shqyrtonin çështjet me dëgjimin e përfaqësuesve të palëve e më pas propozonin një zgjidhje të përshtatshme sipas rëndësisë së mosmarrëveshjes. Sipas mendimit të asaj kohe, gratë e të rinjtë nuk mund të pleqnojnë, apo gjykojnë drejt. Pleqësia kishte karakter patriarkal e fisnor, ajo gjykonte çështje pa procedurë formale, por sipas një riti të trashëguar në breza. I gjithë ky proces bëhej pa rregulla të përcaktuara, ai ishte verbal (i pashkruar) edhe vendimi nga pleqësia jepej me gojë. Ndaj vendimeve të pleqësisë nuk kishte dhe nuk parashikohej mjet ankimi, ai ishte i ekzekutueshëm menjëherë pas shpalljes së tij⁶.

Krahas dhënies së vendimit këto organe kishin detyrë edhe ekzekutimin e tij. Duke analizuar një sërë institutesh origjinale si ai i Besës, shkëlja e së cilës sillte pasoja të rënda për shkelësin,

⁴ Koço Nova, *Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri*, Botim i UT Fakulteti i shkencave politike e juridike, viti 1982, faqe 14

⁵ Koço Nova *E drejta zakonore shqiptare* pjesa I, botim i vitit 1989, fq. 5

⁶ Paragrafi i nenit 1002 të K.L. Dukagjinit. që *plak mbi plak, gjyqë mbi gjyqë dhe be mbi be nuk mund të ketë*

arrijmë në përfundimin se në këtë periudhë e drejta zakonore e bazonte ekzekutimin më tepër në vullnetin e palëve⁷.

Mjete për ekzekutimin e vendimit ishin karakteristikë, kështu përmendim se palët ndërgjyqëse dorëzonin përpara se të fillonte gjyqi, objekte të një rëndësie shumë të madhe për nderin e shqiptarit si armët apo kutinë e duhanit⁸. Me këtë veprim ato tregonin bindjen e tyre ndaj vendimit të dhënë. Në rast se pas dhënies së pengut, palët nuk e zbatonin vendimin, atëherë Kuvendi mblidhej sërish për ta detyruar atë me lëçitje apo kseniti⁹ dhe në disa raste parashikohej edhe masa e dënimit me vdekje.

Organet e ngarkuara me vënien në ekzekutim të vendimeve ishin të ndryshme sipas kanuneve që vepronin në krahina të caktuara. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit vendimet zbatoheshin nga gjobtarët, të cilët ndihmoheshin në veprimet e tyre dhe nga anëtarët e fshatit. Gjobtarë kishin të drejtë të përdornin edhe forcën për të marrë pasurinë e luajshme të debitorit¹⁰, kjo, pasi pasuria e paluajshme nuk mund të prekej duke qenë në bashkësi të fisit. Këto norma juridike (ndonëse në shumicën e tyre të pashkruara) të vendosura nga pleqtë jo vetëm janë trashëguar brez pas brezi, por ato kanë evoluar në raport me kushtet historike, ekonomike e shoqërore. E drejta zakonore nuk është veçori vetëm e popullit tonë por edhe popujve të tjerë të Europës e më gjerë.

1.4. Instituti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor nga viti 1912 deri në vitin 1929

Pas pushtimit turk, ashtu si në të gjithë Perandorinë Osmane edhe në Shqipëri u vendos dhe fillojë të funksionojë e drejta e sheriatit, si pjesë e së drejtës islame e cila e kishte burimin e saj në Kur'an, Ixhma dhe Hadith. Normat e sheriatit mbështeteshin në ideologjinë fetare islame. Legjislacioni osman konsiderohej nga pushtuesi si shprehje e vullnetit të zotit. Ky legjislacion vazhdoi të funksiononte deri në fund të shekullit të 19-të, edhe në kohën e pashallëqeve të mëdha si ai i Shkodrës, Janinës. “Edhe pas ligjësimit të Pashallëkut të Janinës nga Ali Pashë Tepelena (1788) nuk u prek organizimi i drejtësisë, por zbatoheshin sheriatit dhe kanunametë si dhe kishte të drejtën e rishikimit të vendimeve gjyqësore, të shqyrtonte dhe zgjidhte vetë edhe kryesisht konfliktet civile e penale.”¹¹

Shpallja e pavarësisë më 28.11.1912, shënon një periudhë të rëndësishme, atë të formimit dhe konsolidimit të shtetit Shqiptar po ashtu edhe të rendit juridik. Bashkë me të edhe ngritjen e

⁷ Koço Nova, Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri, Botim i UT Fakulteti i shkencave politike e juridike, viti 1982, faqe 17

⁸ Paragrafi i 1022 i K.L. Dukagjinit *Per peng xehet arma, fisheku, ortari a edhe kutija e duhanit, një qi të biejn pëgjjet, qi t'i parasohen vjeftjes, per të cillen kapen*, <https://dl.dropbox.com/u/1401395/Libra%20lexoj.com/kanuni%20i%20lek%20dukagjinit.pdf>. aksesuar në datën 15.11.2015

⁹ Term i përdorur në Labëri për të treguar dënimin e një personi. Dënim që konsistonte në largimin e përjetshëm nga fshati të të dënuarit ose të gjithë familjes së tij.

¹⁰ Paragrafi i 1171 i K.L. Dukagjinit *Giobtarë thirren ata, të cillt nemen të kuvendit mbarë reshten në vath të gjâs së të giobitunit, per të mârrë aq krenë desh a qe si mbas të premes së gjygit të krenvet, të Pleqvet, e të Vogjilis*. Paragrafi i 1172 *“I zoti i vathit nuk guxon me i ndalë giobtarët qi mos t'i hijn në vath. Paragrafi. 1173. Po bani kët pûnë, burrat e kuvendit dynden të gjithë edhe i brumbullaksohen në derë*

¹¹ Ismet Elezi *E drejta zakonore e labërisë...* botim i sipërcituar, fq. 41

një legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, mënyrat e ekzekutimit të tyre si dhe institucionet përkatëse.

Kjo periudhë mund të ndahet në disa etapa, që u pasuan nga ndryshime të njëpasnjëshme: *Së pari* nga viti 1921 deri në 1925 është periudha e Kongresit të Lushnjës, që u pasua me miratimin e Statutit të Lushnjës dhe më pas me aktin e zgjerimit të tij; *Së dyti* nga viti 1925 deri në 1928, periudha e Republikës, në të cilën ndodhi Revolucioni i Qeshorit dhe më pas ardhjen në fuqi të Ahmet Zogut; *Së treti* nga viti 1928 deri në 1939, periudha e Monarkisë, periudhë në të cilën Shqipëria u shpall Monarki deri në pushtimin e saj.

Nisur nga kushtet e vështira në të cilat u shpall pavarësia e shtetit Shqiptar, qeveria e Vlorës me ligjin datë 13.05.1913 “Për organizimin gjyqësor” (Kanuni i zhurisë) dhe me akte të tjera qeveritare, vendosi ngritjen dhe organizimin e gjykatave. Këto gjykata kishin kompetencë gjykimin e çështjeve civile e penale dhe vepronin në çdo nënprefekturë (si gjykata të shkallës parë)¹². Gjykatat vazhduan të ndiqnin rregullat e organizimit gjyqësor të Perandorisë Osmane dhe zbatonin ligjet materiale e procedurale turke¹³. Në kanunin e dëmeve, parashikohej procedura që duhej ndjekur në rastet e dëmeve të shkaktuara dhe masat që merreshin në këtë rast si dënim dhe mënyra e zbatimit të tij. Të gjitha statutet shqiptare nga viti 1914 e deri në vitin 1928 si dhe ligjet organike të pushtetit gjyqësor e lidhin përmbarimin me gjykatën.

Historiku i krijimit të shërbimit të përmbarimit gjyqësor privat, si aktivitet funksional, daton që në vitin 1915, dy vite pas krijimit të shtetit shqiptar. Përgjatë viteve, 1915-1917-1922-1924-1925-1928, aktiviteti përmbarimor privat dokumentohet në shumë shkresa (të ruajtura deri sot nga arkiva e shtetit), si një veprimtari, që zhvillohej nga një zyrë e posaçme, e cila i drejtohej Ministrisë së Drejtësisë së asaj kohe me terminologjinë: “përmbarimi paguhet nga të interesuarit dhe jo nga arka e shtetit”¹⁴.

1.5. Instituti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor në vitet 1930 – 1958

Në këtë periudhë vazhdoi të zbatohet Procedura Civile Otomane, e cila nga ana e saj ishte bazuar mbi atë franceze, e përkthyer në shqip në vitin 1923 prej avokateve Dh. Kacimbra dhe K. Tasi, me porosi të Ministrisë së Drejtësisë¹⁵. Procesi i shkëputjes, nga rregullimet sipas legjislacionit tashmë të vjetëruar otoman, vijoi duke u intensifikuar akoma edhe më shumë gjatë periudhës së Monarkisë. Kështu një “risi ligjore”, nëse mund të quhej për kohën një moment i tillë, ishte miratimi më datë 1 Prill 1929 i Kodit Civil, sic u emërua më vonë dhe që njihet edhe sot si Kodi Civil i Zogut.

Procesi i përshtatjes dhe i ndryshimeve të legjislacionit nuk la jashtë dhe aspektin procedural të aplikimit të ligjeve të reja materiale. Për të evituar mangësitë dhe aplikimin praktik

¹²Irakli Nocka *Gjyqtarët e Shqipërisë gjatë gjysmëshekullit* Drejtësia Popullore Nr 5, botim i vitit 1962, “U vendos që gjykimet të bëhen në gjuhën shqipe, pavarësisht se ky vendim nuk u zbatua menjëherë për shkak të mos njohjes së gjuhës shkruar shqipe nga ana e gjyqtarëve, kadive”.

¹³Nonda Papuli *Organizimi i shtetit të parë shqiptar* Drejtësia Popullore, Nr 5, botim i vitit 1962, fq. 32.

¹⁴<http://www.nchb.al/historiku-2/> aksesuar për here të fundit në datën 02.07.2016

¹⁵Eriol Roshi *Titujt ekzekutivë dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile*, 2005, fq. 36.

që shfaqti me hyrjen në fuqi shtojca e parë, solli si produkt shtojcën e dytë të Kodit të procedurës civile, e miratuar në vitin 1929. Në këtë mënyrë vazhdon procesi i miratimit të ligjeve të tjera me këndvështrim perëndimor në fushën procedurale civile.

Kreu IX i Procedurës Civile Otomane rregullon procedurën e ekzekutimit për shlyerjen e një detyrimi në të holla. Sipas dispozitave të këtij kreu, kreditori që kishte dokumenta dhe vërtetonin detyrimin e debitorit ndaj tij, kishte të drejtë të kërkonte vendosjen e sekuestros mbi pasurinë e debitorit për efekt të shlyerjes së kredisë. Sipas nenit 273, që të zbatohet ekzekutimi i sekuestros, duhet të plotësoheshin disa kushte si: *shuma e debisë apo detës të ishte e ditur, t'i përkiste personit të kreditorit, të ishte e papretendueshme dhe të mos varej nga ndonjë konditë*. Sekuestroja vendosej me letër të shkruar të gjykatës në bazë të letër kërkesës së paraqitur nga kreditori. Ky i fundit duhet të jepte garanci për pretendimin e tij nëpërmjete dorëzanësit. Ligji u jepte fuqi ekzekutive vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pasi parashikonte se garancia nuk kërkohej kur pretendimi i tij bazohej në një vendim të ekzekutueshëm.

Në ndryshimet që pësoi ligji procedural otoman mund të përmendim neni 274 i Shtojcës së Parë, i cili parashikonte sendet që nuk mund të sekuestroheshin. Në veçanti ndalohej sekuestrimi i shtëpisë së banimit të debitorit dhe tokës së nevojshme për mbajtjen e familjes¹⁶. Sipas nenit 296 të Shtojcës së Parë, mund të sekuestrohej edhe sendi mbi të cilin ishte vënë peng për garantimin e detyrimit me kusht që, nga shitja e tij të shlyhej fillimisht gjithë kredia e siguruar dhe më pas kreditorët e tjerë.

Ndërsa në ndryshimet që solli Shojca e dytë për procedurën civile mund të përmendim kreun XXI që parashikon “Cpronësimi i forcuem i pronave, shkallësimi dhe distribuimi i cmimit midis kreditorëve”, i cili detajoi rregullat për zhvillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrimeve në të holla.

Përpara se të fillonte shpronësimi duhej, që përmbaruesi t'i drejtohej debitorit me një paralajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin. Parashikohej që *ky lajmërim të transkriptohej në regjistrin e hipotekave të vendit, ku do të zhvillohej ankandi*. Nga data e transkriptimit të lajmërimit, debitori ndalohej, që të tjetërsonte sendin dhe frytet e tij. Këto sende *mbeteshin në posedim të debitorit, i cili konsiderohej sekuestratar gjyqësor*. Veprimet e administrimit mbi sendin do të kryheshin vetëm me autorizim të kryetarit të përmbarimit¹⁷. Para se të bëhej shitja në ankand, duhet që kreditorëve që kanë kërkuar shpronësimin, t'u bëhet komunikimi në banesat e tyre. Pas shpalljes për zhvillimin e ankandit duhet të kalojë 30 ditë. Kushdo kishte të drejtë për të marrë pjesë në ankand me kusht, që të depozitonte shumën e përafërt të shpenzimeve të ankandit dhe të transkriptimit si dhe një garanci prej 10% të çmimit fillestar. Në rastin kur disa kreditorë kërkojnë shpronësimin e detyruar, *do të veprojë instituti i njohur i shlyerjes më parë i kredive të privileguara ose atyre të preferueshme*. Këtë proces ligji e quan “*bashkëvuejmë*”.

Një ndryshim të madh solli edhe hyrja në fuqi e Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare, i cili parashikonte se: *vendimet e gjyqeve nuk mund të ndryshohen dhe ekzekutimi i tyre nuk mund*

¹⁶Neni 271-296 Shtojca e Parë e Procedurës Civile

¹⁷Nenet 435-445 të Shtojcës së Dytë të procedurës civile

*të ndalohet ose të pezullohet prej asnjë pushteti tjetër, qoftë Legjislativ ose Përmbartues*¹⁸. Nga dispozita e mësipërme kujtojmë rëndësinë e veçantë që ka ruajtja e qëndrueshmërisë juridike të marrëdhënieve juridiko-shoqërore dhe në veçanti ekzekutimi i vendimeve, si pjesë integrale e këtyre të fundit. Në këtë mënyrë ndryshimet bëhen vetëm për rastet dhe mënyra të parashikuara prej vetë këtij Statuti.

Përsa i përket ligjit të përmbartimit gjatë mbretërisë së Zogut, u bë një përmirësim me dekret ligjin mbretëror të datës 09.08.1937¹⁹, në nenin 4 të tij parashikohet se titujt përmbartimore, përveç vendimeve gjyqësore, janë edhe aktet, të cilave ligji iu atribuon karakter ekzekutiv si dhe aktet kontraktuale të marra prej një noteri ose nëpunësi tjetër i autorizuar ligjërisht për marrjen e tyre. Në shtojcën e dytë neni 10, përcaktohen kushtet që një detyrim të jetë i ekzekutueshem: ai duhet të jetë i saktë dhe i likuidueshëm. Ndërsa sipas nenit 16 në rastin e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor njoftohet gjyqumbësi nga ftuesi i gjykatës dhe ky i fundit duhet të merrte një dëftese nga debitori. Pasi kjo dëftese vërtetohet nga sektretari i gjykatës, kreditori mund të vinte në ekzekutim vendimin, në të kundërt nëse nuk bëhet njoftimi si më sipër, vendimi mbetet i paekzekutuar.

Gjatë periudhës së luftës në zonat e pushtuara vepron e njëjta procedurë civile si në kohën e Zogut. Ndërsa në zonat e çliruara vepronin Këshillat Nacional Çlirimtare. Drejtësia penale ishte kompetencë e gjyqëve partizane, ndërsa ajo civile mbeti kompetencë e pandarë e këtyre këshillave. Sipas urdhërit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të Shqipërisë, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të këshillave, përcaktohet se, mosmarrëveshjet civile janë në kompetencë të këshillave nacionaleçlirimtare. Komanda e qarkut dhe të rrethit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet e tyre²⁰. Si organe përmbartimore të viteve 1944-1951, konsideroheshin seksionet e drejtësisë, të krijuara nga qarkoret e organeve të reja të pushtetit popullor. Këto seksione natyrisht, nuk kryenin veprimtari të mirëfilltë përmbartimore, por zgjidhnin vetëm problemin e rivendosjes në posedim²¹.

1.6. Instituti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor në vitin 1958 – 1982

Pas çlirimit, ligjet e mëparshme e humbën fuqinë detyruese dhe mund të shërbenin vetëm si bazë për dhënien e drejtësisë për atë që nuk u kundërviheshin frymës së re demokratike²². Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore filloi të qartësohet vetëm pas daljes së Kodit të Procedurës Civile të vitit 1958. Pavarësisht se ky është një Kod i periudhës së socializmit dhe ka një ndikim ideopolitik, është një ligj mjaft i plotë dhe cilësor në fushën e ekzekutimit të vendimeve. *Nëse krahasojmë institutet proceduriale që ai parashikon me ato të kodit aktual, do të konstatohet një*

¹⁸Art 118 i Statusit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare

¹⁹Dekret ligjin mbretëror të datës 09.08.1937 “Mbi Përmirësimin e disa dispozitave të Procedurave dhe Ligjës së Përmbartimit në Fuqite”

²⁰ Koço Nova, “Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri”, Botim i UT Fakulteti i shkencave politike e juridike, viti 1982, faqe 104

²¹ <http://www.nchb.al/historiku-2/> aksesuar në datën 23.02.2016

²² Ligji nr.61 date 17.05.1945, gazeta zyrtare nr.12 date 22.05.1945

përputhje e plotë. Në disa aspekte Kodi i vitit 1958 paraqitet më i qartë në formulim dhe në përmbajtje.

Përsa i përket procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, të parashikuar prej tij nuk ka ndonjë shmangie të rëndësishme me procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm, aktualisht në fuqi. Lista me titujt ekzekutiv e parashikuar nga neni 365 i Kodit është pak a shumë e njëjtë me nenin 510 të Kodit aktual. Dallimi i vetëm qëndron në faktin se në Kodin e vitit 1958, parashikohej një procedurë ekzekutimi i një detyrimi të veçantë për të liruar një banesë të dhënë me qira.

Duke qënë se shumica e popullsisë në këtë periudhë jetonin si qeramarrës në banesat shtetërore, ishte parashikuar edhe kjo situatë. Kështu nëse gjykata zgjidhte kontratën e qerasë, me të marrë formë të prerë vendimi, përmbaruesi gjyqësor i drejtonte një kërkesë Komitetit Ekzekutiv për t'i siguruar qeramarrësit debitor një banesë tjetër, jo më vonë se një vit. Nga momenti që kjo banesë gjendej, përmbaruesi gjyqësor lajmëronte me shkresë qiramarrësin për të liruar banesën brenda 10 ditëve. Në të kundërt veprohej si për rastin e lirimit të sendit të paluajtshëm. Kur banesa e re ishte e papërshtatshme, kishte të drejtë që të paraqiste ankim në gjykatë në formën e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore.

Përsa i përket pozitës së përmbaruesit gjyqësor, neni 27 i ligjit Nr.4406 datë 24.06.1968 “Mbi organizimin gjyqësor”, përcakton se ai i ushtron detyrat e tij pranë gjykatës se rrethit nën kontrollin e kryetarit të gjykatës, duke zhdukur kështu tërësisht autonome procedurale të një përmbaruesi gjyqësor. Përmbaruesi gjyqësor ushtron një sërë detyrash si: dërgon lajmërimin debitorit me kërkesat përkatëse, fillon sekuestrumin e sendeve të luajtshme e të paluajtshme. Ai mban procesverbal për inventarizimin e sendeve të luajtshme, zhvillon procedurat për shitjen e sendeve në ankand, ekzekuton kreditë që personat e tretë kanë ndaj debitorit etj. Përveç tyre përmbaruesi vendos pezullimin ose pushimin e ekzekutimit. Funkzioni i tij është ekzekutimi i titujve dhe këtë detyrë duhet ta bëjë më objektivitet duke respektuar me përpikmëri afatet ligjore të përcaktuara në kod. Debitori është subjekti, që ka detyrimin për të dhënë dicka, për të kryer një veprim, për të paguar një shumë të hollash, kundrejt kreditorit. Kreditori vë në lëvizje gjykatën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit dhe përmbaruesin për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Një subjekt tjetër që mund të vërë në lëvizje përmbaruesin, ishte dhe prokurori për çështje, të cilat ka ngritur ose mund të ngrinte padi.

Në vitin 1981, u miratua Kodi i dytë i Procedurës Civile i periudhës së socializmit. Ky Kod i jepte një rol tepër aktiv gjykatës në hetimin gjyqësor. Përsa i përket ekzekutimit të detyrueshëm, në të nuk përcaktohet se cilët janë titujt ekzekutiv, nuk njihet instituti i ekzekutimit të përkohshëm etj. Në asnjë dispozitë të kreut 16 për ekzekutimin e detyrueshëm nuk përcaktohen në mënyrë eksplicite kategoritë e titujve ekzekutiv siç përcaktoheshin në Kodin e Procedurës Civile të vitit 1958 dhe atë që është aktualisht në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Dispozitat ligjore përcaktojnë se të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm e kanë këto subjekte: personi i interesuar ose kreditori; prokurori në çështjet në të cilat ka ngritur padi, në rast se detyrimi nuk është përmbushur vullnetarisht; përmbaruesi gjyqësor në rastet kur janë kreditorë ndërmarrjet, institucionet, kooperativat bujqësore ose organizatat shoqërore²³.

²³ Neni 192 i Kodit të Procedurës Civile i vitit 1981

Ligjvënësi parashikon që të bëhen përpjekje për ekzekutimin vullnetar të detyrimit nga debitori (kërkohet ndihma e këshillave popullorë dhe e organizatave shoqërore më qëllim përmbushjen e detyrimit). Përmbaruesi gjyqësor përveç detyrave procedurale si inventarizimi i sendeve të paluajtshme, ekzekutimi mbi sendet në bashkëpronësi apo i pagave të punëtorëve mund të marrë edhe masa administrative si vendosja e gjobës²⁴.

Një tjetër subjekt që del në pah në fazën e ekzekutimit është prokurori. Ky i fundit del si subjekt në këtë fazë të gjykimit, siç parashikohet në nenin 192 në tre momente të rëndësishme. Si legjitimues në vënien në lëvizje të fazës së ekzekutimit; si subjekt, ankimi ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor sjell automatikisht pezullimin e ekzekutimit²⁵; si kontrollues i ligjshmërisë së ekzekutimit të vendimeve²⁶.

²⁴Neni 213 i Kodit të Proçedurës Civile i vitit 1981 parashikon marrjen e mases se gjobes ndaj: a) nënpunësit te ndërmarrjes, institucioneve, kooperativave bujqësore, organizatave shoqerore kur nuk zbatojnë urdhrin e përmbaruesit gjyqësor për të bërë ndalesën në pagën e debitorit, kur nuk njoftojnë largimin nga puna të debitorit dhe nuk lajmërojnë qendrën e re të punës së debitorit për të vazhduar ndalesat për shlyerjen e detyrimit; b) personit të detyruar me vendim gjyqësor, i cili kryen të kundërtën e asaj që me vendim është i detyruar të bëjë; c) personit te detyruar me vendim gjyqësor i cili nuk kryen veprimet që është i detyruar të kryejë vetëm ai.

²⁵Neni 216 i Kodit të Proçedurës Civile i vitit 1981

²⁶Neni 219 i Kodit të Proçedurës Civile i vitit 1981

KAPITULLI I II. KUADRI LIGJOR I MARRËDHËNIES JURIDIKO-PROCEDURIALE EKZEKUTIVE

2.1 Kuptimi i marrëdhënies juridiko-procedurale ekzekutive dhe elementet e saj

Në procesin gjyqësor civil bëhet njohja ose saktësimi i së drejtës së cënuar, nëpërmjet provave që paraqiten përpara një organi të pavarur, të ngarkuar nga ligji për dhënien e drejtësisë, duke synuar vërtetimin e ekzistencës së një të drejte ose një marrëdhënie juridike. Kjo fazë e parë quhet ndryshe faza deklarative ose njohëse e së drejtës. Ndërsa faza ekzekutive është faza e dytë, në të cilën nevojitet ndërhyrja me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor. Në këtë fazë, e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë²⁷.

Në këtë kuptim gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, pra vetëm me dhënien e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë. I gjithë procesi gjyqësor shpeshherë i vështirë e problematik nuk do të kishte vlerë nëqoftëse nuk do të pasohej nga një proces, që lidhet drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e organeve të përmbarimit, me ekzekutimin e vendimit, ose të realizimit të së drejtës së fituar.

Ky është rasti i zakonshëm, kur faza e parë pason fazën e dytë, por kur vendimi gjyqësor ka karakter thjesht njohës dhe jo detyrues, atëherë në këtë rast nuk do të pasohet nga një fazë e dytë ekzekutive, pasi për këto vendime nuk lëshohet urdhër ekzekutimi. Ka raste kur faza e parë është eliminuar nga legjislatori, dhe në këtë mënyrë kalohet menjëherë në fazën ekzekutive, siç janë rastet e akteve noteriale për pagimin e kredisë bankare, ose rastet e faturave të energjisë elektrike dhe faturave të ujit të pijshëm.

Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet që individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Prosesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces²⁸. Rregullimi i marrëdhënieve juridike procedurale gjyqësore, si për fazën e njohjes së të drejtës, ashtu edhe për fazën e ekzekutimit të saj, është bërë nëpërmjet një ligji të përforcuar.

Gjatë vënies në ekzekutim të një titulli ekzekutiv, lind një marrëdhënie juridiko-procedurale midis titullarit të së drejtës materiale, që i është njohur nga titulli ekzekutiv dhe atij që ka shkelur ose mohuar të drejtën që të përmbushë detyrimin që përmban titulli ekzekutiv, duke siguruar kështu respektimin e ligjit dhe rivendosjen në vend e së drejtës së shkelur ose të mohuar²⁹. Kjo marrëdhënie juridike quhet marrëdhënia juridike procedurale ekzekutive.

²⁷ Vendimi Nr.28, date 19.05.2016 i Gjykatës Kushtetuese paragrafi 18

²⁸ Vendimi Nr.12, date 16.04.2013 i Gjykatës Kushtetuese

²⁹Alqiviadh Lamani *E drejta procedurale civile e R.P.Sh-së*, Tiranë 1961

Krijimi i marrëdhënies juridike të ekzekutimit të detyrueshëm kërkon të ekzistojnë njëherazi disa elementë juridikë dhe faktikë, në mënyrë që të kënaqë interesat e ligjit. Marrëdhënia juridike procedurale ekzekutive ka elementet e saj, të cilat janë: *subjekti, objekti dhe përmbatja*. Subjekte të kësaj marrëdhënie janë: *përmbaruesi gjyqësor shtetëror ose privat*, të cilin ligji e ka ngarkuar me detyrën e ekzekutimit të titullit të ekzekutimit. Subjekte të tjerë janë edhe kreditori dhe debitori. Kreditori është personi në favor të të cilit është dhënë titulli ekzekutiv dhe në favor të të cilit do të kryhet ekzekutimi, ndërsa personi ndaj të cilit kryhen të gjitha veprimet e ekzekutimit quhet debitor. Koncepti i kreditorit dhe debitorit në marrëdhënien e ekzekutimit nuk përputhen gjithmonë me konceptin e paditësit dhe të paditurit, në procesin e gjyqimit të padisë. Duhet theksuar se palët pjesëmarrëse në këtë marrëdhënie duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme për të qenë palë, si *zotësia juridike* dhe *zotësia procedurale* për të vepruar.

Përveç subjekteve të sipërpërmendur, gjatë kësaj marrëdhënieje mund të marrë pjesë edhe gjykata, e cila vihet në lëvizje nga pala kreditore për të lëshuar urdhërin e ekzekutimit, ose kur kontrollon ligjshmërinë e veprimeve, ose mosveprimeve përmbare, duke luajtur rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit ekzekutiv. Në ato raste kur pala debitore vdes, si subjekt thirren trashëgimtarët e tij ligjorë, të cilët marrin përsipër po ato të drejta dhe detyrime që kishte pala debitore brenda kufijve të pasurisë trashëgimore që kanë trashëguar. Si subjekt i kësaj marrëdhënie mund të jetë edhe blerësi i sendit të shitur gjatë procedurës së ankandit ose personi i tretë, i cili pretendon pronësinë e sendit të sekuestruar. Po ashtu, punëdhënësi i palës debitore mund të bëhet subjekt i marrëdhënies ekzekutive, nëse me veprimet ose mosveprimet e tij bëhet shkak për moszekutimin e urdhërit për ndalimin e pagës së palës debitore.

Objekt i marrëdhënies ekzekutive, është detyrimi i parashikuar në titullin ekzekutiv, qoftë ky një vendim gjyqësor i formës së prerë, ose titull tjetër ekzekutiv i parashikuar si i tillë në Kodin e Procedurës Civile. Pra përbënë objekt, ajo e drejtë që duan të materializojnë palë që kanë hyrë në këtë marrëdhënie. Si objekt të marrëdhënies ekzekutive mund të përmendim: *detyrimi për të liruar dhe dorëzuar sendin, detyrimi për të kryer një veprim të caktuar, detyrimi për të paguar pensionin ushqimor, detyrimi për të paguar dëmshpërblimin e pagës*.

Përmbatja e marrëdhënies përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet e palëve pjesëmarrëse në procesin ekzekutiv, të cilat parashikohen në K.Pr.Civile. Si të tilla mund të përmendim të drejtat e palës kreditore: e drejta e kreditorit për të kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, pasi gëzon të drejtën e disponibilitetit gjatë kësaj marrëdhënieje, *e drejta për të kërkuar vënien në ekzekutim të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, e drejta për t'u informuar mbi procedurën përmbare, e drejta për t'u ankuar ndaj vendimeve të përmbaruesit gjyqësor në rastin e pushimit ose pezullimit, e drejta për të hequr dorë pjesërisht ose tërësisht nga ekzekutimi ose ka të drejtë të shtyjë ekzekutimin për një kohë tjetër*.

Ndërsa, si palë e kësaj marrëdhënieje, edhe debitori ka të drejtat e veta: e drejta e debitorit që të kërkojë të njihet me çdo veprim të përmbaruesit gjyqësor, e drejta e ankimit për të kundërshtuar veprimin përmbare ose për të kërkuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv si dhe e drejta për të kërkuar përjashtimin e sendeve ndaj të cilave nuk mund të vendoset sekuestro. Po ashtu edhe përmbaruesi ka të drejta dhe detyrime, të cilat duhet t'i zbatojë gjatë punë së tij: e

drejta e përmbaruesit për të filluar ekzekutimin e detyrueshëm kur është përmbushur afatit ligjor sipas 517 dhe 518 të K.Pr.Civile, e drejta për të kërkuar ndalimin e pagës së palës debitore në mbështetje të nenit 533 K.Pr.Civile duke respektuar minimumin jetik, e drejta e përmbaruesit të këshillojë palën kreditore për pasojat juridike që rrjedhin nga veprimet procedurale, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre, detyrimi i përmbaruesit të njoftojë palën debitore dhe kreditore brenda afatit ligjor, me qëllim që të respektohet e drejta e ankimit brenda pesë ditësh nga marrja në dijeni.

Pjesë e marrëdhënies ekzekutive është edhe gjykata, e cila është prezente jo vetëm gjatë fazës së lëshimit të urdhërit të ekzekutimit, por ndërhyt edhe gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm duke mbikëqyrur veprimtarinë e përmbaruesit gjyqësor. Gjykata mund të bëhet përcaktuese edhe gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit³⁰, si dhe nëpërmjet caktimit të përfaqësuesit të palës debitore³¹.

2.1.1. Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit dhe ndryshimet që ka pësuar praktika gjyqësore

Ligji parashikon, se titulli ekzekutiv që të ekzistojë si i tillë, duhet të jetë i padyshimtë për nga të drejtat, që i jep kreditorit dhe që ligji duhet ta njohë cilësinë e “titullit ekzekutiv”. Në këtë kuptim juridik, titulli ekzekutiv është akti përfundimtar që përmban njohjen e detyrimit të plotë, të saktë, të përcaktuar të një personi apo subjekti kundrejt një tjetri sipas parashikimeve të ligjit³². Në nenin 510 parashikohen në mënyrë listuese dhe referuese, se cilat akte në Republikën e Shqipërisë gëzojnë cilësinë e titullit ekzekutiv.

Që marrëdhënia juridiko-procedurale e ekzekutimit të marrë jetë, duhet të ekzistojë një titull ekzekutiv, për të cilin të jetë lëshuar një urdhër ekzekutimi³³. Ligji parashikon edhe disa raste³⁴, kur nuk lëshohet urdhëri i ekzekutimit . Si të tillë mund të përmendim: vendimi për sigurimin e padisë, vendimi për gjobot e dhëna nga gjykata³⁵, vendimin për nxjerrjen e detyrueshme të shpenzimeve³⁶ si dhe vendimet e dhëna me ekzekutim të përkohshëm, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejtë nga zyra e përmbarimit, pas njoftimit të vendimit. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastin e ekzekutimit të vendimit të ndërmjetëm të gjykatës, i cili ka për qëllim të detyrojë palën ndërgjyqëse ose një person të tretë, përfshi këtu edhe ndonjë organ të administratës shtetërore, për paraqitjen e një prove të caktuar në gjykim³⁷ ose ekzekutimin e vendimit të

³⁰ Shiko nenin 313 të K.Pr.Civile, i cili parashikon: *Kur vendimi përmban detyrimin për dorëzimin e një sendi në natyrë ose detyrimin për kryerjen e një veprimi të caktuar, gjykata mund të tregojë në vendim afatin për ekzekutimin e vendimit. Gjykata mund të caktojë një afat për ekzekutimin e detyrimit në të holla ose ta ndajë atë me këste, me kërkesën e palës së interesuar, duke pasur parasysh gjendjen pasurore të palëve dhe rrethanat e tjera të çështjes.*

³¹Shiko 522 të K.Pr.Civile

³²Vendimi nr.169, date 05.03.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

³³Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.458, datë 11.09.2014

³⁴ Shih nenin 511/2 i K.Pr.Civile

³⁵ Shih nenin 167 të K.Pr.Civile

³⁶ Shih nenin 105/2 i K.Pr.Civile

³⁷ Shih neni 223 i K.Pr.Civile

gjykatës për dorëzimin e sendit ose kryerjen e veprimit³⁸. Ky vendim është i zbatueshëm drejtpërsëdrejti, ndonëse nuk është parashikuar shprehimisht si titull ekzekutiv nga ligji.

Urdhëri i ekzekutimit nuk është gjë tjetër veçse instrument për të realizuar ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv. Pra, është vërtetimi zyrtar, i cili është i nevojshëm të lëshohet para fillimit të procedurës së ekzekutimit³⁹. Vetëm pasi të jenë përfunduar këto hapa, pala kreditore ose përfaqësuesi i saj i pajisur me prokurë mund të paraqesë kërkesë për vënien në ekzekutim pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror ose privat. Nuk ka ekzekutim pa titull, “*nulla executio sine titulo*”. Vendimi që lidhet me një detyrim të pakontestueshëm certifikohet si një Urdhër ekzekutimi evropian nga shteti anëtar, i cili ka dhënë vendimin (Shteti Anëtar i origjinës), mbi bazën e një certifikate standarde. Nëse certifikohet vetëm një pjesë e vendimit, atëherë ajo do të njihet si “urdhër ekzekutimi i pjesshëm”⁴⁰.

Me ndryshimet e fundit që i janë bërë K.Pr.Civile⁴¹, kryesisht nenit 511/a të tij, është suprimuar kërkesa për lëshimin e urdhërave të ekzekutimit për një vendim gjyqësor të formës së prerë. Nëpërmjet këtij ndryshimi, lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për një vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk është një proces më vete, por ai lëshohet së bashku me vendimin përfundimtar nga gjykata e shkallës së parë, që ka dhënë vendimin. Në këtë rast kancelari konfirmon urdhërin e ekzekutimit brenda pesë ditëve nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor.

Pra, nuk është i nevojshëm edhe një gjykim tjetër në përputhje edhe me parimin e ekonomisë gjyqësore, por mjafton konfirmimi që i bën kancelari urdhërit të ekzekutimit, me kusht që vendimi të ketë marrë formë të prerë. Ndërsa për vendimet gjyqësore lidhur me çështje civile të paraqitura deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen rregullimet e mëparshme ligjore, pra për këto vendime është i domosdoshëm edhe një gjykim tjetër për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit⁴². Vendimi gjyqësor për njohjen e së drejtës dhe urdhëri i ekzekutimit krijohen në të njëjtën kohë nga i njëjti gjyqtar, por marrin fuqi në momente të ndryshme⁴³. Urdhëri i ekzekutimit nuk duhet të mjaftohet vetëm me citimin e ekstremiteteve të titullit ekzekutiv, por duhet të jetë sa më i qartë dhe i saktë në lidhje me detyrimin që përmbahet në titull dhe që kërkohet të vihet në ekzekutim.

³⁸ Shih nenin 265 i K.Pr.Civile

³⁹ Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Çomo “Vështirim krahasues mbi procedurën civile” Tiranë 2006 , Shkolla e Magjistraturës faqe 321

⁴⁰ Rregullorja e BE-së nr. 805/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 prill 2004, që krijon një urdhër ekzekutimi evropian për pretendimet e pakontestueshme neni 5, Kapitulli 2, faqe 4
<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/IT/TXT/?uri=URISERV%3A133190>

⁴¹Ligji nr.122/2013 datë 18.04.2013 neni 39 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996” “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ka hyrë në fuqi në datën 01.09.2013

⁴²Neni 49 i Ligji nr.122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996” “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ka hyrë në fuqi në datën 01.09.2013

⁴³Vendimi nr. 00-2014-4052, date 11.12.2014 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë arsyeton se: *Kompetente për çështjet me natyrë administrative të regjistruara në gjykata para datës 04.11.2013 janë gjykatat administrative prandaj kompetenca në lëndë për lëshimi i urdhërit të ekzekutimit i përket Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

Kolegjet e Bashkuara, në Vendimin Unifikues nr.3, datë 24.01.2007, nën dritën e parimeve të përgjithshme të legjislacionit procedural civil dhe duke marrë parasysh dhe natyrën e Komisionit të Shërbimit Civil, kanë arsyetuar se: “vendimet e KSHC të cilat ngjasojnë me vendimet e shkallës së parë, si për nga tiparet e tyre ashtu dhe nga fuqia detyruese, kur ato nuk ankimohen ose kanë marrë formë të prerë, përbëjnë tituj ekzekutiv⁴⁴.” Mendojmë se një arsyetim i tillë është i drejtë. Kjo duke u nisur edhe nga rëndësia e këtij institucioni dhe fuqia detyruese që duhet të kenë vendimet e tij. Kur vendim i Komisionit që përbën titull ekzekutiv nuk ekzekutohet në mënyrë vullnetare nga institucionet e administratës qendrore dhe lokale, atëherë mund të kërkohet ekzekutimi i detyrueshëm i tij. Duke qenë se qendra e KSHC është në Tiranë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykata kompetente, e cila do të gjykojë kërkimin në lidhje me lëshimin e urdhërit ekzekutiv për vendimet e KSHC të cilat kanë marrë formë të prerë⁴⁵. Ndërsa me hyrjen në fuqi të ligjit për Gjykatat Administrative⁴⁶, kompetencën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil e ka Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë⁴⁷.

Kur vendimi përfundimtar i Gjykatës Administrative, ka marrë formë të prerë, atëherë do të vihen në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor me kërkesën e kreditorit, pa qenë e nevojshme lëshimi i urdhërit të ekzekutimit⁴⁸. Shërbimi përbarimor gjyqësor shtetëror, nëpërmjet zyrës përbarimore kompetente, si dhe shërbimi përbarimor gjyqësor privat, janë të detyruar të ekzekutojnë vendimet e Gjykatës Administrative, sipas rregullave të këtij ligji. Në ndryshim nga ligji procedural civil, në ligjin e Gjykatës Administrative, ligjvënësi ka parashikuar figurën e posaçme të gjyqtarit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, pra gjyqtari që ka dhënë vendimin vazhdon vendimmarrjen e tij edhe gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit. Një risi mjaft e mirëpritur për efektet pozitive, që duhet të sillte në praktikën ekzekutive, por për shkak të mbingarkesës së Gjykatës Administrative, nuk i është dhënë rëndësia që duhej.

⁴⁴Vendimi nr.3, date 24.01.2007 i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë arsyeton se : *KSHC është organi që ka juridiksionin fillestar të zgjidhjes së mosmarrëveshjes nëpërmjet dhënies së një vendimi në përfundim të këtij procesi. se vendimet e KSHC ngjasojnë me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë nisur nga tiparet dhe nga fuqia detyruese që ligjvënësi u ka dhënë në rast se ato nuk ankimohen”, arrijnë në konkluzionin se: “pasojat dhe efektet që kanë këto vendime do të jenë të njëjta me pasojat dhe efektet që sjellin vendimet e shkallës së parë, në rast se ato nuk ankimohen ose kur marrin formë të prerë.*

⁴⁵Vendimi nr.1, date 17.01.2011 i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë

⁴⁶ Ligji nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Neni 66 i këtij ligji në pikën 1 disponoi se: *1. Gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, gjyqtari apo kryetari i trupit gjykues, që ka dhënë vendimin, me kërkesë të palëve ose të përbaruesit gjyqësor, në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, urdhëron kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e kryerjes së tyre.*

⁴⁷Vendimi nr. 00-2015-3578, date 02.07.2015 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë arsyeton se: *Çështja për të cilën është marrë vendimi i cili kërkohet të vihet në ekzekutim është e natyrës administrative dhe kompetente për të gjykuar një çështje të tillë është gjykata administrative, rrjedhimisht edhe urdhërimin për vënien në ekzekutim të detyrueshëm të këtij vendimi duhet ta bëjë po kjo gjykatë.*

⁴⁸ Neni 65 i ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

2.2. Përgjegjësia e subjekteve në ekzekutim

Palë të rëndësishme të procesit të ekzekutimit të një titulli ekzekutiv janë kreditori, i cili vë në lëvizje të gjithë mekanizmin e ekzekutimit të detyrueshëm, debitori i cili është ngarkuar të përmbushë një detyrim dhe përmbaruesi gjyqësor, i cili me anë të veprimtarisë së tij, është ngarkuar nga ligji që të zbatojë urdhërin e ekzekutimit tërësisht. Për të siguruar mbarëvatjen e procesit ekzekutiv, ligji i ka njohur secilës prej palëve të drejta dhe detyrime juridike, njohja dhe respektimi i të cilave do të mundësonte një proces rigoroz ekzekutiv në bazë dhe për zbatimin e ligjit.

Sigurisht, që gjatë kësaj marrëdhënie mund të përfshihen edhe subjekte të tjera, kjo varet nga lloji i titullit ekzekutiv që do të ekzekutohet. Për këtë arsye, ligji parashikon dhe rastet e përgjegjësive të personave të tretë për përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në titullin ekzekutiv. Subjektet e ekzekutimit, të cilët kanë përgjegjësi në rastet e parashikuara në ligj janë: personi i tretë i cili ka kreditë ose sendet e debitorit. I tillë është rasti kur një debitor ka detyrimin për të kthyer një shumë të hollash dhe po ashtu ka cilësinë e qiradhënësit në një kontratë qiradhënieje, në këtë rast përmbaruesi mund të urdhërojë në bazë të nenit 583 dhe 584 të Kodit të Procedurës Civile sekuestrimin mbi kreditë e debitorit që personat e tretë i detyrohen debitorit. Si subjekt tjetër mund të përmendim bankën, ku debitori ka llogari, depozita ose kreditë e tij, në përputhje me neni 593 e në vijmi deri në nenin 600 të K.Pr.Civile, të cilët rregullojnë këtë fushë si dhe në bazë të Udhëzimit të Bankës së Shqipërisë Nr.2, datë 27.03.2014 “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumatat e llogarive në bankë”, i cili përcakton mënyrën e ekzekutimit mbi shumatat e llogarive në bankë; po ashtu përmendim: punëdhënësi i debitorit, neni 588 i K.Pr.Civile; ruajtësi i sendeve të sekuestruara, neni 545 dhe 565 i K.Pr.Civile; personi i cili ka në posedim sendet e debitorit, neni 586 dhe 603 i K.Pr.Civile.

Gjatë ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në rast të mosekzekutimit të tyre në rastet e parashikuara në ligj, debitori kur nuk ka përgjegjësi penale, atëherë ligji e ka ngarkuar me përgjegjësi civile. Në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile⁴⁹, përgjegjësia civile e debitorit lind atëherë kur ky i fundit me anë të veprimeve apo mosveprimeve të tij, bëhet shkak për pengimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

Debitori për shkak të mosekzekutimit mund të dënohet nga përmbaruesi gjyqësor, me gjobë⁵⁰ në rastet kur: nuk kryen veprimin e caktuar që është objekt ekzekutimi, kur refuzon të kryej në mënyrë të parregullt, ose nuk respekton afatet apo kryen të kundërtën e asaj që me vendim gjyqësor është i detyruar të kryejë. Një tjetër rast kur debitori mund të dënohet me gjobë është edhe atëherë kur veprimi objekt ekzekutimi, nga natyra mund kryhet dhe nga persona të tjerë, por kreditori nuk kërkon ta kryejë vetë veprimin ose përmbaruesi gjyqësor nuk e lejon kryerjen e veprimit nga vetë kreditori.

⁴⁹ Neni 606 i K.Pr.Civile parashikon: *Ndaj debitorit që refuzon, kryen në mënyrë të parregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është i detyruar, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtën e gjobitjes deri 50 000 lekë në çdo rast deri në ekzekutimin e detyrimit. Kundër vendimit të përmbaruesit gjyqësor mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij.*

⁵⁰ Po aty

Për ato raste kur shkalla e përgjegjësisë paraqet një rrezik për shoqërinë, ligji ka njohur edhe përgjegjësinë penale të debitorit⁵¹. Debitori në rastet e parashikuara në ligj, mban përgjegjësi penale për mosekzekutimin e detyrimit kur: a) disponon sendin e luajtshëm ose të paluajtshëm ose kredinë e sekuestruar si dhe fsheh, dëmton apo shkatërron sendin e sekuestruar, objekt ekzekutimi. b) kryen veprime, me qëllim mosekzekutimin ose pengimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor; c) nuk jep mjetet e nevojshme, për jetesën e fëmijës ose personin tjetër, të cilët janë në ngarkim të tij⁵²; d) ka detyrim për ushqim, por largohet nga vendbanimi dhe nuk njofton personin e interesuar ose organin e ekzekutimit, brenda një muaji, për ndryshimin e vendbanimit⁵³; e) merr në mënyrë të padrejtë fëmijën, duke e larguar prej personit, i cili ushtron autoritetin prindëror ose që i është besuar, për rritje dhe edukim⁵⁴.

Përveç rasteve të përmendura me sipër, një lloj i veçantë i përgjegjësisë së debitorit, është dhe përgjegjësia për shpërblimin e dëmit. Çdo mangësi në ekzekutimin e detyrimit e ngarkon debitorin me përgjegjësi për shpërblimin e dëmit. Përgjegjësia për shpërblimin e dëmit bazohet në rregullin, sipas të cilit, çdo marrëveshje që përjashton ose kufizon palët nga përgjegjësia për mosekzekutimin e detyrimit, është e pavlefshme. Debitori mund të çlirohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit vetëm kur provon, se mospërbushja ka ndodhur jo për fajin e tij. Një rast tjetër është përgjegjësia e debitorit, për veprimtarinë e të tretëve. Kur në ekzekutimin e detyrimit, debitori përdor punën e personave të tretë, ai përgjigjet për veprimet e tyre të kryera me faj, sikur të ishin kryer prej atij vet.

Ligji ka parashikuar përgjegjësinë profesionale edhe të përmbaruesit gjyqësor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Në rast se vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, se Përmbaruesi Gjyqësor Privat ka përgjegjësi profesionale, atëherë zhdëmtimi i kreditorit bëhet nëpërmjet shoqërisë së sigurimit. Përmbaruesi Gjyqësor Privat, mban përgjegjësi sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin, për dëmin që mund t'i shkaktojë kreditorit, si pasojë e veprimtarisë së tij gjatë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Me qëllim përmbushjen e detyrimit të mësipërm, Përmbaruesi Gjyqësor Privat, ka detyrimin të sigurojë veprimtarinë e tij profesionale, në përputhje me paragrafin “e” të nenit 32 të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

2.3. Parashkrimi i së drejtës për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi gjyqësor

2.3.1. Kuptimi i institutit të parashkrimit në të drejtën procedurale civile

Titujt ekzekutiv, qofshin vendime gjyqësore apo të përcaktuar si të tillë me ligj, dhe mënyra e ekzekutimit të tyre përcaktohet në Kodin e Procedurës Civile. Ndërsa parashkrimi ose jo i

⁵¹ Neni 320 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, ndryshuar me ligjin nr.144/2013, datë 2.5.2013

⁵² Neni 125 i Kodit Penal

⁵³ Neni 126 i Kodit Penal

⁵⁴ Neni 127 i Kodit Penal

titujve ekzekutiv, meqenëse parashkrimi është një institut i së drejtës materiale, parashikohet në Kodin Civil⁵⁵. Qëllimi i ekzistencës së institutit të parashkrimit, është disiplinimi i qarkullimit civil, i të drejtave dhe të mirave materiale, duke synuar ruajtjen e paprekur të sigurisë juridike dhe nevojave për të ndëshkuar çdo sjellje të pajustificuar pasive dhe indiferente të titullarit të së drejtës⁵⁶. Parashkrimi si institut i së drejtës, ka fushë zbatimi më të gjerë në të drejtën civile. Në këtë kontekst, i referohemi parashkrimit shues dhe parashkrimit fitues, i cili është njohur nga e drejta civile si mënyrë origjinale dhe e pakontestueshme e fitimit të pronësisë.

Parashkrimi përbën mosveprimin e mbajtësit të së drejtës subjektive për të realizuar mbrojtjen e së drejtës të pretenduar si të shkeluar brenda një afati kohor të caktuar në ligj. Parashkrimi është një institut i së drejtës materiale civile dhe si i tillë nuk mund të ekzistojë vetëm duke u bazuar tek rregullimi i tij procedural, por duhet të rregullohet shprehimisht nga dispozitat e së drejtës materiale. Nga ky përkufizim, del kuptimi edhe i parashkrimit të titujve ekzekutiv, që nënkupton pamundësinë e kreditorit për të kërkuar ekzekutimin nëpërmjet forcës shtrënguese të ligjit, shërbimit përmbarimor gjyqësor, të vendimit gjyqësor ose të titujve të tjerë ekzekutiv, për shkak të mosushtrimit të kësaj të drejte brenda afatit të caktuar nga ligji.

Në Kodin Civil aktual dhe atë të Procedurës Civile, që janë në fuqi, nuk gjejmë një parashkrim, i cili në mënyrë qartë të përcaktojë një afat parashkrimi për kërkimin e vënies në ekzekutim të një titulli ekzekutiv. Nga sa u tha më sipër, ekzistojnë dy pikëpamje në lidhje me parashkrimin ose jo të së drejtës për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të një titulli ekzekutiv ose të një vendimi gjyqësor. Grupi i parë është mbështetës i veprimit të institutit të parashkrimit, ndërsa grupi i dytë nuk pranon parashkrimin e titujve ekzekutiv. Në mbështetje të argumentit të grupit të dytë, qëndron fakti se ligjvënësi nuk e ka parashikuar parashkrimin e titujve ekzekutiv në Kodin e ri Civil, ndryshe ka vepruar duke parashikuar parashkrimin e titujve ekzekutiv në ligjin Nr.2023, datë 02.04.1955⁵⁷.

Ndërsa në Kodin Civil të vitit 1981, parashikohej një tjetër rregullim. Sipas tij, e drejta për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës ose të një titulli tjetër ekzekutiv parashkruhet me kalimin e një viti, kur palët janë persona juridikë dhe me kalimin e tre vjetëve, në të gjitha rastet e tjera⁵⁸. Mbështetësit e grupit të dytë argumentojnë se titujt ekzekutiv dhe në veçanti vendimet gjyqësore të formës së prerë i nënshtrohen parashkrimit, pasi kjo siguron qëndrueshmëri dhe respektimin e sigurisë juridike në marrëdhëniet juridike, duke nënkuptuar faktin se kreditori, nëse nuk e ushtron të drejtën e tij për të vënë në ekzekutim titullin ekzekutiv, atëherë me kalimin e afatit kohor, prezumohet se kreditori ka hequr dorë nga kjo e drejtë.

⁵⁵ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.304, datë 16.05.2013

⁵⁶ Faik Brestovci, *E drejta Procedurale Civile II*, shtëpia botuese "Grafo Beni", Prishtine 2006, faqe 161.

⁵⁷ Ligjin Nr.2023, datë 02.04.1955 parashikon se: *E drejta për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë ose të një vendimi arbitrazhi shtetëror ose të një akti tjetër ekzekutiv, parashkruhet me kalimin e një viti në konfliktet midis institucioneve, ndërmarrjeve, oragizatave shoqërore dhe me kalimin e gjashtë vjetëve, në të gjitha rastet e tjera edhe sikur e drejta e padisë në vetvete t'i nënshtrohet një parashkrimi tjetër më të gjatë ose më të shkurtër.*

⁵⁸ Neni 61 i Kodit Civil të vitit 1981

Në mbështetje të argumentit të parashkrimit janë neni 113/2 dhe 131/ç /f në Kodin Civil. Në interpretim të kësaj dispozite, rezulton se, si rregull kërkesat për ekzekutim të detyrueshëm i nënshtrohen afateve të parashkrimit, përveç rastit të vendimeve të dhëna mbi padi që nuk parashkruhen⁵⁹. Si shembull mund të përmendim padinë e pjestimit të një sendi në bashkëpronësi, padia e cila nuk parashkruhet, për rrjedhojë edhe kërkesa për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor, që ka vendosur pjestimin e sendit nuk do të parashkruhet.

Pra një interpretim në të kundërt të kësaj dispozite kuptojmë, se për parashkrimin e vënies në ekzekutim të titujve ekzekutiv, zbatohen të njëjtat afate parashkrimi si dhe padia që qëndron në themel të tyre, kur këto tituj ekzekutiv janë vendime gjyqësore. Pra, nëse padia, që qëndron në themel të këtij vendimi gjyqësor nuk është e parashkrueshme, edhe ekzekutimi i këtij vendimi është i paparashkrueshëm. Në varësi të llojit të titullit ekzekutiv përcaktohet edhe rregullat për afatin e parashkrimit, në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji.

Mendojmë se e drejta e kreditorit për të kërkuar vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv nuk mund të jetë e pakufizuar në kohë, pasi do të krijonte një pasiguri të vazhdueshme për marrëdhënien juridike. Disiplinimi i institutit të parashkrimit është i rëndësishëm, për respektimin e parimit të sigurisë juridike, pasi i siguron marrëdhënies juridike qëndrueshmërinë e nevojshme.

2.3.2. Parashkrimi i vënies në ekzekutim të titujve ekzekutiv: rëndësia e studimit të tij

Duke ndjekur arsyetimin e mësipërm, për sa kohë nuk parashikohet ndryshe, kërkesat për ekzekutim të detyrueshëm do i nënshtrohen të njëjtave afate parashkrimi me ato të padive mbi bazën e të cilave janë dhënë vendimet gjyqësore-tituj ekzekutive. Studimi i institutit të parashkrimit të së drejtës për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv është mjaft i rëndësishëm për t'u njohur gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Palët e marrëdhënies juridike ekzekutive mund të përdorin mjetet mbrojtëse gjatë ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv. Si të tilla, ligji ka njohur padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv⁶⁰ dhe padinë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore⁶¹.

Një nga shkaqet, që përdoret shpesh për t'u mbrojtur gjatë ekzekutimit, është fakti se është parashkruar e drejta për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv. Pasi pala kreditore nuk ka kërkuar ekzekutimin brenda afatit kohor të njohur nga ligji. Por, duke analizuar parashkrimin, kuptojmë se mbajtësi i së drejtës nuk humbet të drejtën në kuptimin material, por humbet të drejtën për t'iu drejtuar me padi gjykatës për njohjen e së drejtës së mohuar. Në paralelizëm me të, qëndron edhe parashkrimi i së drejtës për vënien në ekzekutim të një vendimi

⁵⁹Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.160, datë 28.04.2009: *Keshtu me te drejte gjykatat kane konkluduar se neni 113/“dh” ka lidhur mungesen e parashkrimit te ekzekutimit te detyrueshem te vendimeve te formes se prere, vetem per ato vendime qe jane te lidhura me padi, per te cilat nuk zbatohet parashkrimi, pra vetem per keto lloj padi Kodi ka parashikuar parashkrimin e ekzekutimit te vendimit gjyqesor, sic nuk mund te ndodhe e njejta gje (per shkak te ketij rregullimi), ne ato raste qe lidhen me ekzekutimin e vendimit gjyqesor (tituj ekzekutive), te lidhura me padi qe parashkruhen.*

⁶⁰ Neni 609 i K.Pr.Civile

⁶¹ Neni 610 i K.Pr.Civile

gjyqësor ose titulli ekzekutiv. Në këtë mënyrë pala kreditore, si titullare e së drejtës, nuk humbet të drejtën e njohur nga titulli ekzekutiv, por për shkak të mosveprimit brenda afatit ligjor, humbet të drejtën për të kërkuar ekzekutimin nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit. Pra titulli ekzekutiv, qoftë ky vendim gjyqësor ose jo nuk bëhet i pavlefshëm për shkak të parashkrimit të së drejtës për vënien në ekzekutim të tij, pra titulli në vetvete mbetet i vlefshëm⁶².

Parashkrimi i ekzekutimit të një titulli ekzekutiv nuk hyn në ato fakte ose ngjarje që më pas sjellin pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Ky argument bazohet në arsyetimin, se kjo padi përmban elementet e një padie njohjeje negative dhe si e tillë, në bazë të nenit 113/b të Kodit Civil, kjo padi nuk i nënshtrohet afateve të parashkrimit⁶³. Në këto kushte, kalimi i afatit të parashkrimit, mund të konsiderohet si një element vërtetimi i të cilit krijon bazë të mjaftueshme juridike për të kundërshtuar veprimet përmbartimore, si veprime të kryera në mungesë të kushteve ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm⁶⁴.

Prandaj mjeti i duhur për t'u mbrojtuar është padia për kundërshtimin e veprimit përmbartimor, me argumentin se po ekzekutohet një titull ekzekutiv që është parashkruar. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe praktika gjyqësore dhe në veçanti ajo e Gjykatës së Lartë, kur ka trajtuar konceptin e parashkrimit të titullit ekzekutiv. Kështu në vendimin e tij Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se “detyrimi është parashkruar për shkak të kalimit të afatit, pavarësisht detyrimit principal të paditësit dhe kjo nuk mund ta vërë palën e paditur në pozitën e kërkitimit për atë që është paguar pikërisht për shkak të mos ushtrimit të së drejtës së saj brenda afatit, ç’ka ka sjellë dhe shuarjen e saj. Kur paditësi ka përmbushur detyrimin pas plotësimit të afatit të parashkrimit ai nuk mund të kërkojë kthimin e parave, ky pretendim i tij është i pabazuar pasi ai e dinte se ishte plotësuar afati. Nuk është paditësi ai që ka përmbushur vullnetarisht detyrimin, por ky detyrim i është vjelë atij nga Zyra e Përmbartimit”⁶⁵.

2.3.3. Fillimi i afatit të parashkrimit për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv

Me afat të parashkrimit për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv, do të quajmë afatin kohor të caktuar nga ligji, brenda të cilit kreditori ka të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm me anë të shërbimit përmbartimor. Përcaktimi i momentit të fillimit të afatit të parashkrimit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, është mjaft i rëndësishëm, pasi nga ky moment fillon të përlllogaritet afati i caktuar nga ligji, brenda të cilit duhet të ishte ekzekutuar titulli ekzekutiv. Fillimi i afatit përcakton faktin, nëse është parashkruar e drejta e kreditorit për të kërkuar vënien në ekzekutim me anë të forcës shtrënguese të shtetit. Afati i parashkrimit të ekzekutimit, duhet të fillojë nga dita që kreditorit i ka lindur e drejta, pra kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Kjo, në varësi të asaj që ka vendosur gjykata në dispozitivin e vendimit, pasi nëse gjykata ka përcaktuar një afat në të cilin duhet të bëhet ekzekutimi, atëherë edhe

⁶²Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.297, datë 01.10.2009

⁶³ Erjon Bani *Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të titujve ekzekutiv*, Tiranë 2012, faqe 76

⁶⁴ Revista juridike nr.1 Marsela Dervishi, *Parashkrimi i vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, efekti i tij në paditë që ngrihen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm*, botuar nga Shkolla e Magjistraturës, Tiranë Mars 2013

⁶⁵ Vendim i Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë Nr.152, datë 17.04.2014

parashkrimi do të fillojë me plotësimin e këtij afati, pasi vetëm atëherë lind e drejta për të kërkuar fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Dy janë problemet që mund të shtrohen për diskutim në këtë rast: *së pari*, është ai që ka të bëjë me atë, se cila do të konsiderohet si çast i fillimit të afatit të parashkrimit për vënien në ekzekutim të detyrueshëm: kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nga gjykata apo kërkesa drejtuar zyrës së përmbartimit, referuar nenit 515 të K.Pr.Civile. Kërkesa drejtuar zyrës së përmbartimit për ekzekutim të detyrueshëm duhet të konsiderohet si çast i fillimit të afatit të parashkrimit për vënien në ekzekutim të urdhërit të ekzekutimit. Nga ky moment duhet të fillojë të ecë afati i parashkrimit.

Problemi tjetër ka të bëjë me faktin se kur do të fillojnë të ecin këto afate. Pra, nëse afati parashkrimit për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm do të fillojë nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë, apo nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Fillimi i afatit të parashkrimit është i lidhur edhe me konceptin e ndërprerjes dhe pezullimit. Në rastin e pezullimit, afati i filluar ndërpritet me vërtetimin e asaj ngjarjeje ose fakti juridik të njohur nga ligji dhe pas shkakut të pezullimit, afati vazhdon të ecë aty ku ishte pezulluar.

Një rast që konkretizon pezullimin e afatit të parashkrimit të titujve ekzekutiv, është edhe parashikimi në nenin 617/3 të K.Pr.Civile, sipas të cilit kur merr formë të prerë vendimi i pushimit të ekzekutimit, atëherë përmbartuesi gjyqësor e heq sekuestron e vënë mbi sendet e luajtshme ose të paluajtshme dhe në rastin e parashikuar nga shkronja “b” e nenit 616 të këtij Kodi, i kthen urdhërin e ekzekutimit kreditorit. Ky i fundit ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për ekzekutim brenda kohës së parashkrimit. Në këtë rast, parashkrimi i ri fillon nga dita që vendimi për pushimin e ekzekutimit ka marrë formën e prerë. Këto dispozita mbështesin pikëpamjen se titujt ekzekutiv i nënshtrohen parashkrimit, megjithëse nuk parashikohen afate parashkrimi konkrete.

Ndërsa, në rastin e ndërprerjes afati ndërpritet me vërtetimin e asaj ngjarjeje ose fakti juridik të njohur nga ligji dhe pas shkakut të ndërprerjes, fillon një afat i ri parashkrimi. Nisur nga ky rast i fundit, vlen të kujtojmë përmbajtjen e nenit 131/ç të K.C, sipas të cilit, parashkrimi i padisë ndërpritet me paraqitjen e kërkesës për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor apo arbitrazhit përkatës, si dhe të çdo titulli ekzekutiv tjetër. Duke e parë nenin 131/ç në lidhje me nenin 134 të K.Civil, sipas të cilit pas zhdukjes së shkakut ndërprerës, fillon një afat i ri parashkrimi, arrijmë në konkluzionin, se në momentin e paraqitjes së kërkesës për ekzekutim të detyrueshëm, afati i parashkrimit i filluar më parë ndërpritet dhe fillon të ecë nga e para. Pra, lëshimi i urdhërit të ekzekutimit nuk e ndërpret ecjen e afatit të parashkrimit.

Nëse kreditorit do ti jepej mundësia për të vënë në ekzekutim urdhërin në çdo kohë, pa qënë i detyruar të respektojë afatin e parashkrimit, kjo do të sillte në qarkullim marrëdhënie juridike të vjetra duke cënuar parimin e sigurisë juridike. Nëse në këtë analizë do të mbajmë parasysh edhe

parashikimin e nenit 135/1 të K.Civil⁶⁶, atëherë del që afati i parashkrimit për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm fillon që nga dita që vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë.

Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ka përcaktuar disa kushte dhe premisa që duhet të plotësohen formalisht dhe proceduralisht në lidhje me këtë institut. Mendojmë se drejt ka gjykuar Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij⁶⁷, kur arsyeton se, kur vendimi ka marrë formë të prerë, ka qenë në fuqi Kodi Civil i vitit 1981, dhe sipas neneve 192 dhe 194 të këtij Kodi ka qenë në diskrecion të anës së paditur të kërkonte pranë përmbauesit gjyqësor ekzekutimin e vendimit. Afati për parashkrimin e të drejtës për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv ka lindur në rastin konkret më datë 22.01.1994, datë kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Nga kjo datë e deri më datë 22.01.1997, nuk rezulton se ana e paditur, në cilësinë e kreditorit, të ketë kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Pra, në asnjë rrethanë nuk vërtetohet se ka patur shkaqe për pezullimin apo ndërprerjen e afatit 3 vjeçar të parashkrimit. Në këto kushte, kreditorit i ka humbur e drejta për të kërkuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv, duke e shndërruar për këtë shkak, vetë titullin ekzekutiv të pavlefshëm.⁶⁸

Ndërsa në një rast tjetër Kolegjit Civil⁶⁹, ka interpretuar nenin 115 “dh” të K.Civil. Në këtë nen janë parashikuar afate parashkrimi për paditë për shpërblim dëmi jo kontraktor dhe për paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë. Me kalimin e afatit 3 vjeçar të parashkrimit të padisë, për të cilën bën fjalë titulli ekzekutiv, është parashkruar edhe e drejta e kreditorit për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor, duke e bërë të pavlefshëm titullin ekzekutiv. INSIG nuk mund të kërkojë vënien në ekzekutim të detyrimit për kthimin e shumës së paguar sipas kontratës së sigurimit, pasi ka kaluar afati tre vjeçar i parashkrimit.

2.3.4. Plotësimi i afatit të parashkrimit dhe pasojat që sjell për palët

Plotësimi i afatit të parashkrimit jo vetëm në këtë rast por edhe përgjithësisht është një prapësim, që i takon debitorit, kjo edhe në zbatim të nenit 125 të Kodit Civil⁷⁰. Pasi, nëse debitori ekzekuton një detyrim pas plotësimit të afatit të parashkrimit, atëherë nuk ka të drejtë të kërkojë me padi begatimin pa shkak, edhe sikur të provojë se nuk ka patur ose nuk mund të kishte dijeni për kalimin e afatit. Pra as gjykata dhe as përmbauesi gjyqësor, nuk mund të marrë parasysh kryesisht plotësimin e afatit të parashkrimit të titullit ekzekutiv.

Këtë prapësim debitori mund ta paraqesë me anë të padisë për kundërshtimin e veprimit përmbauesor⁷¹. Këtë qëllim ka mbajtur edhe Gjykata e Apelit Tiranë⁷² duke arsyetuar se gjykata

⁶⁶Neni 135/1 të K.Civil⁶⁶, sipas të cilit *Kur parashkrimi i padisë është ndërprerë për shkak të paraqitjes së padisë ose të kundërpadisë, afati i ri i parashkrimit fillon nga dita që ka marrë formë të prerë vendimi me të cilin është zgjidhur çështja në themel*

⁶⁷ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.506, datë 25.04.2006

⁶⁸Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.506, datë 25.04.2006

⁶⁹ Vendimin nr.160, datë 28.04.2009 të Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë

⁷⁰ Vendos dispoziten e nenit 125 KC parashikon: *Parashkrimi i plotësuar nuk mund të merret parasysh nga gjykata ose organi tjetër kompetent me nismën e vet, por vetëm me kërkesën e palës së interesuar.*

⁷¹Neni 610 i Kodit të Procedurës Civile

⁷² Vendimi i Gjykatës së Apelit Tirane nr.1217, date 23.05.2013

në këtë rast nuk mund të verifikojë me nismën e vet, nëse afati i parashkrimit është plotësuar apo jo. Vetëm në fazën e ekzekutimit, pala e interesuar mund të përdorë mjetet juridike specifike për të pretenduar plotësimin e këtij afati. Në bazë të nenit 125 të Kodit Civil, parashkrimi i plotësuar nuk mund të merret parasysh nga gjykata kryesisht, por vetëm me kërkesë të palës së interesuar. Nëse në zbatim të ligjit procedural civil të kohës, është parashkruar afati për të kërkuar vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv vendimit gjyqësor të formës së prerë, atëherë ky titull ekzekutiv nuk mund të vihet më në ekzekutim, ndaj edhe detyrimi që ai përmban duhet të deklarohet i shuar në kuptim e zbatim të drejtë të nenit 609 të K.Pr.Civile⁷³.

Një argument i fundit në këtë drejtim është edhe rasti që parashikohet në Kodin e Familjes, në lidhje me ekzekutimin e një vendimi, që përmban një detyrim për ushqim, kur ky i fundit vihet në ekzekutim pas 6 muajve nga data që ka marrë formë të prerë, detyrimet e prapambetura për ushqim janë të kërkueshme vetëm për 6 muajt e fundit⁷⁴. Pra, shprehja “janë të kërkueshme”, nënkupton se kërkesa për vënien në ekzekutim të detyrimit për ushqim i nënshtrohet parashkrimit.

Një rast tjetër i praktikës gjyqësore⁷⁵ është edhe rasti i shqyrtuar në lidhje me pagimin e pensionit ushqimor nga pala debitore. Çështja është vënë në ekzekutim pranë zyrës së shërbimit përmbarimor shtetëror dhe më pas pala kreditore ka tërhequr dokumentacionin origjinal, duke e paraqitur për ekzekutim pranë shërbimit përmbarimor privat. Zyra përmbarimore private ka filluar procedurën duke e njoftuar palën debitore për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin e pensionit ushqimor, jo vetëm për detyrimin mujor por edhe për detyrimin e papaguar duke filluar që nga dita që është ngritur kërkesë-padia për zgjidhjen e martesës. Pala debitore ka kundërshtuar veprimin e zyrës përmbarimore me argumentin, se pushimi i çështjes nga zyra përmbarimore shtetërore dhe fillimi i saj në përmbarimin privat, përbën shkak për parashkrimin e detyrimit. Duke pretenduar se në këtë mënyrë detyrimet e prapambetura për ushqim janë të kërkueshme vetëm për 6 muajt e fundit dhe jo dita e ngritjes së padisë.

Gjykata e Apelit Vlorë ka arsyetuar se qëllimi i institutit juridik të parashkrimit shues është mbi të gjitha, disiplinimi i subjekteve për të kërkuar dhe rivendosur në vend të drejtën brenda një afati të caktuar. Ndërkohë, që në rastin në gjykim, konstatohet qartë qëllimi dhe kërkimi i kreditorit për të vënë në ekzekutim këtë titull ekzekutiv qysh në çastin kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë.

Ecja e afatit të parashkrimit në raport me pushimin e ekzekutimit nga përmbaruesi gjyqësor nuk mund të identifikohet me rastin e pushimit të gjykimit siç parashikon neni 135 paragrafi II i Kodit Civil. Nisur nga natyra e kësaj të drejte, afati i parashkrimit duhet të fillojë të llogaritet nga çasti, kur ka lindur e drejta për të përfutuar pension ushqimor. Nuk rezulton, që ekzekutimi i vendimit gjyqësor të mësipërm, që përmban detyrimin ushqimor, të jetë vënë në ekzekutim pas 6 muajve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë dhe për rrjedhojë kërkimi

⁷³ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.552, datë 06.12.2011

⁷⁴ Neni 211 i Kodit të Familjes

⁷⁵ Vendimin Nr.1326 datë 25.07.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili është shprehur për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore për titullin ekzekutiv Vendimin Nr.2084 datë 05.07.2012 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Vlorë⁷⁵, i ndryshuar me vendimin Nr.306 datë 30.04.2013 i Gjykatës së Apelit Vlorë, ky i fundit është sqaruar dhe interpretuar me vendimin Nr.63 datë 08.05.2014 i Gjykatës së Apelit Vlorë

për ta detyruar paditësen për të përmbushur këtë detyrim qysh nga çasti i ngritjes së padisë për zgjidhjen e martesës, nuk rezulton i parashkruar.

Kur padia e themelit nuk ka një afat parashkrimi të përcaktuar, atëherë në lidhje me plotësimin e afatit të parashkrimit edhe kërkesa për ekzekutimin e saj do t'i nënshtrohen afatit maksimal 10 vjeçar, kjo në përputhje edhe me nenin 141 i K.Civil. Mendojme se, është i drejtë qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin e saj kur argumenton, se kanë kaluar 15 vjet nga lindja e së drejtës për kërkimin për ekzekutim të detyrueshëm, atëherë kjo e drejtë është parashkruar si e tillë dhe ky titull ekzekutiv nuk duhet të ekzekutohet për shkak të parashkrimit të tij. Mosushtrimi i një të drejte legjitime brenda një afati ligjor të arsyeshëm, në rastin konkret mosvënia në lëvizje për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv pranë Zyrës së Përmbarrimit Gjyqësor, përbën një sjellje ose qëndrim të njeriut, të cilat përbëjnë fakte dhe që në kuptim të Nenit 609/2 të K. Pr. Civil pas sjellin pavlefshmëri të titullit ekzekutiv⁷⁶.

Në lidhje me lehtësimin dhe përshpejtimin e procedurave përmbarrimore, rekomandojmë që të bëhen ndryshime edhe në dispozitat e Kodit Civil në lidhje me institutin e parashkrimit. Duhet të parashikohet shprehimisht parashkrimi i së drejtës për të vënë në ekzekutim një titull ekzekutiv dhe jo vetëm kaq, por të disiplinohet momenti i fillimit të afatit të parashkrimit, kohëzgjatja e tij dhe rastet përjashtimore. Një parashikim i tillë do të ndihmonte palët për të mbrojtur më mirë të drejtat e tyre si dhe zbatuesit e së drejtës për të qenë më të saktë në aplikimin e institutit të parashkrimit të së drejtës për të vënë në ekzekutim një titull ekzekutiv.

2.4. Titujt ekzekutiv

2.4.1. Koncepti i titullit ekzekutiv dhe elementet e tij sipas doktrinës shqiptare

Titulli ekzekutiv është një kusht i domosdoshëm pa të cilin nuk mund të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm. Titulli është "provë e probabilitetit, se realiteti i korrespondon afirmimit të personit që kërkon mbrojtje"⁷⁷. Të gjithë ato akte për të cilat ligji parashikon shprehimisht se përmbajtja e tyre vihet në zbatim nëpërmjet forcës shtrënguese të ligjit përbëjnë titull ekzekutiv. Titulli ekzekutiv, si koncept juridik është krijuar për të treguar ekzistencën e një të drejte subjektive materiale të cënuar ose të papërmbushur. Për këtë arsye, titulli ekzekutiv është burim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i legjitimitetit të kreditorit për të inicuar procesin e ekzekutimit të detyrueshëm. Legjitimiteti që buron nga fakti që, ai që ka titullin ekzekutiv ose në favor të të cilit është lëshuar titulli ekzekutiv, ka dhe të drejtën e përfshirë në të⁷⁸.

Në nenin 510 të K.Pr.Civile janë listuar aktet që përbëjnë tituj ekzekutiv. Kjo dispozitë nuk na jep ndonjë përkufizim në lidhje me konceptin e titullit ekzekutiv, por kufizohet vetëm në përcaktimin e rasteve, kur kemi të bëjmë me titull ekzekutiv. Roli i doktrinës dhe praktikës gjyqësore na ndihmon së tepërmi në përkufizimin e titullit ekzekutiv. Titull ekzekutiv është akti

⁷⁶ Vendimin i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr.404, datë 28.02.2012

⁷⁷ Francecco Carnelutti marre nga https://it.wikipedia.org/wiki/Titolo_eseutivo aksesuar per here te fundit ne daten 08.04.2016

⁷⁸Vendimi nr. 297, date 01.10.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

zyrtar përfundimtar, që përmban njohjen e detyrimit të plotë, të saktë, të përcaktuar dhe të pakondituar të një personi apo subjekti kundrejt një tjetri sipas parashikimeve të ligjit⁷⁹.

Edhe nga leximi i kësaj dispozite, natyrshëm kuptohet se, ekzekutimi i detyrueshëm nga ekzekutimi i detyrueshëm i zakonshëm. Ky i fundit realizohet në bazë të një titulli ekzekutiv-vendim gjyqësor ndërsa ekzekutim i detyrueshëm i posaçëm është ai që nuk realizohet në bazë të një vendimi gjyqësor, por në bazë të një akti tjetër të sanksionuar nga ligji si titull ekzekutiv.

Pra, nisur nga kriteri i organit që i lëshon, tituj ekzekutiv i klasifikojmë në tituj ekzekutiv gjyqësor dhe tituj ekzekutiv jogjyqësor. Tituj ekzekutiv jogjyqësor, janë ato që janë lëshuar nga organet administrative, referuar neni 510/e i K.Pr.Civile, ose ato që janë vërtetuar nga një person, që ushtron një shërbim publik, si noteri ose janë bërë në formën e kërkuar nga ligji. Këto akte, janë ato që përcaktohen në mënyra taksative nga pika d),dh) dhe e) të nenit 510 të K.Pr.C, përcaktohen si tituj ekzekutiv nga vetë ligjet e veçanta.

Përcaktimi i një akti si titull ekzekutiv do të thotë, që ky i fundit i nënshtrohet procedurës së ekzekutimit pa e marrë konfirmimin e ekzistencës së tij përmes një procesi të rregullt ligjor. Me vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, kreditori, përmes procedurës së ekzekutimit, vë dorë mbi pasuritë e debitorit, pra cënon të drejtën e pronësisë së këtij të fundit. Është e vërtetë se debitori mund të mbrohet më tej me padinë e parashikuar nga neni 609 i KPC-së, por një mbrojtje e tillë është *a posteriori*, ndërkohë që garancia e ofruar nga neni 42 i Kushtetutës, si një mbrojtje *a priori* e të drejtave, është një garanci që duhet të zbatohet në çdo rast.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, janë shprehur në vendim⁸⁰ se, që të jetë titull ekzekutiv, një akt i nxjerrë nga një organ kompetent shtetëror, apo i përgatitur e i vërtetuar nga një nëpunës publik, në kushtet e parashikuara në mënyrë eksplicite në ligj, duhet të përmbajë një detyrim të njohur e të përcaktuar saktë, të kërkueshëm, që nuk lidhet me plotësimin e afateve të caktuara, dhe mbi të gjitha, të pakushtëzuar nga rrethana të tjera apo nga detyrime të tjera të ndërsjella⁸¹. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr. 6, datë 10.01.2012, duke theksuar shprehimisht, se kushtet e vlefshmërisë së titullit ekzekutiv janë siguria, përcaktueshmëria dhe kërkueshmëria. Kushti i sigurisë nënkupton, që e drejta duhet të rezultojë në ekstremet e saj objektive dhe subjektive nga titulli ekzekutiv.

2.5. Llojet e titujve ekzekutiv. Titujt ekzekutiv gjyqësor

Titujt ekzekutiv gjyqësor, që hasen më shpesh në praktikën përmbartimore, përbëjnë pjesën më të madhe të titujve që vihen në ekzekutim dhe që ekzekutohen. Në nenin 510/a të K.Pr.Civile janë përcaktuar si të tillë vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë, vendimet e dhëna për sigurimin e padisë si dhe vendimet e dhëna me ekzekutim të përkohshëm. Titulli ekzekutiv, është një e drejtë e padyshimtë e kreditorit potencialisht e aftë të realizohet me forcën

⁷⁹ Vahid Lama *E drejta Procedurale Shqiptare*, Pjesa I, Dispenca II, Tiranë 1974

⁸⁰ Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 980, datë 29.09.2000 me palë paditëse Gj.L dhe të paditur Dh.L me objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv

⁸¹ Po aty faqe 3 paragrafi 3

shtrënguese të ligjit, pasi fuqia e tij ekzekutive është e njëjtë me titullin më klasik e më përfaqësues ekzekutiv, që është vendimi gjyqësor civil i formës së prerë.

Në këtë kuptim, ky titull nuk mund t'i nënshtrohet një gjykimi themeltar për t'u kontestuar, por si i tillë trajtohet për pavlefshmëri dhe si për gjithë titujt e tjerë ekzekutiv, mund të goditet për fallsitet apo të kundërshtohet, sipas parashikimeve të nenit 609 të K.Pr.Civile. Sipas legjislacionit tonë, një vendim gjyqësor civil përfundimtar bëhet i ekzekutueshëm, kur ai merr formë të prerë me një nga mënyrat e parashikuara në nenin 451 të K.Pr.Civile dhe përbën *res judicata* për çka është vendosur midis palëve ndërgjyqëse, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak⁸². Kjo do të thotë, se ai mund të vihet në ekzekutim të detyrueshëm, në qoftë se nuk ekzekutohet vullnetarisht⁸³. Rastet kur një vendim gjyqësor civil, merr formë të prerë përcaktohen në nenin 451 të K.Pr.Civile. Që një vendim të marrë formë të prerë, do të thotë se ndaj tij ligji nuk lejon ankim, ose ankimi nuk është paraqitur në afatin e caktuar ligjor apo është tërhequr, nuk është pranuar ankimi, ose vendimi i gjykatës është lënë në fuqi. Në teorinë procedurale civile pranohet se formë të prerë merr vendimi në tërësinë e tij, pra jo vetëm pjesa urdhëruese por edhe pjesa arsyetuese.

Megjithatë shtrohet çështja, nëse janë të gjitha vendimet gjyqësore civile të formës së prerë tituj ekzekutiv, të tillë që zbatimi i tyre të realizohet nëpërmjet procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm. Në varësi të llojit të padisë mbi bazën e të cilës gjykata ka dhënë këtë apo atë lloj vendimi, vendimet gjyqësore përfundimtare kalsifikohen në vendime njohjeje, vendime detyrimi dhe në vendime shndërruese⁸⁴.

Vendime njohjeje janë ato vendime, nëpërmjet të cilave gjykata në pjesën urdhëruese të tyre, njeh vetë qenien ose mosqenien e një marrëdhënieje juridike. Ndërsa vendimet e detyrimit, janë ato vendime me anë të të cilave gjykata, në pjesën urdhëruese të tyre ka vendosur detyrimin e një ose më shumë personave për të kryer ose jo një veprim, për të dhënë një send etj. Pra, vendimet e njohjes, edhe pse janë vendime gjyqësore të formës së prerë, nuk janë tituj ekzekutiv, por mund të shërbejnë si bazë, për fillimin e një procesi tjetër gjyqësor.

Nisur nga sa u tha më lart, arrijmë në konkluzionin se nuk mund të lëshohet urdhër ekzekutimi, dhe për rrjedhojë nuk mund të investohet përmbaruesi gjyqësor për ekzekutimin e vendimet gjyqësore të dhëna mbi padi njohjeje apo për vendimet gjyqësore, që anulojnë apo shfuqizojnë një akt administrative. Vendime të tilla njohëse, mund të shërbejnë më tej si bazë për dhënien e vendimeve me karakter detyrues.

Ka disa raste përjashtimore, të përcaktuara në mënyrë taksative nga ligji, kur nuk është nevoja për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nga gjykata, pasi titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim drejtpërdrejt nga përmbaruesi gjyqësor. Pra, jo çdo vendim gjyqësor i formës së prerë përbën titull ekzekutiv, në kuptimin që të jetë objekt i ekzekutimit të detyrueshëm. Detyrimi i përmbajtur në

⁸² Neni 451/a i K.Pr.Civile parashikon: *Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohej përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe.*

⁸³Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 495, datë 09.10.2014

⁸⁴Vahid Lame *E drejta procedurale civile shqiptare viti 1974*

këto vendime duhet të jetë: a) përfundimtar, që do të thotë që vendimi të ketë marrë formë të prerë; b) i plotë, kur detyrimi është i kërkueshëm, i saktë dhe i caktuar; c) i pakushtëzuar, kur ekzekutimi i tij nuk është i lidhur as me afat, as me kusht dhe as me ndonjë kufizim tjetër; d) të përmbushë kushtet e formës, p.sh. duhet të përmbajë nënshkrimin e gjyqtarit/gjyqtarëve, vulën e gjykatës etj.

Përcaktimi i elementëve, që e bëjnë detyrimin e përmbajtur në vendimin gjyqësor-titull ekzekutiv, të plotë, është mjaft i rëndësishëm, p.sh., lind problemi në rastin kur në vendimin e saj, gjykata, veç përcaktimit të detyrimit kryesor, në terma konkrete, disponon edhe për detyrimin për pagimin e kamatëvonesës apo interesit deri në ditën e ekzekutimit të vendimit⁸⁵. Duhet të jenë vendime të tilla detyruese të pakushtëzuara ato që kanë të bëjnë me detyrimin e palës, për pagimin e një shume të hollash, dorëzimin e një sendi, shembjen e një ndërtimi, kthimin në vendin e mëparshëm të punës, pagimit të pensionit ushqimor etj.

2.5.1. Vendimet civile për sigurimin e padisë, si tituj ekzekutiv

Në nenin 510/a parashikohen si tituj ekzekutiv edhe vendimet për sigurimin e padisë. Kur flasim për vendimet civile të dhëna për sigurimin e padisë, kemi parasysh ato vendime që merren në bazë të rregullimit ligjor të parashikuar nga nenet 202-208 të K.Pr.Civile, neni 329, 609/3, si dhe neni 418 për rastin, kur vendimi për sigurimin e padisë është dhënë nga gjykata e arbitrazhit. Këto masa procedurale kanë karakter të përkohshëm, janë të lidhura me procesin dhe kanë forcë të menjëhershme ekzekutive. Pavarësisht, se nuk gëzojnë cilësinë procedurale të gjësë së gjykuar, shërbejnë për të garantuar në fund ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ky institut procedural është vendosur me qëllim për të mbrojtur të drejtat e paditësit kundrejt të paditurit.

Marrja e masave të përkohëshme të sigurimit të padisë synon “ta mbajë gjendjen ashtu siç është”, apo “të ngrirë”, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, e cila për vetë natyrën e çështjes, duhet të realizohet nëpërmjet një procedurë të shpejtë dhe relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur, gjithsesi, që të respektohet një standard i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor⁸⁶.

Në nenin 202 të K.Pr.Civile janë përcaktuar rastet, kur gjykata duhet të lejojë sigurimin e padisë, pra fillimisht duhet të ekzistojë mundësia e një të drejte subjektive për të cilën kërkohet mbrojtje nëpërmjet padisë, dhe më pas të ekzistojë frika se, në të ardhmen ekzekutimi i vendimit do të bëhet i pamundur ose tepër i vështirë. Për këtë, padia duhet të mbështet në prova shkresore ose paditësi jep garanci, në masën dhe llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Kur ka prova me shkresë, nuk është e detyrueshme që të vendoset garancia bankare, por është në vlerësim të gjykatës nëse duhet vendosur ose jo kjo garanci.

Sipas gërmës a) të nenit 202/2 të K.Pr.C, gjykata duhet të ketë parasysh që të plotësohen dy kushte njëherësh, të cilët janë: pala kërkuese të ketë paraqitur prova shkresore dhe të ketë

⁸⁵ Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr.1622, date 16.10.2014, i cili është lene në fuqi me vendimin nr. 1194, date 28.10.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë

⁸⁶Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë Nr.10 datë 24.03.2004

dyshime se ekzekutimi i vendimit bëhet i pamundur ose i vështirë. Por gjykata nuk ka asnjë të drejtë që të bëjë vlerësimin e provave shkresore të paraqitura nga kërkuesi, sepse kjo do ta çonte atë në paragjykimin e zgjidhjes së çështjes në themel, duke cënuar parimin e rëndësishëm të zhvillimit të rregullt të një procesi gjyqësor, të parashikuar nga neni 4 i K.Pr.Civil⁸⁷.

Bazuar mbi shkaqet, që justifikojnë marrjen e vendimit të sigurimit, gjykata në përputhje me nenin 206 të K.Pr.Civile, vendos për masën ose masat e sigurimit, por gjithmonë për një shumë të përgjithshme jo më të madhe se atë të padisë. Masa kryesore e përkohshme e sigurimit të padisë, është ajo e parashikuar në pikën “a” të dispozitës së mësipërme: kjo masë quhet sekuestro konservative dhe ka të bëjë me sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe i kredive të debitorit.

Llojet e tjera të masave të sigurimit të padisë, sipas parashikimit të pikës “b” të nenit 206 të K.Pr.Civile, janë lënë në diskrecion të gjykatës të vendosë rast pas rasti, për atë masë të natyrës së sigurimit të padisë, që ajo e gjykon të përshtatshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të të paditurit.

Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë është unifikuar në lidhje me dhënien e masës së sigurimit të padisë. Vendimin për marrjen e masës së përkohëshme për sigurimin e padisë nuk duhet mbështetur në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Kjo, me qëllim, që të shmangë çdo lloj perceptimi, sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanëshme në gjykim. Urdhërimi për të kryer i padituri atë që kërkon paditësi nëpërmjet padisë nuk mund të vendoset me anë të një mase të përkohëshme të sigurimit të padisë. E thënë ndryshe, masa e përkohëshme e sigurimit të padisë, që vendoset nga gjykata, nuk ka kuptim të jetë e njëjtë me urdhërimin për përmbushjen e kërkit të palës paditëse të shprehur në objektin e padisë.⁸⁸

Këtu i duhet kushtuar rëndësi e veçantë formulimit të dispozitivit të vendimit për sigurimin e padisë, në mënyrë që ai të jetë i ekzekutueshëm. Për këtë, gjykata duhet të ketë paraprakisht të dhëna të sakta të bazuara në prova. Në nenin 208 të K.Pr.Civile përcaktohet, se masa e sigurimit, si titull ekzekutiv, ekzekutohet sipas rregullave të përcaktuara në nenet 540 dhe 581 të K.Pr.Civile, që rregullojnë ekzekutimin e detyrueshëm mbi sendet e luajtshme ose të paluajtshme. Gjithashtu, vlen të theksohet se përbëjnë tituj ekzekutiv, vetëm ato vendime të gjykatës, që lejojnë marrjen e masave për sigurimin e padisë, pasi ankimi ndaj tyre nuk e pezullon ekzekutimin.

Ndërkohë nuk janë tituj ekzekutiv dhe nuk ekzekutohen pa marrë formë të prerë, vendimet për heqjen ose zëvendësimin e masës së sigurimit të padisë, sipas nenit 207 të K.Pr.Civile. Kjo, pasi ankimi ndaj këtyre vendimeve pezullon ekzekutimin e tyre, gjë që përcaktohet në nenin 210 K.Pr.Civile. Vendimi për marrjen e masës për sigurimin e padisë, qëndron në fuqi edhe pas përfundimit të shqyrtimit në themel të çështjes dhe dhënies së vendimit nga gjykata e shkallës së parë, deri sa të shprehet gjykata e apelit, nëse ka ankim dhe në varësi të vendimit të kësaj të fundit.

⁸⁷Vendimi i Gjykatës së Lartë Nr.227 datë 08.05.2012

⁸⁸Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr.10 datë 24.03.2004 faqe nr.5

Për rastet, kur ndaj vendimit të shkallës së parë ushtrohet ankim nga njëra ose të dyja palët, nëse pranohet padia, ligjërohet masa; nëse rrëzohet padia, hiqet masa, por ajo mbetet në fuqi deri sa gjykata e apelit të vendosë, eventualisht, lënien në fuqi të vendimit të rrëzimit të padisë të dhënë nga gjykata e shkallës së parë. E njëjta gjë ndodh nëse pushohet gjykimi i çështjes. Përsa i përket pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin unifikues⁸⁹, se një gjë e tillë mund të kërkohet, duke përdorur si bazë ligjore nenin 329 dhe jo 202 të K.Pr.Civile. Nëpërmjet ekzekutimit të një vendimi të ndërmjetëm, siç është vendimi për sigurimin e padisë, pra një vendim jo përfundimtar e i formës së prerë, legjislatori ka ceduar dhe ka bërë lëshime nga filozofia ligjore e drejtësisë e matur në emër dhe për llogari të drejtësisë efektive⁹⁰.

2.5.2. Vendimet me ekzekutim të përkohshëm, si tituj ekzekutiv

Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, procesi i ekzekutimit të detyrueshëm mund të fillojë edhe pa marrë formë të prerë vendimi përfundimtar. Pra marrja formë të prerë nuk është një kusht pa të cilin nuk mund të fillojë ky proces. Rastet kur një vendim përfundimtar, që nuk ka marrë formë të prerë, të përbëjë titull ekzekutiv janë të përcaktuar në nenin 317 të K.Pr.Civile. Këto vendime për ekzekutim të përkohshëm janë të njëjta me ato për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Përveç rasteve të parashikuara në mënyrë taksative, në dispozitë, duhet marrë në konsiderat edhe diskrecioni i gjykatës, që të bëjë një gjë të tillë edhe në raste të tjera, për çdo lloj vendimi gjyqësor përfundimtar.

Por paditësi ka detyrimin të provojë, kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose kur ekzekutimi do të vështirësohej së tepërmi, se ai mund të pësojë dëme të rëndësishme dhe të pariparueshme. Në këtë rast shkaqet e lejitimit të ekzekutimit të përkohshëm rrjedhin jo nga natyra juridike e padisë dhe qëllimit që ajo synon të plotësojë, por nga gjendja e faktit, e cila duhet t'i krijojë bindjen gjykatës se ekziston rreziku i parashikuar në ligj. Gjykata mund të japë vendim për ekzekutim të përkohshëm në rastet e dhënies së detyrimit për ushqim, shpërblimit që rrjedh nga marrëdhëniet e punës si dhe për rivendosjen në posedimin e banesës bashkëshortore. Dhënia e garancisë, në funksion të mbrojtjes së interesave të të paditurit, vlerësohet prej gjykatës për rastet e parashikuar nga neni 317, paragrafi i fundit. Gjykata shprehet për ekzekutimin e përkohshëm me vendim përfundimtar, dhe jo me vendim të ndërmjetëm.

Duke qënë se vendimet për ekzekutimin e përkohshëm janë një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, gjykata duhet të argumentojë për shkaqet që e kanë shtyrë në pranimin e kërkesës për lejimin e ekzekutimit të përkohshëm. Kur vendimi i dhënë me ekzekutim të përkohshëm, prishet nga Gjykata e Apelit ose nga Gjykata e Lartë, ekzekutimi i vendimit pezullohet dhe pala e paditur ka të drejtë në bazë të nenit 319 të K.Pr.Civile, të kërkojë kthimin e asaj që është ekzekutuar padrejtësisht.

⁸⁹ Po aty faqe nr.6

⁹⁰ Florjan Kalaja, "Dilema Kushtetuese I", botuar nga shtëpia botuese Fan Noli, faqe 407, Tiranë 2015

Ekzekutimi i vendimeve në fushën e së drejtës familjare i nënshtrohet dispozitave, që parashikon K.Pr.Civile për të gjithë titujt ekzekutiv. Kështu, sa i takon pagesës së shumës në të holla, që përbën detyrimin për ushqim, ekzekutimi ndjek rregullat e ekzekutimit të detyrimeve në të holla kundrejt personave fizikë e juridikë. Përsa i takon rivendosjes në posedim të banesës bashkëshortore, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 602, sa i takon realizimit të së drejtës së takimit me fëmijën, janë të aplikueshme, rast pas rasti, dispozitat e kreut për ekzekutimi i detyrimit për kryerjen e një veprimi të caktuar.

Në praktikë janë jo të pakta rastet, kur përmbaruesi gjyqësor përballet me vështirësi për të ekzekutuar detyrimin për pagimin e pensionit ushqimor, kur pala debitore nuk ndodhet në territorin e vendit. Praktika përmbarimore në këtë fushë nuk është konsoliduar, në mënyrë që përmbaruesi gjyqësor duke shfrytëzuar të gjitha parashikimet e instrumenteve ndërkombëtarë të ratifikuara prej vendit tonë dhe që janë në fuqi⁹¹, të bëjë të mundur zbatimin e vendimit gjyqësor, qoftë nëpërmjet dorëzimit të akteve a njoftimeve autoriteteve respektive të shtetit të kërkuar, qoftë duke kërkuar nga këto të fundit ekzekutimin e vetë vendimit. Kështu, pala kreditore e pakënaqur me ecurinë ekzekutimit të vendimit gjyqësor, vazhdon kalvarin gjyqësor deri sa të arrijë ekzekutimin e të drejtës që i takon. I tillë është rasti *Bajramaj kundër Shqipërisë*, ku Shqipëria është dënuar nga Gjykata e Strasburgut për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, pasi ka dështuar në ekzekutimin e vendimit lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe së drejtës për takimin e fëmijës, duke qenë se pala debitore jetonte jashtë vendit⁹².

2.5.3. Vendimet penale të formës së prerë, si tituj ekzekutiv

Vendimet penale të formës së prerë do të konsiderohen tituj ekzekutiv vetëm për atë pjesë ku disponohet për të drejta pasurore. Tre janë rastet kur vendimi penal i formës së prerë disponon mbi të drejtat pasurore.

Së pari, kur është disponuar mbi padinë civile të paraqitur dhe të pranuar për shqyrtim në procesin penal. Në këtë rast është vetë personi, që i janë njohur të drejta pasurore, pra, kreditori ose i dëmtuari civil, ai që do të kërkojë lëshimin e urdhërit të ekzekutimit nga gjykata dhe më pas, vënien në ekzekutim nga zyra e përmbarimit, sipas parashikimeve të K.Pr.Civile. Në rast se pala e dëmtuar gjyqësore është shteti, atëherë organi kompetent shtetëror vepron sipas mënyrës së sipërcituar dhe në mungesë të tij, prokurori ka të drejtë të urdhërojë drejtpërdrejt ekzekutimin e vendimit nga zyra e përmbarimit shtetëror⁹³. Në këtë rast mund të themi, se nuk cënohet parashikimi i nenit 511/a të K.Pr.Civile, që përcakton gjykatën si kompetente për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.

⁹¹ Konventa e Hagës "Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes", bërë në Hagë më 23 nëntor 2007, ratifikuar me ligjin nr.63 datë 31.05.2012, marrë nga faqja e internetit <http://www.magjistratura.edu.al/#491>, aksesuar për herë të fundit në datë 06.03.2016

⁹² Vendim nr.35853/04 çështja *Bajrami kundër Shqipërisë* datë 12 dhjetor 2006, marrë nga faqja e internetit <http://www.qbz.gov.al/botime/permbledhese/Permbledhje%20e%20vendimeve%20te%20Gjykates%20Europiane%20oper%20te%20Drejtat%20e%20Njeriut.pdf>, faqe 81 aksesuar për herë të fundit në datë 06.03.2016

⁹³ Nenin 15 të Ligjit 8331, datë 21.04.1998, "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale"

Së dyti, përbëjnë tituj ekzekutiv vendimet penale për pjesën që përmban si dënim plotësues atë të konfiskimit të mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe përfitimeve prej saj⁹⁴. Këto vendime vihen në ekzekutim nga zyra e përmbartimit mbi bazën e urdhërit të ekzekutimit jo më të lëshuar nga gjykata, por nga prokurori. Mendojmë se në këtë mënyrë duhen kuptuar dhe interpretuar edhe vendimet e tjera penale për pjesët ku disponojnë për provat materiale⁹⁵, ato që kanë të bëjnë me ekzekutimin e masës së sekuestros⁹⁶.

Së treti, janë gjithashtu tituj ekzekutiv vendimet penale që përmbajnë dënim penal me gjobë⁹⁷. Parashikohet se këto vendime vihen në ekzekutim nga zyra e përmbartimit mbi bazën e urdhërit të ekzekutimit të lëshuar nga prokurori, ku përcaktohen dhe modalitetet përkatëse.

Së fundi, vendimet penale për pjesën që bën fjalë për shpenzimet gjyqësore edhe në këtë rast është zyra e përmbartimit që ekzekuton vendimin, mbi bazën e urdhërit të ekzekutimit të lëshuar nga prokurori⁹⁸.

2.5.4. Vendimet e gjykatave dhe arbitrazheve të shteteve të huaja, si tituj ekzekutiv

Neni 510 paragrafi *c* i K.Pr.Civile parashikon si tituj ekzekutiv edhe vendimet e gjykatave të arbitrazhit apo arbitrazhit të shteteve të huaja, që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij kodi, për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj. Përsa i përket vendimeve të gjykatave dhe të arbitrazheve të shteteve të huaja, ekzekutimi i tyre bëhet mbi bazën e urdhërit të ekzekutimit të lëshuar nga gjykata e apelit, e cila bën dhe njohjen e tyre, duke i dhënë fuqi juridike brenda territorit të R.SH⁹⁹.

Pasi vendimi gjyqësor i huaj është njohur dhe i është dhënë fuqi juridike, gjatë fazës së vënies së tij në ekzekutim zbatohen gjithmonë normat procedurale të shtetit, ku bëhet ekzekutimi. Pra, nuk mjafton që vendimi i autoritetit të huaj, i cili është ngarkuar me dhënien e drejtësisë, të këtë marrë formë të prerë, por duhet që të jëtë titull ekzekutiv, në të kundërt nuk mund të ekzekutohet. Për këtë arsye, vendimi i autoritetit të huaj, duhet të kalojë në një gjykim njohës, përveç kur ka një marrëveshje ndërkombëtare që e shmang procedurën e njohjes të përcaktuar në K.Pr.Civile. Pranimi i një parimi të tillë, është mjaft i rëndësishëm për funksionimin e drejtësisë, pasi nëse në një shtet është dhënë një vendim gjyqësor dhe më pas ky vendim nuk mund të ekzekutohet, pasi pala debitore është larguar dhe ka vendndodhjen në një shtet tjetër, atëherë moszbatimi i këtij parimi nga shteti do të bënte, që shumë vendime gjyqësore civile apo penale do të mbeteshin pa u ekzekutuar.

⁹⁴ Pika 2 e nenit 30 të Kodit Penal si dhe në nenin 17 dhe 40 të Ligjit 8331, datë 21.04.1998, "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale"

⁹⁵ Neni 190 i K.Pr.Penale

⁹⁶ Neni 273 i K.Pr.Penale dhe neni 17 i ligjit nr. 9284, datë 30/09/2004, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar".

⁹⁷ Nenin 467/1 të K.Pr.Penale, si dhe nenet 17, 32 dhe 33 të Ligjit 8331, datë 21/04/1998, "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale"

⁹⁸ Nenet 463/1, 467/1 dhe 471/1 të K.Pr.Penale

⁹⁹ Neni 395 dhe 399 i K.Pr.Civile

Nevoja për bashkëpunim ndërkombëtar dhe për realizimin e ekonomisë gjyqësore, imponon shmangien nga parimi i sovranitetit dhe lejon njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe gjykatave të arbitrazhit të huaj. Sa më sipër, kërkesa për njohjen e vendimit të gjykatës ose arbitrazhit i paraqitet Gjykatës së Apelit duke e shoqëruar me dokumentacionin e treguar në nenin 396 të K.Pr.Civile. Në këtë rast, Gjykata e Apelit nuk e shqyron çështjen në themel, por kontrollon, nëse vendimi i paraqitur nuk është në kundërshtim me pengesat e nenit 394 të Kodit. Ajo që paraqet rëndësi, është që vendimi i huaj, qoftë ky gjyqësor apo arbitrar, duhet të ketë marrë formë të prerë, pra të ketë fituar fuqi ekzekutive sipas ligjit të shtetit, ku është dhënë. Pasi Gjykata e Apelit e ka njohur vendimin e huaj, atëherë për zbatimin e tij, do të ndiqet e njëjta procedurë e ekzekutimit të detyrueshëm që parashikon K.Pr.Civile.

2.5.5. Vendimet e gjykatës së arbitrazhit, si tituj ekzekutiv

Vendimet e gjykatës së arbitrazhit përbëjnë titull ekzekutiv sipas nenit 510 paragrafi “ç”. Arbitrazhi është një organ, që jep drejtësi. Është menduar si një mjet alternativ, krahas gjykatës, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që rrjedhin nga një marrëdhënie pasurore. Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se, ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t’ia nënshtrojnë arbitrazhit mosmarrëveshjet, që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre¹⁰⁰.

Marrëveshja për gjykimin e çështjes me procedurë arbitrazhi, mund të arrihet edhe pasi ka filluar gjykimi nga një gjykatë kompetente. Në një rast të tillë procesverbali i seancës gjyqësore nënshkruhet nga gjykata dhe nga palët ose përfaqësuesit e tyre. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit është i formës së prerë në lidhje me mosmarrëveshjen e shqyrtuar, sapa shpallet, përveç rasteve të parashikuara nga neni 434 i këtij Kodi. Ai bëhet i ekzekutueshëm forcërisht në bazë të një urdhëri ekzekutimi të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të vendit, ku është dhënë vendimi. Për një qëllim të tillë, në sekretarinë e gjykatës depozitohet origjinali i vendimit me një kopje të marrëveshjes së arbitrazhit, nga një prej arbitrave ose nga pala e interesuar. Kundër vendimit të gjykatës që lëshon urdhër ekzekutimin nuk lejohet ankimi.

2.6. Titujt ekzekutiv jogjyqësor

2.6.1 Akti noterial si titull ekzekutiv

Një akt noterial, që përmban një detyrim në të holla, që të gëzojë cilësinë ligjore të titullit ekzekutiv në kuptim të nenit 510/d të K.Pr.Civile. Ky formulim, që është aktualisht në fuqi, është ndryshuar disa herë, respektivisht, me ligjin nr. 8812, datë 17.05.2001 dhe ligjin me nr.9953, datë 14.07.2008. Kështu, më parë aktet noteriale-tituj ekzekutiv formuloheshin si "aktet noteriale me të

¹⁰⁰ Neni 403 i K.Pr.Civile parashikon: *Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t’ia nënshtrojnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre.*

cilat autorizohet shlyerja e një detyrimi kontraktual, ose e çdo detyrimi tjetër të mëparshëm, drejtpërdrejtë nga depozitat bankare ose nga paga e autorizuesit dhe në kreditë e tij tek të tretët"¹⁰¹. Ai duhet të prodhojë vetëm të drejta për njërën palë dhe vetëm detyrime për palën tjetër, në kuptimin, që nuk duhet të prodhojë detyrime të ndërsjellta, apo të varet nga vërtetimi ose jo i rrethanave të caktuara si dhe duhet të jetë një veprim juridik i njëanshëm në kuptimin e shpërndarjes së të drejtave midis palëve.

Gjithashtu, detyrimet apo të drejtat që prodhon ky veprim juridik formal, duhet të jenë të thjeshta, të pakushtëzuara dhe krejt të pavarura nga njëra tjetra. Ai duhet të jetë përcaktuar saktë dhe qartë dhe të jetë bërë i kërkueshëm. Gjithashtu, detyrimet apo të drejtat që prodhon ky veprim juridik formal duhet të jenë të thjeshta, të pakushtëzuara apo të pakondituara dhe krejt të pavarura nga njëra tjetra.

Jurisprudenca gjyqësore, e konsoliduar tashmë, e ka elaboruar mjaftueshëm konceptin e “akteve noteriale që përmbajnë detyrimin në të holla”, duke nxjerrë në pah disa piketa, të cilat mundësojnë dallimin e atyre akteve që janë tituj ekzekutiv dhe atyre akteve që nuk e gëzojnë dot një cilësi ligjore të tillë. Lidhur me këtë çështje ka mbajtur qëndrimin e saj dhe Gjykata e Lartë, në referim të këtij vendimi unifikues, ku arsyeton se: “që akti noterial të konsiderohej titull ekzekutiv, duhej të plotësojë njëkohësisht këto kushte: 1) të konsistonte në një veprim juridik të njëanshëm, i cili të përmbajë një detyrim të njëanshëm për pagimin e një shume në të holla, ku detyrimi mund të ishte; a) abstrakt, në rastin ku përcaktohet thjesht shuma e detyrimit, pa u treguar origjina e tij, ose b) konkret, kur tregohet se detyrimi buron, p.sh., nga një kontratë e mëparshme. 2) Detyrimi të ishte i përcaktuar saktë, pra, të mos kishte ekuivokë lidhur me masën e tij. 3) Detyrimi të ishte i kërkueshëm. Këto kushte të trajtuara më lart duhet të konkurronin, në mënyrë që akti noterial të konsiderohej titull ekzekutiv.”¹⁰² »

Nëse akti noterial do të përmbante një detyrim, që nuk do ishte përcaktuar saktë, apo nuk do ishte i kërkueshëm, apo do të varej nga plotësimi i ndonjë afati a detyrimi ose kushti nga një palë tjetër, atëherë verifikimi i këtyre rrethanave do të kërkonte domosdoshmërisht shqyrtimin dhe gjykimin e çështjes në themel, mbi bazën e pretendimeve dhe prapësimeve si dhe të provave të paraqitura nga palët.

Ndryshime ka pasur edhe në praktikën gjyqësore në këtë drejtim. Kështu, me vendimin nr.427, datë 11.04.2006, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, argumenton se janë titull

¹⁰¹ Vendimi Unifikues nr.980, datë. 29.09.2000 i Gjykatës së Lartë Tiranë

¹⁰²Vendimi Unifikues nr.980, datë. 29/09/2000 i Gjykatës së Lartë Tiranë, i njëjti qëndrim është mbajtur edhe në Vendimin Nr.222 datë 03.05.2011 e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili argumenton se: *Marrëveshja e huasë e datës 20.12.1995 është lidhur ndërmjet një institucioni bankar dhe një personi që ka cilësinë e kredimarrësit. Ajo përmban shumën e marrë kredi, interesin vjetor, afatin e kthimit dhe shumën që kërkohet të kthehet, prandaj i përmban të gjitha elementët e një akti për dhënien e kredisë bankare dhe në këtë kuptim përmbën titull ekzekutiv sipas nenit 510/d të K.Pr.Civile. Kolegji Civil vlerëson që vendimi unifikues nr.980, datë 29.09.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të cilit i referohet gjykata e apelit nuk bën fjalë për aktet e dhënies së kredisë bankare, por për aktet noteriale që kanë të bëjnë me shitblerjen e letrave me vlerë, për të cilat Kolegjet e Bashkuara kanë arritur në përfundimin që ato nuk mund të jenë tituj ekzekutiv dhe orientohet praktika gjyqësore që, mosmarrëveshjet ndërmjet palëve për këto raste mund të zgjidhen vetëm me padi themeli.*

ekzekutiv të gjitha ato akte noteriale që përmbajnë detyrime në të holla, duke përmendur si të tillë dhe kontratën e huasë, e redaktuar nga noteri¹⁰³.

Akti noterial, si titull ekzekutiv, duhet të përmbajë në vetvete një veprim juridik me detyrim të njëanshëm dhe abstrakt për pagimin e një shume të caktuar në para. Akti për pagimin e një shume në para, i hartuar në formën e një deklarate noteriale, duke qenë titull ekzekutiv, mund të goditet vetëm për falsitet ose të kundërshtohet vetëm për shkaqet e parashikuara në nenin 609/1 të K.Pr.Civile¹⁰⁴.

Praktika gjyqësore identifikon dy forma të aktit noterial të lidhur mes personave dhe aktet për dhënien e kredive bankare nga ana e subjekteve dhe institucioneve të parashikuara me ligj, si format kryesore të kontratës së huasë¹⁰⁵. Në rastin kur një akt noterial përmban një detyrimin në të holla, subjektet që janë palë të këtij akti duhet të parashikojnë dhe të përcaktojnë mënyrën dhe periodicitetin e përmbushjes së detyrimit¹⁰⁶. Për shkak të vërtetimit të përmbushjes së këtij detyrimi, subjektet duhet të konsiderojnë dhe formën e aktit me të cilin ato do të pranojnë përmbushjen e detyrimit për efekt provueshmërie.

Pra, që akti noterial të jetë titull ekzekutiv¹⁰⁷, në kuptim të nenit 510 shkronja "d" të ndryshuar të K.Pr.Civile, ky akt, duhet të përmbajë edhe shkakun e ligjshëm të lindjes së detyrimit¹⁰⁸. Është e rëndësishme të konstatohet se e njëjta mbrojtje ligjore që i rezervohet me ligj ekzekutimit të akteve për dhënien e kredive bankare, pra dhënie hua në formë kredie, duhet të njihet dhe të zbatohet dhe në marrëdhëniet kontraktuale mes personave me objekt dhënien në pronësi të një shume të hollash në kushtet e parashikuara nga neni 1050 i Kodit Civil në aktin noterial. Duke sanksionuar me ligj aktet e dhënies së kredisë bankare në cilësinë e titullit ekzekutiv, i kërkueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë nga huadhënësi, Gjykata Kushtetuese vlerëson, se ligjvënësi ka ndjekur një qëllim të përligjur dhe të justifikuar, në këndvështrimin e konceptit kushtetues "interes publik"¹⁰⁹.

¹⁰³ Vendimin nr.427, datë 11.04.2006, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë cmon se: *Ka qënë vullneti i ligjvënësit, që me ndryshimin e dispozitës së nenit 510/d të Kodit të Procedurës Civile, të parashikonte si titull ekzekutiv të gjitha ato akte noteriale që përmbajnë detyrime në të holla, e si të tillë dhe kontratën e huasë, e redaktuar nga noteri.*

¹⁰⁴ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.109, datë 11.02.2016

¹⁰⁵ Vendimin nr.427, datë 11.04.2006, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë faqe 4 arsyeton se: *Është e rëndësishme të konstatohet se e njëjta mbrojtje ligjore që i rezervohet me ligj ekzekutimit të akteve për dhënien e kredive bankare (dhënie hua në formë kredie) duhet të njihet dhe të zbatohet dhe në marrëdhëniet kontraktuale mes personave me objekt dhënien në pronësi të një shume të hollash në kushtet e parashikuara nga neni 1050 i Kodit Civil në aktin noterial.*

¹⁰⁶ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.77, datë 12.02.2015 arsyeton se: *mosmarrëveshja objekt gjykimi është e një natyre krejt tjetër, akt marrëveshja e lidhur ndërmjet palëve në zbatim të nenit 510/d të K.Pr.Civile është një akt noterial i cili përmban një detyrim në të holla, të përcaktuar qartë, që për nga natyra barazohet me aktet për dhënien e kredive bankare dhe përbën titull ekzekutiv.*

¹⁰⁷ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.558, datë 30.10.2014 arsyeton se: *Kontrata e huasë me nr.1942 rep, nr.748 kol, datë 11.06.2008 të lidhur ndërmjet palëve nuk përbën titull ekzekutiv, pasi e bën këtë kontratë të ndërvarur me veprime pasuese sipas vullnetit të shprehur nga debitori dhe jo menjëherë të ekzekutueshme, pranimi nga ana e gjykatave të kundërshtimit të veprimeve përmbartimore nga pala paditëse dhe të deklarimit të pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv të vendimit gjyqësor, duhet konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligjin procedural nënen 510,609 dhe 610 të Kodit të Procedurës Civile.*

¹⁰⁸ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.427, datë 11.04.2006

¹⁰⁹ Vendimi nr.52, datë 05.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese

Sanksionimi me ligj si titull ekzekutiv i akteve për dhënien e kredive bankare, krijon masa lehtësuese ligjore për rikuperimin sa më të shpejtë dhe efikas të kredive bankare, si dhe përbën një garanci për sistemin bankar që e vendos atë në një raport më të favorshëm kundrejt huadhënësve të tjerë. Në këtë rast, legjislatori e ka bërë evidente ekzistencën e një dallimi për subjektet bankare, duke e spostuar barrën e të provuarit nga huadhënësi tek huamarrësi, duke sqaruar dallimin gjatë fazës së lëshimit të urdhërit të ekzekutimit për kontratën e kredive bankare¹¹⁰.

Kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit presupozon se kontrata e kredisë bankare do të konsiderohet e zgjidhur dhe detyrimi përbëhet nga pjesa e principalit të pashlyer ende deri në këtë datë, si dhe interesat mbi këtë shumë, deri në këtë datë. Mendojmë se për këtë shumë, duhet të lëshohet edhe urdhëri i ekzekutimit, duke bërë edhe specifikimin përkatës. Llogaritja e interesave dhe penaliteteve pas datës së lëshimit të urdhërit të ekzekutimit, nuk ka ende një zgjidhje përfundimtare apo të unifikuar nga ana e legjislacionit aktual, por këto vakume ligjore nuk mund të lejohen të shfrytëzohen në favor të palëve kreditore, duke cënuar ndjeshëm interesat e palëve debitore.

Përmbauesit gjyqësor janë dëshmitarë të shumë rasteve, ku me qindra debitorë të çdo lloji kategorie kredimarrësish gjenden përballë vlerave të shtuara të detyrimit, për shkak të aplikimit të interesave dhe penaliteteve, si pasojë e kalimit të një kohe të gjatë që nga momenti i mospërmbushjes së detyrimit dhe deri në momentin e fillimit të procedurës përmbaimore ekzekutive. Mendojmë se, trupa përmbaimore nuk duhet të marrë në konsideratë një situatë tillë, e cila nuk gjen mbështetje ligjore. Të njëjtin qëndrim ka shprehur edhe Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësor Privatë me anë të një direktive orientuese dhe unifikuese¹¹¹. Në të parashikohet, se përmbauesit gjyqësor nuk mund të ekzekutojnë vlera të reja detyrimi, përveçse vlerës përfundimtare të titullit të ekzekutimit, për të cilin urdhëri ka dalë si vendim ekzekutues, në kundërshtim me pretendimin bankar për vazhdimin e ekzekutimit përmbaimor me praktikën e vërtetimeve të ndryshueshme të detyrimeve, ku debitorëve përgjatë procesit do të duhet t'u ekzekutohen edhe interesat apo penalitetet e përllogaritura pas datës së lëshimit të urdhërit të ekzekutimit¹¹².

Në vendimin nr.170, datë 13.04.2010 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë analizon dispozitën 510/d të K.Pr.Civile duke nxjerrë në pah, se nëse akti noterial nuk përmban kushtet e nevojshme të vlefshmërisë, që parashikohen nga nenit 49 të ligjit nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”¹¹³,

¹¹⁰Vendimi nr.39, datë 16.10.2007 i Gjykatës Kushtetuese

¹¹¹ Direktiva nr.61.Prot date 09.02.2015 e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privat

¹¹² Parashtrime, komente dhe problematika të ngritura nga këndvështrimi i juristit përmbaimor / 11 pika shtjelluese, adresuese edhe argumentuese në lidhje me “kreditë e këqija” në Shqipëri, nr.92.Prot datë 06.05.2015, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësor Privat, faqe 20

¹¹³Nenit 49 të ligjit nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, parashikohet se: *Akti noterial hartohet nga noteri në prani të palëve.*

Akti noterial duhet të përmbajë:

a) Ditën, muajin dhe vitin e redaktimit, llojin e aktit dhe kur është rasti, orën dhe minutën e fillimit dhe atë të mbarimit të tij;

b) vendin e redaktimit të tij dhe numrin e repertorit;

c) emrin dhe mbiemrin e noterit dhe vendin ku ndodhet zyra noteriale;

ç) emrin dhe mbiemrin, emrin e atit, datëlindjen, profesionin dhe vendbanimin e palëve, emërtimin dhe qendrën, kur

pra mungesa e nënshkrimit të noterit përpara të cilit është deklaruar vullneti i lirë i palëve, përbën një shkak ligjor, i cili e bën nul aktin noterial. Mendojmë se, duke mos plotësuar kushtet për të qenë akt noterial, në vështrim të përmbajtjes së nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile dhe sipas përmbajtjes së nenit 609 të K.Pr.Civile, nuk mund të jetë as titull ekzekutiv, pasi është i pavlefshëm¹¹⁴.

2.6.2. Titujt dhe letrat me urdhër që barazohen me to

Cilësimi i këtyre letrave me vlerë si tituj ekzekutiv është lehtësisht i kuptueshëm. Këto lloj titujsh, që janë parashikuar në nenin 510/dh të K.Pr.Civile, janë instrumente financiare, të cilat emetohen dhe tregtohen për sigurimin e fitimit, nëpërmjet administrimit të të drejtave, që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Në termin “tituj” përfshihen pa kufizim aksionet, obligacionet e shoqërive tregtare dhe të pushtetit vendor, bonot e thesarit dhe obligacionet e emetuara nga shteti shqiptar, titujt e emetuar nga Banka e Shqipërisë, dëftesat tregtare, aksionet ose kuotat e fondeve të investimit, si dhe instrumente të tjera financiare, të krahasueshme me aksionet dhe obligacionet dhe që vlerësohen dhe miratohen si të tilla nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare¹¹⁵.

Titujt mund të jenë, tituj të pjesëmarrjes në kapital, tituj borxhi, aksione ose kuota të fondit të investimeve apo fondit të pensioneve. Tituj të pjesëmarrjes në kapital janë tituj, të cilët provojnë të drejtat dhe detyrimet për një pjesë të kapitalit minimal apo atij të regjistruar të shoqërisë aksionere. Titujt e borxhit janë instrumente, të cilat provojnë të drejtat dhe detyrimet e lindura nga marrëdhënia debitor-kreditor, ndërmjet emetuesit dhe mbajtësit të titullit. Aksionet ose kuotat e fondit të investimeve janë titujt, që krijojnë të drejta dhe detyrime, që lidhen me një pjesë të kapitalit të një fondi investimesh. Aksionet e fondit të pensioneve janë tituj, që krijojnë të drejta dhe detyrime të lidhura me një pjesë të kapitalit të një fondi pensionesh. Detyrimi i emetuesit për të paguar principalin dhe interesin mund të sigurohet përmes një barre hipotekore për prona të paluajtshme dhe vënieje si garanci për tituj, vlera e të cilave nuk duhet të jetë më e vogël se detyrimi total i emetuesit për të gjithë titujt e garantuar.¹¹⁶

Kambiali është një urdhër i pakushtëzuar për të paguar një shumë të caktuar parash dhe ka të shkruar në trupin e instrumentit të dhënat e mëposhtme: emrin e personit që është i detyruar të

është fjala për person juridik; emrin, atësinë dhe mbiemrin e përfaqësuesve të tyre dhe të çdo personi tjetër pjesëmarrës në akt, si dhe verifikimin e bërë nga noteri për identitetin e palëve, zotësinë juridike dhe zotësinë e tyre për të vepruar.

d) deklarimet e palëve dhe aktet që paraqiten prej tyre;

dh) tregimin e qartë të sendeve që përbëjnë objektin e aktit me gjithë cilësitë dhe shenjat dalluese të tyre. Kur sendet janë të paluajtshme, tregohen në përbërje të tyre vendi i ndodhjes dhe kufijtë e saktë;

e) në akt përmenden ndodhi serioze që mund të jenë vërtetuar gjatë redaktimit të tij, kur e kërkojnë palët;

ë) faktin se noteri ua lexoi e u shpjegoi aktin palëve dhe deklarimet e tyre se e kanë kuptuar dhe e pranojnë atë, si dhe faktin e vënies së nënshkrimeve në prani të noterit; kur është rasti, akti duhet të përmbajë edhe numrin e pagimit e ndonjë sasi parash të kryer në prani të tij;

f) nënshkrimin e palëve të të gjithë personave të pranishëm në akt, si dhe atë të noterit dhe vulën e tij.

¹¹⁴Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartënr.170, datë 13.04.2010

¹¹⁵ Shih nenin 3 të ligjit nr.9879 datë 21.02.2008 “Për Titujt”

¹¹⁶ Po aty shih neni 104

paguajë kambialin (pritësi), një deklaratë të kohës së pagesës, një deklaratë të vendit ku kryhet pagesa, emrin e personit të cilit ose të cilëve u kryhet urdhër-pagesa, një deklaratë të datës dhe vendit ku emetohet kambiali dhe nënshkrimin e personit që emeton kambialin (lëshuesi)¹¹⁷.

Kambiali është titull ekzekutiv për shumën bazë të tij, interesin dhe shpenzimet, në përputhje me dispozitat përkatëse të K.Pr.Civile. Ekzekutimi i mëtejshëm mbi kambialin nuk pezullohet, përveç rasteve kur kemi arsye të bazuara shumë serioze, sipas rregullave përkatëse të K.Pr.Civile. Në çdo procedurë gjyqësore të bazuar në veprimet mbi kambialin, debitori mund të ngrejë padi sipas nenit 2 të këtij ligji vetëm për përjashtimet për pavlefshmërinë e kambialit, të cilat nuk ndalohen në përputhje me nenin 17 të këtij ligji. Në rastin e pretendimeve të ngritura nga debitori, kur kërkohet një sqarim i provave të reja, gjykata me kërkesën e kreditorit, nxjerr një vendim gjyqësor të përkohshëm për pagesën. Në këtë rast, sipas vlerësimit të saj, gjykata vendos një masë sigurimi me depozitë garancie, kur ajo e quan të nevojshme, sipas dispozitave përkatëse të K.Pr.Civile. Të gjitha veprimet të rrjedhura nga kambiali kundrejt pranuesit, parashkruhen me kalimin e tre vjetëve, duke filluar që nga data e maturimit.

Premtim-pagesë është një premtim i pakushtëzuar për të paguar një shumë të caktuar parash. Dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet për kambialin zbatohen dhe për premtim-pagesa, deri atëherë kur ato nuk janë kontradiktore me natyrën e këtij instrumenti. Vendi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv merr rëndësi në rastin e akteve noteriale, që përmbajnë detyrime në të holla, kambialeve, çeqeve etj dhe akteve që përcaktohen si tituj ekzekutiv nga ligje të veçanta, të parashikuara, përkatësisht nga pika “d”, “dh” dhe “e” e nenit 510 të K.Pr.C. Në këto raste, kompetente për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit është pikërisht gjykata e vendit ku është caktuar ose parashikohet të bëhet ekzekutimi.

Zgjidhja e konflikteve, që mund të kenë palët me njëra-tjetrën, si ato që lidhen me detyrimet e marra përsipër me kontratën e shitjes se letrave me vlerë, ashtu dhe ato që mund të kenë për detyrime të tjera të ndërsjellta midis tyre, mund të realizohet vetëm në rrugën e zakonshme duke paraqitur në gjykatë padi themeli¹¹⁸.

2.6.3. Aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta, quhen tituj ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre

Në bazë të nenit 510 të K.Pr.Civile, ne gjejmë të rradhitur se çfarë konsideron ligji si titull ekzekutiv, dhe në germën “e” janë parashikuar edhe rastet e titujve ekzekutiv të parashikuar në ligje të posaçme. Përcaktimi i një akti si titull ekzekutiv mbart në vetvete pasoja për të drejtën e pronës ose të drejta të tjera, pasi një akt i tillë është i ekzekutueshëm mbi pasurinë ose të drejta të tjera të debitorit. Për këtë motiv, përcaktimi si titull ekzekutiv i një akti, që nuk parashikohet në nenin 510 të K.Pr.Civile, mund të bëhet vetëm përmes një ligji të miratuar me të njëjtën shumicë me Kodin, pasi në këtë rast jemi përpara rezervës ligjore të përforcuar.

¹¹⁷ Ligji Nr.8077 datë 22.02.1996 “Për kambialin dhe premtim-pagesën”

¹¹⁸ Shihni vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr.980 date 29.09.2000

Si raste të parashikuara në ligje të veçanta sipas nenit 510/e përmendim, vendimin përfundimtar të gjykatës administrative, që ka marrë formë të prerë, dhe vendimi për sigurimin e padisë, të cilët vihen në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor me kërkesën e palës kreditore¹¹⁹, fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike¹²⁰; fatura tatimore e konsumit të ujit të pijshëm¹²¹; kundravajtja administrative e caktuar nga Enti Rregullator¹²²; urdhëri i menjëherëshëm i mbrojtjes¹²³; vendimet për kundravajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë¹²⁴; gjoba e vendosur nga KQZ-ja¹²⁵; akti që përmban detyrimin për pagesën e kontributit për sigurimet shoqërore¹²⁶. Përzgjedhja e ligjvënësit, nëpërmjet atribuimit të titullit ekzekutiv faturës së energjisë elektrike, është proporcionale me gjendjen që e ka diktuar atë, që është vështirësia në mbledhjen e detyrimeve të konsumatorëve të energjisë elektrike dhe për rrjedhojë, dhe ndikimi negativ në cilësinë e ofrimit të shërbimit¹²⁷.

Si tjetër rast i titujve ekzekutiv sipas 510/e duhen parë edhe aktet doganore. Nga tërësia e akteve të administratës doganore janë tituj ekzekutiv¹²⁸ vetëm ato të cilat nxirren në formën e një vendimi¹²⁹, me qëllim për të garantuar dhe rikuperuar me forcë një borxh doganor,¹³⁰ si dhe kur i janë njoftuar drejtpërsëdrejti debitorit¹³¹. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë është e pasur me shqyrtimin e rasteve të tilla¹³².

Në praktikë ka raste kur, ndonëse ligji i veçantë e përcakton një akt si titull ekzekutiv, nuk parashikon që ngarkohet zyra e përbarimit me ekzekutimin e tij. Pika "e" e nenit 510 të K.Pr.Civle përcakton si kusht një gjë të tillë. Vlen të theksohet, se praktika gjyqësore, ndoshta në mënyrë jo të bazuar, ka anashkaluar këtë fakt, duke i konsideruar këto akte si tituj ekzekutiv, ndonëse ligji që i parashikon si të tillë nuk ngarkon zyrën e përbarimit për ekzekutimin e tyre. Të tilla janë, p.sh, akti që përmban përcaktimin e borxhit doganor, siç parashikohet në nenin 245 të Kodit Doganor ; akti për rikuperimin me forcë të borxhit të akcizës¹³³ ; akti që përmban dënimin me gjobë¹³⁴; akti për pagimin e tarifës së administrimit¹³⁵ ; akti me të cilin administratori

¹¹⁹ Neni 65,66/3 i Ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

¹²⁰ Neni 1 i Ligjit 8662, datë 18/09/2000, "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike"¹²⁰,

¹²¹ Neni 1 i Ligjit 8975, datë 21/11/2002, "Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të përdorura si titull ekzekutiv "

¹²² Neni 32/1 i Ligjit 9915, datë 12/05/2008, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujrave të ndotura, të ndryshuar"

¹²³ Neni 23 i Ligjit 9669, datë 18/12/2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"

¹²⁴ Neni 22 i Ligjit 10279, datë 20/05/2010, "Për kundërvajtjet administrative"

¹²⁵ Neni 176 i Ligjit 10019, datë 29/12/2008, "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

¹²⁶ Neni 2 i Ligjit 8392, datë 02/09/1998, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 7703, datë 11/05/1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"

¹²⁷Vendimi Nr.52, datë 05.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese

¹²⁸Vendimi Unifikues Nr.4, datë 29.01.2003 i Kolegjit të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

¹²⁹ Vendimi nr.544 datë 28.10.2014 i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë

¹³⁰ Vendimi Nr.36, datë 19.02.2009 i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë

¹³¹Neni 245/4 i Kodit Doganor të Republikës të Shqipërisë

¹³²VendimiNr.1, datë 11.01.2011 i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë

¹³³ Neni 103 të ligjit nr. 61/2012 " Për akcizat në Republikën e Shqipërisë"

¹³⁴ Neni 36 të ligjit nr.168/2013 " Për sigurinë në anije dhe në porte"

¹³⁵ Neni 27 të ligjit nr.10112, datë 09/04/2009 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"

i një shoqërie huamarrëse shpall një subjekt debitor ¹³⁶etj. Në rastin që vetë ligji përcakton veç detyrimit, edhe kamatëvonesën si titull ekzekutiv, siç parashikohet në ligjin nr.48/2014, atëherë urdhëri i ekzekutimit lëshohet edhe për pjesën e kamatëvonesës mbi vlerën e detyrimit, pasi vetë ligji e përcakton atë si titull ekzekutiv. Ndërsa në rastin kur ligji përcakton si titull ekzekutiv vetëm shumën e pasqyruar në faturën e konsumit e cila përfaqëson vlerë e detyrimit, atëherë interesat në formën e kamatëvonesave mbi këtë shumë, si shpërblim dëmi për vonesën në përmbushjen e detyrimit, nuk përbën pjesë të titullit ekzekutiv, për të cilin lëshohet urdhëri i ekzekutimit, por duhet të kërkohet me padi themeli.

Një tjetër rast, që përbën titull ekzekutiv sipas nenit 510 paragrafi e) është edhe vendimi i ndërmjetësit. Ndërmjetësimi, është një proces ku marrin pjesë dy a më shumë palë në mosmarrëveshje, të cilët kërkojnë zgjidhje jashtëgjyqësore, të ligjshme e në mirëkuptim. Ai realizohet me ndihmën e një personi të tretë, të kualifikuar dhe asnjans, të zgjedhur nga vetë këto palë, i cili është ndërmjetës i licensuar dhe anëtar i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve. Ndërmjetësimi ofron zgjidhje ligjore jo arbitrare. Aktmarrëveshja e arritur përbën Titull Ekzekutiv¹³⁷ i njëllojtë me Vendimin e Gjykatës së Shkallës Parë dhe në këtë rast, ngarkohet Shërbimi Përmbarimor për ekzekutimin e tij. Procedurat e Ndërmjetësimit përfshijnë rregullat dhe standardet, që duhet të ndiqen për ndërmjetësimin në gjykatë, që nga faza fillestare e referimit të çështjes për ndërmjetësim, deri tek rezultati përfundimtar i procesit të ndërmjetësimi. Në qoftë se palët bien dakord me mirëkuptim, marrëveshja bëhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet në katër kopje: dy për palët, një për t'iu dorëzuar gjykatës, në rast se mosmarrëveshja në fjalë është referuar nga gjykata, i dorëzohet specifikisht kancelarit të gjykatës dhe një kopje, që mbahet në Qendrën e Ndërmjetësimi. Kjo e fundit sipas ligjit, përbën titull ekzekutiv dhe vihet në zbatim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor me kërkesën e palës së interesuar.

Rasti i Procedurës Civile shqiptare është pak i veçantë, pasi i jep vendimit gjyqësor formë të prerë, kur përfundon gjykimi në shkallën e dytë të gjyqësorit, ose siç njihet ndryshe në gjykatën e Apelit. Vendimi i formës së prerë apo që përbën “gjë e gjykuar”, përjashton mundësinë e aktivizimit të juridiksionit rishikues të gjykatave më të larta për të rishqyrtuar sërish atë çka është vendosur në këtë çështje. Pra, autoriteti dhe efektet e gjësë së gjykuar janë përfundimi i procesit civil dhe pamundësia e të njëjtave palë ndërgjyqëse për t'i kërkuar gjykatës që të shqyrtojë dhe vendosë përsëri mbi të njëjtin objekt gjykimi¹³⁸. Kjo do të thotë, se në çdo rast gjëja e gjykuar ka fuqi ekzekutive kundrejt çdo subjekti, që detyrohet të bëjë, të mos bëjë, apo të japë diçka. Problemi qëndron në faktin, se ligji njeh të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi gjyqësor të formës së prerë me një mjet të zakonshëm ankimimi, siç është rekursi në Gjykatën e Lartë. Kjo shkakton një pasiguri juridike për palën, që ka fituar gjyqin, e cila duhet të presë me ankth për një, dy ose tre vjet derisa çështja të shqyrtohet në gjykatën e Lartë, duke i dhënë fund shqyrtimit gjyqësor në hallkat e gjyqësorit. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë. GJK ka çmuar, se cënimi i parimit të gjësë së

¹³⁶ Neni 5 i ligjit 8471, datë 08/04/1999, "Për nxjerrjen e detyrimeve debitorë dhe rikthimin e vlerave pasurore në llogarite e personave juridike, jobankare që kanë marrë hua nga publiku i gjere"

¹³⁷ Siç parashikon Ligji nr.10385, datë 24.02.2011 "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve"

¹³⁸ Florjan Kalaja, *vep. cit.*, faqe 401

gjykuar do të çonte në cënimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cënim të vetë sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës.¹³⁹ Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Për sa më sipër, duhet të bëhen ndryshimet e nevojshme në legjislacion, në mënyrë që vendimi gjyqësor të përbëjë gjë të gjykuar vetëm, pasi përfundon shqyrtimi në gjykatën e Lartë. Këto ndryshime janë të nevojshme dhe përputhen me organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri.

Ky fakt është konstatuar edhe nga jurisprudenca e Gj.E.D.Nj, e cila ka argumentuar, se një vendim gjyqësor përfundimtar, që është bërë *res judicata* është një vendim apo gjykim, që nuk mund të jetë objekt kontrolli nga një instancë më e lartë gjyqësore dhe që eventualisht mund të priset¹⁴⁰. Gj.E.D.Nj ka kritikuar dhe konkluduar se, mosformimi i kuadrit ligjor, që garanton sigurinë juridike, pra *res iudicata*, vjen në kundërshtim me K.E.D.Nj, si dhe me nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konventës. Për këtë i referohet çështjes së "*Mullai v.Albania*"¹⁴¹, duke i kërkuar zgjidhje në ligjin e brendshëm të keqkonceptuar, në lidhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe parimin e sigurisë juridike. Për këtë arsye, mendojme se në përputhje me modelin kushtetues, vendim gjyqësor i formës së prerë, duhet të jetë vetëm vendimi i Gjykatës së Lartë, ose vendime të tjera, të cilat nuk janë ankimuar në afatin e lejuar nga ligji.

Problemi i ndryshimit të vendimeve gjyqësore, pas marrjes formë të prerë të tyre dhe ushtrimit të mjeteve të jashtëzakonshme të ankimit, ka investuar Gjykatën Kushtetuese vitet e fundit. Kjo Gjykatë ka trajtuar parimin e pandryshueshmërisë së vendimeve gjyqësore si pjesë e sigurisë juridike, e cila nuk trajtohet më vetëm në aspektin e akteve normative¹⁴², por shtrihet edhe ndaj vendimeve të gjykatave. Si rregull nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë, vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre, duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit ligjor.

Pasi, çfarë do të ndodhte nëse një vendim gjyqësor i formës së prerë është ekzekutuar dhe pas përfundimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, pala gjyqësore duhet të rikthejë të gjithë shumën monetare të ekzekutuar, praktika e Gjykatës së Lartë i ka dhënë zgjidhje kësaj situatë.

¹³⁹ GJK ka çmuar se ...vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar është shprehje e konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi por dhe siguri kësaj marrëdhënie. Vlerësimi dhe arsyetimi nga ana e gjykatave, lidhur me vendimin gjyqësor të paraqitur si provë nga ana e kërkuarit ka rëndësi dhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Ndërsa, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj duhet të vihet në dyshim.

¹⁴⁰ Çështja Gjyli vs. Albania, nr.32907/07, paragrafi 33-34, dt 29.09.2009 Gj.E.D.Nj

¹⁴¹ Shiko çështjen "*Mullai and other vs. Albania*", Seksioni IV i Gj.E.D.Nj nr. 9074/07, dt 03.03.2010

¹⁴² Shihni vendimin nr.34, datë 28.05.2012 të Gjykatës Kushtetuese, http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php, aksesuar në datën 12.06.2016

Praktika unifikuese e Gjykatës së Lartë ka zgjidhur edhe çështjen e rregullimit të pasojave, të cilat vijnë nga ekzekutimi i një vendimi gjyqësor i formës së prerë, që është prishur nëpërmjet rekursit ose kërkesës për rishikim, në vendimin Nr.1028 datë 27.10.2000 është arsyetuar se: “në të gjitha rastet, kur vendimi i ri që jepet pas prishjes, është i ndryshëm nga vendimi i parë, i cili është ekzekutuar tërësisht ose pjesërisht, personi që ka përfituar, detyrohet të kthejë të gjitha përfitimet që ka marrë nga ekzekutimi i vendimit. Kthimi i përfitimeve, si rregull, duhet të përcaktohet në vendimin e ri të formës së prerë, që jepet pas prishjes së vendimeve të mëparëshme. Megjithatë, edhe në rastet, kur në këtë vendim gjykata nuk shprehet në mënyrë eksplicite për rregullimin e pasojave, që kanë ardhur nga ekzekutimi tërësisht apo pjesërisht i vendimit të padrejtë që është prishur më pas, zgjidhja në këtë mënyrë e pasojave është evidente. Zyra e Përmbarimit që ka bërë ekzekutimin e plotë apo të pjesëshëm të vendimit të padrejtë, që është prishur më pas, me kërkesën e gjyqfituesit, sipas procedurës që përcakton neni 511 i K.Pr.Civile, duhet të detyrojë përfituesin të kthejë të gjitha përfitimet e padrejta.” I njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë Nr.2346 datë 09.10.2012. Mendojmë që, më shumë se një rregullim që duhet të bëjë praktika gjyqësore, kjo çështje duhet rregulluar nga pikëpamja e ligjit duke saktësuar momentin, se kur vendimi merr formë të prerë dhe përbenë res judicata.

KAPITULLI I III. AKTORËT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE NË FUSHËN CIVILE

3.1. Vështrim i përgjithshëm

Jurisprudenca kombëtare dhe ndërkombëtare, e detyrueshme për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë, ka afirmuar, se faza e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit të gjykatës është pjesë përbërse e procesit të rregullt ligjor, si e tillë i nënshtrohet fushëveprimit të nenit 6 të K.E.D.NJ, përsa kohë kjo është faza përmbyllëse e tij¹⁴³. Duhet që vendimet e gjykatave dhe jo vetëm, të hyjnë në fuqi nëpërmjet veprimeve përmbarimore. Në këtë mënyrë do të ketë më shumë besim në sistemin e drejtësisë.

Në fillimet e tij, shërbimi përmbarimor ishte në varësi direkte të gjykatave të rretheve, si shtojcë ekzekutive e veprimtarisë së tyre. Vetëm në vitin 2001 u miratua për herë të parë një ligj organik për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror, i cili trajtoi në mënyrë të veçantë këtë shërbim. Ai funksionon edhe sot si i tillë, autonom dhe i pavarur nga hallkat e sistemit gjyqësor, por në varësi direkte, hierarkike dhe të centralizuar nga Ministria e Drejtësisë.

Me krijimin e tij, shërbimi përmbarimor shtetëror pati 113 përmbarues të ndarë në zyra juridiksionale të veçanta sipas gjykatave, në gjithë territorin e vendit¹⁴⁴. Ky shërbim ka pësuar ndryshime duke e përgjysmuar numrin e tij, pas ndryshimeve të vitit 2008. Aktualisht ushtrojnë funksionin e përmbaruesit gjyqësor shtetëror 57 persona, nga këta 22 përmbarues gjyqësor ushtrojnë edhe funksionin e kryetarit të zyrës përmbarimore¹⁴⁵.

Nevoja e përafrimit të legjislacionit mbi shërbimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, sipas standardeve ndërkombëtare dhe ato të BE-së, nëpërmjet krijimit të shërbimit të dyfishtë (shërbimit publik shtetëror dhe atij privat), kërkonte ndihmën e ekspertëve më të mirë vendas dhe të huaj. Në kuadër të këtij bashkëpunimi me misionin e Euralius, u bë i mundur në vitin 2008 hartimi i ligjit Nr.10031 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”. Nëpërmjet këtij ligji, Ministria e Drejtësisë ndërmori reformën e sistemit të përmbarimit, duke vënë në funksionim për herë të parë Shërbimin Përmbarimor Privat.

Ky lloj sistemi, i cili funksionon edhe në shumë vende demokratike të botës¹⁴⁶, ka avantazhin se i jep lirinë e zgjedhjes individit apo subjekteve të interesuara ndërmjet dy shërbimeve. Ky shërbim përbëhet nga operatorët privatë të çertifikuar për këtë qëllim, të cilët respektojnë të njëjtat rregulla procedurale referuar në K.Pr.Civile, me dallimin e vetëm se shërbimi privat ka juridiksion veprimtarie për të gjithë territorin e vendit dhe është i organizuar brenda Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privatë, ndërsa ai shtetëror ka kompetenca

¹⁴³ Vendimet nr.23/2009, nr.7/2009 dhe nr.31/2005 dhe nr.16/2012 të Gjykatës Kushtetuese

¹⁴⁴ <http://www.nchb.al/historiku-2/2/> aksesuar për herë të fundit 21.02.2016

¹⁴⁵ http://reformatnedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf faqe 239 aksesuar për herë të fundit 24.02.2016

¹⁴⁶ http://www.uilhj.com/en/ressources/21650/91/bulgaria_-_en.pdf aksesuar për herë të fundit 01.03.2016

juridiksioni lokale sipas ndarjes (zyrat vendore), dhe varet direkt nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit).

Liberalizimi i këtij Shërbimi u shoqërua me krijimin e disa avantazheve, siç është rritja e cilësisë së shërbimit përmbarrimor, duke reduktuar kohën për ekzekutimin e titujve ekzekutiv; nxitja e konkurrencës së lirë midis operatorëve, që do të merren me ekzekutimin e titujve ekzekutiv dhe uljen e fenomeneve korruptive në shërbimin përmbarrimor si dhe krijimi i mundësive të reja punësimi për juristët. Shërbimi i përmbarrimit gjyqësor privat, i cili funksionon si i tillë që prej vitit 2010, ka në përbërje të tij një trup prej 150 përmbarrues¹⁴⁷.

Shërbimi përmbarrimor gjyqësor është një shërbim i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë, i pajisur me të gjithë mekanizmin institucional dhe praktik, i cili po nuk funksionoi, mund të shkatërrojë edhe vetë ekuilibrat e sistemit të një shteti, duke destabilizuar të drejtën dhe ekonominë. E rëndësishme është të aplikohet drejt ai sistem, që përdoret më tepër se sa të zgjidhet njëri prej tyre.

3.2. Shërbimi përmbarrimor shtetëror dhe struktura e tij

Shërbimi përmbarrimor gjyqësor ka si objekt të veprimtarisë së tij¹⁴⁸ ekzekutimin e detyrueshëm të titujve në rastet e parashikuara nga K.Pr.Civile dhe e ushtron funksionet nëpërmjet përmbarruesve gjyqësor. Shërbimi përmbarrimor përbën shkallën e dytë të procesit të dhënies së të drejtës dhe pikërisht atë të materializimit të saj në një mënyrë konkrete, e cila qëndron më afër dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me palën kreditore dhe me palët e një procesi civil në përgjithësi¹⁴⁹.

Shërbimi i përmbarrimit gjyqësor shtetëror është organizuar në një institucion qendror në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të shërbimit gjyqësor përmbarrimor shtetëror, rregullohet me ligjin nr. 8730, datë 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarrimit gjyqësor". Shërbimi përmbarrimor gjyqësor përfaqëson autoritetin shtetëror dhe ka organizim unik dhe të centralizuar. Funksionon i pavarur nga hallkat e sistemit gjyqësor, por në varësi direkte hierarkike dhe të centralizuar nga Ministria e Drejtësisë.

Shërbimi përmbarrimor gjyqësor shtetëror ka organizim të centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky shërbim organizohet në: *a*) nivel qendror, ku përfaqësohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor dhe *b*) në nivel vendor për të cilën janë 22 zyra përmbarrimore, të organizuar brenda juridiksionit të çdo rrethi gjyqësor të shkallës së parë, dhe varen administrativisht nga Drejtoria e Përgjithshme¹⁵⁰.

Zyrat përmbarrimore janë persona juridikë pranë çdo rrethi gjyqësor dhe përbëhen nga kryetari i zyrës, përmbarruesit gjyqësor dhe personeli administrativ dhe teknik. Çdo zyrë

¹⁴⁷http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Dokumenta/REGJISTRI_I_PERMBARRUESVE_GJYQESORE_PRIVATE_AKTIVE_08.03.2016.pdf aksesuar për herë të fundit 01.04.2016

¹⁴⁸ Ligji nr 8730 datë 18.1 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarrimor gjyqësor "Fletore Zyrtare nr.1 ,fq..20, neni 2.

¹⁴⁹ <http://dpp.gov.al/historiku/> aksesuar për herë të fundit në datën 01.04.2016

¹⁵⁰ <http://dpp.gov.al/struktura/> aksesuar për herë të fundit në datën 30.03.2016

përmbardimore merr masat e nevojshme procedurale për ekzekutimin efektiv të titujve ekzekutiv. Vetë shërbimi përmbardimor gjyqësor varet nga ministri i Drejtësisë. Kemi të bëjmë me një lloj hierarkie të organizimit të shërbimit përmbardimor, hierarki e nivelit qendror nga ai vendor. Numri i përmbarduesve gjyqësorë shtetëror përcaktohet me urdhër të Kryeministrit në bazë të propozimit të Ministrit të Drejtësisë¹⁵¹. Kështu, me urdhërin nr.165, datë 19.05.2014, numri i punonjësve të këtij shërbimi është gjithsej 81 veta.¹⁵²

Në nivelin qendror të organizimit të Shërbimit të Përmbardimit është Drejtori i Përgjithshëm. Ai emërohet dhe shkarkohet nga kryeministri, me propozimin e ministrit të Drejtësisë. Me ligji i janë ngarkuar disa detyra, si: përgjegjësia për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e Shërbimit të Përmbardimit Gjyqësor, zbatim i njëjtë të akteve ligjore e nënligjore si dhe praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit, përgatitja dhe nxjerrja e urdhëra, udhëzime të brendshme dhe metodika për trajtimin e çështjeve në ekzekutim, organizimi dhe ndjekja e edukimit profesional dhe trajnimi i përmbarduesve gjyqësor, ndjekja dhe zbatimi i etikës profesionale gjatë veprimtarisë përmbardimore si dhe përfaqësimi i shërbimit të përmbardimit gjyqësor në marrëdhënie me të tretët.

Shërbimi Përmbardimor Gjyqësor, për të realizuar detyrat e tij, financohet nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë. Çdo veprim përmbardimor kryhet kundrejtë pagesës, e cila është përcaktuar me akt normativ nga ministri i Drejtësisë. Administrimi i të ardhurave të vjela nga ky shërbim, është përcaktuar nga një rregullore e përbashkët e Ministrisë së Drejtësisë dhe e Ministrisë së Financave. Organi i ngarkuar nga ligji me rekrutimin, emërimin, vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve disiplinore është Këshilli i Përmbardimit. Ka funksion këshillimor, dhe mendimet e tij ia paraqet ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga marrja në dijeni.

3.2.1. Statusi i përmbarduesit shtetëror

Për të gëzuar statusin e përmbarduesit gjyqësor, kandidati për përmbardues duhet të plotësojë këto kushte: a) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar, b) të ketë kryer arsimin e lartë juridik, c) të gëzojë figurë të pastër morale, ç) të mos jetë dënuar për kryerjen e një vepre penale me vendim gjyqësor të formës së prerë, d) të mos jetë larguar nga administrata publike për shkelje disiplinore

¹⁵¹ Neni 10 i Ligji nr 8730 datë 18.1 2001"Per organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbardimor gjyqësor "

¹⁵²Me urdhërin nr.129, datë 25.03.2014, të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së shërbimit të përmbardimit gjyqësor", i ndryshuar me urdhërin nr.165, datë 19.05.2014, numri i punonjësve të këtij shërbimi është gjithsej 81 veta, nga të cilët 14 punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbardimit Gjyqësor dhe 67 punonjës të shpërndarë në 22 zyra vendore (Zyra Vendore Tiranë – 18 punonjës; Zyra Vendore Durrës – 5 punonjës; Zyra Vendore Vlorë – 5 punonjës; Zyra Vendore Berat – 4 punonjës; Zyra Vendore Elbasan – 4 punonjës; Zyra Vendore Shkodër – 4 punonjës; Zyra Vendore Gjirokastrë – 3 punonjës; Zyra Vendore Fier – 3 punonjës; Zyra Vendore Kukës – 2 punonjës; Zyra Vendore Lushnje – 2 punonjës; Zyra Vendore Sarandë – 2 punonjës; Zyra Vendore Dibër – 2 punonjës; Zyra Vendore Lezhë – 2 punonjës; Zyra Vendore Korçë – 3 punonjës; Zyra Vendore Përmet -1 punonjës; Zyra Vendore Mat – 1 punonjës; Zyra Vendore Pogradec -1 punonjës; Zyra Vendore Pukë – 1 punonjës; Zyra Vendore Kavajë – 1 punonjës; Zyra Vendore Kurbin – 1 punonjës; Zyra Vendore Krujë – 1 punonjës; dhe Zyra Vendore Tropojë – 1 punonjës).

brenda një afati prej 3 vjetësh nga data e depozitimit të kërkesës, dh) kur shkelja disiplinore është kryer gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtar, prokuror, oficer i policisë gjyqësore, noter ose avokat afati është 5 vjet¹⁵³.

Pranimi në shërbimin e përmbarimit gjyqësor bëhet me konkurs, i cili organizohet nga Këshilli i Përmbarimit. Bazuar në rezultatin e konkursit, Këshilli i Përmbarimit bën vlerësimin e kandidatëve dhe mendimin e vet ia paraqet Ministrin të Drejtësisë brenda 15 ditësh. Konkuresi fitues emërohet përkohësisht përmbarues gjyqësor nga ministri i Drejtësisë, për një periudhë 3-mujore. Gjatë periudhës së provës, përmbaruesi gjyqësor është nën kujdesin e një përmbaruesi të vjetër në detyrë dhe vlerësohet nga eprori i tij. Veprimtaritë e trajnimit janë të detyrueshme për përmbaruesin gjyqësor në periudhën e provës. Në fund të periudhës së provës, ministri i Drejtësisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm vendos emërimin përfundimtar të tij ose largimin.

Në ligj janë të parashikuar të drejtat që gëzojnë përmbaruesit gjyqësor shtetërorë gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Kështu, përmbaruesi ka të drejtë të marrë pjesë në sindikata ose shoqata profesionale, të përfitojë trajtim shëndetësor dhe sigurime shoqërore, të trajnohen për ngritjen e nivelit profesional si dhe t'i paguhen shpenzimet për udhëtime pune, sipas kriterëve dhe masës së parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kahas të drejtave, ashtu si çdo punonjës i Administratës Publike, ligji i ka ngarkuar përmbaruesit edhe detyrimin për të respektuar dhe zbatuar Kushtetutën, K.Pr.Civile, Kodin Civil dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, që lidhen me veprimtarinë përmbarimore, si dhe urdhërat, udhëzimet dhe metodikat e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor. Në funksion të këtij qëllimi, përmbaruesi gjyqësor duhet të përsosë aftësitë profesionale dhe të marrë pjesë në veprimtaritë trajnuese të organizuara për këtë qëllim.

Përmbaruesi gjyqësor, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, krahas të drejtave, ka një sërë kufizimesh ligjore, që është i detyruar t'i respektojë, të cilat kanë të bëjnë me papajtueshmëritë. Ai nuk mund të kryejë asnjë veprimtari tjetër publike me përjashtim të atyre edukative e të mësimdhënies¹⁵⁴. Por kjo do të thotë, që mund të ushtrojë lirisht çdo veprimtari tjetër jopublike me kufizimin e vetëm, që kjo marrëdhënie pune ose veprimtari të tjera nuk duhet të paraqesë konflikt interesash me detyrën që ka ose pengojnë përmbushjen e saj. Njëkohësisht, përmbaruesit nuk i lejohet të jetë anëtar i organeve qendrore ose ekzekutive të partive politike. Kjo, në shërbim të detyrës, që përmbaruesi mbar në vetvete. Ai është zbatues i ligjit dhe si i tillë duhet të karakterizohet nga objektiviteti e paanshmëria.

Përbën gjithashtu papajtueshmëri të ushtrimit të funksionit të tij të ekzekutimit të titujve ekzekutiv, të ketë në një mënyrë a një tjetër, interes të drejtpërdrejtë apo të tërthotë në ekzekutimin e titullit. Për këtë arsye, përmbaruesi është i detyruar të heqë dorë për shkak të lidhjes së gjakut ose lidhje krushqie, kur ai vetë ose bashkëshortja është i afërt deri në

¹⁵³ Neni 15 i Ligjit Nr.8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor"

¹⁵⁴ Neni 17/1 i Ligjit Nr.8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor"

shkallë të katërt kur ka krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi ose bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët ose mbrojtësit. Një tjetër rast, është kur përmbauesi ka interes në çështjen objekt ekzekutimi, pra kur ai vetë ose bashkëshortja është në konflikt gjyqësor ose në armiqësi ose në marrëdhënie kredie ose huaje me njërën prej palëve ose njërën prej përfaqësuesve të tyre, që ka lidhje me atë në ekzekutim; është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që kanë interesa në çështjen në ekzekutim. Në çdo rast tjetër, kur sipas rrethanave konkrete ka arsye serioze njëanshmërie. Përveç këtyre parashikimeve ligjore, praktika mund të tregojë në të ardhmen raste të tjera, që mund të çënojnë paanshmërinë e përmbauesit dhe që janë gjithmonë në favor të palëve të fazës ekzekutive. Është gjykata, ajo që konstaton dhe vendos rast pas rasti nëse çënohet objektiviteti, figura morale e përmbauesit gjatë fazës së ekzekutimit.

3.2.2. Shërbimi përmbaues shtetëror dhe problematikat e tij

Shërbimi përmbaues shtetëror duke filluar nga viti 2001 e në vazhdim, ka pasur evoluimin e vet, duke unifikuar praktikat përmbauese. Një ndër kërkesat më të theksuara me forcë nga individët, që e kanë përdorur këtë shërbim, është eliminimi i zvarritjeve dhe ekzekutimeve me vonesë. Janë evidente mangësitë profesionale tek një pjesë e stafit përmbaues, për shkak të mungesës së trajnimeve, po ashtu zvarritjet e pajustificuara gjatë procedimit të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv, mungesa e transparencës dhe përkushtimit¹⁵⁵. Shërbimi përmbaues gjyqësor, duhet të jetë më transparent dhe të informojë palët për ecurinë e ekzekutimit të vendimit, pasi ky është një detyrim ligjor. Çdo përmbaues gjyqësor, për të siguruar mbarëvatjen e procedurave ligjore ka detyrimin ligjor për të njoftuar palët pjesëmarrëse në proces për çdo veprim përmbaues, pasi vetëm në këtë mënyrë pala mund të ushtrojë të drejtën e tij për ankim ndaj veprimit përmbaues, brenda afatit ligjor pesë ditor, nga moment që ka marrë dijeni¹⁵⁶.

Një aspekt i veçantë gjatë ushtrimit të veprimtarisë përmbauese, luan edhe etika e komunikimit, e cila duhet të përmirësohet. Përmbauesi, nëpërmjet detyrës që ushtron, përfaqëson autoritetin e shtetit përballë individit. Nëse etika është maja e ajsbergut, lufta kundër shfaqjeve korruptive dhe shmangia e ndërhyrjeve nga palët ose eprorët, është një kërkesë tjetër e shtetasve-gjyqfitues. Krijimi i dyshimit tek palët e përfshira, se përmbauesi po vepron në mënyrë të njëanshme, duke shkelur parimin e barazisë midis palëve, përbën një rrezik për të gjithë procedurën përmbauese. Veprimtaria e përmbauesve gjyqësor në pjesën më të madhe të rasteve, nuk karakterizohet nga profesionalizmi dhe paanësia në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv¹⁵⁷.

¹⁵⁵ Raport i Veçantë i Avokatit të Popullit “Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë”, 2012

¹⁵⁶ Neni 609 i K.Pr.Civile

¹⁵⁷ Raport i Veçantë i Avokatit të Popullit *cit*, 2012

Kapacitetet profesionale dhe krijimi i mundësive për zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme, si dhe kualifikimi në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira janë të ulëta, dhe përbën një tjetër gjetje për përmirësimin e këtij shërbimi. Përveç periudhës së provës, gjatë të cilës i rekrutuari fillon të mësojë në lidhje me profesionin e përmbaruesit gjyqësor dhe është nën mbikëqyrjen e një përmbaruesi me eksperiencë, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme nuk organizohet ndonjë trajnim vazhdues për përmbaruesit e thjeshtë apo kryetarët e zyrave. Trajtim, i cili do të përmirësonte aftësitë profesionale, organizuese dhe menaxhuese të përmbaruesit gjyqësor. Njohja dhe zbatimi më i mirë dhe më i saktë i ligjeve, do të ndihmonte procesin përmbarimor, sigurisht duke u monitoruar dhe kontrolluar nga strukturat përgjegjëse. Përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror për drejtimin, kontrollin dhe mbarëvajtjen e procesit ekzekutiv të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duhet të rriten duke qënë më produktive.

Në këtë kuadër, është prezantuar nga Ministria e Drejtësisë edhe projekti për përmirësimin e Sistemit Përmbarimor në vendin tonë¹⁵⁸, që konsiston në binjakëzimin e shërbimit përmbarimor të Francës, Hollandës dhe Shqipërisë. Projekti, me një buxhet 700.000 Euro do të financohet nga Bashkimi Europian dhe do të ketë një kohëzgjatje prej 18 muajsh, me qëllim rritjen e besimit në sistemin e drejtësisë, i cili do të ketë si përfitues kryesor Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privatë, por edhe Shërbimin e Përmbarimit Publik Shtetëror në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë¹⁵⁹. Nëpërmjet thjeshtëzimit dhe shkurtimit të procedurave përmbarimore, përmirësimit të kuadrit të brendshëm ligjor, forcimi i koordinimit ndërinstytucional, mbështetje e teknologjisë së informacionit për shërbimet përmbarimore, trajnime për agjentët përmbarimorë, përmirësim të sistemit aktual ALBIS¹⁶⁰.

Infrastruktura dhe kushtet fizike të punës në zyrat e përmbarimit gjyqësor shtetëror, veçanërisht mungesa e mjeteve teknike në përdorimin e sistemit ALBIS, i cili është sistemi i menaxhimit elektronik, bën që cilësia e ofrimit të shërbimit të jetë e ulët. Përdorimi efikas i sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve përmbarimore përbën një tjetër problematikë, e cila kërkon adresim në kohë dhe masa konkrete.

3.3. Shërbimi përmbarimor privat

Domosdoshmëria e shërbimit përmbarimor privat, erdhi si nevojë për të përafuar legjislacionin mbi shërbimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, duke ndjekur një strukturë të bazuar mbi standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së., pasi në Shqipëri, sistemi aktual i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, apo titujve ekzekutiv linte shumë për të dëshiruar. Kjo ishte një problematikë që konstatohej shpesh, jo vetëm nga shtetasit shqiptarë, por edhe në Progres Raportet e BE-së. Reforma në sistemin e përmbarimit mori jetë për herë të parë me hyrjen në fuqi

¹⁵⁸ <http://dpp.gov.al/aktivitete/> aksesuar në datën 02.04.2016

¹⁵⁹ <http://www.nchb.al/blog/2015/07/01/permbarimi-gjyqesor-shqiptar-drejt-rruges-se-standardeve-te-se-projekti-binjakezimit-si-ndihme-dhe-mision-drejtperdrejte-bashkimit-evropian-per-permiresimin-e-sher/>

¹⁶⁰ Projekti Binjakëzimit të BE-së Nr. AL/12/IB/JH/02 ``Përmirësimi i sistemit përmbarimor në Shqipëri`` 29 Prill 2015- 30 Tetor 2016, përditësuar në dhjetor 2015, faqe 2

te ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat"¹⁶¹, i cili zbatohet për përmbartuesit gjyqësor privatë që kryejnë veprimet e tyre procedurale për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv. Ligji përcakton kriteret, që duhet të përmbushin shtetasit për të ushtruar detyrën e përmbartuesit gjyqësor privat, statusin, masat disiplinore, detyrat, përgjegjësitë, tarifën, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

Përmbartuesi gjyqësor privat, ose shoqëritë përmbartimore private ushtrojnë funksionin me karakter publik në mënyrë të pavarur, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë¹⁶². Subjekti që legjitimohet të ushtrojë këtë funksion është personi fizik, i cili mund të organizohet në dy forma: si përmbartues gjyqësor privat dhe si shoqëri përmbartimore private. Personi fizik, që të legjitimohet, duhet të plotësojë disa kushte të domosdoshme, mungesa e njërit prej të cilëve, sjell si pasojë moslicensimin e tij. Kushtet që duhet të plotësojë janë : të jetë shtetas shqiptar, të këtë zotësi të plotë për të vepruar, duhet të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik dhe të këtë një eksperiencë pune si jurist për një periudhë prej tre vjetësh. Kriteri i fundit është i ndryshëm nga kriteret e kualifikimit për shërbimin përmbartimor shtetëror. Gjatë kësaj kohe duhet të mos ekzistojë një vendim i formës së prerë, që e dënon atë për kryejnë e një vepër penale. Së fundmi, duhet të kalojë me sukses provimin e kualifikimit si përmbartues gjyqësor privat duke u licensuar si i tillë.

Një ose më shumë përmbartues gjyqësor privatë mund të organizohen së bashku për të ushtruar veprimtarinë e tyre në shoqëri tregtare, sipas legjislacionit në fuqi¹⁶³. Ky parashikim ligjor i lë mundësinë përmbartuesve gjyqësor që të zgjedhin lirisht formën e organizimit, pra të zgjedhin të formojnë shoqëri kolektive, shoqëri komandite, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara apo shoqëri aksionere. Në këto shoqëri, pavarësisht formës të tyre, ortakët domosdoshmërisht duhet të jenë përmbartues gjyqësor të licensuar, por edhe administratorët e shoqërisë detyrimisht duhet të jenë të tillë. Duke qenë se janë të organizuara si "shoqëri tregtare" në ligjin rregullues¹⁶⁴, përcaktohet se shoqëritë tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtari, e cila nuk ndalohet me ligj. Në përputhje të plotë me këtë dispozitë, ligji për shërbimin përmbartimor privat, ka përcaktuar si objekt të veprimtarisë së tyre tregtare "ekzekutimin e titujve"¹⁶⁵.

Ashtu siç e përcakton vetë ligji, kryejnë veprimtari tregtare, por duhet theksuar se veprimtaria e tyre është funksion me karakter publik, pavarësisht faktit se është e pavarur. Karakteri publik kufizon objektin, por i jep mbrojtje në aspekte të tjera. Veprimtaria tregtare e ushtruar prej tyre i jep lirinë ligjore për të reklamuar publikisht veprimtarinë e tyre, me kufizimin e vetëm, që të mos çënohet konkurrenca e ndershme dhe praktikat e ligjshme tregtare. Organizimi në formën e një shoqërie tregtare, rrjedhimisht sjell, që veprimtaria

¹⁶¹ Ligji nr. 10031/2008 ka ndryshuar 3 herë: ligji nr.10137, datë 11.05.2009, ligji nr.36/2012, datë 29.03.2012 dhe ligji nr. 80/2013, datë 14.02.2013

¹⁶² Neni 5 i Ligji nr.10031 date 11.12.2008

¹⁶³ Neni 4 i Ligji nr.9901dt.14.4.2008" Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare "Fletore Zyrtare nr.60, fq.. 2631

¹⁶⁴ Po aty

¹⁶⁵Neni 8/paragrafi 2 i Ligji nr.9901dt.14.4.2008" Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare "Fletore Zyrtare nr.60,fq.. 2631

tregtare e ushtruar prej tyre i nënshtrohet kufizimeve për mbrojtjen e konkurrencës¹⁶⁶. Në funksion të kësaj pike, ndalohen të gjitha marrëveshjet që kanë si objekt apo si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës¹⁶⁷.

3.3.1. Kontrata e shërbimit dhe efektet që sjell për palët në procesin ekzekutiv

Përmbaruesi gjyqësor privat, e ka për detyrë ligjore të përmbushë interesat ligjore të kreditorit, por në njëjtën kohë duhet të garantojë të drejtat themelore të debitorit, përgjatë kryerjes së veprimeve detyruese dhe ekzekutuese të procesit përmbarimor. Për këtë arsye, legjislatori ka parashikuar edhe mënyrën e pagimit të detyrës që kryen ky funksionar publik. Të drejtat dhe detyrimet e përmbaruesit gjyqësor privat sipas ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat, janë të parashikuara në nenin 31 dhe 32 të tij.

Përveç këtij rregullimi ligjor, është parashikuar një rregullim më i posaçëm në kontratën e shërbimit. Kontrata e shërbimit është një kontratë tip, e cila është marrëveshje, ku palët me vullnetin e tyre të lirë, vendosin të përdorin shërbimin përmbarimor, për të ekzekutuar titullin ekzekutiv. Pa nënshkrimin e kësaj kontrate, përmbaruesi privat nuk mund të fillojë ekzekutimin¹⁶⁸. Me anë të kësaj forme ligjëvendësi, ka pasur si qëllim, që të marrë në mbrojtje të veçantë të drejtat e palës kreditore. Nga kjo pikëpamje ndryshon edhe mënyra sesi fillon procedura ekzekutive pranë përmbaruesit gjyqësor shtetëror, pranë këtij të fundit mjafton, që pala kreditore të paraqesë një kërkesë të thjeshtë dhe kur dokumentacioni është në përputhje me nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile fillon ekzekutimi i tij.

Përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë të pranojë lirisht kërkesat e subjekteve fizike apo juridike për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, kur ato gjenden në përputhje me ligjin. Ai ka të drejtë të kërkojë parapagimin nga kreditori, të tarifave dhe shpenzimeve përmbarimore, që i vlerëson të nevojshme për kryerjen e ekzekutimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në kuadër të procesit të ekzekutimit, ka të drejtë të kërkojë nga kreditori dhënien e informacionit të nevojshëm, për debitorin dhe për personin e tretë.

Krahas të drejtave janë përcaktuar edhe detyrimet për secilën nga palët kontraktuese. Disa detyrime të përmbaruesit janë: të këshillojë palën kreditore për pasojat juridike, që rrjedhin nga veprimet procedurale, me qëllim që të mos dëmtohen interesat e tyre; të kryejë në favor të kreditorit të gjitha veprimet e duhura ligjore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv; të informojë kreditorin, për të gjitha veprimet e kryera dhe në rast se i kërkohet të japë informacion me shkrim lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, të njoftojë kreditorin kur konstaton ekzistencën e konfliktit të interesit dhe deri në momentin e zgjidhjes së kontratës, të mos kryejë

¹⁶⁶Ligji nr.9121 dt.28.7.2003" Për mbrojtjen e konkurrencës " Fletore Zyrtare nr.71, fq..3189

¹⁶⁷ Po aty neni 3 i *Marrëveshjet janë marrëveshje të çdo forme të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve me apo pa forcë detyruese, vendime apo rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve si dhe praktikave të bashkërenduara të ndërmarrjeve të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, pra marrëveshje horizontale ose në nivele të ndryshme, pra marrëveshje vertikale*. Sipas Gjykatës Europiane të Drejtësisë një marrëveshje duhet të përmbajë këto elemente : të ketë ujdi të fshehtë; ka për qëllim të zbatohet për të gjitha marrëveshjet ndërmje ndërmarrjeve, në çfarëdo forme qofshin; ECJ-49/92p Commission Anka partecipazione

¹⁶⁸ Kontrata Tip e Shërbimit miratuar me Urdhërin nr.219, datë 11.01.2016 të Ministrisë të Drejtësisë

veprime që rëndojnë interesin e saj, si dhe të sigurojë pranë një shoqërie sigurimi veprimtarinë e tij profesionale¹⁶⁹. Palët në rast mosrespektimi të kontratës së shërbimit mund t'i drejtohen gjykatës duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

3.3.2. Tarifat për shërbimin e ofruar nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat dhe rregullat për caktimin e saj

Për shërbimin përbarimor privat, veprimtaria e kryer është një marrëdhënie shërbimi në këmbim të të cilit marrin një tarifë të përcaktuar. Legjislatori ka parashikuar në nenin 525 të K.Pr.Civile, se tarifa përbarimore paguhet fillimisht nga kreditori i procesit dhe me përfundimin e tij i ngarkohet debitorit. Parapagimi i tarifës përbarimore detyrimisht e vendos përbaruesin gjyqësor në pozitat e zbatimit rigoroz të ligjit, si ndaj palës kreditore, por edhe ndaj palës debitore. Të njëjtin qëndrim mban edhe Kodi Global mbi Ekzekutimin e Detyrueshëm¹⁷⁰, i cili po ratifikohet nga të gjitha shtetet dhe anëtarësitë e Organizatës Botërore e Funkionarëve Gjyqësor, anëtare e së cilës është edhe Shqipëria. Përcaktimi i tarifës përbarimore në një kornizë të përcaktueshme dhe të detyrueshme ligjore për t'u zbatuar nga të gjithë përbaruesit gjyqësor privatë, vendos një standard të lartë garancie dhe pavarësie ekonomike për autoritetin publik të përbaruesit. Si në rastin e shërbimit përbarimor shtetëror, ashtu edhe atij privat, rregulli është që tarifa përbarimore arkëtohet në fillim të procesit, pasi kjo e bën të padiskutueshëm autoritetin ligjor të përbaruesit. Një autoritet i lëkundur, për shkak të pagesës së tarifës, do të sillte si pasojë veprime të paligjshme përbarimore të kryera për përfitime dhe interesa të ngushta ekonomike.

Taksa përbarimore është e përcaktuar me udhëzimin e përbashkët Nr.1240/5, datë 15.09.2009 “Për caktimin e tarifave për shërbimin e ofruar nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat”, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Financave, pasi merret më parë mendimi i Dhomës Kombëtare të përbaruesve gjyqësor privatë¹⁷¹. Ky udhëzim, përcakton parimet për përcaktimin e tarifës përbarimore, e cila përbëhet nga një tarifë normale, përveç tarifës shtesë, e cila mund të aplikohet për kryerjen e veprimeve përbarimore, sipas kushteve të nenit 48 të ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përbarimor privat” dhe shpenzimeve, sipas nenit 525 të K.Pr.Civile.

Taksa përbarimore, sipas Kontratës së Shërbimit, që lidhet midis palës kreditore dhe shërbimit përbarimor privat, paguhet në këtë mënyrë: fillimisht kur kreditori dorëzon

¹⁶⁹ Neni 10 i Kontratës Tip të Shërbimit

¹⁷⁰ Neni 5 i Kodit Global mbi Ekzekutimin e Detyrueshëm “*Tarifat e shërbimit përbarimor paguhen nga debitorët, por ato parapaguhen fillimisht nga kreditorët, përveç rasteve përjashtimore të ligjit (veçanërisht për rastet e pagimit të detyrimeve ushqimore për rritjen e fëmijëve). Në rastet kur debitorët janë insolvabël, kostot e tarifave përballohen nga kreditorët. Nëse gjykata vendos se kreditorët kanë abuzuar me të drejtën e tyre për të kërkuar ekzekutim përbarimor, ajo mund t'i detyrojë kreditorët të paguajnë jo vetëm tarifat përbarimore, por edhe humbjet e pësuarat të debitorëve prej procesit përbarimor. Shtetet duhet të sigurojnë që të vendoset një sistem tarifash apo kostosh që paguhen për shërbimin e detyrueshëm përbarimor dhe këto tarifa duhet që të jenë fikse, të parashikuara, transparente dhe të arsyeshme*”.

¹⁷¹ Neni 471/1

dokumentacion në përputhje me nenin 515 të K.Pr.Civile paguhet taksa paraprake, e cila është e përcaktuar në bazë të vlerës së detyrimit. Nëse kreditori nuk i paguan taksën paraprake, subjekti përmbaues nuk i lejohej të fillojë procedurë e ekzekutimit dhe i kthen menjëherë dokumentat ligjore që i janë paraqitur. Taksa përmbaimore paguhet në llogarinë bankare zyrtare të subjektit përmbaues. Tarifat përmbaimore i nënshtohen ligjit 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat përmbaimore”. Tatimi mbi vlerë e shtuar i shtohet tarifës së mbledhur nga një subjekt përmbaues privat.

Momenti i marrjes së parapagimit të tarifave përmbaimore të përcaktuara në Udhëzimin Nr. 1240/5, si dhe bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 7928 date 27.04.1995 “Për TVSH-në”, konsiderohet si momenti i kryerjes së furnizimit të shërbimit, moment ky, në të cilin subjekti përmbaues lëshon faturë tatimore për kreditorin dhe llogarit TVSH-në përkatëse. Subjekti kreditor mund të kreditojë TVSH-në e faturuar për shërbimin e përmbauesit në përputhje me nenin 33 të Ligjit për TVSH-në në fuqi dhe pikën 18 të Udhëzimit Nr. 17 datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”, i ndryshuar.

Nëse në fund të procedurës së ekzekutimit, tarifa përmbaimore e subjektit përmbaues paguhet nga debitori atëherë në momentin e marrjes së pagesës nga debitori, përmbauesi lëshon një faturë shtesë, duke saktësuar në ulje për kreditorin shumën e mbledhur nga debitori, e cila i referohet faturës së lëshuar më parë për kreditorin¹⁷² dhe njëkohësisht lëshon faturën tatimore të shitjes për debitorin për vlerën e tarifës normale të paguar efektivisht prej këtij të fundit. Tarifa e subjektit përmbaues përbën të ardhur të tatueshme për efekte të tatimit mbi fitimin.

Nëse paraqitet për ekzekutim pagimi i një detyrimi në të holla, për një shumë që kalon 500.000 lekë deri në 90.000.000 lekë, tarifa paraprake e subjektit përmbaimore është vlera e detyrimit 24.000 lekë¹⁷³. Ndërsa taksa e plotë përmbaimore, e cila është diferenca e tarifës bazë me tarifën paraprake, paguhet kur kalohet në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, e përcaktuar kjo në kontratën e “Tip” e shërbimit që lidhen midis shoqërive përmbaimore/përmbauesve gjyqësor privatë dhe palëve të interesuara, përpara fillimit të procedurave të ekzekutimit përmbaimore¹⁷⁴, e cila është e miratuar me Urdhërin nr.219, dt.11.01.2016 të Ministrit të Drejtësisë. Taksa përmbaimore, paguhet fillimisht nga pala kreditore, e cila përbën çelësin për aktivizimin e tij, pra vë në lëvizje shërbimin përmbaimore dhe i ndalet palës debitore, kur ekzekutohet tërësisht detyrimi ligjor. Shpenzimet e tjera gjatë procedurës së ekzekutimit paguhen nga pala, që i ka shkaktuar ato¹⁷⁵.

Debitori solidar është në mënyrë solidare përgjegjës për pagimin e tarifës së subjektit përmbaues. Në udhëzim përcaktohen tarifat, që kërkohen në varësi të llojit të padive, për paditë me objekt detyrimi ushqimor, për sigurimin e padisë për objekte të pavlerësueshme. Tarifë shtesë për veprimet e sekuestrimit, për mënyrën e shitjes së sendeve pasurore dhe tarifë shtesë në formën

¹⁷² “Sqaruese për qëllime tatimore mbi veprimtarinë e përmbauesve gjyqësor privatë” e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr.759/2,prot datë 24.03.2015

¹⁷³ Kreu IX i Udhëzimit të përbashkët Nr.1240/5, datë 15.09.2009 “Për caktimin e tarifave për shërbimin e ofruar nga shërbimi përmbaimore gjyqësor privat”, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Financave

¹⁷⁴ Neni 7 pika 3 e Kontratës “Tip” të Shërbimit

¹⁷⁵ Neni 525 i Kodit të Procedurës Civile

e tarifave për orë. Ky udhëzim është baza që udhëheq mënyrën e shpërblimit të punës së përmbaruesve gjyqësor, por janë hasur shumë vështirësi në aplikimin e tij, pasi nuk është krijuar një praktikë e unifikuar dhe sqaruere as nga Minsitria e Drejtësisë as nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privatë.

Një rast i praktikës gjyqësore shqiptare në lidhje me mbarëvatjen dhe mirëfunksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor privat, është edhe rasti i shqyrtuar edhe nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë në Vendimin Nr.7, datë 18.06.2014. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privatë në cilësinë e palës paditëse ka kërkuar “Shfuqizimin e udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr.1665/1, datë 5.3.2014, “Për caktimin e tarifave përmbarimore dhe shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat”, si akt i dalë në kundërshtim me përmbajtjen e ligjit”, duke thirrur si të paditur Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë. Gjykata, pasi ka vlerësuar në bazë të ligjit se përmbaruesit gjyqësor privatë organizohen në shkallë vendi nëpërmjet përfaqësimit profesional në Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privatë. Për rrjedhojë pala paditëse sipas gjykatës gëzon legjimitetin aktiv. Më pas gjykata¹⁷⁶ ka shqyrtuar ligjshmërinë e udhëzimit të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave nr.1665/1, datë 5.3.2014, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 37 të ligjit nr.49/2012, sipas të cilit në rastin e aktit nënligjor normativ, gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit që kundërshtohet duke vlerësuar të tria kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

Në vendimin e saj nr.7, datë 18.6.2014, Gjykata Administrative e Apelit argumenton se: “Udhëzimi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, pasi ligji “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, delegon rregullimin me udhëzim vetëm të shërbimeve përmbarimore të tarifueshme dhe masës përkatëse të kësaj tarife. Tarifa e suksesit përbën një lloj të re tarife dhe miratimi i saj nuk është në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit, që ka autorizuar nxjerrjen e udhëzimit. Në analizën e saj, në gjykata, gjendet i pabazuar pretendimi se udhëzimi nuk ka vendosur tarifa të reja, por vetëm u referohet llojeve të shërbimeve përmbarimore për të cilat tarifa aplikohet. Tarifa e suksesit nuk rezulton të jetë e lidhur me asnjë veprim procedural apo lloj të shërbimit përmbarimor. Suksesit është i lidhur me rezultatin final të të gjithë veprimtarisë së përmbaruesit në ekzekutimin e titullit ekzekutiv, pavarësisht veprimtarisë së tij procedurale, është i lidhur me sigurimin e përmbushjes së detyrimit nga pala debitore dhe me shkallën e kësaj përmbushjeje”.

Mendojmë se udhëzimi i ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë me Nr. 1665/1, datë 05.03.2014, i cili kërkoi të ndryshojë situatën duke njohur tarifën e suksesit, jo vetëm që nuk do të përmirësonte gjendjen e shërbimit përmbarimor privat, por vuri në pikëpyetje edhe vetë ekzistencën e tij, pasi kërkoi të ndryshonte parimet themelore të funksionimit të tij, që janë parashikuar në nenin 525 të K.Pr.Civile dhe neni 48 të ligjit nr.10031 datë 11.12.2008.

¹⁷⁶Vendimin Nr.7, datë 18.06.2014 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë çmon se: *udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave nr. 1665/1, datë 5.3.2014, është akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin, për shkak se nuk rezulton të jetë nxjerrë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit që ka autorizuar nxjerrjen e tij. Kjo mënyrë veprimi ka cenuar parimin e ligjshmërisë së organeve të administratës publike të parashikuar në nenin 9 të Kodit të Procedurave Administrative.*

3.3.3. Struktura organizative e shërbimit përbarimor privat

Përbaruesi gjyqësor privat ose shoqëritë përbarimore private ushtrojnë funksionet e tyre procedurale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë¹⁷⁷. Përveç juridiksionit, që nuk ka kufizim, ky referon indirekt në kodin e procedurës civile. Përbaruesit gjyqësor privatë organizohen në shkallë vendi, nëpërmjet përfaqësimit profesional në Dhomën Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësor Privatë. Dhoma është person juridik, që e ushtron veprimtarinë e saj në mënyre të pavarur nga shteti. Organet drejtuese të Dhomës janë Asambleja e përgjithshme dhe Këshilli drejtues. Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrjes së Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësor Privatë, e cila zgjedh çdo 4 vjet organet drejtuese të Dhomës, Kryetarin e Dhomës, Nënkyetarin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe 7 anëtarët e Këshillit Drejtues.

Dhoma Kombëtare e Përbaruesve Gjyqësor Privatë ka si detyrë të sigurojë zbatimin e kritereve profesionale dhe etike, me të cilat duhet të veprojnë përbaruesit gjyqësor privatë, po ashtu zgjedh organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësor Privatë, cakton kuotat, që duhet të derdhen përbaruesit gjyqësor privatë në llogarinë e Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësor Privatë. Asambleja e Përgjithshme në 21 Shkurt 2015 vendosi me votim unanim: “Miratimin e shumës 40.000 lekë si kuotë vjetore për çdo përbarues gjyqësor aktiv në aktivitetin e tij, e cila do të paguhet nga përbaruesit gjyqësor privatë në llogarinë e Dhomës Kombëtare”. Për vitin 2015 Asambleja ka miratuar një projekt-buxhet të detajuar për vitin kalendarik, i cili parashikon shpenzime dhe të ardhurat e nevojshme për të realizuar detyrat e ngarkuara nga ligji.

Në të parashikohen shpenzime të menjëhershme operative për vënien në funksionim ndërveprues me Regjistrat Elektronike të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, Gjendjes Civile si edhe rikonfigurimit të atij me ZQRPP, nëpërmjet sistemit SIAIP dhe burimit të këtij informacioni elektronik-AKSH. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shumicë votash. Ky organ ka të drejtë të miratojë Statutin e Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësor Privatë si dhe çdo akt tjetër që është i nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Shërbimit Përbarimor Gjyqësor Privat.

Këshilli drejtues i përbaruesve gjyqësor privatë zgjidhet nga Asambleja dhe ka si detyrë të miratojë programet e trajnimit vazhdues të përbaruesve gjyqësor privatë. Në kuadër të këtij qëllimi, ai bashkërendon dhe përkrah nismat, që kanë si qëllim përmirësimin dhe ngritjen profesionale. Është organi që thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme si dhe bashkëpunon me strukturat drejtuese të Dhomës së Avokatisë dhe Dhomës së Noterisë për probleme, që kanë të bëjnë me çështjet e ekzekutimit.

¹⁷⁷ Neni 7 i Ligji nr.10031 date 11.12.2008 “Për shërbimit përbarimor gjyqësor privat”

3.3.4. Statusi i përmbaruesit gjyqësor privat

Përmbaruesi gjyqësor privat e kryen detyrën në emër të tij dhe nën përgjegjësinë vetjake dhe i ushtron funksionet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Funksioni publik e lidh përmbaruesin gjyqësor jo vetëm me misionin kontribues ndaj shoqërisë, por edhe me vetë themelet e rendit juridik. Në ligj janë parashikuar kriteret që duhet të plotësojë një person që të licensohet si përmbarues gjyqësor privat. Kandidatët fitues të provimit të kualifikimit, me kërkesën e tyre, regjistrohen në regjistrin e përmbaruesve gjyqësor privatë, që të pajisen me licencën përkatëse. Ministri i Drejtësisë është autoriteti shtetëror, i cili i jep licencën personave që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si përmbarues gjyqësor privatë, në përputhje me rregullat funksionale dhe organizative të këtij ligji. Përmbaruesi gjyqësor privat, para se të fillojë detyrën e tij, betohet se detyrat do t'i kryejë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, duke u udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, paanësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Veprimtaria e përmbaruesit ka disa kufizime në ushtrimin e saj, që kanë të bëjnë me papajtueshmërinë e ushtrimit të funksioneve publike në çdo nivel vendor apo qendror. Kur përmbaruesi merr licensën është i detyruar ligjërisht të mos praktikojë profesionin e avokatit ose noterit, derisa ushtron veprimtarinë përmbarimore, duke qenë se çdo funksion tjetër është i papajtueshëm me ushtrimin e paanshëm të profesionit të tij¹⁷⁸.

Përmbaruesi është i detyruar të heqë dorë në fazën ekzekutive, kur ka konflikt interesi në çështjen objekt ekzekutimi. Këtë mund ta bëjë në dy moment të ndryshme. Së pari, kur ende nuk ka filluar ekzekutimi nëpërmjet mospranimit të kërkesës. Së dyti, kur ekzekutimi ka filluar, përmbaruesi heq dorë në momentin kur merr dijeni apo duhej të kishtë marrë dijeni për ekzistencën një shkak që tregon konflikt interesi. Rastet që përbëjnë konflikt interesi janë përcaktuara në ligj. Si të tilla mund të përmendim rastin kur përmbaruesi gjyqësor çënon interesat e njëres prej palëve gjatë fazës ekzekutive, nëpërmjet shfaqjes së njëanshme dhe duke mos qenë objektiv. Përcaktimi i shkaqeve që tregojnë konflikt interesi, kërkon një "vlerësim objektiv" të situatave të tilla. Objektiviteti në përcaktim është thelbësor në efektivitetin dhe drejtësinë e veprimeve të tyre, në të gjitha rastet e përmendura më lart¹⁷⁹.

Kur përmbaruesi gjyqësor vendos të heqë dorë nga vazhdimi i veprimeve procedurale, për një nga shkaqet e përmendura më lart, ai detyrohet të njoftojë 15 ditë përpara palën kreditore. Gjatë kësaj periudhe përmbaruesi gjyqësor privat, është i detyruar që të kryejë veprimet procedurale eventuale.

3.4. Rëndësia e përfshirjes së shërbimit përmbarimor në reformën në drejtësi

Termi "reformë" nënkupton ndryshim, transformim dhe evoluim të sistemit aktual duke pasur si qëllim përmirësimin e tij. Sistemi i drejtësisë ka qenë shpesh objekt i reformave të

¹⁷⁸ Neni 8 i Ligji nr. 10031 date 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat"

¹⁷⁹ Neni 9 i Ligji nr. 10031 date 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat"

ndryshme, herë të imponuara nga faktorët e brendshëm si ndryshimi i regjimit politik dhe herë e imponuar nga faktorët e jashtëm në kuadër të arritjes së standardeve europiane.

Reforma aktuale në drejtësi është përpjekur me të vërtetë të reformojë sistemin e drejtësisë duke u fokusuar së tepërmi në aktorët që i japin jetë këtij sistemi. Patjetër që një rol të rëndësishëm kanë gjyqëtarët dhe prokurorët, por edhe profesionet e lira, siç janë avokati, noteri, përbaruesi gjyqësor, ndërmjetësi dhe avokati i shtetit, të cilët janë pjesë e rëndësishme e funksionimit të sistemit të drejtësisë. Këto shërbime, të cilat ju sigurojnë qytetarëve mjetet e nevojshme ligjore për mbrojtjen dhe ushtrimin e të drejtave të tyre si dhe garantimin dhe rivendosjen e këtyre të drejtave, kur ato janë shkelur përbëjnë një kusht të domosdoshëm në vendosjen e standardeve europiane në lidhje me organizimin dhe funksionimin e tyre. Shtrirja e reformës në drejtësi edhe tek profesionet e lira, dëshmon për një reformë, që synon të përfshijë të gjithë aktorët dhe faktorët e rëndësishëm në funksionimin e shtetit ligjor, pasi zhvillimi i demokracisë dhe i shtetit të së drejtës është një qëllim, i cili mund të arrihet vetëm bashkërisht.

Fakti, që shërbimi përbarimor gjyqësor u bë për herë të parë pjesë e reformës në drejtësi, nënvizon faktin se ky shërbim përbën një garanci reale dhe efektive për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Mbështetja dhe vëmendja, që po i jep legjislatori këtij shërbimi jep mesazhin e një shërbimi themelor, që ka një impakt jo vetëm ligjor por edhe ekonomik. Kjo mbështetje u konkretizua me pjesëmarrjen e Dhomës Kombëtare të Përbaruesve Gjyqësor privatë në reformën për drejtësi. Për herë të parë u bë e mundur të dëgjohet dhe merret në konsideratë zëri i përbaruesve gjyqësor, në lidhje me problematikat që hasin në punën e përditshme. Kjo pjesëmarrje u konkretizua nëpërmjet paraqitjes së analizës së sistemit aktual të shërbimit përbarimor dhe të propozim-strategjisë¹⁸⁰. Kjo do të bënte të mundur përmirësimin e dispozitave të ligjit material dhe atij procedural në funksion të garantimit të ekzekutimit efektiv dhe efikas të titujve ekzekutiv.

Shërbim përbarimor gjyqësor dhe në veçanti ai privat, paraqesin interes për operatorët shtetërorë dhe jo vetëm, pasi mund të ndihmojë për daljen nga kriza e rëndë e “kredive të këqija”, si dhe mbledhjen e borxheve në sistemin doganor apo tatimor¹⁸¹, duke zbutur krizën e mospagimit të tyre dhe fuqizuar pozicionin e kreditorit për vjeljen e detyrimeve. Aktualisht, shërbimit përbarimor nuk i është njohur tagri ligjor për të mundësuar mbledhjen e këtyre borxheve. Përmirësimi i sistemit apo shërbimit përbarimor nuk mund të përmirësohet apo ndihmohet i ndarë në dy. Pra, përbarimi gjyqësor nga një çështje thjesht teknike është shndërruar në një fushë të së drejtës, ku kërkohet inovacion dhe profesionalizëm bashkëkohor.

¹⁸⁰<http://www.nchb.al/blog/2015/06/21/filozofia-praktike-e-reformes-per-drejtësi-dhe-vemendja-e-re-ndaj-institutit-te-ekzekutimit-te-detyrueshem-perbaruesi-privat-si-predikues-gjyqësor-shtetit-te-se-drejtës/> për herë të fundit 01.03.2016

¹⁸¹ Parashtrime, komente dhe problematika të ngjitura nga këndvështrimi i juristit përbarimor / 11 pika shtjelluese, adresuese edhe argumentuese në lidhje me “kreditë e këqija” në Shqipëri, nr.92.Prot datë 06.05.2015, Dhoma Kombëtare e Përbaruesve Gjyqësor Privat

3.5. Organizimi i trupës përmbarimore në kuadër të veprimtarisë së tyre dhe iniciativat ligjore që duhen ndërmarrë

Trupa e përmbaruesve gjyqësor privatë është e organizuar dhe përfaqësohet profesionalisht nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor. U krijua në tetor të 2010-ës, pasi ishin licensuar 62 përmbarues gjyqësor privatë¹⁸² dhe përbëhet nga Asambleja e Përgjithshme, organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrjes, e cila zgjedh çdo 4 vjet organet drejtuese të Dhomës, Kryetarin e Dhomës, Nënkryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe 7 anëtarët e Këshillit Drejtues.

Dhoma Kombëtare, jo vetëm mbikëqyr ushtrimin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat, por edhe e përfaqëson atë përpara të gjithë aktorëve në tregun përmbarimor. Ajo i ushtron funksionet e pavarur nga shteti, në përmbushje të funksionit të vet. Në kuadër të këtyre detyrave, dhoma ka ndërmarrë nisma të orientimeve ligjore brenda tagrave që ajo ka, duke adresuar disa nga problemet më të mprehta aktuale jo vetëm ligjore, por edhe sociale. E tillë është Direktiva Nr.46, datë 19.01.2015 “Për unifikimin dhe zbatimin e përkohshëm të masës së sekuestros konservative mbi pagën e debitorit ¹⁸³”. Me anë të kësaj direktive Dhoma në mbështetje të nenit 25 të Ligjit Nr. 10031 datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, ka kërkuar të orientojë të gjithë përmbaruesit gjyqësor privatë. Gjatë kryerjes së veprimeve ekzekutive mbi të ardhurat e pagës së palës debitore, duhet të respektohet “minimumin jetik” sipas Vendimit Nr. 573, datë 3.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

Mendojmë që kjo direktivë është një mjet, e cila synon të disiplinojë këtë fushë, duke mundësuar realizimin e të drejtave të kreditorit, por pa cënuar të drejtat themelore të debitorit. Për këtë arsye në direktivë janë parashikuar edhe dy rastet përjashtimore nga rregulli “i pagës minimale”. Përjashtimi së pari i referohet vetëm rasteve të detyrimeve ushqimore, duke vendosur, se për këto raste duhet të aplikohet një masë sa gjysma e pagës minimale të sekuestruar. Ndërsa rasti tjetër i përjashtimi ndodhur kur ndaj debitorit nuk arrihet të kryhet asnjë sekuestrim tjetër pasurie, përveç atij të pagës, atëherë për këto raste qëndron me vend dhe do të duhet të aplikohet një masë sekuestrimi sa 30% e pagës për nevoja të ekzekutimit.

Mendojmë se deri diku, Dhoma ka mbajtur një qëndrim të drejtë duke dashur të unifikojë praktikën përmbarimore. Gjithsesi jo të paktë kanë qenë zërat brenda trupës së përmbaruesve gjyqësor kundër Direktivës duke argumentuar se Dhoma ka dalë jashtë tagrave, që i janë njohur nga ligji. Në një situatë të tillë informaliteti, ku debitori nuk deklaron të ardhurat e tij ose i detyruar nga ligji i deklaron deri në masën e pagës minimale, kjo direktivë e favorizon më tepër atë duke cënuar të drejtat e kreditorit për ekzekutimin efektiv të titullit ekzekutiv. Mendojmë se kësaj situatë të lënë pezull për një kohë relativisht të gjatë, duhet t’i jepet një zgjidhje sa më

¹⁸² Vlerësim i sistemit të Drejtësisë, Kontribut i Dhomës Kombëtare të përmbaruesve gjyqësor private 18.06.2015 faqe 3

¹⁸³ <http://www.nchb.al/blog/2015/01/20/njofitim-aksesuar-per-herë-te-fundit-ne-date-20.01.2016>

shpejtë nga ligjvënësi, duke mënjanuar çdo hapësirë për interpretim dhe duke iu garantuar masën minimale të paprekshmërisë ekonomike të çdo individit.

Ndërkohë, nisma tjetër ligjore që vlen të analizohet, është direktiva nr.61. Prot, datë 09.02.2015, e cila ka ngjallur jo pak debat, sidomos nga ana e sektorit bankar, pasi ka të bëjë me “Vlerën e pandryshueshme të detyrimit monetar ndaj debitorëve në një proces përmbarimor”. Kjo direktivë prek një aspekt mjaft të rëndësishëm të punës së përditshme të përmbaruesve gjyqësor. Ajo synon të orientojë zbatimin e njëjtë nga përmbaruesit gjyqësor, të pandryshueshmërisë së detyrimit monetar ndaj debitorit në çështje me palë kreditore bankat tregtare ose institucionet financiare jobankare.

Përlllogaritja e interesave dhe penalteteve në vonesë ndaj debitorëve sipas vlerave dhe përqindjeve të parashikuara në kontratën e kredisë edhe pas marrjes së vendimit të urdhërit të ekzekutimit, përbën një situatë shqetësuese dhe joligjore, me të cilën në mjaft raste përballeshin debitorët dhe përmbaruesit gjyqësor, të cilët ligjërojnë këto shuma. Shpeshherë, pjesë e kësaj praktike të gabuar, në mënyrë të imponuar, është bërë edhe shërbimi përmbarimor. Sipas direktivës, në çështjet ku palë kreditore është një institucion financiar bankar ose jobankar, përmbaruesit gjyqësor për fillimin dhe përfundimin e procedurës përmbarimore, duhet të marrin si bazë vetëm vërtetimin e detyrimit që mban të njëjtën datë me atë të kërkesës për vënien në ekzekutim dhe asnjë vërtetim tjetër¹⁸⁴.

Mendojmë se, miratimi i kësaj direktive përbën një qëndrim të drejtë e ligjor, në mbështetje të punës së përmbaruesve gjyqësor, të cilët duhet të distancohen nga këto praktika aspak ligjore, që çënojnë akoma më shumë integritetin e përmbaruesit dhe rëndojnë pa të drejtë pozitën sociale të palës debitore.

Gjithsesi puna e Dhomës duhet të intensifikohet më tepër në planin e mbrojtjes së të drejtave të përmbaruesve gjyqësor gjatë punës së përditshme. Ky fakt reflektohet në situatën e krijuar me hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.37, datë 21.01.2016¹⁸⁵ ku qëndrimi i Dhomës ishte i vonuar dhe mjaft i vakët. Lobimi dhe reagimi ligjor duhet të ishte më aktiv, pasi prekej drejtpërdrejt interesi ekonomik i secilit përmbarues gjyqësor privat gjatë ushtrimit të profesionit të tij.

3.6. Ndryshimet që propozohen nga reforma në drejtësi në fushën e shërbimit përmbarimor dhe atë të ekzekutimit të vendimeve

Reforma aktuale në drejtësi parashikon një strategji në fushën e profesioneve të lira e veçanërisht në atë të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Ekzekutimit efektiv i titujve ekzekutiv garantohet duke përmirësuar rregullat procedurale dhe nivelin e shërbimit të përmbaruesve si dhe duke rritur profesionalizmin, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien në ushtrimin e këtij profesioni.

¹⁸⁴ Direktivë e cituar, faqe 6

¹⁸⁵ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.37, datë 21.01.2016 “Për përcaktimin e pagës mujore për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personat e regjistruar si të vetëpunësuar, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale dhe punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë dhe bashkëjetojnë me të”

Nga analiza, që është kryer nga grupi i punës për reformën në sistemin e drejtësisë¹⁸⁶ janë evidentuar një sërë mangësish në shërbimin përbarimor shtetëror dhe privat, zgjatje të pajustificuara në ekzekutimin e titujve ekzekutiv, mungesë transparence, paanshmërie dhe përkushtimi në ushtrimin e detyrave, si dhe vonesa të mëdha në ekzekutim¹⁸⁷. Për këtë arsye, është thelbësor reformimi nëpërmjet ndryshimeve legjislative, për plotësimin e vakumit ligjor dhe nxitjes së bashkëpunimit korrekt ndërmjet institucioneve, për mënyrën e ndërhyrjes në reformimin e profesionit të përbaruesit gjyqësor.

Janë ndërmarrë një sërë ndryshimesh në kuadrin ligjor, të cilat kanë synuar krjimin e lehtësirave në fushën e procedurave përbarimore. Me ndryshimet e fundit, që i janë bërë K.Pr.Civile¹⁸⁸, kryesisht nenit 511/a të tij, është suprimuar kërkesa për lëshimin e urdhërave të ekzekutimit për një vendim gjyqësor të formës së prerë. Nëpërmjet këtij ndryshimi, lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për një vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk është një proces më vete, por ai lëshohet së bashku me vendimin përfundimtar nga Gjykata e Shkallës së Parë, që ka dhënë vendimin. Në këtë rast, kancelari konfirmon urdhërin e ekzekutimit, brenda pesë ditëve nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor.

Ndërsa ligji 49/2012 “Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” e suprimoi fazën e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit duke bërë që, vendimi gjyqësor të jetë njëkohësisht edhe titull ekzekutiv edhe urdhër ekzekutimi¹⁸⁹. Ligji nuk mjaftohet me kaq, por sjell edhe një risi tjetër në fushën ekzekutive, atë të figurës së gjyqtarit ekzekutues. Kjo, pasi gjyqtari i Gjykatës Administrative me kërkesën e palëve ose të përbaruesit gjyqësor edhe gjatë fazës që, çështja është duke u shqyrtuar nga shërbimi përbarimor, mund të urdhërojë kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e kryerjes së tyre. Në ndryshim nga procedura civile në atë administrative, është parashikuar edhe fakti që gjyqtari ndjek procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, që ai vetë ka shpallur. Kështu, në përfundim të afatit të ekzekutimit të detyrueshëm, gjyqtari njoftohet me shkrim nga përbaruesi gjyqësor për veprimet e kryera nga organi publik debitor dhe në rast se konstaton moskryerje me faj të detyrimeve dhe pa shkaqe të përligjura, sipas vendimit apo urdhërave të gjykatës, vendos gjobë ndaj titullarit të organit publik debitor¹⁹⁰. Kur është rasti, gjyqtari kërkon marrjen e masave disiplinore ose paraqet kallëzim penal ndaj personave përgjegjës.

¹⁸⁶Analizë e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për reformën në sistemin e drejtësië, Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, faqe 247

¹⁸⁷Raport i veçantë i Avokatit të Popullit “Për situatën e krijuar nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë” 2012

¹⁸⁸Ligji nr.122/2013 datë 18.04.2013 neni 39 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996” “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ka hyrë në fuqi në datën 01.09.2013

¹⁸⁹Neni 66 pika 3 i ligjit 49/2012 *Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative i cili parashikon: Shërbimi përbarimor gjyqësor shtetëror, nëpërmjet zyrës përbarimore kompetente, si dhe shërbimi përbarimor gjyqësor privat janë të detyruar të ekzekutojnë vendimet e gjykatës administrative, sipas rregullave të këtij ligj.*

¹⁹⁰Neni 66 i ligjit 49/2012 *Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative parashikon se: masa e gjobës është e barabartë me 20 përqind të pagës minimale, në shkallë vendi, për çdo ditë vonesë në ekzekutim.*

Ky është një ndryshim thelbësor nga praktika e procedurës civile. Mendojmë që, ndërhyrja e gjyqtarit administrativ edhe gjatë fazës ekzekutive e ka përmirësuar këtë fazë, duke e bërë më se të domosdoshëm prezencën e këtij gjyqtari edhe në procedurën civile. Kjo, pasi ndodh shpesh në praktikën procedurale-civile, që të bëhen kundërshtime të çdo veprimi të përmbaruesit gjyqësor gjatë ekzekutimit të të njëjtit titull ekzekutiv, të cilat për shkak të shortit mund të shqyrtohen nga disa gjyqtarë të ndryshëm paralelisht. Kjo, pasi për të njëjtin titull ekzekutiv, mund të jepen vendime gjyqësore të ndryshme ose kontradiktore¹⁹¹. Për këtë arsye, mendojmë se në kuadër të reformës në drejtësi, një nga ndryshimet që duhet marrë në konsideratë është edhe ajo e nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, në mënyrë të tillë që të parashikohet mundësia që paditë dhe kërkesat gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të një titulli ekzekutiv, të shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar që është kompetent sipas nenit 511 i K.Pr.Civile.

Ligji nr.122/2013 solli të tjera ndryshime në K.Pr.Civile¹⁹² në lidhje me lehtësimin dhe përsheptimin e procedurave përmbarimore, mbi pasuritë e paluajtshme të lëna si kolateral për kreditorët në institucione bankare apo institucione financiare jobankare. Duke e limituar kohën e shqyrtimit gjyqësor, për këto lloj çështjesh brenda afatit 20 ditor, kohë gjatë së cilës është e vlefshme masa e pezullimit. Ndryshime të cilat patën tjetër impakt në praktikë, pasi ka rezultuar se gjykata e ka të pamundur të zhvillojë një proces hetimi dhe vlerësimi gjyqësor për një afat kaq të shkurtër.

Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor për ekzekutimin në përputhje me standardet e vendeve anëtare të BE-së, mbetet një sfidë që reforma në drejtësi synon ta përmbushë. Për këtë duhen shqyrtuar mundësitë për hartimin e një ligji të ri për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, ndoshta kjo në formën e një Kodi në fushën e ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Kod, i cili do të ndihmonte në unifikimin e praktikës përmbarimore gjyqësore dhe plotësimin e evakumit ligjor në këtë fushë. Si shembull mund të shërbej edhe modeli i adoptuar nga Organizata Botërore e Funkionarëve Gjyqësor ose ndryshe UIHJ, siç është ai i Kodit Global të Ekzekutimit të Detyruar. UIHJ ka punuar 10 vjet rresht për krijimin e këtij kodi, i cili përmbledh një tërësi rregullash mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe funksionarëve që i kryejnë ato, duke u përpjekur të krijojë një unifikim global për të gjitha shtetet dhe profesionistët që do e përdorin atë. Kodi Global, si dokumenti final i përpunuar mbi parime dhe udhëzime të përafruara nga eksperiencat kombëtare të të gjitha shoqërive të përparuara demokratike, shpejt do të synohet të prezantohet dhe implementohet në të gjitha vendet anëtare të UIHJ¹⁹³. Ndjekja e Kodit mund të shërbej si një model për ta implementuar këtë dokument në sistemin juridik shqiptar.

¹⁹¹ Gjatë zbatimit të titullit ekzekutiv, kontratës huaje nr.1337.Rep, nr.266.Kol date 26.05.2005 janë bërë disa kundërshtime veprimesh përmbarimore dhe për këtë janë marrë disa vendime, Vendimin nr.62-2012-4252- (1859), date 11.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i cili ka marrë formë të prerë pasi nuk është pranuar ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë me vendimin nr.1319, date 19.11.2015. Vendimit nr.582, date 30.04.2015 te Gjykatës së Apelit Vlorë dhënë për kundërshtimin e një veprimit tjetër përmbarimor dhe vendimi nr.62-2012-6735 (2408) date 05.12.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr.277, date 20.02.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

¹⁹² Në nenet 564 dhe 610 të këtij Kodi

¹⁹³ http://www.uilh.com/en/global-code-of-enforcement_2165010.html aksesuar për herë të fundit në datë 15.03.2016

Një tjetër aspekt, që synon të ndryshojë reforma është ajo e rritjes së nivelit profesional të përmbauesve duke parashikuar trajnime fillestare dhe të vazhdueshme, nëpërmjet mekanizmave të kontrollit gjatë trajnimit. Nevoja për trajnim fillestar i përmbauesve gjyqësor të sapocertifikuar dhe trajnim i vazhdueshëm për të gjithë përmbauesit, është domosdoshmëri në kuadër të zhvillimeve të reja dhe përafrimit me standardet evropiane. Ekzekutimi i titullit ekzekutiv është një fushë krejt e veçantë dhe për një jurist që ka fituar konkursin e pranimit si përmbaues gjyqësor, kryerja e trajnimit fillestar përbën një etapë mjaft të rëndësishme të njohjes dhe zhvillimit profesional. Prandaj trajnimi duhet të gërshetohet të dy sferat, si atë ligjore e teorike, dhe atë praktike. Për realizimin e trajnimit është i nevojshëm krijimi i një strukture bazuar në modelin e Shkollës së Magjistraturës ose Shkollës së Avokatisë. Nuk ka një model-strukturë të preferuar për trajnimin, pasi çdo zgjedhje ka avantazhet dhe disavantazhet e saj, në varësi nga faktorët ekonomikë, profesionalë dhe politikë.

Kjo strukturë duhet të jetë organ i Dhomës Kombëtare të përmbauesve gjyqësor privatë me objekt formimin teorik dhe trajnimin rigoroz të përmbauesve gjyqësor, për rregullat e etikës dhe standardeve profesionale. Për vetë funksionin që kërkon të realizojë kjo shkollë, duhet të shikojë mundësitë e bashkëpunimit me institucionet e ngjashme me të, jo vetëm në nivelin rajonal por edhe atë evropian. Sistemi akademik sipas mendimit tonë, duhet të përbëhet nga një program studimor njëvjeçar dhe duhet të realizojë edhe studime apo botime në fushën e ekzekutimit të titujve, revistave. Trajnimi i profesionistëve përmbaues është e vetmja rrugë drejt suksesit dhe konsolidimit të këtij profesioni në Shqipëri. Prandaj inkurajohet ngritja e një shkolle për këtë qëllim. Një praktikë e tillë ndiqet nga shumë vende evropiane, të cilët e kanë pjesë të detyrueshme trajnimin fillestar për profesionin e përmbauesit.¹⁹⁴

Sipas parimit të 4 të Rekomandimit 17/2003, përmbauesi gjyqësor duhet të jetë i paanashëm dhe kompetent në ushtrimin e detyrave të tij, duke vepruar në çdo kohë sipas parimeve më të larta profesionale dhe etike. Përmirësimi i shërbimit përmbaues duke fuqizuar masat mbikëqyrëse, do të bëhej i mundur nëpërmjet krijimit të një mekanizmi të veçantë kontrolli dhe monitorimi për vlerësimin e ekzekutimit në aspektin e legjitimitetit. Prandaj nuk mjafton vetëm trajnimi i kësaj trupe juristësh përmbaues, por po aq i rëndësishëm është edhe implementimi i sistemit të vlerësimit individual të përmbauesve gjyqësor. Ky sistem vlerësimi do të shërbente, për monitorimin dhe kontrollimin e përmbauesve, duke nxjerrë në pah të metat dhe anët pozitive të secilit përmbaues. Nga ky vlerësim, së pari do të përfitonte secili përmbaues, pasi do të korrigjonte të metat profesionale të tij dhe nga ana tjetër përmirësimi i secilit komponent do t'i shërbente të mirës së përgjithshme, në këtë mënyrë i gjithë shërbimi përmbaues do të fuqizonte kapacitetet e tij në këndvështrimin profesional, funksional dhe financiar, si një shërbim konkurrues.

Sistemi i monitorimit dhe kontrolli efektiv do të ndihmonte në rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë për ekzekutimin e titujve ekzekutiv. Për bërë të mundur këtë të fundit, propozojmë krijimin e një databaze publike për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve përmbaues. Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbauesit gjyqësor (ALBIS) u

¹⁹⁴Zlatislava Mihailova, Jos Uitdehaag "Analysis of training needs of the enforcement agents in Albania" 2 November, fq. 10

krijua dhe implementua nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2013. ALBIS ishte një sistem informatik që synonte zëvendësimin e procedurave manuale të përpunimit të çështjeve me procedura elektronike, për ta bërë sistemin përmbartimor më transparent. Nëpërmjet digjitimit të informacionit bëhet i mundur edhe përpunimi i të dhënave nga sistemi në formën e analizave dhe raporteve. Këto të fundit hedhin dritë për performancën e secilit përmbartues dhe bëjnë të mundur inspektimin e respektimit të procedurave përmbartimore.

Për funksionimin e sistemit ALBIS, janë kryer inspektime nga ana e Ministrisë së Drejtësisë gjatë muajit Prill 2012 në 46 zyra përmbartimore të përmbartuesve gjyqësor privatë në shkallë vendi dhe janë konstatuar shkelje në përdorimin e sistemit të regjistrimit, të çështjeve përmbartimore (ALBIS) duke mos hedhur në sistemin dixhital të dhënat. Për këtë arsye janë dhënë masa disiplinore ndaj përmbartuesve gjyqësor, të llojit gjobë¹⁹⁵. Megjithatë, jetëgjatësia e këtij sistemi për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme në sistem, ishte e shkurtër. Prandaj vlerësojmë mëse të nevojshëm riimplementimin sërish të këtij sistemi, ashtu siç funksionon edhe për shërbimin e noterisë.

Krijimi i një platforme elektronike për të siguruar shkëmbimin e informacionit dhe dokumenteve ndërmjet shërbimit përmbartimor gjyqësor. Në kuadër të bashkëpunimit institucional duhet marrë në konsideratë edhe mundësia për ta shkëmbyer këtë informacion edhe me vendet e rajonit edhe më gjerë. Ky shkëmbim do të sigurojë njohuri më të mira të proceseve, që lidhen me praktikën e ekzekutimit të vendimeve, si dhe koordinim e ndërveprim më të plotë në këtë fushë. Në mënyrë që shërbimi përmbartimor të jetë efikas, nuk mjafton vetëm reformimi i tij, por është e nevojshme edhe rritja e bashkëpunimit midis palëve të interesuara, qofshin këto institucione publike dhe private, të përfshira në procedurat e ekzekutimit.

Problematike mbetet ende fakti se vendimet e gjykatave dhe në veçanti i Gjykatës Kushtetuese mbeten pa u ekzekutuar. Në rastin e Gjykatës Kushtetuese i referohem atyre vendimeve që konstaton cënim të procesit të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Kjo ka vënë në pikëpyetje efikasitetin e vendimeve të GJK, gjë e cila është konstatuar edhe nga GJEDNJ në praktikën e saj me palë shtetin shqiptar. Sepse, sistemi i drejtësisë nuk mund të zhvillohet me vonesa, që çojnë në dobësimin e rolit të gjykatave dhe të besimit në to¹⁹⁶. Një situatë e tillë ka krijuar precedentin e rrezikshëm për t'i mohuar këtij organi funksionin e garantit të Kushtetutës, për faktin se roli i Gjykatës qëndron pikërisht në fuqinë detyruese të vendimeve të saj. Ky efekt ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit¹⁹⁷. Mekanizmat e përcaktuara nga neni 81 i ligjit organik i Gjykatës Kushtetuese, duhet të bëhen funksionale dhe këtë përgjegjësi e ka, si Gjykata Kushtetuese,¹⁹⁸ ashtu edhe Kuvendi përmes procesit legjislativ.

¹⁹⁵ Plani i veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të drejtësisë për vitin 2011-2013 e Ministrisë së Drejtësisë, faqe 31

¹⁹⁶ Çështja *Bageta k. Italisë*, 25 qershor 1998, cituar në vendimin nr.6, datë 31.03.2006 i Gjykatës Kushtetuese

¹⁹⁷ Shihni vendimin nr.14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese të RSH

¹⁹⁸ Shihni nenin 81 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" *Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore, megjithatë Gjykata Kushtetuese në këtë drejtim gëzon diskrecion për sa i përket mundësisë së caktimit vetë të një organi tjetër që ngarkohet me zbatimin e vendimit të saj dhe, kur është e nevojshme, ajo mund të përcaktojë edhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit. Personat që nuk zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose*

Në kuadër të ndryshimeve kushtetuese për reformën në drejtësi është e nevojshme që të bëhen ndryshimet në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese duke e bërë efikas sistemin e ekzekutimit të vendimeve të kësaj gjykate, për gjykimin e kërkesave për proces të rregull ligjor në lidhje me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm. Reforma në drejtësi ka theksuar rëndësinë e veçantë për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe organizativ të ushtrimit të profesionit të përmbartuesit, duke fuqizuar rolin rregullator të Dhomës. Në këtë kuadër, duhet të përcaktohet një mekanizëm i qartë ligjor për numrin e përmbartuesve privatë, bazuar kjo në një vlerësim të rregullave ekzistuese për numrin e licensave dhe praktikave më të mira evropiane.

3.7. Statusi i përmbartuesit gjyqësor në Bashkimin Europian: krahasimi me atë shqiptar

Në mënyrë të përmbledhur po parashtrijmë mënyrën e organizimit të sistemeve përmbartimore në disa nga vendet e Bashkimit Europian, duke nxjerrë në pah veçantitë dhe të përbashkëtat. Në Bullgari ka një sistem miks ku bashkëveprojnë sistemi shtetëror me sistemin përmbartimor privat, të ngjashëm me sistemin shqiptar. Juridiksioni i përmbartuesve shtetërorë është rajonal, ndërsa përmbartuesi privat është pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Kriteret për të qënë përmbartues gjyqësor janë: të jetë shtetas bullgar, të ketë aftësi për të vepruar, të ketë diplomë në drejtësi, të ketë një përvojë juridike tre vjeçare, nuk është dënuar me burgim për kryerjen e një krimi, pavarësisht nëse është rehabilituar, nuk është dënuar për falimentim, nuk është në procedurë falimentimi. Në ligj për përmbartimin privat, i cili hyri në fuqi në vitin 2005, është parashikuar një përmbartues gjyqësor privat për 30.000 banorë. Përmbartuesi emërohet nga ministri i Drejtësisë, pasi ka fituar provimin e kualifikimit. Aktualisht në sistemin bullgar veprojnë 159 përmbartues privatë¹⁹⁹, nga të cilët 81 janë gra.

Sistemi përmbartimor gjyqësor bullgar është i ngjashëm me sistemin shqiptar, i vetmi ndryshim është se përmbartuesit privatë në Bullgari kanë kompetencë territoriale vetëm pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, ku ata ushtrojnë veprimtarinë. Përmbartuesit privatë mund ta ushtrojnë individualisht profesionin, ose mund të organizohen në formën e parashikuar nga neni 357-364 i ligjit për Kontratat dhe Detyrimet. Kanë të drejtë për të kërkuar informacion mbi të dhënat personale dhe pasurore të debitorit në të gjithë institucionet.

Në Francë²⁰⁰, përmbartuesit gjyqësor e kanë të drejtën për të kryer njoftimet e akteve dhe për ekzekutimin e vendimeve të drejtësisë dhe të akteve që përbëjnë tituj ekzekutiv. Ata mund të përpilojnë raporte, mund të mbledhin kredi dhe në disa raste mund të vlerësojnë dhe të kryejnë shitje publike të sendeve. Ata kujdesen edhe për thirrjen e seancave gjyqësore. Kriteret për të qënë funksionar gjyqësor janë: të jetë shtetas francez me integritet të lartë moral, të ketë një

pengojnë zbatimin e tyre, kur veprimi nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë deri në 100 mijë lekë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është i formës së prerë dhe përbën titull ekzekutiv. Nga kjo dispozitë duket që sistemi i zgjedhur i ngjason atij të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ku organi që merret me ekzekutimin e vendimeve të kësaj Gjykate është Komiteti i Ministrave nëpërmjet strukturave të tij.

¹⁹⁹International Union of Judicial officers. *General Assembly of the Bulgarian Chamber of Private Enforcement Agents on 28 January 2012 in Sofia*. Marrë nga: <http://www.uhj.com> parë për herë të fundit më [12.05.2015].

²⁰⁰International Union of Judicial officers. *The judicial officer in the European Union*. Marrë nga: <http://www.uhj.com/en/ressources/10148/54/france-en.pdf>. parë për herë të fundit më [22.08.2015].

diplomë Masteri, të ketë përfunduar një program trajnimi, si praktikë dy vjeçar, të ndjekë kurset e trajnimit profesional dhe të ketë fituar provimin e kualifikimit. Në vazhdim duhet të gjejë një vend për të praktikuar profesionin, përveç rasteve të veçanta, kur ai mund të blejë të drejtën e përfaqësimit nga një profesionist paraardhës. Në Francë ekzistojnë një sërë institucionesh trajnuese, që njihen në nivel ndërkombëtar. Ata veprojnë si funksionar ministrie të emëruar nga Ministria e Drejtësisë. Përmbartimi gjyqësor është një profesion i lirë dhe i pavarur, por duhet të jetë i siguruar profesionalisht.

Përmbartuesit gjyqësor mund ta ushtrojnë individualisht profesionin, ose mund të organizohen si person juridik, për të ushtruar detyrën mund të punësojnë bashkëpunëtorë ose ndihmës. Përmbartuesi e ushtron aktivitetin brenda rrethit të vendbanimit, pra kufizohet nga kompetenca territoriale e vendit të ekzekutimit. Liria e zgjedhjes së përmbartuesit i përket kreditorit, por duke respektuar kompetencën territorial. Përmbartuesi pasi ngarkohet me ekzekutimin, duhet të bëjë fillimisht përpjekje për një ekzekutim vullnetar. Në rast dështimi, ai përpriqet të marrë një titull ekzekutiv, që i jep të drejtën e fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm. Kostot e këtij shërbimi i ngarkohen debitorit. Nëse ky i fundit është në pamundësi për të paguar, i mbeten kreditorit. Funksionarët gjyqësor kanë të drejtë të japin konsulencë juridike, nuk ka kufizim për këtë fakt, kanë monopol të ekzekutimit të urdhërit të ekzekutimit, të vendimeve gjyqësore, për mbledhjen e borxhit, e cila përbën edhe 20% të punës, si dhe kanë të drejtë të organizojnë dhe shesin sendet në ankand publik.

Në shtator të vitit 2014 nga ana funksionarëve gjyqësor francez, u organizua një protestë ndaj reformës, që kërkonte të implementonte Ministria e Ekonomisë, kjo reformë sjell për Francën dobësimin e ligjit kontinental në favor të forcimit të modelit Common Laë. Por duke qenë se, modeli francez është një model i adoptuar nga tridhjetë shtete, një reformë e tillë do të ketë një impakt të përgjithshëm të veçantë. Prandaj është e nevojshme të kryen konsultime paraprake me grupet e interesit.

Në Gjermani përmbartuesit gjyqësor quhet funksionar gjyqësor dhe janë funksionarë në shërbim të Landit dhe jo të shtetit Federal, që emërohen në detyrë nga ministri i Drejtësisë së Landit²⁰¹. Në kuadër të reformimit është liberalizuar ky shërbim dhe aktualisht ushtrojnë veprimtarinë 4600 funksionarë, nga të cilët 1150 janë femra. Në sistemin e gjerman ky profesion ushtrohet individualisht dhe nuk lejohet të ushtrohet bashkërisht. Kompetenca territoriale është e kufizuar nga njësia teritoriale e “Landit” shtetit.

Në ndryshim nga sistemi francez, në sistemin gjerman funksionarët kanë monopol vetëm për zbatimin e vendimit gjyqësor, nuk kanë të drejtën e përfaqësimit të palëve në gjykatë, merren me mbledhjen e borxhit, vetëm kur ka urdhër ekzekutimi dhe për një periudhë 6-12 muaj. Nuk përfshihet vullnetarisht në organizimin dhe në procedurën e shitjes në ankand publik. Ndryshe nga sistemi francez dhe bullgar, në sistemin gjerman përmbartuesi nuk ka akses për të kërkuar informacion mbi të dhënat personale dhe pasurore të debitorit, por kërkon nga ky i fundit të bëjë vetëdeklarimin e pasurisë dhe në rast të deklarimit të rremë mban përgjegjësi sipas ligjit.

²⁰¹International Union of Judicial officers.The Judicial Officer in the World. Marrë nga: <http://www.uij.com/en/ressources/10148/72/allemande-en.pdf>, parë për herë të fundit më [22.08.2015].

Në Belgjikë, përmbauesit gjyqësor janë nëpunës publikë ministrorë të emëruar nga mbreti me propozim të ministrit të Drejtësisë. Ata janë profesionistë të pavarur dhe ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të lirë. Rregullat e këtij profesioni dhe të emërimit në këtë pozicion, janë të përcaktuara hollësisht, dhe numri i përmbauesve është i kufizuar. Përmbauesi gjyqësor mund të mbledhë informacion për pasurinë e debitorit, ai ka mundësi të kontrollojë regjistrin kombëtar të popullsisë (për identitetin, adresat, ditëlindjet, kombësinë, statusin civil dhe përbërjen familjare). Ai mund të kontrollojë skedarët e sekuestrove, të bëjë kërkime mbi pasuritë e paluajtshme, të kontrollojë regjistrin e Drejtorisë së Transportit, ku janë të regjistruara automjetet, të kontrollojë Zyrën Kombëtare të Sigurimeve Shoqërore mbi identitetin e punëdhënësit të debitorit. Disa të dhëna mund të sigurohen vetëm pas paraqitjes së një titulli ekzekutiv, që tregon se personi në fjalë është shpallur debitor. Ai ka monopolin e njoftimit të akteve juridike, që kanë të bëjnë me gjykatën.

Në ndryshim nga sistemi francez dhe në ngjashmëri me atë shqiptar, nëse ka dështuar shlyerja vullnetare do të nevojitet ndërhyrja e avokatëve dhe e kreditorit para gjykatësit, për të marrë një urdher ekzekutiv, pasi përmbauesi nuk e përfaqëson klientin juridikisht si dhe mund të kryejë aktivitetet të tjera, si psh. të veprojë si ndërmjetës për borxhet, si sekuestrues ose si administrator i përkohshëm. Nga sa më sipër, mund të themi se sistemi bullgar i organizimit të shërbimit përmbauesor është i ngjashëm me sistemin shqiptar, qoftë në strukturë qoftë edhe në të drejtat që i njihen nga ligji përmbauesit.

Përveç modeleve të mësipërme kemi edhe një organizim tjetër, që është Dhoma Evropiane e Oficerëve Gjyqësor dhe Përmbauesor. Kjo dhomë është krijuar në vitin 2012, si një organ përfaqësues i këtyre profesioneve dhe merr pjesë në konsolidimin e hapësirës evropiane të drejtësisë duke zhvilluar mjetet teknike në të mirë të qytetarëve dhe kompanive, duke synuar përmirësimin e njohjes të së drejtës evropiane nga ana e oficerëve gjyqësor dhe përmbauesit si dhe në shkëmbimin e praktikave profesionale më të mira²⁰².

3.8. Marrëdhëniet e shërbimit përmbauesor me institucionet e përfshira në procesin e ekzekutimit, kjo edhe në këndvështrimin e legjislacionit evropian

Shërbimi përmbauesor ka një rol të veçantë në ekzekutimin e së drejtës së fituar, e cila përbën titull ekzekutiv. Për rolin dhe rëndësinë që ka përmbauesi, ka të drejtë të bashkëveprojë dhe të kërkojë mbështetjen e institucioneve të ndryshme. Në bazë të nenit 523 të K.Pr.Civile parashikohet, se me kërkesë të përmbauesit gjyqësor, ka detyrim ligjor përfaqësuesi i njësisë vendore për të qenë i pranishëm në vendekzekutim, kur duhet të kryhet ekzekutimi i detyrueshëm i çeljes së banesës së debitorit dhe ky i fundit nuk është i pranishëm. Kur përmbauesi e kërkon, pasi është e nevojshme në këtë procedurë, Policia e Shtetit ka detyrim ligjor për të mbështetur përmbauesin në mbarëvatjen e ekzekutimit. Po në këtë dispozitë të K.Pr.Civile parashikohet, se detyrimi për bashkëpunim midis Përmbauesit Gjyqësor dhe Inspektoriatit ndërtimor pranë

²⁰²International Union of Judicial officers. *The judicial officer in the European Union*. Marrë nga: <http://www.cehj.eu/organisation/edito/> aksesuar per here te fundit ne daten 06.07.2016

pushtetit vendor dhe Inspektoriatit Kombëtar, në rastet kur ekzekutimi ka si objekt lirim dhe dorëzimin e sendit të debitorit. Ky detyrim për bashkëpunim parashikohet edhe në Ligjin nr.10031, datë 11.12.2008²⁰³. Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përmbaruesin gjyqësor privat në ushtrimin e funksioneve sipas ligjit, sa herë që kërkohet ndihma e tyre²⁰⁴.

Mungesa e bashkëpunimit me institucionet, në veçanti në ato raste kur si palë debitore janë institucionet shtetërore, të cilat për shkak të paaftësisë paguese, zgjasin dhe vështirësojnë procedurën përmbarimore pa shkak ligjor. Në këto raste ekzekutimi i vendimeve të gjykatave mbetet i ngadalë, dhe vazhdon të minojë sigurinë juridike. Cënimi i një parimi të tillë ka pasoja të rëndësishme, jo vetëm për palët e përfshira në procesin ekzekutiv, por në veçanti për figurën e shtetit, pasi qytetarët humbasin besimin tek funksionimi i sistemit të drejtësisë. Ka mungesë bashkëpunimi midis përmbaruesit gjyqësor me organe të tilla si Ministria e Financave, Policia e Shtetit, Inspektoriatit Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor apo Kombëtar, organet e pushtetit vendor, institucioneve që mbulojnë të drejtat e pronësisë etj, mossqarim për të drejtat dhe detyrimet e palëve pjesëmarrëse në procesin e ekzekutimit dhe me vetë përmbaruesin, fakt, që reflekton në cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit.

Ndërsa përsa i përket nivelit ndërkombëtar, Shqipëria është bërë anëtare me të drejta të plota e Organizatës Botërore e Funkionarëve Gjyqësor (UIHJ) në maj të vitit 2012. UIHJ është angazhuar për monitorimin dhe kontrollin e profesionit të përmbaruesve gjyqësor dhe ka inkurajuar për vazhdimin e aktiviteteve të trajnimit, në përputhje me rekomandimet e përfshira në udhëzimet e Komisionit për Efikasitetin e Drejtësisë të Këshillit të Europës (CEPEJ) mbi zbatimin e 17 dhjetorit, 2009. UIHJ me anë të asistencës së saj, ka mbështetur në forcimin e aftësive profesionale të përmbarimit gjyqësor privat dhe strukturave përfaqësuese të tij. Nisma më e fundit e saj është hartimi, promovimi i Kodit Global të ekzekutimit të detyrueshëm në maj të vitit 2015, i cili po ratifikohet nga të gjitha shtetet dhe anëtarësitë e UIHJ-së, anëtare e së cilës është edhe Shqipëria, me Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat.

3.9. Respektimi i Kodit të Etikës së përmbaruesve gjyqësor shtetërorë dhe privat

Kodi i Etikës²⁰⁵ përcakton një sërë rregullash mbi bazën e të cilave udhëhiqet veprimtaria profesionale. Përmbaruesi gjyqësor duhet të veprojë në mënyrë profesionale, të paanëshme dhe të ndershme, në mënyrë që autoriteti shtetëror të gjejë shprehjen e vet në këtë shërbim. Duke

²⁰³ Në nenin 31,46 të ligjit 10031 dt 11.12.2008 “ Për shërbimin Përmbarimor gjyqësor Privat” në pikën b thuhet shprehimisht: *Përmbaruesi gjyqësor privat, kur e konsideron të nevojshme për veprimatrinë e tij procedurale ka të drejtë të kërkojë çdo informacion që ka të bëjë me gjendjen e debitorit, apo vendodhjen e tij të nevojshme për procedurat e ekzekutimit nga institucione shtetërore, personat juridike apo fizike në përputhje me ligjin , ndërsa në pikën c të të njëjtit nen thuhet: Përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë të aplikojë sanksionet e parashikuara në ligj ndaj subjekteve fizike apo juridike që pengojnë në mënyrë të paligjshme procedurën e ekzekutimit në përputhje me nenin 46 të këtij ligji.*

²⁰⁴ Neni 46 i Ligji nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbarimor privat”

²⁰⁵ Miratuar me urdhrin nr.3851, datë 08.05.2009 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Kodit të Etikës të Përmbaruesve Gjyqësorë shtetërorë dhe privatë”

respektuar të drejtat dhe liritë themelore të palëve në një proces ekzekutiv. Drejtësia, që ballafaqohet apo jepet në terren nëpërmjet veprimeve përbarimore, është pjesa më e vështirë e të gjithë sistemit të dhënies së drejtësisë në këtë vend. Për këtë arsye, zbatimi dhe respektimi i Kodit të Etikës gjatë punës përbarimore merr një rëndësi të veçantë, pasi njohja e të drejtës së mohuar nga sistemi gjyqësor është e shtrirë në kohë dhe përveç kësaj ka kosto financiare për secilën palë. Në përfundim të këtij kalvari të stërgjatur, përbaruesi duhet të zbatojë në mënyrë të detyrueshme rregullat e Kodit të Etikës, për të qenë i duruar si me palën kreditore që pret me padurim të realizojë të drejtën e fituar ashtu edhe me pretendimin dhe paaftësinë paguese të palës debitore. Përbaruesi duhet të balancojë interesat e palëve në procesin e ekzekutimit, duke u përgjigjur në raport me objektivat e ekzekutimit.

E gjithë veprimtaria e përbaruesve gjyqësor, duhet të karakterizohet nga tre parime bazë: ligjshmëria, objektiviteti dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj të subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim. Çdo veprim ekzekutiv i ndërmarrë prej tyre, duhet domosdoshmërisht të jetë i parashikuar nga ligji, pasi ligji përbën bazën dhe kufijtë e shtetit. Veprimet e kryera prej tyre për ekzekutim, duhet të jenë të paanëshme edhe aty ku ka vend për diskrecion si në rastin e fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm. Këtu është rasti tipik, ku duhet të shfaqet objektiviteti dhe paanshmëria e përbaruesit, të cilat përbëjnë një detyrim ligjor dhe mbi të gjitha një detyrim kushtetues.

Të gjithë subjektet, kushdo qoftë kreditori, debitori, apo personi i tretë, në çdo fazë të procesit të rregullt ligjor duhet t'i kushtojnë rëndësi themelore respektimit të tyre, pasi kjo shërben si etalon matës për vlefshmërinë e të drejtës pozitive dhe si kufij që i vendosen pushtetit legjitim të shtetit²⁰⁶. Mosrespektimi i këtij parimi do të sillte pasoja të rënda. Duke qenë se faza ekzekutive, është pjesë e procesit të rregullt ligjor, mosrespektimi i të drejtave në çdo fazë të tij, e bën procesin të "parregullt", i cili deri në përfundim të fazës ekzekutive është ende i papërfunduar. Ky proces mbaron kur përbaruesi gjyqësor ekzekuton tërësisht detyrimin dhe kreditori merr të drejtën e përcaktuar nga titulli ekzekutiv. Respektimi i këtij parimi nga përbaruesi gjyqësor sjell, që veprimet e tyre të jenë në përputhje me kushtetutën, ligjin.

Këto parime janë të cilësuar si "bazë" të Kodit të Etikës, pikërisht për rëndësinë themelore që paraqesin dhe pasojat ligjore të moszbatimit të tyre. Për vetë rëndësinë që kanë, duhet të zbatohen me përpikëmeri nga përbaruesit gjyqësor gjatë procedurës përbarimore. Këto parime duhet të udhëheqin përbaruesit gjatë fazës ekzekutive dhe janë vlerësues të veprimeve ekzekutive. Respektimi i tyre është tregues i qartë i punës së tyre dhe sjell një mbrojtje të sigurisë juridike.

²⁰⁶ Aurela Anastasi "E drejta kushtetuese" shtëpia botuese Pegi, Tiranë 2004, fq.. 57

KAPITULLI I IV. REGJIMI JURIDIK I EKZEKUTIMEVE TË VEÇANTA TË VENDIMEVE GJYQËSORE

4.1. Kuptimi i ekzekutimit të detyrueshëm

Një vendim përfundimtar, do të mbetet një deklaratë e thjeshtë për të drejtat dhe detyrimet e palëve, nëse palët nuk do të kenë mundësinë për ta vënë në zbatim me anë të forcës shtrënguese të shtetit. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për të gjithë titujt e tjetër ekzekutiv. Këto masa shtrënguese për respektimin e normave të së drejtës në fushën e raporteve juridike civile gjejnë shprehjen e tyre pikërisht në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv²⁰⁷.

Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës dhe të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë²⁰⁸ dhe është i detyruar t'i respektojë ato. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre, pasi ekzekutimi i vendimit të formës së prerë konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Sa më sipër, është një proces i tërë, pasi nuk do të kishte kuptim fitimi i një të drejte dhe zhvillimi i një procesi gjyqësor në rast se nuk do të arrihej ekzekutimi dhe rivendosja në vend e saj. Faza e ekzekutimit të vendimit është faza përfundimtare e të gjithë procesit gjyqësor të zhvilluar, e cila është e lidhur pazgjidhshmërisht me gjithë gjykimin që është zhvilluar²⁰⁹.

Gjykimi i një çështjeje, nuk duhet të kuptohet dhe konceptohet ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse nuk arrihet të realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë. Kjo e drejtë, jo vetëm që duhet të realizohet, por duhet të realizohet brenda një afati të arsyeshëm dhe është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës dhe të KEDNJ.

Pavarësisht se, vendimi përfundimtar për t'u ekzekutuar merr formën e një vendimi gjykate ose të një vendimi të organit administrativ, legjislacioni i brendshëm dhe konventa parashikojnë, që ai duhet të ekzekutohet²¹⁰. Ekzekutimi i detyrueshëm bëhet me qëllim që të rivendoset sundimi i ligjit dhe e të drejtës objektive që i është cënuar kërkuesit, nëpërmjet forcës shtrënguese të ligjit. Gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm midis palëve, kreditor e debitor, krijohet një marrëdhënie procedurale e ndryshme nga ajo e detyrimit dhe mosmarrëveshjet që lindin gjatë këtij procesi rregullohen nga dispozitat e pjesës së katërt të Kodit të Procedurës Civile apo nga ligje të veçanta, që përmbajnë dispozita me karakter procedural²¹¹.

Ekzekutimi i detyrueshëm është mjet juridik me natyrë procedural, që mundëson realizimin e të drejtave të kreditorit, nëse ato nuk janë përmbushur vullnetarisht sipas përcaktimeve ligjore.

²⁰⁷ Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Çomo *Vështrim krahasues mbi procedurën civile*, Tiranë 2006, Shkolla e Magjistraturës fq. 321

²⁰⁸ Shihni Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.42 datë 19.07.2012 paragrafi 20

²⁰⁹ Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr.1, datë 17.01.2011

²¹⁰ Vendimi nr.1, datë 19.01.2009 i Gjykatës Kushtetuese

²¹¹ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.589, datë 24.10.2013

Vendi i ekzekutimit të detyrueshëm, ka të bëjë me vendin ku do të zbatohet titulli ekzekutiv, pas lëshimit të urdhërit të ekzekutimit dhe vënies në lëvizje të shërbimit përbarimor. Pra, i përgjigjet një marrëdhënieje procedurale të krijuar në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe jo marrëdhënies së krijuar nga aplikimi i sanksionit administrativ.

Pra, nëse pala debitore me kalimin e afatit 10 ditor, siç parashikohet në nenin 517 të K.Pr.C nuk e ka ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, atëherë ligji parashikon fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Lajmërimi për ekzekutim vullnetar njofton debitorin se kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit vullnetarisht. Në të kundërt me kalimin e afatit ligjor, do të zbatohen masat e ekzekutimit të detyrueshëm. Ky është rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit nuk mund të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm pa kaluar afati për ekzekutim vullnetar, përveç kur ka rrezik se me kalimin e këtij afati, ekzekutimi do të bëhet i pamundshëm. Mosrespektimi sa më sipër i dispozitave procedurale gjatë ekzekutimit të titullit ekzekutiv përbën kundërligjshmëri të veprimeve të përbaruesit gjyqësor, dhe sjell si pasojë pavlefshmëri të akteve të nxjerra nga ai për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

Pasi debitori merr njoftimin për ekzekutim vullnetar, ai mund të kërkojë në Gjykatën e Shkallës së Parë të vendit të ekzekutimit, në varësi të situatës së tij paguese, që të shtyjë afatin e ekzekutimit në të holla ose të ndajë këtë detyrim me këste, ose të kërkojë pezullimin e ekzekutimit si masë për sigurimin e padisë²¹². Mendojmë se në këtë moment, ende nuk janë shfaqur ato veprime të përbaruesit gjyqësor, që përbëjnë shprehje të ekzekutimit të detyrueshëm dhe që sjellin pasoja për debitorin. Lajmërimi për ekzekutim vullnetar është një parakusht për nisjen e ekzekutimit të detyrueshëm, pasi ky veprim nuk sjell ende si pasojë cënimin e intresave të debitorit. Për këtë arsye, debitori nuk mund të kërkojë me padi themeli të kundërshtojë lajmërimin për ekzekutim vullnetar duke përdorur nenin 610 të K.Pr.Civile, i cili është një mjet mbrojtës gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, pasi përbaruesi ende nuk ka filluar kryerjen e veprimeve të ekzekutimit të detyrueshëm dhe mungon vetë kërkimi i zgjidhjes së pasojës së supozuar.

Përfundimisht nga rregulli bëhet vetëm në këtë rast, ku përbaruesi gjyqësor mund të fillojë menjëherë nga ekzekutimi i detyrueshëm, edhe pa e kryer fazën e lajmërimit për ekzekutimin vullnetar, me kërkesë të palës kreditore²¹³. Praktika përbarimore e ka pranuar këtë përjashtim të nenit 519, nëpërmjet deklarimit noterial të palës kreditore, se ekziston një rrezik i mundshëm, që pala debitore gjatë afatit të ekzekutimit vullnetar, të kryejë transaksione, të cilat do ta bënin të pamundur ekzekutimin, nëse nuk do të veprohej menjëherë. Kuptimi i pamundësisë së ekzekutimit, sipas përcaktimeve të nenit 519 të K.Pr.Civile, referon kryesisht në situata të tilla si fillimi i procedurave të falimentit apo likuidimit të shoqërisë, si palë debitore.

²¹² Shih nenin 517 të K.Pr.Civile

²¹³ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.102, datë 11.02.2016 arsyeton se: *Zyra përbarimore ka nisur ekzekutimin e detyrueshëm sipas nenit 519 të K.Pr. Civile dhe nuk ka mundur të vërtetojë faktin se pala debitore ka qënë në pamundësi për të paguar vullnetarisht detyrimin kundrejt kreditorit. Ajo në mënyrë të padrejtë duke rënduar pozitën e debitorit pa asnjë shkak të ligjshëm dhe për rrjedhojë këto veprime përbarimore duhen anuluar duke u rinisur procedura përbarimore nga veprimi përbarimor lajmërim për ekzekutim vullnetar parashikuar në nenin 517 të Kodit të Proçedurës Civile.*

Në këtë mënyrë përmbaruesi si palë mbi palët në procesin e ekzekutimit, do të respektojë të drejtën e debitorit dhe situatën e tij, por pa cënuar të drejtën e kreditorit. Mendojmë se, nëse do të duhet të kalohej menjëherë në ekzekutim të detyrueshëm sipas nenit 519, kundrejt këtij veprimi, kreditori duhet të ofrojë një garanci, kundrejt çdo dëmi të mundshëm që mund t'i vijë debitorit. Duke marrë si model edhe rastin e ngjashëm që parashikohet në K.Pr.Civile Italine në nenin 482 të tij.

Ndërkohë, në praktikë ka pasur mjaft raste në lidhje me zbatimin e nenit 519 të K.Pr.C, konkretisht me faktin se, nëse procedura përmbarimore ka filluar me nenin 517, duke i kërkuar debitorit ekzekutimin vullnetar dhe më pas me kërkesë të palës kreditore, i është kërkuar përmbaruesit gjyqësor, që të kalojë në ekzekutim të detyrueshëm edhe pa respektuar afatin 10 ditor²¹⁴. Është e nevojshme, që praktika gjyqësore të rregullojë këtë hapësirë që parashikohet nga dispozita ligjore 519, në mënyrë që përmbaruesit gjyqësor dhe, jo vetëm këta të fundit, ta kenë të qartë këtë dispozitë gjatë zbatimit në punën e tyre të përditshme.

Mendojmë që, qëndrimi i duhur do të ishte ai, që e përjashton afatin e ekzekutimit vullnetar dhe fillon menjëherë me ekzekutimin e detyrueshëm dhe, nëse përmbaruesi e ka filluar procedurën në bazë të nenit 517, nuk mund të ndërpresë këtë afat për të filluar ekzekutimin e detyrueshëm. Në këtë rast, pala kreditore mund të kërkojë realizimin e së drejtës me një mjet tjetër procedural, siç është ai i masës së sigurimit. Me anë të këtij mjeti mund të vendos masën e sekuestros konservative në llogaritë e palës debitore, nëse arrin të vërtetojë ekzistencën e rrezikut dhe pamundësisë së ekzekutimit. Por në këtë rast, vendimmarrja i takon Gjykatës dhe jo përmbaruesit gjyqësor, i cili vetëm zbaton titullin ekzekutiv, pasi nuk ka tagër që të interpretojë titullin ekzekutiv.

4.2. Mënyra dhe kufijtë e realizimit të ekzekutimit të detyrueshëm

4.2.1. Ekzekutimi mbi kreditë e debitorit dhe mbi sendet që personat e tretë i detyrohen debitorit

Pavarësisht llojit të detyrimit, që duhet të ekzekutohet, përmbaruesi gjatë procedurës përmbarimore pasi sigurohet për ekzistencën e kredive të debitorit, që personat e tretë i detyrohen atij, ka të drejtë të lajmërojë si palën debitore ashtu edhe personin e tretë në lidhje me sekuestrimin e këtyre kredive dhe kërkon konfirmimin, nëse ky informacion është i saktë.

Në cilësinë e personave të tretë që mbajnë kreditë e debitorit mund të përmendim disa raste: Bankat, ku mund të jenë depozituar sasi të caktuara mjetesh monetare në emër të debitorit, shoqëritë e Sigurimit me të cilat debitori ka lidhur kontrata respektive në përmbushje të të cilave, debitori përfiton mjete të caktuara monetare, punëdhënësi i debitorit, i cili detyrohet t'i japë debitorit shpërblimin për punën e kryer, bazuar në marrëdhënien e punës së krijuar, blerësi, i cili i detyrohet debitorit, për çmimin e shitjes së një malli apo sendi.

²¹⁴ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 2999, datë 19.12.2012

Ndërsa persona të tretë, që mbajnë sendet e debitorit, janë persona fizikë apo juridikë, të cilët përdorin sendin e debitorit, bazuar në një marrëdhënie juridike të krijuar midis debitorit dhe tyre. Këtu mund të përfshihen: *qiramarrësi i sendit, depozituesi, transportuesi i mallrave, furnizuesi i tyre etj.*

I tillë është rasti, kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor i formës së prerë²¹⁵, i cili ka vendosur detyrimin e palës debitore E. B. për t'i paguar paditëses H. D. në shumën 2 milion (dy milion) lekë si vlerë për përdorimin e sendit në bashkëpronësi. Pra, objekt i ekzekutimit është kthimi i një shume të hollash në favor të palës kreditore. Nga të dhënat e marra si nga pala kreditore, por edhe bankat e nivelit të dytë, rezultoi se pala debitore kishte lidhur një kontratë qiraje me një institucion bankar. Ndodhur në këto kushte, përmbaruesi në zbatim të nenit 581 të K.Pr.C ka lajmëruar personin e tretë, në cilësinë e palës qiramarrëse, për saktësinë e informacionit që disponon përmbaruesi gjyqësor, si dhe në lidhje me ekzistencën e kredisë së debitorit E.B që persona të tretë i detyrohen atij. Duke qenë se, personi i tretë nuk e kundërshtoi, që kredia të është e debitorit, atëherë detyrohet që t'ia dorëzojë këtë kredi përmbaruesit gjyqësor për ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Pra vlera e qirasë mujore përbën kredinë e debitorit, që personat e tretë i detyrohen atij, kalon pranë llogarisë së zyrës përmbarimore dhe kjo e fundit ia kalon në favor të palës kreditore.

Kredi e siguruar quhet kredia, përmbushja e së cilës në të ardhmen garantohet nëpërmjet një garancie të vënë nga kredimarrësi. Garanci për përmbushjen e kredisë janë: *a) pengu dhe b) hipoteka.* Pengu vihet mbi një pasuri të luajtshme, mbi një të drejtë ndaj prurësit, ose me urdhër, ose mbi uzufruktin e kësaj pasurie ose të drejtë me qëllim përmbushjen e ekzekutimit në të ardhmen.

Ekzekutimi mbi kredinë e siguruar me peng përfshin dhe sendin që e siguron atë. Ekzekutimi kryhet nëpërmjet sekuestrimit duke njoftuar personin që mban pengun. Me marrjen e njoftimit për sekuestrimin e sendit të vënë peng, mbajtësi i tij detyrohet të mos ia dorëzojë këtë send asnjë personi, pa urdhëin e përmbaruesit gjyqësor. Kur sendi i luajtshëm i vënë peng është i regjistrueshëm, akti me të cilin urdhërohet sekuestrimi i njoftohet zyrës ku është kryer regjistrimi. Ky ekzekutim kryhet nëpërmjet shitjes së sendit të vënë peng duke respektuar rregullat e shitjes së sendeve të luajtshme të sekuestruara dhe atyre të shitjes së pengut. Në ato raste kur kredia e sekuestruar e debitorit është e siguruar me hipotekë, me qëllim njohjen e saj, përmbaruesi gjyqësor duhet të regjistrojë urdhërin për vënien e sekuestrimit pranë Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku ndodhet sendi i hipotekuar.

Në aktin e sekuestrimit duhet të tregohen me saktësi kredia dhe sendi që e siguron atë. Ky akt sekuestrimi i njoftohet edhe personit që ka vënë hipotekë sendin e tij për sigurimin e ekzekutimit të kredisë. Sekuestrimi quhet i ekzekutuar, kur vendndodhja e tij i është njoftuar dhe ka marrë dijeni si personi që ka kredinë e siguruar ashtu dhe pronari i sendit që ka vënë në hipotekë sendin e paluajtshëm për të siguruar kredinë e siguruar. Ekzekutimi i kredisë së siguruar kryhet mbi sendin në hipotekë që e siguron atë, vetëm pasi kreditori e kërkon ekzekutimin mbi

²¹⁵Vendimi Nr.1236, date 13.05.2013 te Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Vlore

këtë send. Për shitjen e sendit në hipotekë zbatohen rregullat për shitjen e sendeve të paluajtshme të sekuestruara.

Kur personi i tretë është një insitucion ose ndërmarrje shtetërore dhe nuk kthen përgjigje brenda afatit ligjor, pesë ditor nga dita e marrjes dijeni për “lajmërim për sekuestrim”, mund të gjobitet nga përmbaruesi gjyqësor deri në 50.000 lekë. Kundër vendimit të përmbaruesit mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i vendimit të gjobës. Personi i tretë ka detyrim ligjor në bazë të nenit 583 të K.Pr.C që të informojë përmbaruesin në lidhje me ekzistencën e kredisë së debitorit dhe se pranon ta shlyejë atë, ta informojë nëse mbi kredinë kanë pretendime edhe persona të tjerë. Përmbaruesi duhet të njoftohet nëse mbi kredinë e debitorit, është vendosur sekuestro edhe për zbatimin e një urdhëri tjetër ekzekutimi. Ndodh shpesh, që përmbaruesit gjyqësor gjatë punës së tyre të hasin vështirësi në vërtetimin e faktit të ekzistencës së kredisë së debitorit tek personi i tretë, pasi informacioni refuzohet që të jepet i saktë. Për këtë arsye mendojmë, se një formulim i ri kësaj dispozite do ta bënte aplikimin në praktikë më efektiv.

Ndodh shpesh në praktikë, që punëdhënësit të jenë të paqartë për detyrimin e ndalimit të pagës sipas Kodit të Procedurës Civile dhe për këtë fakt përmendin nenin 123 i Kodit të Punës duke argumentuar se ka një pagë të paprekshme, e cila është e nevojshme për të siguruar jetesën e punëmarrësit dhe të familjes së tij²¹⁶. Sigurisht që këto dispozita janë në harmoni me njëra-tjetrën pasi edhe neni 533 dhe 529 i K.Pr.Civile përcaktojnë kriteret në lidhje me të drejtat ekonomike, që nuk mund t’i cënohen palës debitore. Si i tillë përmbaruesi gjyqësor, duhet të respektojë këto dispozita dhe nëse ka pretendime nga pala debitore, kjo e fundit duhet t’i drejtohet gjykatës për t’u shprehur, me një nga mjetet e mbrojtjes gjatë fazës së ekzekutimit.

4.3. Llojet e detyrimeve të ekzekutueshme dhe ekzekutimi i tyre. Ekzekutimi i një detyrimi në të holla

4.3.1. Ekzekutimi i detyrimit në të holla ndaj insitucioneve buxhetore

Kur titulli ekzekutiv ka si objekt detyrimin e palës debitore, në këtë rast një institucioni buxhetor, për të paguar një shumë të hollash, palët në përgjithësi dhe përmbaruesi gjyqësor në veçanti, gjatë kësaj procedure, duhet të respektojë dispozitat e parashikuara nga kreu V, neni 589 e në vijim të K.Pr.C. Në praktikën përmbarimore shqiptare këto lloj çështjesh përbëjnë numrin më të madh të rasteve për ekzekutim, pasi përfaqësojnë rastet, kur pala kreditore është pushuar nga puna nga një institucion buxhetor, jo vetëm kaq, por përbëjnë edhe rastet më me vështirësi për t’u ekzekutuar, për shkak të paftësisë paguese të institucionit debitor.

Vendimet gjyqësore zbatohen me buxhetin e miratuar të insitucioneve, pasi njoftohet titullari i Ministrisë/Institucioni Qedror nga varet institucioni. Këto insitucione duhet të

²¹⁶Neni 123 i Kodit të Punës: *Paga e paprekshme vendoset rast pas rasti nga gjykata. Në vendimin e saj, gjykata merr parasysh shpenzimet e nevojshme për ushqim, qira, veshje, si edhe detyrimet fiskale ose kontributet për sigurime shoqërore të detyrueshme të punëmarrësit dhe të familjes së tij. Kur gjykata vendos që nuk ka mundësi të vlerësojë të gjitha elementet për të përcaktuar pagën e paprekshme, kjo do të jetë e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi, të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.*

analizojnë të gjitha vendimet, që sjellin dëm efektiv për buxhetin e shtetit dhe duhet të kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësisë. Me fondet e akorduara sipas Ligjit të Buxhetit Vjetor, çdo ministri apo institucioni buxhetor gjatë procesit të detajimit të këtyre fondeve sipas zërave të shpenzimeve, institucioni debitor planifikon edhe fondet e nevojshme për likuidimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore. Nëse të gjithë mendojnë, se do të jetë buxheti i shtetit, që do të mbulojë çdo vendim të padrejtë, atëherë rastet e vendimeve të padrejta vetëm do të rriten. Parimi i përgjegjshmërisë kërkon, që personi, i cili vepron në kundërshtim me ligjin, duhet të përballet me këto pasoja²¹⁷. Është e qartë se administrata shqiptare është shumë larg këtij koncepti. Ekzekutimi i vendimeve të gjykatave kombëtare, sidomos ato ku palë janë institucionet shtetërore, mbetet i ngadalë dhe vazhdon të dëmtojë sigurinë juridike.

Zyra përbarimore urdhëron për të vendosur sekuestro konservative në të gjitha llogaritë bankare, që mund të ketë institucioni. Nëse institucioni nuk ka llogari bankare, atëherë kërkohet bllokimi i llogarisë së institucionit debitor pranë Degës së Thesarit në llogarinë 602. Nevoja për ndryshime nënligjore në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësor, ku shteti është palë, është ende e pranishme. Megjithatë, kjo nuk e justifikon situatën aktuale. Fillimisht në këtë fushë ka vepruar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 355, datë 02.06.1998, që rregullonte marrëdhëniet ndër-institucionale në fushën e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore, pavarësisht disa përpjekjeve ndër vite si Udhëzimi Nr. 2, datë 18.08.2011 (i shfuqizuar nga Udhëzimi Nr. 1, datë 04.06.2014) të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. Në kuadër të ekzekutimit dhe efikasitetit të punës së përbaruesit, mbetet domosdoshmëri një akt nënligjor për mënyrën dhe afatin maksimal të ekzekutimit të titujve ekzekutiv nga organet e shtetit lidhur me detyrimet monetare apo kryerjen e nje veprimi te caktuar. Për këtë arsye, u pa i nevojshëm reformimi i këtij shërbimi, me qëllim për të shmangur burokracinë, për të rritur transparencën si dhe për të përmirësuar ndjeshëm ekzekutimin e titujve.

Me qëllim, rregullimin e kësaj shtate ndërmjet njësisve të qeverisjes së përgjithshme, degëve të thesarit dhe përbaruesve gjyqësor është nxjerrë Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit”. Udhëzimi përcakton mënyrën e ekzekutimit nga llogaria e thesarit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme, që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit buxhetor, mbajnë database për vendimet gjyqësore të formës së prerë, që parashikojnë detyrime monetare si dhe për shumat e detyrimeve. Shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatëse. Këto parashikime i bëhen të njohura edhe njësisë së qeverisjes së përgjithshme nga e cila varen.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes bëhet

²¹⁷ Vlerësim i sistemit të Drejtësisë, Kontribut i Dhomës Kombëtare të përbaruesve gjyqësor private 18.06.2015 faqe 7

publik, nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar. Në rastin kur insitucioni debitor, nuk ka ndjekur vullnetarisht asnjë nga procedurat e parashikuara në këtë udhëzim, atëherë përmbaruesi gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyruar nga llogaria e thesarit. Dega e thesarit vendos masën e sekuestros, sipas urdhërit të përmbaruesit gjyqësor në shpenzimet operative (artikulli buxhetor 602) të njësisë shpenzuese, në masën e përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë, por pa prekur shpenzimet e detyrueshme për funksionimin e institucionit, si: energji, ujë dhe materiale e shërbime speciale (artikulli 6021), të përshkruara në Manualin e Shpenzimeve Publike, të publikuara nga ministri i Financave²¹⁸. Vendimet gjyqësore të njësive të qeverisjes vendore, të paraqitura zyrtarisht te këto njësi, ndjekin të njëjtën procedurë të përshkruar në këtë udhëzim.

Ndërsa në rastin, kur institucioni buxhetor debitor nuk ka gjendje në llogarinë bankare, as në llogarinë e thesarit, i kërkohet organit epror financiar të përcaktojë një fond të nevojshëm nga do të bëhet shlyerja e detyrimit. Organet e institucionit shtetëror debitor, duhet të tregojnë kujdesin e duhur për përmbushje të detyrimeve në të holla në ngarkim të tij, sipas përcaktimeve të bëra në urdhërin e ekzekutimit, pasi në rast se organi shtetëror pa shkaqe nuk kryen ekzekutimin e detyrimit, mund të dënohet me gjobë deri në 50.000 lekë, sipas nenit 606 të K.Pr.C. Kundër vendimit për vendosjen e gjobës, institucioni shtetëror debitor ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë brenda 5 ditëve nga komunikimi i tij dhe ka të drejtë të kërkojë shkarkimin e tij nga dënimi, sipas rregullave të caktuara në nenin 169 të këtij Kodi. Vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor të vendit ku kryhet ekzekutimi, është i formës së prerë.

Në një rast ekzekutimi të një titulli ekzekutiv²¹⁹, vendim gjyqësor i formës së prerë, ku debitor është Bashkia Patos, me objekt detyrim e kësaj të fundit për të dëmshpërblyer palën kreditore A.SH në masën 1.462.171 (nje milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një) lekë. Përmbaruesi gjyqësor në përputhje me dispozitat ligjore, ka kërkuar vënien e sekuestros konservative në llogarinë e thesarit dhe është konfirmuar nga ky i fundit vënia e saj. Detyrimi i palës debitore i është komunikuar në datën 12.12.2014, kjo, e vërtetuar dhe pranuar edhe nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

Ndërsa pala debitore Bashkia Patos, ka bërë me dije se nuk ka parashikuar shlyerjen e këtij detyrimi në buxhetin e vitit 2015, çfare bie në kundërshtim me udhëzimin nr.1 të KM 04.06.2014, duke mos kryer asnjë nga procedurat e parashikuar në pikën 5 dhe 6 të këtij Udhëzimi. Në kuadër të veprimeve përmbarimore, është aplikuar sanksioni ligjor ndaj personit të ngakuar nga ligji, si titullar i palës debitore Bashkia Patos. Kundër vendimit të gjobitjes së përmbaruesit gjyqësor është bërë ankim brenda afatit pesë ditor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Gjykata²²⁰ në arsyetimin e saj argumenton, se përmbaruesi ka vepruar gabim, kur ka aplikuar masën e gjobës, pasi duhet të ezauronte fazën e parashikuar sipas nenit 589 paragrafi i dytë, duke i drejtuar

²¹⁸Pika 11 e Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit”

²¹⁹ Vendimi Nr.62-2012-4687 (1435), datë 09.07.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi me vendimin Nr.673, datë 12.03.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë

²²⁰ Vendimi Nr.62-2015-2453 (810), date 15.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

kërkesë institucionit epror të palës debiore për çeljen e fondit të nevojshëm për ekzekutimin e detyrimit.

Arsyetimi i gjykatës, se neni 606 i K.Pr.Civile aplikohet vetëm atëherë kur kemi të bëjmë me ekzekutimin e atyre detyrimeve, që kanë si objekt detyrimin për kryerjen e një veprimi të caktuar nuk qëndron, pasi kjo do të thotë se ky sanksion nuk mund të aplikohet në asnjë rast tjetër, ku edhe pse pala debitore nuk është e detyruar të kryejë një veprim konkret, por duhet të përmbushë një detyrim në të holla, përmbaruesi nuk ka të drejtë ta gjobisë. Nëse i referohemi paragrafit të dytë të kësaj dispozite 606, parashikon se mund të gjobiten personat e tjerë, që sipas urdhërit të ekzekutimit ose ligjit janë të detyruar të kryejnë veprime të caktuara. Pra, debitori Bashkia Pastos, përveç faktit që e njeh këtë detyrim duhet të ndërmarrë, që të gjitha veprimet në bazë të ligjit dhe udhëzimit nr.1 duke parashikuar mënyrën e shlyerjes se këtij detyrimi. Ligji ka parashikuar edhe bazën ligjore në dispozicion të procedurës përmbarimore, që duhet të aplikohet për të siguruar zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë, mosekzekutimi i të cilit përbën një cënim të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

Në rastet e ekzekutimit të detyrimeve në të holla ndaj Institucioneve Buxhetore shkak i vonesave në ekzekutim, ka qenë shtyrja e planifikimit të fondit të detyrimeve nga Institucionet, që e mbartin këtë detyrim për vitin pasardhës. Në disa raste vlera e detyrimit, që një Institucion mbart ndaj subjekteve të ndryshme mund të jetë më i lartë se fondi i parashikuar në buxhet, ndaj ky detyrim është mbartur duke sjellë si pasojë pezullim të veprimeve procedurale dhe si rrjedhojë tejkalim të afateve procedurale nga ana e zyrave të përmbarimit.

Një rast tjetër i praktikës gjyqësore është edhe kur pala debitore, Trajtim Studenti sh.a Vlorë, ka ngritur kërkesë-padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke kërkuar dëmshpërblim nga zyra përmbarimore gjyqësore. Në bazë të nenit 608,609,626,640 të Kodit Civil, me arsyetimin se fondet nga të cilat u krye ekzekutimi i vendimit gjyqësor ishin të ardhura në burim, për të cilat sh.a. Studenti ishte subvencionuar nga Ministria e Arsimit. Gjykata Vlorë²²¹ ka rrëzuar padinë si të pambështetur me argumentimin, se nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për shkaktim dëmi, përmbaruesi gjyqësor, që ka ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë, pasi pala paditëse nuk arriti të provojë lidhjen shkakësore midis veprimit të përmbaruesit dhe pasojës së pretenduar se ka ardhur. Pra këto elementë, duhet të vërtetohen në mënyrë kumulative dhe të njëkohshme, në mënyrë që të aktivizohet përgjegjësia pasurore e të paditurit për shpërblimin e dëmit²²².

Udhëzimi i ri nr.1 datë 04.06.2014 i Këshillit të Ministrave, duket se i ka dhënë një zgjidhje me të mirë problemit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ndaj institucioneve debitore, megjithatë situata varet nga përgjegjshmëria e titullarëve të njësive të përgjithshme ose vendore dhe në këto rethana, udhëzimi duhet të parashikojë përgjegjësinë ligjore të tyre, në rastet kur ata me veprimet ose mosveprimet e tyre, bëhen shkak për zvarritjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

²²¹Vendimi Nr.2751, datë 09.12.2015 dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

²²² Shihni qëndrimin e mbajtur në Vendimin e Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, Nr.2693/561 i Regj. Themeltar, Nr.1185 i Vendimit, dt. 19.07.2005; Vendimin e Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, Nr.11118-00544-00-2005 i Rregj. Themeltar, Nr.00-2006-831 i Vendimit (1264), dt. 21.11.2006.

Ndërkohë, që ekzekutimi i detyrueshëm ndaj kredive të caktuara të debitorit të huaj bëhet vetëm kur nuk ka ndalim ose kufizim me ligj të veçantë ose me marrëveshje ndërkombëtare shtetërore²²³. Në rast se pala debitorë është një person i huaj publik, ekzekutimi i titullit ekzekutiv në mënyre të detyrueshme nuk mund të fillojë pa marrë më parë leje nga ministri i Drejtësisë. Për këtë, përmbaruesi gjyqësor me depozitimin e praktikës përmbarimore, mbasi sigurohet, që ka të bëjë me person të huaj publik si psh , Banka Botërore ose përfaqësi të shtetit të akredituar në vend etj, është i detyruar të paraqesë pranë ministrit të Drejtësisë kërkesën për lejimin e kryerjes se ekzekutimit të detyrueshëm. Në mungesë të kësaj leje, përmbaruesi gjyqësor nuk mund të kryejë ekzekutim të detyrueshëm ndaj personit të huaj publik.

4.3.2. Ekzekutimi i një detyrimi në të holla në llogaritë bankare

Dispozitat e K.Pr.Civile, që rregullojnë ekzekutimin e titujve ekzekutiv, nga njëra anë i japin të drejtë përmbaruesit gjyqësor që të jetë i shpejtë dhe efektiv për jetësimin e të drejtës së kreditorit, ndërsa nga ana tjetër e kufizojnë atë për të mos kryer veprime që do të dëmtojnë interesat e debitorit, përtej përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në titullin ekzekutiv.

Duke qenë se K.Pr.Civile, nuk ka përcaktuar një rradhë për pasuritë dhe kreditë, që do t'i nënshtrohen sekuestrimit për efekt të realizimit të drejtës së kreditorit, kjo e drejtë e përzgjedhjes i takon përmbaruesit, e cila mund të ushtrohet vetëm pas identifikimit të pasurisë së debitorit. Më pas të vijojë me sekuestron ekzekutive vetëm mbi ato pasuri apo kredi të debitorit, që ai gjykon se mund të realizohet më shpejt e drejta e kreditorit e njohur me titullin ekzekutiv. Neni 528/2 K.Pr.Civile, i ka krjuar mundësinë debitorit për ta zhvendosur përmbaruesin në pasuri të tjera, të ndryshme nga ato që ka vendosur sekuestron. Këtu duhet të kemi parasysh se neni 528/2 e lë në vlerësimin e përmbaruesit këtë kërkesë të debitorit, është ai që duhet ta miratojë këtë kërkesë²²⁴.

Në varësi të llojit të detyrimit, që do të ekzekutohet, ligji ka parashikuar dispozitat ligjore për të rregulluar marrëdhënien procedurialo-ekzekutive. Duke përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrat e palëve, një lloj i veçantë detyrimi është edhe ekzekutimi i atyre titujve ekzekutiv, që kanë si objekt të tyre vjeljen e një shume të hollash nga pala debitore. Duke iu referuar edhe dispozitave të Kodit Civil, përmbaruesi gjyqësor kur ekzekuton një detyrim në të holla e kryen ekzekutimin në vleftën e vet nominale, përveç kur rezulton ndryshe në titullin ekzekutiv. Detyrimi në të holla ekzekutohet në monedhën, që është në qarkullim në shtetin ku bëhet ekzekutimi ose me monedhën e përcaktuar në titullin ekzekutiv. Pagesa e detyrimit në të holla, kryhet në vendbanimin e kreditorit në datën e pagesës. Kreditori mund të caktojë një vend tjetër brenda kufijve të shtetit ku ka vendbanimin në kohën e pagimit ose të lindjes së detyrimit. Pagesa quhet e kryer në momentin e kreditimit të saj në llogari.

Ekzekutimi i detyrimit në të holla sipas titullit ekzekutiv kryhet sipas kësaj radhe: a) Shlyerja e shpenzimeve të ekzekutimit; b) Shlyerja e kamatave të arrira; c) Shlyerja e vetë detyrimit së bashku me kamatat e zakonshme. Mosrespektimi i kësaj radhe në ekzekutim, i jep të

²²³Neni 590 i K.Pr.C

²²⁴ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.1131, datë 17.02.2016

drejtë kreditorit, që të refuzojë pagesën e ekzekutimit të detyrimit. Vonesat në ekzekutimin e detyrimit në të holla, përbëhet nga kamatat e arrira prej datës së fillimit të vonesës së debitorit, duke e detyruar këtë të fundit, që të përgjigjet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesat. Përqindja e kamatës caktohet me ligj.

Përmbaruesi gjyqësor, me kalimin e afatit të lajmërimit për ekzekutim vullnetar, fillon ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit²²⁵. Banka, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e urdhërit për vendosjen e sekuestros, vendos sekuestron në shumat, të cilat gjenden në llogarinë e debitorit, deri në shumën e përcaktuar në urdhër, duke njoftuar përmbaruesin gjyqësor për vendosjen e sekuestros, brenda 3 ditësh pune nga marrja e urdhërit²²⁶.

Në funksion të vënies në ekzekutim të titujve ekzekutiv, që kanë si objekt përmbushjen e një detyrimi në të holla, bashkëpunimi i institucioneve bankare me shërbimin përmbarimor gjyqësor është, jo vetëm i domosdoshëm, por edhe i detyrueshëm. Bashkëpunimi i ngushtë reciprok është shumë i rëndësishëm, pasi dhe vetë bankat janë subjekte të procedurave të ekzekutimit si kreditor apo dhe debitor. Në funksion të këtij bashkëpunimi dhe për të disiplinuar mënyrën e ekzekutimit mbi shumat e llogarive bankare, nga Banka e Shqipërisë janë nxjerrë Udhëzimet e nevojshme²²⁷, të cilat përcaktojnë procedurat, që kryen banka për realizimin e dhënies së informacionit të kërkuar, ashtu sikundër janë përcaktuar dhe dokumentet apo të dhënat e nevojshme, që duhet të vihen në dispozicion institucioneve bankare nga përmbaruesit gjyqësor me qëllim dhënien e informacionit dhe ekzekutimin e detyrimeve monetare.

Përmbaruesi urdhëron transferimin e shumës ose heqjen e sekuestros për këtë shumë, brenda 10 ditësh pune nga marrja e njoftimit të bankës, në të kundërt masa e sekuestros konsiderohet e rënë²²⁸. Sekuestroja në llogarinë e debitorit nuk pezullon pagimin e kredive që, sipas nenit 605 të Kodit Civil, paguhen me preferim ndaj urdhërit për sekuestro. Kur shuma e sekuestruar në llogari, nuk është e mjaftueshme për të shlyer detyrimet e paraqitura për ekzekutim, banka njofton përmbaruesin gjyqësor, i cili respekton dhe përcakton radhën e referimit, që përcaktohet në nenin 605 të Kodit Civil²²⁹.

Në zbatim të nenit 598 të Kodit të Procedurës Civile, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtë të verifikojë në vend dokumentacionin bankar, që lidhet drejtpërdrejt me ekzekutimin, në prani të punonjësit të ngarkuar nga administratorët e bankës, kur ai ka bazë të dyshojë se banka: a) Nuk ekzekuton pa arsye detyrimin tërësisht ose pjesërisht; b) Shkel afatet e ekzekutimit të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, si dhe në këtë udhëzim; c) Nuk respekton radhën e preferimit të përcaktuar nga përmbaruesi gjyqësor. Verifikimi i kryer dokumentohet me procesverbal, një kopje të të cilit i vihet në dispozicion bankës. Nëse përmbaruesi konstaton shkelje ose parregullsi

²²⁵Neni 527 i K.Pr.C

²²⁶Neni 594 i K.Pr.C

²²⁷Udhëzimi nr. 2, datë 24.09.2003 i Bankës së Shqipërisë “Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë” miratuar me vendimin nr.43, datë 11.06.2003 të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²²⁸Udhëzimi nr. 2, datë 27.03.2015 i Bankës së Shqipërisë “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”

²²⁹Neni 597 i K.Pr.C

mund të aplikojë sanksionin e gjobës ndaj punonjësit bankar fajtor ose ndaj organit drejtues të bankës. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë ankim ndaj vendimit të gjobitjes.

Duke iu referuar edhe modeleve europiane si rasti i Francës, Belgjikës ose Gjermanisë ka ardhur koha, që edhe në praktikën përmbartimore shqiptare, duhet të bëhet e mundur marrja e informacionit elektronik në lidhje me llogaritë bankare të debitorëve, drejtpërdrejtë nga bankat, pa qenë e nevojshme dërgimi i shkresave pafund. Një akses i tillë në sistemin e të dhënave të bankave, kërkon një investim të madh, që sigurisht kërkon mbështetjen e padiskutueshme të shtetit për t'u materializuar.

4.3.3. Ekzekutimi i detyrimit në të holla në fusha të veçanta

Detyrimet në të holla mund të ekzekutohen mbi pagën e debitorit në rastet kur, detyrimi është një shumë e vogël dhe mund të përmbushet shpejt. Ky ekzekutim kryhet nëpërmjet ndalesave nga paga e debitorit, përfshi dhe rastin e detyrimit për ushqim që për nga vetë natyra e tij duhet të përmbushet në mënyrë periodike.

Detyrimi për ushqim fillon nga data e ngritjes së padisë dhe lind vetëm kur personi që kërkon këtë detyrim është i paaftë për punë dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar. Kur një vendim, që përmban një detyrim për ushqim, vihet në ekzekutim pas gjashtë muajve nga data që ka marrë formë të prerë, detyrimet e prapambetura për ushqim janë të kërkueshme vetëm për gjashtë muajt e fundit. Vetëm kur kryhet ekzekutimi i detyrimit për pension ushqimor, ka një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i parashikuar në nenin 529 të K.Pr.C. Në këtë rast mund të sekuestrohet jo më shumë se gjysma e shumës së pensionit ose të bursës që përfiton pala debitore.

Ekzekutimi mbi pagën e debitorit²³⁰, nga përmbartuesi gjyqësor bëhet, pasi zbritet kontributi për sigurimet shoqërore dhe taksat mbi të ardhurat, por pa cënuar minimumin jetik, të përcaktuar sipas akteve ligjore²³¹ dhe nënligjore në fuqi²³². Në zbatim të kësaj dispozite nga ana e shërbimit përmbartimor nxirret urdhëri për vënien e sekuestros konservative mbi pagën e debitorit, urdhër i cili i dërgohet për zbatim punëdhënësit dhe për dijeni palës debitore. Në praktikë ndodh shpesh jo vetëm nga punëdhënësit e sektorit privat, por edhe nga institucionet shtetërore në cilësinë e punëdhënësit që nuk e zbatojnë urdhërin e përmbartuesit për ndalimin e pagës. Argumenti sipas punëdhënësve qëndron në faktin se këtë detyrim nuk iu njeh ligji. Këtë rast ligji e ka rregulluar duke parashikuar sanksione sipas nenit 588 të K.Pr.Civile. Po ashtu ka pasur vështirësi në përcaktimin e minimumit jetik që duhet të respektohet nga ana e punëdhënësit në momentin që bëhet ndalimi i pagës, për shkak të mungesës së një akti të posaçëm për t'u aplikuar në përcaktimin e "minimumit jetik".

Përmbartuesit gjatë punës së tyre janë ndarë në dy pikëpamje, njëri grupim ka qënë i mendimit se minimumi jetik është në masën 8.000 (tetë mijë) lekë referuar ndihmës ekonomike

²³⁰Neni 533 i Kodit të Proçedurës Civile

²³¹Vendim Nr. 787, datë 14.12.2005 i Këshillit të Ministrave "Për Përcaktimin e Kriteve, të Procedurave dhe të Masës së Ndhmës Ekonomike"

²³²Vendimin Nr. 573, datë 3.7.2013 të Këshillit të Ministrave "Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi"

ndësa grupi tjetër është i mendimit se ky minimum jetik duhet të jetë në masën e pagës minimale prej 22.000 (njëzet e dy mijë) lekë. Për këtë arsye nga ana e Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privatë në mbështetje të nenin 25 të Ligjit Nr. 10031 datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbauesve Gjyqësor Privat”, është nxjerr Direktiva nr.46 datë 19.01.2015 “Për unifikimin dhe zbatimin e përkohshëm të masës së sekuestros konservative mbi pagën e debitorit”. Kjo e fundit kërkon të orientojë dhe unifikoj praktikën përmbauese gjyqësor gjatë kryerjes së veprimeve ekzekutive mbi të ardhurat e pagës së debitorit, duke respektuar “minimumin jetik” në vlerën e pagës minimale sipas Vendim Nr. 573, datë 3.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”. Vetë Direktiva parashikon dy raste përjashtimore nga rregulli²³³.

Përveç ekzekutimi mbi pagën e debitorit, detyrimet në të holla mund të ekzekutohen edhe mbi shpërblime të tjera. Sipas neni 587 i K.Pr.Civile urdhëri për vënien e sekuestros konservative mbi pagën shtrihet edhe në çdo shpërblim tjetër që debitori merr nga e njëjta punë ose nga një punë tjetër, në të njëjtin person fizik apo juridik, shtetëror apo privat. Personi kompetent në qendrën e punës ku punon debitori duhet të lajmëroj përmbauesin gjyqësor për zbatimin e urdhërit, ose për kalimin e debitorit në një punë tjetër. Në rastin kur debitori ndërron vendin e punës, lajmërimi për sekuestrimin e pagës i dërgohet qendrës së re të punës nga qendra ku punonte më parë debitori. Punëdhënësi ka detyrim ligjor të njoftoj përmbauesin nëse debitori pushohet nga puna²³⁴.

4.4. Sekuestrimi i sendeve për efekt të ekzekutimit

4.4.1. Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme

Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme të debitorit kryhet kur ka filluar procedura përmbauese për ekzekutimin e detyrueshëm të titulli ekzekutiv dhe është verifikuar se debitorit nuk i janë gjetur mjete monetare ose kur këto sende janë vendosur si kolateral për përmbushjen e detyrimit. Ekzekutimi mbi sendet e luajtshme kryhet nëpërmjet njoftimit që përmbauesit gjyqësor i bën debitorit, për sekuestrimin e tyre, mbi ato sende që janë pjesë e qarkullimit civil dhe të cilat nuk janë përjashtuar nga ekzekutimi²³⁵.

Njoftimi përmban ditën dhe orën kur do të kryhet sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe bëhet sipas rregullave mbi njoftimin e akteve gjyqësore. Konsiderohen si sende të luajtshme në pronësi të debitorit, sendet që ndodhen në shtëpinë e debitorit, si dhe ato që ndodhen në një lokal tjetër që është i përbashkët për debitorin dhe personat e tretë, përveçse kur del se ato janë të një personi tjetër.

²³³Direktivën nr.46 datë 19.01.2015 “Për unifikimin dhe zbatimin e përkohshëm të masës së sekuestros konservative mbi pagën e debitorit”, rastet përjashtimore janë: *Në rastet kur duhet të ekzekutohet një detyrim ushqimor, debitorit duhet të aplikohet një masë sa gjysma e pagës minimale të sekuestruar, si dhe për rastet kur ndaj debitorit nuk arrihet të kryhet asnjë sekuestrim tjetër pasurie, përveç atij të pagës, atëherë për këto raste qëndron me vend dhe do të duhet të aplikohet një masë sekuestrimi sa 30% e saj (pagës) për nevoja të ekzekutimit.*

²³⁴ Neni 587 i K.Pr.Civile

²³⁵ Neni 529 i K.Pr.Civile

Personi i tretë që pretendon pronësinë mbi sendet e luajtshme të sekuestruara në posedim faktik të debitorit, duhet ti paraqesë përmbaruesit dokumentet përkatëse që provojnë këtë pretendim. Nëse nga verifikimi i këtyre të fundit nuk krijohet bindja se sendet e pretenduara janë të personit të tretë, sendet mbahen në sekuestrim. Nëse sekuestrimi bëhet mbi sende që janë në bashkëpronësi të debitorit dhe të personave të tjerë, pra nëse kemi të bëjmë me një send të përbashkët, përmbaruesi i drejtohet gjykatës kompetente të vendit të ekzekutimit me kërkesëpadi për veçimin e pjesës takuese që i takon debitorit, në mënyrë që ekzekutimi i mëtejshëm të shtrihet mbi këtë pjesë.

Sekuestrimi i sendeve të luajtshme bëhet me inventarizimin e tyre nga përmbaruesi gjyqësor, i cili vendos një etiketë të shërbimit të përmbarimit në momentin e sekuestrimit. Për inventarizimin mbahet procesverbal, i cili duhet të përmbajë: a) shënimin e urdhrin të ekzekutimit, në bazë të të cilit vihet sekuestroja, b) emrin, emrin e atit dhe mbiemrin e përmbaruesit gjyqësor, të debitorit, kreditorit dhe të personave të tjerë që janë të pranishëm në inventarizim, c) vendin ku kryhet inventarizimi dhe koha e kryerjes së tij, ç) pretendimet e personave të tretë në lidhje me sendet e inventarizuara, d) përshkrimin e hollësishëm të sendeve dhe vlerësimin e tyre, dh) kujt i lihen për ruajtje sendet; e) nënshkrimin e personave që marrin pjesë në inventarizim.

Inventarizimi i sendeve që sekuestrohen në bazë të vendimit të përmbaruesit gjyqësor bëhet në prani të debitorit. Kur debitori është njoftuar rregullisht për vendin dhe orën e kryerjes së tij, sipas rregullave mbi njoftimin e akteve gjyqësore, atëherë inventarizimi mund të kryhet në mungesë të debitorit. Në mungesë të debitorit, inventarizimi kryhet në prani të një personi madhor të familjes së tij dhe kur nuk ndodhet një person i tillë, në prani të një përfaqësuesi të njësisë së qeverisjes vendore ku ka vendbanimin debitori. Në çdo rast inventarizimi bëhet duke qenë të pranishëm edhe dy dëshmitarë.

Sendet e inventarizuara mund t'i lihen në ruajtje debitorit, me qëllim mos ngarkimin e tyre me shpenzime ekzekutimi, i cili ka të drejtë edhe t'i përdorë, por pa pakësuar vlerën e tyre. Nëse debitori refuzon të marri në ruajtje këto sende, atëherë përmbaruesi emëron në këtë detyrë një person tjetër kundrejt një shpërblimi, fatura e shpërblimit i ngarkohet në bazë të nenit 545 të K.Pr.Civile palës debitore. Në këtë rast, sendet e sekuestruara merren nga debitori dhe dërgohen pranë ruajtësit të caktuar. Debitori ose personi i emëruar japin llogari dhe kanë përgjegjësi penale për çdo të ardhur ose shpenzimet të bërë për sendin e sekuestruar të lënë në ruajtje.

Pas sekuestrimit të sendit të luajtshëm, çdo disponim i tij nga debitori është i pavlefshëm përveç kur është kryer një veprim juridik për kalimin e pronësisë, kundrejt shpërblimit dhe blerësi ka qenë në mirëbesim. Në mirëbesim quhet blerësi, i cili nuk e dinte, se sendi i blerë prej tij ishte i sekuestruar. Në sekuestrim përfshihen ato sende, çmimi i shitjes së të cilave, vlerësohet se mund të përmbushë detyrimin e caktuar në titullin ekzekutiv²³⁶. Pasi është kryer inventarizimi i sendeve të luajtshme bëhet vlerësimi i tyre. Përcaktimi i çmimit të sendit të sekuestruar bëhet nga përmbaruesi, në bashkëpunim me kreditorin dhe debitorin. Përmbaruesi njofton palët që brenda një afati shtatë ditor të arrijnë një marrëveshje për vlerën e sendit. Kur ka kundërshtime midis tyre

²³⁶ Neni 527 i K.Pr.Civile "Sekuestroja vendoset në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit."

thirret një ekspert²³⁷. Vlerësimi bëhet nga përbaruesi në bazë të vlerësimeve të ekspertëve. Eksperti e bënë vlerësimin në bazë të çmimeve të tregut dhe duke zbritur përqindjen përkatëse të konsumimit ose të vjetërsisë së tyre. Për këtë arsye përbaruesi gjyqësor me vendim cakton një ekspert dhe këtë akt ia komunikon palëve në proces. Akti i ekspertit i njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e kundërshtimit në gjykatë brenda afatit pesë ditor nga dita e marrjes dijani²³⁸.

Nëse debitori dhe kreditori nuk bien dakort për këtë vlerë të shitjes së sendit, për arsye të ndryshme, siç mund të jetë, mospërfaqësimi i vlerës reale të tregut për sendin, mund të kundërshtojnë këtë vendim të përbaruesit në bazë të nenit 564/2 të K.Pr.Civile, në gjykatën e vendit të ekzekutimit. Përbaruesi përpara se të vazhdoj me procedurën përbarimore, duhet të lajmëroj debitorin se sendet e luajtshme të sekuestruara në zbatim të titullit ekzekutiv do të shiten, nëse brenda pesë ditëve ai nuk ekzekuton detyrimin²³⁹.

4.4.2. Organizimi i ankandit për shitjen e sendit të luajtshëm të sekuestruar

Kur debitori nuk e përmbush detyrimin brenda afatit të përcaktuar, përbaruesi gjyqësor i dërgon sendet e sekuestruara në dyqanin me shitje të lirë. Shitja e sendeve të luajtshëm kryhet në dy mënyra: a) shitja në dyqanin me shitje të lirë dhe b) me ankand.

Caktimi i shpërblimit për shitjen bëhet në marrëveshje ndërmjet përbaruesit gjyqësor dhe shitësit. Shpërblimi nxirret nga vlera e sendit të sekuestruar pas shitjes së tij. Nëse brenda dy muajve sendi nuk shitet në shitje të lirë, përbaruesi gjyqësor, duke marrë edhe pëlqimin e palëve, vendos nëse duhet të vazhdojë me shitjen e lirë edhe për 30 ditë të tjera apo të kalojë në procedurë ankandi. Nëse merret vendimi për vazhdimin e shitjes së lirë dhe për 30 ditë të tjera, çmimi nuk ndryshon dhe vijon mbajtja e sendit në dyqanin me shitje të lirë deri në kalimin e afatit 30 ditor. Nëse pas kalimit të këtij afati sendet e luajtshme nuk arrijnë të shiten në dyqanin me shitje të lirë, do të fillojë procedura e shitjes së sendeve në ankand. Sendi i luajtshëm shitet me ankand kur: a) për shkak të natyrës ose të gjendjes, nuk mund të pranohet në shitje të lirë nga dyqanet e shitjes së lirë; b) përbaruesi gjyqësor vendos për shitjen në ankand të tij, pasi ka kaluar afati dy mujor i lajmërimit të shitjes së lirë dhe nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë ofertues gjatë kësaj kohe.

Ankandi për shitjen e sendit, nuk mund të fillojë përpara se të kenë kaluar pesë ditë nga shpallja. Lajmërimi për shitjen me ankand të sendit të luajtshëm, shpallet në zyrën e përbaruesit gjyqësor, në vendin ku ndodhet sendi ose në vendin e caktuar për shitjet me ankand, kur ka të tilla, si dhe për pesë ditë me radhë në dy gazeta kombëtare me tirazhin më të madh. Lajmërimi duhet të tregojë çmimin, me të cilin do të fillojë shitja e sendit, vendin, ditën dhe orën kur do të kryhet shitja. Çmimi fillestar i ankandit të parë është 80% e çmimit të përcaktuar nga përbaruesi, në bashkëpunim me kreditorin dhe debitorin apo nga një ekspert kur midis tyre ka patur kundërshtime, në mbështetje të nenit 552 të K.Pr.Civile. Në ditën dhe orën e caktuar,

²³⁷ Neni 552 i K.Pr.Civile

²³⁸ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.574 datë 16.12.2015

²³⁹ Vendimi i Kolegjtit Civil të Gjykatës së Tiranë nr.568 datë 11.12.2012

përmbaruesi gjyqësor shpall të hapur ankandin, para pjesëmarrësve. Përmbaruesi gjyqësor fton pjesëmarrësit të paraqesin ofertat e tyre. Ofertat për blerjen e sendit regjistrohen, sipas radhës së paraqitjes së tyre. I njëjti ofertues, mund të paraqesë oferta të ndryshme. Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal. Mbyllja e ankandit përfundon, me mbarimin e orarit zyrtar të ditës kur zhvillohet ankandi përfundon, si dhe kur nga shitja e një ose disa sendeve, nxirret shuma e nevojshme për shlyerjen e detyrimit.

Blerës quhet ofertuesi që ka dhënë çmimin më të lartë, i cili duhet ta paguaj menjëherë çmimin. Me pagimin e menjëhershëm të çmimit sendi i dorëzohet blerësit. Blerësi i sendit të shitur në dyqanin e shitjes me të lirë ose në ankand bëhet pronar i tij edhe sikur sendi të mos ishte në pronësi të debitorit. Kundër shitjes nuk mund të bëhet ankim dhe as të kundërshtohet vlefshmëria e saj, përveç rastit kur në ankand kanë marrë pjesë persona që tregohen në nenin 709 të Kodit Civil. Në të kundërt, nëse ndonjë nga këta perona merr pjesë në ankand dhe bëhet blerës i sendit, kjo shitje është absolutisht e pavlefshme, si veprim juridik që bie në kundërshtim me ligjin.

Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, për shitjen e sendeve zhvillohet një ankand i dytë. Brenda 10 ditëve nga përfundimi i ankandit të parë, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri, jo më të ulët se 30 % të çmimit fillestar, të caktuar në ankandin e parë. Në ankandin e dytë zbatohen të njëjtat rregulla për shitjen e pasurive të luajtshme sipas rregullave të përcaktuara për ankandin e parë. Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, përmbaruesi i propozon në fillim kreditorit, që kundrejt kredisë, të marrë sendin në pronësi me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbaruesi heq sekestron mbi këtë send, duke ia kthyer atë debitorit dhe vijon procedurat përmbarimore mbi pasuri të tjera të tij. Nëse kreditori pranon të marrë sendin kundrejt çmimit të ankandit të dytë, përmbaruesi vazhdon procedurën me “vendim për kalimin në pronësi të sendit të luajtshëm”. Vendimi së bashku me fotokopjen e njesuar me vulën lidhëse të përmbaruesit i dërgohet pvr zbatimin institucionit përkatës, si të tillë mund të përmendim Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor. Institucioni duhet të pajis kreditorin me dokumentin e pronësisë për sendin e luajtshëm.

Pavarsisht se naftën mund ta konsiderojmë si send të luajtshëm dhe të zbatojmë të njëjtat dispozita, për vetë specifikën që ka duhet të parashikohen ndryshime në ligj. Në rastin në ekzekutim pala debitore është një shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e hidrokarbureve. Në zbatim të titullit ekzekutiv²⁴⁰ pala debitore ka detyrimin të dëmshpërblejë palën kreditore për dëmin e shkaktuar. Meqënëse nga procedura përmbarimore ka rezultuar se pala debitore nuk disponon të ardhura monetare pranë bankave të nivelit të dytë. Një alternativë që të mund të realizohet ekzekutimi është bllokimi i aktivitetit të palës debitore, nëpërmjet sekestrimit të sendit të luajtshëm, naftës bruto. Problematika që haset në praktikë është se nafta duke qënë një send që i nënshtrohet regjimit të akcizës nuk mund të sekeustrohet në mënyrë të detyrueshme. Pasi pala debitore duhet të plotësoj në sistemin *online* dokumentin shoqerues administrativ ose ndryshe njihet me emrin D.S.H.A. Aksesin për të hyrë në sistem e disponon vetëm pala debitore nëpërmjet

²⁴⁰ Vendimi nr.96 datë18.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

një numri unik. Autoriteti doganor si subjekt që monitoron procedurën nuk ka asnjë fuqi detyruese ndaj palës debitore. Ndodhur në këto kushte e vetmja mënyrë për të detyruar palën debitore që të plotësoj dokumentin shoqërues administrativ është të kallëzohet penalisht personin përgjegjës pranë shoqërisë debitore për veprën penale të pengimit të ekzekutimit, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal. Ndërkohë që për hetimin e veprës dhe ngarkimin e personit me përgjegjësi penale duhet kohë. Kohë e cila është në disfavor të ekzekutimit të vendimit, pasi pala debitore qëllimisht me mosveprimet e saj bëhet shkak për mos ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Një boshllëk i tillë në rikuperimin me forcë të detyrimit ekziston edhe në fushën doganore, prandaj ndërhyrja për përmirësimin e kësaj situate është domosdoshmëri. Ndërkohë në fushën doganore është parashikuar mundësia që pasi të jetë marrë urdhëri i ekzekutimit për një detyrim doganor, autoritet kanë të drejtë të kërkojnë pezullimin e niptit të subjektit debitor në sistem duke pezulluar çdo veprim financiaro-tregtarë të tij, për rikuperimin me forcë të detyrimit. Ndërkohë një masë e tillë nuk gëzon mbështetje ligjore në K.Pr.Civile për një detyrim të njohur nga një vendim gjyqësor i forëms së prerë. Prandaj propozojmë ndërhyrjen e legjislatorit për disiplinimin e kësaj situate në favor të ekzekutimit.

Sigurisht që K.Pr.Civile nuk mund të parashikoj të gjitha rastet e ekzekutimit e praktikës përbarimore, por rregullat e përgjithshme janë mëse të nevojshme. Një rast tjetër që shërbimi përbarimor ka hasur gjatë punës s tij është edhe ekzekutimi në pjesën e aksioneve që zotëron pala debitore. Kështu kur pala debitore është aksioner në një shoqëri tregtare, ai gëzon një pjesë të të drejtave të materializuar në formën e aksionit. Aksioni është një e drejtë që mund të sekuestrohet për pjesën që i përket palës debitore. Sekuestrua vendoset me anë të urdhërit të përbaruesit gjyqësor që i drejtohet Qendrës Kombëtare të Publikimeve ose ish-Q.K.R-ja dhe njëkohësisht nëpërmjet regjistrimit pranë Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve (Q.R.A). Regjistrimi i urdhërit të sekuestrohet bëhet vetëm në rast se shoqëria i ka të regjistruar aksionet pranë këtij institucioni. Po ashtu regjistrimi i urdhërit bëhet edhe pranë regjistrimit të barrëve regjistruese. Më pas njoftohet pala debitore se nëse nuk përmbushet detyrimi brenda afatit ligjor 5 ditor, atëherë përbaruesi do të filloj procedurën e shitjes së aksioneve në ankand. Në këtë moment duhet bërë një zgjidhje nga përbaruesi nëse do ta konsiderojmë aksionin si send të luajshëm apo të paluajshëm, pasi në varësi të këtij klasifikimi do të përcaktohet edhe procedura që do të ndiqet për zhvillimin e ankandit. Meqë nuk është krijuar një praktikë e konsoliduar në këtë fushë, propozojmë që institucionet përkatëse të ndërhyjnë për të rregulluar këtë situatë. Aq më tepër që edhe aksionet gëzojnë një statut të veçantë dhe nuk ekziston një treg i mirëfilltë për shitjen e tyre. Institucione të tilla janë Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit ose Dhoma Kombëtare e Përbaruesve Gjyqësor Privat, të cilat me anë të propozimet dhe nismat e tyre ligjore mund të ndryshojnë dhe reformoj situatën ekzistuese.

4.4.3. Ekzekutimi mbi sendet e paluajshme

Kur për shlyerjen e një detyrimi, që përbën titull ekzekutiv, debitori nuk ka mjete monetare të mjaftueshme si dhe kur vlera e detyrimit nuk mund të nxirret nga ekzekutimi mbi sendet e

luajtshme, atëherë përmbaruesi kryen ekzekutimin mbi sendet e paluajtshme në pronësi të debitorit.

Për sa i takon kompetencës tokësore të gjykatës për paditë që ngrihen për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm mbi sende, kompetente është gjykata ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre, kjo në raport me vlerën e tyre ekonomike²⁴¹. Përpara se të vendosë sekuestron, përmbaruesi fillimisht verifikon pronësinë e sendit të paluajtshëm²⁴². Informacioni kërkohet në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ku është i regjistruar sendi. Njëkohësisht përmbaruesi duhet të verifikoj që nuk jemi përpara rastit të parashikuar nga neni 529 i K.Pr.Civile²⁴³. Në rast se sendi i paluajtshëm nuk është i regjistruar, informacioni merret nga organet financiare dhe ato të pushtetit lokal të vendit, ku ndodhet sendi. Por edhe vetë kreditori mund të paraqesë tek përmbaruesit gjyqësor dokumentet që vërtetojnë, se sendi i paluajtshëm është në pronësi të debitorit.

Ekzekutimi i vendimit të gjykatës apo të titujve të tjerë ekzekutiv mbi sendet e paluajtshme të debitorit bëhet me vendosjen e sekuestros mbi to. Urdhëri për vënien e sekuestros konservative i drejtohet zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe ka të përcaktuar: urdhrin e ekzekutimit, mbi bazën e të cilit kryhet ekzekutimi; emrin, atësinë dhe mbiemrin e debitorit; shumën e kredisë apo kredive ekzekutive, kur ato janë disa; llojin, natyrën dhe të paktën tre kufij të sendit të paluajtshëm, vendin e ndodhjes së tij, si dhe hipotekat dhe të drejtat reale që mund të jenë vendosur mbi të.

Derisa të kryen veprimet përmbarimore për shitjen, sendi i paluajtshëm i sekuestruar i lihet në ruajtje debitorit, duke qenë i detyruar debitorit të kujdeset për të, si për sendin e tij. Po kështu është i pavlefshëm çdo disponim i debitorit që përbën disponim të sendit të paluajtshëm pas regjistrimit të sekuestros. Kur debitorit refuzon ose nuk kujdeset si duhet për sendin, përmbaruesi gjyqësor, ashtu si në rastin e sendit të luajtshëm, emëron një person tjetër, për ruajtjen e tij. Në këtë rast, sendi i paluajtshëm lirohet nga sendet e debitorit dhe i dorëzohet ruajtësit. Për dorëzimin e sendit të paluajtshëm, mbahet procesverbal. Për ruajtjen e sendit të paluajtshëm caktohet një shpërblim. Caktimi i shpërblimit bëhet me marrëveshje, midis përmbaruesit gjyqësor dhe ruajtësit. Shpërblimi për ruajtësin paguhet fillimisht nga kreditori dhe nxirret nga vlera e sendit të paluajtshëm, pas shitjes së tij. Gjatë kohës së ruajtjes, debitorit ose ruajtësi kanë përgjegjësi për të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e bëra.

Pas vënies së sekuestros, përmbaruesi i dërgon lajmërim debitorit se sendi i sekuestruar do të shitet, nëse brenda dhjetë ditëve të njoftimit ai nuk e përmbush detyrimin. Në kuadër të procedurave përmbarimore pala kreditore dhe ajo debitore njoftohen nga përmbaruesi, për të arritur një marrëveshje për çmimin e shitjes së sendit të paluajtshëm të sekuestruar, e cila duhet të

²⁴¹ Neni 49 paragrafi i parë i K.Pr.Civile

²⁴² Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 758 datë 07.04.2015 arsyeton se: *Zyra përmbarimore përpara se të vendoste sekuestron duhej të verifikonte pronësinë e debitorit mbi sendet dhe që nga momenti që është vënë në dijeni nga debitorit se apartamenti në fjalë ishte porositur shumë kohë para lindjes së detyrimit titull ekzekutimi nuk duhej të kryente asnjë veprim mbi të. Në bazë të nenit 585 të K.Pr.Civile kur gjatë kryerjes së ekzekutimit konstatohet se preken interesa të të tretëve, pezullohet ekzekutimi dhe kreditori ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës, ndërsa vazhdohet me ekzekutimin vetëm në kushtet e nenit 603 të K.Pr.Civile.*

²⁴³ Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 758 datë 07.04.2015

arrihet brenda një jave nga dita e njoftimit. Nëse ka disa pasuri të paluajtshme të ngarkuara me hipotekë si kolateral që garanton përmbushjen e detyrimit, si dhe disa pasuri të luajtshme të vëna peng ose barrë siguruese, vlera e të cilave kapërcen vlerën e detyrimeve, atëherë nuk mund të ketë radhë preferimi në ekzekutimin e detyrueshëm, ky proces udhëhiqet nga realizimi i interesit të kreditorit gjithmonë duke respektuar të drejtat e debitorit.

4.4.4. Zhvillimi i ankandit për shitjen e sendit të paluajtshëm të sekuestruar

Nëse brenda një jave, palët nuk arrijnë një marrëveshje për vlerën e sendit, përmbaruesi gjyqësor, brenda pesë ditëve, përcakton me vendim vlerën e tij, bazuar në aktin e ekspertimit, të paraqitur nga një ekspert i licensuar dhe në vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e vënies së sekuestros mbi të²⁴⁴. Vendimi i përmbaruesit gjyqësor, për caktimin e vlerës së shitjes së sendit të paluajtshëm në ankand, i njoftohet brenda dhjetë ditëve kreditorit dhe debitorit. Kundër këtij vendimi të përmbaruesit palët mund të bëjnë ankim të veçantë në gjykatën e rrethit gjyqësor ku ndodhet sendi.

Në ndryshim nga sendet e luajtshme, sendi i paluajtshëm i sekuestruar shitet vetëm me ankand. Shpallja për shitjen në ankand afishohet në zyrën e përmbaruesit gjyqësor dhe në vendin ku ndodhet sendi i paluajtshëm gjykatë, komunë, bashki, njësitë bashkiake, si dhe për pesë ditë me radhë në dy gazeta kombëtare me tirazhin më të madh²⁴⁵ dhe në një vend apo vende të tjera publike, siç mund të jetë zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që përmbaruesi vlerëson të përshtatshme me qëllim informimin e personave të interesuar dhe realizimin e shitjes së sendit.

Njoftimi për shpalljen e shitjes në ankand të sendit të paluajtshëm duhet të përmbajë: a) tregimin e urdhrin të ekzekutimit, mbi bazën e të cilit kryhet ekzekutimi; b) emrin, atësinë dhe mbiemrin e pronarit të sendit; nëse sendi është vënë në hipotekë, shumën e kredisë për të cilën sendi është vënë në hipotekë, c) çmimin e sendit me të cilin do të fillojë shitja, vendi, dita kur do të përfundojë shitja në ankand; ç) detyrimin e ofertuesve të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në ankand, për të parapaguar garancinë e pjesëmarrjes.

Informacioni për sendin që do të shitet në ankand përgatitet nga përmbaruesi gjyqësor dhe përmban karakteristikat e sendit, duke e përshkruar atë sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, për të krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Secili ofertues që është pjesëmarrës në ankand, përpara fillimit të ankandit duhet të depozitojë si garanci në zyrën e përmbarimit një shumë të hollash të barabartë me 10% të çmimit të sendit të caktuar në shpallje. Shuma e garancisë duhet të depozitohet në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor. Kreditori nuk lë garanci, në rast se kredia e tij e kalon masën e garancisë. Çmimi fillestar në ankand është 80% i çmimit të përcaktuar, sipas procedurës së cituar më lart.

²⁴⁴ Neni 564 i K.Pr.Civile

²⁴⁵ Ligji nr.122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, neni 42

Për shpalljen e shitjes në ankand duhet të njoftohen të gjitha palët e interesuar si edhe nëse ka kreditorët që kanë hipotekë apo të drejta të tjera reale mbi sendin objekt ankandi, sipas rregullave për njoftimin e akteve gjyqësore. Shitja e sendit të paluajtshëm në ankand nuk mund të fillojë pa kaluar pesëmbëdhjetë ditë nga shpallja e ankandit. Vendi i kryerjes së shitjes në ankand është zyra e përmbauesit gjyqësor ose në një vend tjetër publik, nëse është i përshtatshëm për zhvillimin e ankandit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka pranuar kërkesën e paditëses dhe ka pezulluar veprimin përmbauesit “Vendim për kalim të sendit në pronësi të kreditorit”²⁴⁶. Kjo mbështetur në arsyetimin se ankandi ishte zhvilluar në shkelje të rënda të ligjit procedural civil. Sipas akteve rezulton se ankandi ishte zhvilluar në një ditë të vetme, ndërsa sipas ligjit ankandi duhet të vazhdojë të jetë i hapur për një afat 15 ditor, kjo e bën veprimin përmbauesit të ankandit, totalisht të pavlefshëm, vërehen dhe mangësi të tjera, që gjithashtu duhet të ishin respektuar nga përmbauesi. Një shkelje tjetër që konsiderohet e rëndë është edhe mospagesa paraprake në llogarinë e përmbauesit e shumës prej 12.675.573,70 lekë si diferencë midis çmimit të sendit të shitur dhe shumës së detyrimit që debitori detyrohet ndaj bankës. Detyrimi për parapagimin e çmimit të diferencës midis shumës së realizuar nga shitja dhe detyrimit që ka debitori gjen rregullim në nenin 579 të K.P.Civile. Një tjetër shkelje që vihet re nga ana e Z.Përmbauesit është edhe fakti që mbi katin e fundit të objektit të sekuestruar ndodhet një gjysmë kati i meremetuar e rregulluar plotësisht, me sipërfaqe rreth 250 m² për të cilin nuk thuhet asgjë në vendimin e sekuestros.

Përmbauesi gjyqësor fillimisht verifikon pjesëmarrjen në ankand, duke lexuar emrat e ofertuesve pjesëmarrës, të regjistruar sipas listës së pagesës së garancive të depozituara nga pjesëmarrësit në llogarinë e tij. Përmbauesi gjyqësor u tregon pjesëmarrësve të drejtat dhe detyrimet e ofertuesit, të dhënat mbi sendin që do të shitet, shpall shumën fillestare të fillimit të shitjes, shumën e kredive ekzekutive për realizimin e të cilave do të shitet sendi i paluajtshëm, hipoteka apo të drejta të tjera reale mbi sendin si objekt ankandi, nëse ka, si dhe shumën e kredive të siguruara me hipotekë nga sendi i paluajtshëm që shitet me ankand.

Për zhvillimin e ankandit mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga palët e pranishme. Përmbauesi gjyqësor fton ofertuesit të paraqesin ofertat e tyre. Ofertat pranohen vetëm nga ofertuesit të cilët kanë depozituar shumën e garancisë së pjesëmarrjes. Ofertuesit kundrejt nënshkrimit, shënojnë në procesverbalin e ankandit, çmimin që japin për blerjen e sendit. Ofertat regjistrohen sipas radhës së paraqitjes së tyre. I njëjti ofertues mund të paraqesë ofertë të re pavarësisht çmimit të ofruar më parë. Rregulli është që oferta më e madhe në vlerë rrëzon ofertën më të vogël. Në ankand nuk zbatohet e drejta e para blerjes.

Ankandi për shitjen e sendit të paluajtshëm përfundon me mbarimin e orarit zyrtar, të ditës së fundit që tregohet në shpalljen për shitjen me ankand. Në përfundim të ankandit, përmbauesi gjyqësor shpall fituesin. Blerësi i sendit është ofertuesi, i cili ka dhënë çmimin më të lartë. Pronësia mbi sendin i kalon blerësit vetëm pasi të ketë paguar të gjithë çmimin, duke zbritur prej

²⁴⁶ Vendimin nr. 116/539 Akti, datë 29.12.2011i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.157, datë 19.03.2015

tij shumën e lënë si garanci. Garancitë e lëna nga persona të tjerë që kanë marrë pjesë në ankand, u kthehen atyre menjëherë pas përfundimit të ankandit.

Blerësi duhet të paguajë çmimin e sendit të blerë në ankand brenda 15 ditëve nga mbarimi i ankandit. Blerësi vihet në posedim të sendit nga përmbauesi gjyqësor brenda 10 ditëve nga pagimi i çmimit të sendit si kundrejt debitorit ose personit të cilit i është lënë në ruajtje, ashtu edhe kundrejt çdo personi të tretë që ka në posedim sendin. Personi i tretë për heqjen e sendit nga posedimi, mund të mbrohet vetëm me padinë për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi sendin²⁴⁷. Në qoftë se blerësi, nuk paguan çmimin brenda afatit të caktuar, humbet të drejtën e kthimit të shumës së lënë si garanci, e cila kalon në degën e thesarit, për dobi të shtetit dhe për shitjen e sendit bëhet një ankand i ri, duke vepruar sipas rregullave të caktuara në këtë kapitull. Rregullat e hollësishme për zhvillimin e ankandit përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave²⁴⁸. Në praktikë janë hasur raste kur përmbauesi duhet të derdh shumën e lënë si garanci, por ka pasur vështirësi në lidhje me numrin e llogarisë së degës së thesarit ku duhet bërë derdhja.

Në rastet kur në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij përmbauesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 30 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë. Ankandi i dytë për shitjen e sendit zhvillohet 30 ditë nga e nesërmeja e datës së caktimit të çmimit të ri nga ana e përmbauesit.

Në rast se dhe në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë përmbauesi i propozon në fillim kreditorit që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbauesi gjyqësor heq sekuestron mbi sendin e sekuestruar dhe vijon procedurat përmbaimore mbi pasuri të tjera të debitorit. Në rastin kur kreditori pranon marrjen në pronësi ose shpallet një ofertues fitues i ankandit, me pagimin e çmimit dhe taksës mbi aktet për shitjen e sendit, përmbauesi gjyqësor merr vendimin për kalimin e sendit në pronësi të blerësit²⁴⁹.

Ky akt nga pikëpamja formale, shënon kalimin e pronësisë mbi sendin, nga debitori tek blerësi. Kur kreditorët që kërkojnë të marrin sendin kundrejt kredisë janë disa, përmbauesi gjyqësor deklaron blerës kreditorin që brenda 3 ditëve nga propozimi jep çmimin më të lartë se çmimi i caktuar për ankandin e dytë. Kur kreditori që merr sendin me çmimin e caktuar në shitjen e dytë dhe ky i fundit është më i vogël se vlera e kredisë ekzekutive, kreditori ruan të drejtën që të kërkojë një ekzekutim të ri për plotësimin e kredisë së tij. Ndërsa kur shuma e realizuar nga shitja në ankand është më e madhe se shuma e kredisë së kreditorit apo kreditorëve, diferenca i kthehet debitorit, pasi zbriten shpenzimet e bëra për ruajtjen e sendit apo për zhvillimin e ankandit.

Shitja e sendit të paluajtshëm në ankand nuk ndalon personin e tretë i cili pretendon se është pronari i tij që ta kërkojë sendin me padi²⁵⁰. Kundër shitjes në ankand mund të bëhet ankim në gjykatë në formën e kundërshtimit të veprimeve të përmbauesit gjyqësor. Nëse ankandi ka

²⁴⁷Referuar nenit 612 të K.Pr.Civile *Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja.*

²⁴⁸Udhëzimi nr.5, datë 12.12.2012 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbauesi gjyqësor”

²⁴⁹ Neni 574/2 i K.Pr.Civile

²⁵⁰ Shiko nenin 580/1 të K.Pr.Civile

përfunduar dhe shitja është kryer, vlefshmëria e saj mund të kundërshtohet me padi, për mosrespektim të kushteve të nenit 556 të K.Pr.Civile.

4.4.5. Ekzekutimi mbi sendet e paluajtshme në bashkëpronësi

Një send i paluajtshëm është në bashkëpronësi kur ai dhe të drejtat reale që lidhen më të u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave. Bashkëpronësia mbi sendet ekziston në dy forma: a) bashkëpronësi në pjesë kur pjesët e secilit bashkëpronar konsiderohet se janë të pandara dhe të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta; dhe b) bashkëpronësi në tërësi, ku pjesët takuese të bashkëpronarëve nuk rezultojnë të jene të barabarta dhe duhet të caktohen me vendim gjykate. Ekzekutimi i sendeve të paluajtshme në bashkëpronësi me qëllim zbatimin e një titulli ekzekutiv, kryhet nëpërmjet sekuestrimit të sendit. Përmbaruesi gjyqësor para se të vendos sekuestron mbi sendin e paluajtshëm në bashkëpronësi, duhet të verifikojë pronësinë e sendit, nëpërmjet aplikimit për t'u pajisur me kartelë pasurie pranë zyrën së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të përcaktuar më pas rrethin e bashkëpronarëve në emër të cilëve figuron i regjistruar sendi.

Pas vendosjes së sekuestron me qëllim vijimin e ekzekutimit të titullit ekzekutive, bëhet veçimi i pjesës takuese të debitorit bashkëpronar mbi sendin e paluajtshëm në bashkëpronësi. Veçimi i pjesës takuese mbi sendin e sekuestruar në bashkëpronësi, kryhet: me marrëveshje të bashkëpronarëve, kur këta të fundit bien dakord që të ndajnë sendet në bashkëpronësi me kusht që marrëveshja të mos rëndojë pozitën e kreditorit; ose me vendim gjyqësor, kur palët nuk bien dakord të pjesëtojnë sendin e përbashkët apo kur marrëveshja rëndon pozitën e kreditorit dhe nuk mund të pranohet.

Veçimi i pjesës takuese të debitorit bashkëpronar mbi sendin e paluajtshëm në bashkëpronësi mund të kryhet me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve të sendit kur këto të fundit bien dakord dhe arrijnë të përcaktojnë pjesën takuese të debitorit, me kusht që ndarja e saj të mos dëmtojë interesat e kreditorit. Marrëveshja për pjesëtimin e sendit të paluajtshme në bashkëpronësi duhet të kryhet me akt noterial.

Ndërkohë në rast të mosarritjes së marrëveshjes midis bashkëpronarëve për veçimin e pjesës takuese, apo kur marrëveshja nuk pranohet për shkak se ka rënduar pozitat e kreditorit, veçimi i pjesës takuese mund të kërkohet të kryhet në gjykatë nga përmbaruesi gjyqësor. Kompetente për shqyrtimin e kërkesës së përmbaruesit gjyqësor është gjykata e rrethit gjyqësor të vendit ku kryhet ekzekutimi, pra ku ndodhet sendi i paluajtshëm që do të pjestohet. Caktimi i pjesës takuese të debitorit bashkëpronar në sendin në bashkëpronësi kryhet sipas të pjesëtimit gjyqësor.

Pjestimi kalon në dy faza. Në fazën e parë bëhet caktimi i rrethit të bashkëpronarëve si dhe caktimi i pjesës takuese të secilit prej tyre mbi sendin e paluajtshëm, duke përcaktuar pjesën ideale, ndërsa në fazën e dytë bëhet ndarja faktike, pjestimi fizik i pjesës takuese të palës debitore. Veçimi dhe ndarja në natyrë e pjesës takuese të debitorit në sendin e paluajtshëm kryhet kur kjo ndarje është e mundshme dhe nuk dëmton qëllimin e përdorimit të sendit si dhe përcaktimi i ekuivalenës në vlerë monetare, nëse është kërkuar gjatë hetimit gjyqësor. Sendi i paluajtshëm në

bashkëpronësi i nënshtohet ekzekutimit në tërësi kur të gjithë bashkëpronarët janë debitorë solidar dhe kanë dhënë të gjithë pëlqimin për shitjen, i cili duhet të shprehet në formën e aktit noterial.

Vetëm pas kësaj faze duhet të vazhdojë shitja e pasurisë së debitorit për të bërë të mundur zbatimin e titullit ekzekutiv. Kolegji Civil në praktikën e tij ka arsyetuar në lidhje me faktin se përmbaruesi gjyqësor ka detyrimin të verifikojë subjektin që gëzon titullin e pronësisë mbi sendin ndaj të cilit drejtohen veprimet përmbarimore. Në rastin në shqyrtim përmbaruesi nuk e ka kryer detyrën ashtu siç e parashikon ligji, por ka qëndruar besnik vetëm anës formale të regjistrimit të pasurisë. “Për pasojë në bazë të nenit 612 të K.Pr.Civile duhet të përjashtohet nga sekuestrimi dhe shitja ½ pjesë e paditëses S.Sh në apartamentet e sekuestruara debitorit. Zyra e Përmbarimit duhet të realizojë veçimin gjyqësisht të pjesës së bashkëpronares jodebitore S.Sh në sendet bashkëpronësi dhe më pas të vijojë procesi i shitjes së pronave vetëm për pjesën e debitorit P.Sh²⁵¹”

E njëjta procedurë që parashikohet në nenin 578 të K.Pr.Civile parashikohet edhe në nenin 546 të K.Pr.Civile edhe për ekzekutimin mbi sendin e luajtshëm që është në bashkëpronësi, për të cilat ndiqet e njëjta rrugë. Në K.Pr.Civile nuk parashikohet fare se ç’ndodh nëse nga fillimi i ekzekutimit mbi shumat e llogarive në banka, rezulton se këto shuma janë në bashkëpronësi të debitorit me persona të tjerë. Mendojmë se në këtë rast duhet të vepohet në të njëjtën mënyrë si me sendet e luajtshme në bashkëpronësi duke respektuar edhe dispozitat e parashikuara nga Kodi Civil mbi bashkëpronësinë në pjesë²⁵².

4.5. Ekzekutimi i detyrimit për dorëzimin e një sendi

4.5.1. Vënia në posedim e një sendi të luajtshëm

Kur titulli ekzekutiv që vihet në ekzekutim ka si objekt të tij vënien në posedim të një sendi të luajtshëm, pala kreditore pasi paraqet dokumenacionin e kërkuar në përputhje me nenin 515 të K.Pr.C, vë në lëvizje shërbimin përmbarimor gjyqësor. Përmbaruesit gjyqësor pasi ka kryer veprimet e duhura procedurale për hapjes e dosjes përmbarimore, fillimisht njofton palën debitorë për të ekzekutuar vullnetarisht titullin ekzekutiv. Nëse pala debitorë nuk e kryen ekzekutimin në mënyrë vullnetare kalon ekzekutimin e titullit në ekzekutim të detyrueshëm.

Përmbaruesi gjyqësor për ekzekutimin e detyrueshëm njofton palën debitorë për ditën dhe orën e caktuar për ekzekutim të detyrueshëm. Kur nga përmbaruesi çmohet e nevojshme mund të njoftohet edhe forcat e policisë për të qënë të pranishme në ekzekutim²⁵³. Përmbaruesi së bashku me palët e njoftuara paraprakisht shkojnë në vendin ku ndodhet sendi dhe kryejnë veprimin e duhur duke i marë sendin palës debitorë dhe duke ia dorëzuar kreditorit. Ky fakt shënohet në

²⁵¹ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.350, datë 18.02.2016

²⁵² Neni 199 i Kodit Civil parashikon se: *Ka bashkëpronësi kur një ose disa sende dhe të drejta të tjera reale u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave. Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve caktohen në përpjestim me pjesët përkatëse.*

²⁵³ Neni 523 i K.Pr.Civile, dhe nenin 31, germa c, të Ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin e Përmbarimit Gjyqësor Privat”.

procesverbal dhe si çdo veprim tjetër përmbartimor palët mund ta kundërshtojnë në gjykatë brenda afatit pesë ditor nga moment që kanë marrë dijeni²⁵⁴.

Në rast se sendi nuk ndodhet më pranë palës debitorë ose është prishur, ose pranë palës debitorë ndodhet një pjese e sendit dhe në rast se gjykata në vendimin e saj ka caktuar dhe vleftën e sendit përmbartuesi gjyqësor merr nga pala debitorë kundërvleftën e sendit ose të pjesës që mungon. Me kërkesë të palës së interesuar gjykata e vendit të ekzekutimit bën caktimin e vleftës së sendit, pasi dëgjon palët ose në rast nevojë ajo thëret dëshmitarë dhe ekspert. Në cilësinë e kërkuarit mund të jetë pala kreditore ose edhe vetë përmbartuesi me qëllim vazhdimin e procedurave përmbartimore për ekzekutimin e titullit. Kundër vendimit të gjykatës për caktimin e vlerës së sendit të luajtshëm mund të bëhet ankim i veçantë.

Rastet më të shpeshta kur përmbartuesi duhet të vendosë në posedim sendin e luajtshëm palës kreditore janë ato raste kur pala debitorë ka marrë një kredi dhe e ka siguruar me një send të luajtshëm. Nëse pala debitorë nuk ka mundësi pagese atëherë pala kreditore do të kërkojë nga përmbartuesi që pasi të jetë respektuar procedura, të sekuestrohet sendi i luajtshëm që është vendosur kolateral ose garanci për shlyerjen e kredisë. Sendi i luajtshëm mund të jetë automjeti, orënditë shtëpiake pa çënuar ato pajisje që në bazë të nenit 529 nuk mund të sekuestrohen.

4.5.2. Vënia në posedim e një sendi të paluajtshëm

Ekzekutimi i titujve që kanë si objekt, vënie në posedim të një sendi të paluajtshëm në praktikën e përditshme përmbartimore njihen ndryshe me termin “lirim dhe dorëzim sendi”. Këta tituj klasifikohen si tituj të vështirë për t’u ekzekutuar pasi përgjithsisht pala debitorë refuzon të kryejë librim vullnetar, për rrjedhojë ekzekutimi i këtyre titujve ekzekutiv do të kryhet në formën e ekzekutimit të detyrueshëm. Përmbartuesit gjyqësor njofton me shkresë palën debitorë për ditën dhe orën, në të cilën do të vë kreditorin në posedim të sendit, të paktën tre ditë përpara. Në datën dhe në orën e caktuar në njoftim përmbartuesi gjyqësor së bashku me përfaqësuesit e rendit dhe të njësisë vendore kryen ekzekutimin e titullit duke vendosur palën kreditore në posedimin e sendit.

Për këtë përmbartuesi gjyqësor mban një procesverbal duke shënuar të gjitha veprimet kundërveprimet si dhe pretendimet e palëve në ekzekutim. Në procesverbal shënohet dhe masa e shpenzimeve të kryera për librimin dhe dorëzimin e sendit. Përmbartuesit duhet të bëjë kujdes në mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve përmbartimore pavarësisht se ato do të përballohen fillimisht nga pala kreditore dhe do të vilen në përfundim të ekzekutimit nga pala debitorë²⁵⁵.

Përmbartuesi duhet të dorëzojë sipërfaqen e tokës dhe nëse verifikohet se debitori ka ndërtuar në këtë tokë ndërkohë që ishte në hipotekë, ai me padi të veçantë mund të kërkojë vlerësim të banesës, por ai nuk mund të bëjë të paekzekutueshëm detyrimin e tij duke zënë me ndërtim një truall që e kishte vendosur në hipotekë²⁵⁶.

²⁵⁴Neni 524 i K.Pr.Civile *Përmbartuesi gjyqësor, për çdo veprim të kryer prej tij, është i detyruar të mbajë procesverbal, në të cilin përmenden dita dhe vendi i kryerjes së veprimit, kërkesat dhe deklaratimet e bëra nga palët, sendet e marra, shumat e nxjerrë dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin.*

²⁵⁵ Neni 525 i K.Pr.C

²⁵⁶ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.522 datë 01.12.2015

Në rast se pala debitore megjithë njoftimet e marra nuk qëndron në vendin e ekzekutimit, atëherë përmbaruesit gjyqësor i duhet që të hapi me forcë banesën e palës debitorë dhe të vendosi palën kreditore në posedim të sendit. Hyrja me forcë në banesën duhet të bëhet vetëm në prani të përfaqësuesve të njësisë së qeverisjes vendore si dhe të dy dëshmitarëve. Përmbaruesi gjyqësor bën inventarin e të gjitha sendeve të gjetura në banesë dhe nën përgjegjësinë e tij ia dorëzon ato palës debitore ose familjarëve të tij. Në rast se debitori ose familjaret e tij nuk janë të pranishëm përmbaruesi gjyqësor merr masat e duhura për magazinimin e këtyre sendeve në mjediset e liruara nëse pala kreditore pranon për një periudhë 2 mujore²⁵⁷.

Në rast se nuk arrin marrëveshje me kreditorin përmbaruesi gjyqësor merr masa për largimin e sendeve të gjetura në objekt duke i magazinuar ato në ambiente të tjera që disponohet nga shërbimi përmbarimor ose në një ambient neutral, ku mund të ruhen në mënyrë të sigurt. Në të gjitha rastet këto sende mbahen në ruajtje nga shërbimi përmbarimor për një periudhë 2 mujore. Shpenzimet për magazinimin e sendeve paguhen nga pala debitorëve në çastin e dorëzimit të tyre. Nëse brenda dy muajve nga lirimi dhe magazinimi pala debitorë nuk i kërkon sendet e tij ose pala debitore nuk paguan detyrimin për ruajtjen e sendeve atëherë përmbaruesi gjyqësor për sendet të cilat janë të sekuestrueshme, bën vlerësimin dhe shitjen në përputhje me dispozitat ligjore për shitjen e sendeve të luajtshme në rast se ka sende të cilat nuk mund të jene të sekuestrushme ato i kthehen palës debitorë. Sendet e luajtshme që nuk mund të shiten ose nuk kërkohen nga pala debitorë asgjësohen apo i kalojnë institucioneve shtetërore ose enteve publike në formën e kalimit kapital.

Në praktikë ka ndodhur që pala debitore edhe pse është njoftuar për të marrë në dorëzim sendet e luajtshme që ndodhen brenda sendit të paluajtshëm që është liruar dhe dorëzuar, nuk ka ardhur qëllimisht t'i mari në dorëzim, duke u bërë pengesë dhe shkaktar i zvarritjes së procedurave përmbarimore. Përmbaruesit gjyqësor në kryerjen e këtyre veprimeve lidhur me sendet e luajtshme të ndodhura brenda sendit të paluajtshëm duhet të mbajnë procesverbale të rregullta ku të pasqyrohen saktë veprimet përmbarimore.

4.6 Ekzekutimi i detyrimit për kryerjen e një veprimi

Nëse titulli ekzekutiv përmban si objekt, detyrimin e debitorit për të kryer një veprim atëherë nga përmbaruesi do të mbahet në konsideratë dispozita 605 të K.Pr.Civile. Kur debitori nuk ekzekuton detyrimin e tij, që ka të bëjë me një veprim që mund ta kryejnë edhe persona të tjerë, kreditori mund të kërkojë nga përmbaruesi gjyqësor që të lejohet ta kryejë vetë këtë veprim për llogari të debitorit.

Ndërsa paragrafi i dytë i nenit 49 të K.Pr.Civile e lidh përcaktimin e kompetencës tokësore, për paditë që ngrihen për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar, me kriterin e vendit ku duhet të përmbushet një detyrim i tillë. Për këtë rast vendi i ekzekutimit duhet të caktohet me vendimin e gjykatës që ka marrë formë të prerë²⁵⁸.

²⁵⁷ Neni 601/a i K.Pr.C

²⁵⁸ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.589, datë 24.10.2013

Ndryshe nga vendi i përmbushjes së detyrimit, vendi i ekzekutimit të detyrueshëm ka të bëjë me vendin ku do të zbatohet titulli ekzekutiv, pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit dhe vënies në lëvizje të shërbimit përmbartimor; pra i përgjigjet një marrëdhënie procedurale të krijuar në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe jo marrëdhënies së detyrimit të krijuar nga kontrata apo ligji material.

KAPITULLI V. NATYRA E MJETEVE TË MBROJTJES NË FAZËN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT GJYQËSOR

5.1. Vështrim i përgjithshëm

Ekzekutimi i vendimit gjyqësor është pjesë integrale e procesit gjyqësor dhe cënimi i kësaj së drejte përbën cënim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së dhe neni 42 i Kushtetutës²⁵⁹. Në këtë kuadër e rëndësishme është edhe analiza e mjeteve mbrojtëse që janë parashikuar nga ligji gjatë fazës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Titulli ekzekutiv si koncept juridik është krijuar për të treguar ekzistencën e një të drejte subjektive materiale të cënuar, ose të papërbushur. Për këtë arsye titulli ekzekutiv është burim i menjëhershëm dhe i drejtëpërdrejtë i legjitimitetit të kreditorit për të nisur procesin e ekzekutimit të detyrueshëm. Legjitimitetit që buron nga fakti se ai që ka titullin ekzekutiv ose në favor të të cilit është lëshuar titulli ekzekutiv, ka dhe të drejtën e përfshirë në të.

Titulli është i vlefshëm dhe i ekzekutueshëm pasi e drejta që është përfshirë në të është e vlefshme dhe ekzekutueshme njëkohësisht²⁶⁰. Kushtet e vlefshmërisë së titullit ekzekutiv janë: siguria, përcaktueshmëria dhe kërkueshmëria. Kushti i sigurisë nënkupton që e drejta duhet të rezultojë në ekstremet e saj objektive dhe subjektive nga titulli ekzekutiv. Kushti i përcaktueshmërisë është vlerësimi në të holla, i sendit ose i së drejtës si objekt ekzekutimi. Kushti i kërkueshmërisë ka të bëjë me faktin se kërkimi i ekzekutimit të detyrueshëm mund të kërkohet menjëherë, pa u lidhur me një afat të papërfunduar, apo me një kusht pezullues që nuk ka ndodhur²⁶¹.

Për të mbrojtur intersat ligjorë të subjekteve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor, iu është njohur e drejta për të kundërshtuar aktet dhe veprimet e organeve që drejtojnë procesin e ekzekutimit. Për të rregulluar gabimet që mund të bëhen në një proces ekzekutimi të detyrueshëm si dhe për të shmangur dëmet që mund t'u vijnë subjekteve nga një ekzekutim jo në përputhje me ligjin, paditësi ka të drejtë të zgjedhë të mbrohet. Mjet i posaçëm kundër ekzekutimit të titullit ekzekutiv që mbron këto të drejta është padia për pavlefshmërinë e titujve ekzekutiv, e cila parashikohet nga neni 609 i Kodit të Procedurës Civile.

5.2 Padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv si mjet mbrojtës dhe praktika gjyqësor në lidhje me të

Kodi i Procedurës Civile lejon mundësinë e kundërshtimit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, duke parashikuar mjetet mbrojtëse kundër ekzekutimit të vendimit të formës së prerë. Ky kundërshtim mund të bëhet:

²⁵⁹Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 510, datë 25.11.2015

²⁶⁰Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 658, datë 10.12.2014

²⁶¹Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 6, datë 10.01.2012

- (i) me kërkesën për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv (neni 609 i K.Pr.Civile);
- (ii) me kërkesën për kundërshtim veprimesh përbarimore (neni 610 i K.Pr.Civile);
- (iii) me padinë për kërkimin e sendit nga personi i tretë (neni 612 i K.Pr.Civile).

Nëpërmjet mjeteve sigurohet realizimi i garancive kushtetuese për ligjshmërinë e procedurës përbarimore²⁶². Ndërmjet këtyre mjeteve procedurale për mbrojtjen gjatë ekzekutimit ekzistojnë dallime thelbësore, pasi kanë baza ligjore dhe shkaqe ligjore të ndryshme. Për secilin nga këto mjete ligjvënësi, në dispozitat përkatëse të këtij Kodi, ka parashikuar kushte dhe kritere të ndryshme lidhur me ngritjen e tyre. Ndodh shpesh në praktikën gjyqësore që palët ndërgjyqëse të ngatërrojnë mjetet ligjore që duhet të përdorin. I tillë është rasti kur ankimi bëhet ndaj veprimit të përbaruesit ndërsa pretendime e palëve lidhen me vlefshmërinë e titullit ekzekutiv ose e anasjellta ankimi bëhet për pavlefshmërinë e titullit, ndërsa pretendimet ngrihen mbi veprimet e përbaruesit²⁶³. Këto kërkitime dhe pse hyjnë në rrethin e mjeteve mbrojtëse të debitorit ndaj ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kanë: (i) *shkak ligjor të ndryshëm*; (ii) *afate të ndryshme ankimi*; (iii) *mënyra mbrojtje të ndryshme*; dhe (iv) *pasoja dhe efekte të ndryshme ndaj palëve* të përfshira në një procedure ekzekutimi të detyrueshëm të titullit ekzekutiv.

Gjatë kohës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor ose të titujve të tjerë ekzekutiv mund të ndodhin rrethana ose mund të zbulohen rrethana të reja që e bëjnë plotësisht ose pjesërisht të pavlefshëm titullin ekzekutiv. Mund të ndodh që titulli ekzekutiv të jetë i vlefshëm, por rrethanat që kanë ndodhur më vonë, e bëjnë detyrimin e paqenë ose passjellin shuarjen ose pakësimin e detyrimit²⁶⁴. Në varësi të rrethanave të reja që vërtetohen përcaktohet edhe lloji i pavlefshmërisë që ato sjellin, disa rrethana nuk e bëjnë titullin të pavlefshëm por saktësojnë se ai ekziston në një masë më të vogël ose nuk ekziston fare. Neni 609 është një padi e rregullt njohjeje, e lidhur drejtpërdrejtë me themelin e çështjes dhe si e tillë i nënshtrohet një gjykimi të zakonshëm kontradiktor²⁶⁵.

Pra, me anë të kësaj padie, nëpërmjet vërtetimit të së kundërtës, debitori synon të kontestojë të drejtën e kreditorit, i cili nga ana e tij, synon të procedojë me ekzekutimin e detyrimit²⁶⁶. Padia e pavlefshmërisë së titullit, përmban elementet e një padie njohje negative dhe si e tillë, bazuar në nenin 113/b të Kodit Civil, kjo padi nuk i nënshtrohet parashkrimit.²⁶⁷ E drejta për të kërkuar ekzekutim të detyrueshëm të vendimeve gjyqësore si rregull i nënshtrohet afatit të parashkrimit, përveç rastit kur kërkohet ekzekutimi për ato vendime që janë të lidhura me padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi²⁶⁸. Në ndryshim nga kjo e fundit, padia për goditjen e vlefshmërisë së titullit ekzekutiv është gjithmonë e paparashkrueshme. Mendojmë se instituti i parashkrimit nuk futet në ato fakte dhe ngjarje të cilat sjellin si pasojë pavlefshmërinë e titullit të ekzekutimit. Ky argument

²⁶² Faik Brestovci, “E drejta Procedurale Civile II”, Ribotim 4, shtepia botuese “Grafo Beni” Prishtine 2006

²⁶³ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.174, datë 01.04.2015, i njëjti qëndrim është mbajtur me Vendimin nr.609, datë 20.11.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

²⁶⁴ Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol ÇOMO, “Vështrim krahasues mbi procedure civile”, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë 2006, faqe 341

²⁶⁵ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.1210, datë 26.10.2006

²⁶⁶ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.81, datë 22.02.2011

²⁶⁷ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.160, datë 28.04.2009

²⁶⁸ Neni 113/dh i Kodit Civil

bazohet në arsyetimin se kjo padi përmban elementet e një padie njohje negative dhe si e tillë në bazë të nenit 113/b të Kodit Civil, kjo padi nuk i nënshtrohet afateve të parashkrimit²⁶⁹.

Neni 609 i K.Pr.Civile kur shprehet në paragrafin e dytë të tij për “*ngjarje dhe fakte që kanë ndodhur pas dhënies së vendimit*”, nuk ka parasysh institutin e parashkrimit, por ngjarje të tjera, si përmbushja plotësisht ose pjesërisht e detyrimeve, shuarja e tyre. Vlerësojmë se parashkrimi i ekzekutimit të një titulli ekzekutiv nuk e bën të pavlefshëm titullin. Fakti që neni 128 i Kodit Civil, parashikon pamundësinë e debitorit për të kërkuar kthimin e shumës së paguar për përmbushjen e një detyrimi pas kalimit të afatit të parashkrimit i shërben agumentit, sipas të cilit e drejta subjektive vazhdon të jetë e vlefshme, por proceduralisht ajo nuk mund të realizohet nëpërmjet organeve të ekzekutimit të detyrueshëm²⁷⁰.

Duke qenë se parashkrimi i së drejtës së ekzekutimit është parashkrim i së drejtës së padisë në kuptimin material, që nuk sjellë shuarjen e së drejtës subjektive, për rrjedhojë nuk mund të pretendohet parashkrimi shues si shkak për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Pasi parashkrimi nuk shuan detyrimin, por të drejtën për të kërkuar ekzekutimin me forcën shtrënguese të shtetit²⁷¹, pra titulli në vetvete mbetet i vlefshëm. Në këto kushte, kalimi i afatit të parashkrimit, nuk mund të konsiderohet si një fakt që qëndron në themel të padisë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, por si një fakt vërtetimi i të cilit krijon bazë të mjaftueshme juridike për të kundërshtuar veprimet përmbartimore, si veprime të kryera në mungesë të kushteve ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm²⁷². Edhe pse përmbartuesi gjyqësor po ekzekuton një titull ekzekutiv të vlefshëm, por që është parashkruar, ai me veprimin e tij sjell pasojë duke vendosur në ekzekutim një titull ekzekutiv që nuk duhet të ekzekutohet nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit.

Ky i fundit me veprimet e tij i jep jetë një titulli të vlefshëm por që sipas ligjit është parashkruar dhe se si i tillë nuk duhet të vihet në ekzekutim, pra nuk mund të sjellë pasoja për palën debitorët. Ky qëndrim përforcohet akoma më tepër me argumentin se padia e pavlefshmërisë është një padi njohjeje dhe e vetmja mënyrë për të mos sjellë pasoja nga ekzekutimi i një titulli ekzekutiv të parashkruar është anulimi i veprimeve përmbartimore dhe pushimi i ekzekutimit të mëtejshëm të tij. Pasi padia sipas nenit 610 të K.Pr.Civile legjitimon ose nxjerr në pah paligjshmërinë e veprimeve përmbartimore duke e detyruar përmbartuesin për të kryer ose mos kryer një veprim të caktuar, ndërsa padia e pavlefshmërisë së titullit vetëm konstaton këtë fakt.

Padia për goditjen e një titulli ekzekutim mund të ngrihet gjatë procesit të ekzekutimit të një titulli ekzekutiv²⁷³, ende pa u ekzekutuar detyrimi. Prandaj kjo padi nuk mund të ngrihet pasi titulli ekzekutiv është ekzekutuar, pasi debitori nuk ka çfarë të pengojë me anë të kësaj padie. Por debitori mund të proçodojë me mjete të tjera ligjore mbrojtjen e të drejtave të tij.

²⁶⁹ Erjon Bani “Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të titujve ekzekutiv”, Tiranë 2012, faqe 76

²⁷⁰ Valentina Kondili, “E drejta Civile I” Pjesa e përgjithshme, Ribotim, Geer 2008, Faqe 282.

²⁷¹ Vendimi i Kolegjtit Civil të Gjykatës së Lartë nr.297, datë 01.10.2009

²⁷² Revista juridike nr.1 Marsela Dervishi “Parashkrimi i vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, efekti I tij në paditë që ngrihen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm”, botuar nga Shkolla e Magjistraturës, Tiranë Mars 2013

²⁷³ Vendimi i Kolegjtit Civil të Gjykatës së Lartë nr.353, date 15.07.2015

5.2.1. Legjitimi i palëve për të ngritur padinë e pavlefshmërisë së titullit

Në këtë padi, sipas paragrafit të parë të nenit 609 të K.Pr.Civile vetëm debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit të vendimit që titulli ekzekutiv të deklarohet i pavlefshëm. Vetëm debitori legjitimohet aktivisht dhe kreditori legjitimohet pasivisht, të cilët janë subjekte të marrëdhënies juridike procedurale që lind gjatë fazës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Këto subjekte jo gjithmonë janë të pandryshueshmë, përveç rastet e suksedimit të të drejtave, por me kusht që identiteti i tyre juridik nuk ndryshon. Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.403, datë 01.03.2005 ka sqaruar konceptin e legjitimitetit të palës paditëse. Kolegji sjellë në vëmendje paragrafit e II të nenit 609 të K.Pr.Civile dhe arsyetuar se: “kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve. Paditësi nuk e gëzon këtë të drejtë për shkak se nuk është debitor në vendimin që vihet në ekzekutim dhe as janë vërtetuar fakte të ngjara mbas dhënies së vendimit si titull ekzekutiv. Në rrethanat si më sipër paditësi ka ngritur një padi që nuk mund ta ngrinte²⁷⁴.”

Nga sa më sipër, mendojmë se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata e Lartë në lidhje me legjitimitetin e palës paditëse në procesin ekzekutiv është i drejtë. Paditësi jo vetëm duhet të vërtetojë faktin se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël, ose është shuar më pas, por duhet të gëzojë cilësinë e palës debitore. Në procesin e ekzekutimit mund të ketë edhe raste suksedimi në të drejta, si në rastet e riorganizimit apo mbarimit të personave juridikë ose në rast transferimi të të drejtave mbi pasurinë objekt ekzekutimi me trashëgimi ose me kontratë. Në këto raste të drejtat kalojnë nga paditësi ose i padituri në persona të tjerë.

Suksesorët në të drejtat e personave juridikë ose fizikë, ashtu sikurse mund të fillojnë procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të dhënë në favor të personit prej të cilit ata heqin të drejtat ose të ndërhyjnë në një proces të filluar, duke zenë vendin e kreditorit, po ashtu mund të zenë dhe vendin e debitorit të dalë nga procesi apo të bëhen palë e të përfshihen si subjekte së bashku me kreditorin apo debitorin fillestar. Verifikimi i legjitimitetit të palës është i rëndësishëm, pasi mungesa e tij passjell rrëzimin e padisë, të njëjtin qëndrim ka thesuar edhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj. Ku arsyeton se: “në gjykim është paraqitur në cilësinë e kreditorit Sh.M, ndërkohë që në procesin gjyqësor për të cilin është dhënë titulli ekzekutiv, kreditorin figuron Shoqëria I.T.T Kurbin. Pronar i pasurisë së shoqërisë së fituar në përputhje me ligjin nga të tretët është vetëm shoqëria. Në këtë rast jemi para suksedimit të të drejtave si pasojë e riorganizimit të personit juridik.²⁷⁵”

Koncepti i kreditorit dhe i debitorit në procesin e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor jo gjithmonë përputhet me konceptin e paditësit dhe të paditurit të procesit gjyqësor²⁷⁶.

²⁷⁴Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.403, date 01.03.2005

²⁷⁵Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.580, datë 12.11.2014

²⁷⁶Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.1, datë 07.01.2010 Me të drejtë, Kolegjit Civil ka arsyetuar se: *Në rigjykim gjykata duhet të verifikojë momentin e kalimit të pronësisë tek paditësat, dhe në varësi të këtij momenti dhe rregullave procedurale të vlerësojë pasojat juridike që u nënshtrohen paditësave ju*

Kreditori ose personi që rezulton si titullar i së drejtës së titullit ekzekutiv, objekt kundërshtimi, apo personi që heq të drejta nga kreditori që përmendet në këtë titull, në këtë gjykim thirret në cilësinë e personit të paditur. I padituri në padinë e pavlefshmërisë së titullit ka barrën e provës vetëm të vërtetë ekzistencën e titullit ekzekutiv, i cili përbënë një fakt krijues. Kjo pasi vetë titulli ekzekutiv si koncept juridik është krijuar për të treguar ekzistencën e një të drejte subjektive materiale të cënuar.

Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.147, datë 12.03.2015 ka arsyetuar se: “meqë pala e paditur nuk vërtetoi marrjen e kredisë nga paditësi, në këto kushte titulli ekzekutiv është “i paqenë”, rrjedhimisht i pavlefshëm dhe veprimet e përmbaruesit duhet fillimisht të pezullohen e pastaj pasi vendimi të marrë formë të prerë të anulohen si të tilla.”

Barra e provës, në bazë të nenit 12 të K.Pr.Civile, i takon paditësi që në këtë padi është debitor, i cili duhet të provojë faktin se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston²⁷⁷, ose ekziston në një masë më të vogël, ose është shuar më pas, rrethana këto që hyn në kategorinë e fakteve penguese dhe shuese.

5.2.2. Gjykata kompetente për gjykimin e padisë së pavlefshmërisë

Padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv është në disponibilitetin e kreditorit dhe debitorit, si subjektet kryesore të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Si një mjet për t'u mbrojtur nga çdo ekces i veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor dhe me qëllim të fundit për të siguruar garantimin e realizimit të ligjshmërisë të kësaj veprimtarie dhe të shtetit të së drejtës. Nën këtë logjikë, ligji i ka njohur gjykatës një vend të rëndësishëm gjatë kësaj faze në gjykimin e këtyre padive për të pasur një garanci më shumë për zbatimin e procesit të rregullt ligjor²⁷⁸. Kompetente për gjykimin e padisë për pavlefshmërinë e titullit është gjykata e vendit ku bëhet ekzekutimi i titullit ekzekutiv²⁷⁹. Kompetenca është një kusht procedural i vlefshmërisë së procesit gjyqësor dhe i akteve të realizuara gjatë tij. Në kuptimin që një gjykatë jokompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale.

Zbatimi i drejtë i dispozitave procedurale lidhur me kompetencën lëndore të këtij procesi gjyqësor ka rëndësi në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në mbështetje të nenit 42/1 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ ²⁸⁰. Kompetenca, ashtu si juridiksioni, përcaktohet në momentin e ngritjes së padisë mbi bazën e gjëndjes faktike që ekziston në momentin e ngritjes së

ka kaluar pronësia pas ngritjes së padisë, pavarësisht se ata nuk janë thirrur në atë gjykim, vendim i të cilit është vënë në ekzekutim, gjykata duhet të referojë në rregullat e parashikuara në nenet 200 e 451/a të K.Pr.Civile. Nëse rezulton se paditësat kanë fituar pronësinë para ngritjes së padisë, gjykata duhet të vlerësojë ekzekutueshmërinë e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kjo jo vetëm në lidhje me objektin ndaj të cilit duhet të kryhen veprimet përkatëse, por edhe ndaj subjektit apo subjekteve që gëzojnë të drejta mbi këtë objekt, të cilët, megjithëse kanë qënë pronarë të sendit, nuk janë thirrur në gjykimin e zhvilluar vendimi i të cilit është vënë në ekzekutim të detyrueshëm. Nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e paditësave janë probleme që i përkasin themelit të zgjidhjes së çështjes.

²⁷⁷Shihni vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.147, datë 12.03.2015

²⁷⁸Shihni për më tepër Vendim i Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë, Nr.30, dt. 11.01.2006

²⁷⁹ Shihni vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.333, datë 13.07.2010

²⁸⁰ Shihni vendimet nr.23/2009, nr.7/2009 dhe nr.31/2005 dhe nr.16/2012 të Gjykatës Kushtetuese

saj. Pra nuk kanë asnjë rëndësi ndryshimet e mëvonshme që mund të ndodhin gjatë procesit, të cilat mund të bëjnë që gjykatës t'i mungojë kompetenca²⁸¹.

Në ndryshim nga paditë e tjera²⁸², në të cilat rregulli i përgjithshëm është që kompetente është gjykata e vendbanimit të debitorit. Vetë dispozita 609 e K.Pr.Civile ka përcaktuar si gjykatë kompetente gjykatën e vendit ku do të ekzekutohet titulli ekzekutiv²⁸³. Proçesi i ekzekutimit të detyrueshëm është i dallueshëm nga ai i përmbushjes të drejtave dhe detyrimeve kontraktore, si nga pikëpamja e të drejtave dhe detyrimeve të palëve ashtu dhe nga ligji që rregullon këtë situatë juridike. Nuk duhet të konfundohet marrëdhënien e detyrimit, që është krijuar nga kontrata e kredisë, me atë procedurale, që është krijuar pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit dhe vënies në lëvizje, po prej saj, të shërbimit përmbarimor²⁸⁴.

Për të përcaktuar kompetencën tokësore në padinë e pavlefshmërisë së titullit ekzekutive, duhet të interpretohet në mënyrë sistematike dhe logjike nenet 516 dhe 609 të K.Pr.Civile²⁸⁵. Pavarësisht se kush është gjykata që lëshon urdhrin ekzekutiv, vendi i ekzekutimit të titullit është vendi ku parashikohet kompetenca e përmbaruesit gjyqësor, si organ kompetent për zbatimin e titujve ekzekutiv. Në praktikë ka ndodhur shpesh që palët për të kërkuar pavlefshmërinë e titullit i janë drejtuar si kompetente Gjykatës që kanë parashikuar në aktin noterial²⁸⁶ të lidhur midis tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Për rrjedhojë me të drejtë gjykata ka argumentuar se kompetenca në këto lloj padish për pavlefshmërinë e titullit, i takon gjykatës së vendit ku do të ekzekutohet titulli ekzekutiv.

Mendojmë se është i drejtë vendimi i Kolegji Civil, kur çmon se ligji procedural ka përcaktuar në mënyrë të posaçme gjykatën kompetente për kërkimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv sipas neni 609 i K.Pr.Civile. Ky përcaktim nuk mund të ndryshohet me marrëveshje midis palëve, pasi nuk jemi përpara rastit të kompetencës konkurruese ku paditësi ka të drejtën e zgjedhjes midis disa gjykatave kompetente në bazë të nenit 52 dhe 54 të K.Pr.Civile. Në të tilla rrethana gjykatë kompetente të vendit të ekzekutimit nuk mund të jetë tjetër veçse ajo që ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit²⁸⁷.

Përcaktimi i gjykatës kompetente në ngritjen e padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv i referohet pikërisht identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes që i shtrohet për gjykim, nëse ajo

²⁸¹ Ky interpretim është pranuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në Vendimin Nr.25, dt. 25.01.2011, në të cilin ndër të tjera shprehet se: *Ky Kolegj vlerëson se sa më sipër ka lidhje edhe me zbatimin dhe respektimin e parimit të ekonomisë gjyqësore, si dhe të përfundimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor. Në rast se gjykatat do të ndryshonin kompetencën tokësore sa herë që paditësi do të ndryshonte ndërgjyqësinë, atëherë do të ndodheshim përpara faktit që çështjet të mos përfundonin asnjëherë brënda afateve të arsyeshme ligjore, dhe pasojat që mund të vinin do të ishin të rënda dhe të pariparueshme, duke bërë që të çenoheshin neni 28 i K.Pr.Civile, si dhe nenet 6/1, 13 të KEDNJ.*

²⁸²Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.509, datë 15.11.2011 arsyeton se *vendi i ekzekutimit, bazuar në shkronjën "e" të nenit 510 dhe shkronjën "ç" të nenit 511 të këtij Kodi, në lidhje me rregullimet që përmban edhe Kodi Doganor për aktet që përbëjnë titull ekzekutiv, është territori ku shtrihet juridiksionin e saj gjyqësor Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.*

²⁸³Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.442, datë 11.07.2013

²⁸⁴Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.589, datë 24.10.2013

²⁸⁵ Erjon Bani cit, faqe 76

²⁸⁶Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.256, datë 11.04.2013

²⁸⁷Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.348, datë 04.06.2013

është e natyrës civile apo administrative si dhe statusit juridik të palëve që kjo padi i kundrejtohet. Ky problem ka gjetur trajtim edhe në praktikën e Gjykatës së Lartë. Në vendimin e tij Kolegji Administrativ ka konstatuar se: “ asnjë nga palët ndërgjyqëse në këtë gjykim, nuk ka statusin e një organi publik ose organi administrativ shtetëror.

Në mënyrë që zgjidhja e konfliktit midis tyre, të mund të ishte nën juridiksionin e gjykatës administrative si dhe brenda parashikimeve të nenit 7 të ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe mosmarrëveshjeve administrative”. Të dyja këto palë, janë subjekte të së drejtës private, ku pala paditëse është person fizik privat, ndërsa pala e paditur, është person juridik, i organizuar në formën e shoqërisë tregtare, e konkretisht, një shoqërie anonime. Pra, statusi juridik i palës së paditur, rezulton që të mos jetë ajo e një organi publik, por të jetë një subjekt i së drejtës tregtare. Në këto kushte, në vështrim të legjislacionit administrativ e atij tregtar, rezulton që pala e paditur nuk ushtron pushtet shtetëror, kështu që dhe aktet dhe veprimet e kryera prej saj, në rast se ato do të kundërshtohen nga subjekte të ndryshme nuk do të gjykohen nga gjykata administrative, por nga gjykata e zakonshme. I tillë është rasti kur kërkohet të deklarohet pavlefshmëria absolute e titullit ekzekutiv, faturë e lëshuar nga O.S.H.E.E sh.a”²⁸⁸.

5.2.3. Shkaku i padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv

Shkaku ligjor i padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv qëndron në të drejtën e debitorit²⁸⁹, që parashikohet në nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile, për t’u çliruar nga një detyrim i cili rrjedh nga titulli ekzekutiv, për shkak të mospërputhjes ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutiv, me realitetin që ekziston efektivisht²⁹⁰, kur e drejta e kreditorit nuk ka ekzistuar si e tillë që në origjinë ose për fakte shues ose formuar të ngjara pas formimit të titullit.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka parashtruar në vendimin e tij nr. 134, datë 05.03.2015 se: “ pala e paditur, në kohën kur ka ndodhur fakti i pretenduar nuk kishte të drejtë dhe as legjitimohet që të demin e mundshëm ekonomik të shkaktuar nga mos faturimi i energjisë elektrike, ta pasqyronte këtë energji në faturën e energjisë elektrike si zë të mëvetësuar dhe të ngarkonte subjektin e furnizuar me energji elektrike, për rastin paditësen e këtij gjykimi, me detyrime për pagim me anë të faturës të energjisë elektrike, që sipas ligjit nr.8662, datë 18.09.2000 është titull ekzekutiv.”²⁹¹ Pra, siç shihet, shkak për ngritjen e kësaj padie behet mospërputhja që ekziston mes

²⁸⁸Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr.00-2015-3336, datë 09.07.2015 me palë padiëse: K.B dhe i paditur: O.S.H.E.E sh.a, me objekt: Pavlefshmëri titulli ekzekutiv në formën e faturës tatimore për periudhën mars 2014, datë 10.04.2014 për periudhën 28.02.2014 – UV.4 nr.faturës 609504146 me nr.matësi 200810501 me kod nr.Kontrate FIOA 020052042236 në emër të Kastriot Brahimmuço në vlerën 14,813,20 lekë së bashku me kamatat pasi ky detyrim nuk ekziston.

²⁸⁹ Shihni vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.00-2014-3886, datë 29.12.2014

²⁹⁰ Shihni vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.375, datë 12.02.2015

²⁹¹ Shihni vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.134, datë 05.03.2015

te drejtës së pasqyruar në një titull ekzekutiv me gjendjen faktike, të drejtës që ekziston konkretisht²⁹².

Në parim titulli ekzekutiv, përsa kohë shoqërohet me urdhërin e ekzekutimit konsiderohet *prima facie* i vlefshëm për t'u ekzekutuar, por kjo nuk përjashton mundësinë që ai të jetë prekur nga vese të tilla që e bëjnë atë të pavlefshëm²⁹³. Shkaqet e pavlefshmërisë ose veset e titullit ekzekutiv mund të jenë shkaqe që lidhen me formën dhe shkaqe që lidhen me përmbajtjen. Pavlefshmëria për shkak të formës lidhet me aktin që përmban detyrimin që ekzekutohet. Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv qëndron pikërisht në mospërputhjen ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutiv, me realitetin që ekziston efektivisht. Nëse kundërshtohet titulli ekzekutiv nëpërmjet deklaratimit të pavlefshëm të tij, kërkohet të kundërshtohet plotësisht ose pjesërisht e drejta e përfshirë në të²⁹⁴.

Pavlefshmëria për shkak të formës rrjedh nga fakti se akti nuk e ka cilësinë e titullit ekzekutiv ose e ka humbur këtë cilësi. Kolegji Civil evidenton se konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një vendimi gjyqësor, sipas tij kjo mund të ndodhë: “vetëm në raste ekstreme ku përfshihen veçanërisht inekzistenca e vendimit (mungesa e nënshkrimit të tij nga gjyqtari, gjykimi a shpallja e vendimit nga një person jo gjyqtar apo organ jashtë sistemit gjyqësor, vërtetimi i përpilimit kriminal të një akti të tillë nëpërmjet falsifikimit në formë, përmbajtje e nënshkrime), mungesa totale e arsytimit, kundërshtia e hapur e arsytimit me disponimin në vendim²⁹⁵.”

Ndërsa shkaqet e pavlefshmërisë që lidhen me përmbajtjen e titullit ekzekutiv, janë fakte që kanë të bëjnë me detyrimin e parashikuar në titull. Kështu ky detyrim mund të rezulojë se nuk ekziston, ekziston në një masë më të vogël ose është shuar. E drejta është një koncept juridik dinamik, e cila me kalimin e kohës ndryshon, ajo mund të shuhet, ndryshohet, ripërtërihet, kompensohet. Në këto kushte, nëse do të kundërshtohet titulli ekzekutiv për pavlefshmëri do të kundërshtohet dhe e drejta e përfshirë në të. Pikërisht nga ky unitet i titullit të ekzekutimit dhe i së drejtës së përfshirë në të rrjedhin dhe pasojat të cilat kanë lidhje me kundërshtimin që i bëhet titullit.

Kolegji Civil vlerëson se në gjykime të këtij lloji përveç mungesës së të drejtës të përfshirë në titullin ekzekutiv, debitori, mund të pretendojë dhe të parashtrijë dhe ndryshime që mund të kenë ndodhur për shkaqe të tjera dhe të mëvonshme. Shkaqe që kanë ndikuar mbi urdhërueshmërinë e titullit, siç mund të jetë pagimi i plotë apo i pjesshëm i detyrimit, apo çdo shkak tjetër i shuarjes ose i ndryshimit të së drejtës që përfaqëson titulli ekzekutiv.²⁹⁶

5.2.4 Dallimi i shkaqeve sipas llojit të titullit ekzekutiv

²⁹²Shihni vendim i Kolegji të Civil Gjykatës së Lartë, nr.00-2010-815 i Vendimit (214), dt. 06.05.2010.

²⁹³Shihni vendimi Unifikues i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.272, datë 10.06.2010

²⁹⁴Vendimi Unifikues i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.4, datë 29.01.2003

²⁹⁵Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.81, datë 22.02.2011, i njëjti qëndrim është mbajtur ne Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.580, datë 12.11.2014

²⁹⁶Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.297, datë 01.10.2009

Normalisht me anë të padisë së pavlefshmërisë, mund të goditet çdo titull ekzekutiv, megjithatë nga përmbatja e nenit 609, del se ekziston një ndryshim ndërmjet vendimit gjyqësor si titull ekzekutiv dhe të gjithë titujve të tjerë ekzekutiv²⁹⁷. Kodi i Procedurës Civile në varësi të llojit të titullit që goditet gjyqësisht ka përcaktuar edhe një regjim të posaçëm kundërshtimi gjyqësor. Normalisht me anë të padisë së pavlefshmërisë, mund të goditet çdo titull ekzekutiv, megjithatë nga përmbatja e nenit 609, del se ekziston një ndryshim ndërmjet vendimit gjyqësor si titull ekzekutiv dhe të gjithë titujve të tjerë ekzekutiv²⁹⁸.

Në varësi të llojit të titullit ekzekutiv që do të zbatohet, ligji bënë një dallimi edhe të shkaqeve të kundërshtimit të tij. Kur objekti i gjykimit janë të llojit vendime gjyqësore të formës së prerë që përmbajnë një detyrim, paditësi për të kundërshtuar këto lloje titujsh ekzekutiv, duhet të evokojë vetëm ato që kanë ngjarë pas dhënies së vendimit gjyqësor të formës së prerë titull ekzekutiv e jo ato të ndodhura përgjatë harkut kohor kur po formësohej urdhshmëria e titullit apo vetë titulli²⁹⁹. Këto fakte nuk implikojnë gjykatën që shqyrton padinë në një proces rishqyrtimi të ligjshmërisë së zgjidhjes në themel të atij vendimi apo të respektimit të ligjit procedural, sepse këto të fundit mund të ngrihen vetëm në rrugën e kundërshtimit të atij vendimi³⁰⁰.

Në këtë vështrim, nëse kundërshtohet titulli ekzekutiv nëpërmjet deklarimit të pavlefshmërisë së tij, në thelb kundërshtohet tërësisht ose pjesërisht vetë e drejta subjektive e përfshirë në të³⁰¹. Mendojmë se ky regjim juridik i ndarjes së shkaqeve për të cilat mund të atakohet një titull ekzekutiv i tillë është rrjedhojë e drejtëpëdrejtë e autoritetit ligjor të gjësë së gjykuar që ka në këtë rast vendimi gjyqësor i formës së prerë.

Megjithatë jo çdo lloj shkak i ngjarë pas dhënies së një vendimi të formës së prerë mund të passjell goditjen e titullit, nuk mund të jenë kurrësi ato fakte për shqyrtimin e të cilave ligjërisht janë kompetente gjykata e apelit ose Gjykata e Lartë³⁰². Në gjykimet me objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, përveç sa thamë më lart për mungesën e së drejtës, mund të parashtrihen edhe ndryshimet që kanë ndodhur për shkaqe të tjera dhe të mëvonshme se ato që kanë ndikuar mbi urdhërueshmërinë e titullit, siç mund të jetë pagimi i detyrimit, apo çdo shkak tjetër i shuarjes ose i ndryshimit të së drejtës që përfaqëson titulli.³⁰³

Fakte të tilla janë përmbushja, parashkrimi apo shuarja e detyrimit (debisë), falja, përzierja apo kompensimi i detyrimit, formimi i një detyrimi të ri të ndryshëm nga detyrimi origjinal³⁰⁴. Ankimi dhe rishikimi janë mjete procedurale që debitori ka në dispozicion dhe mund t'i përdorë për mbrojtjen e interesave të tij, në fazën para ekzekutimit të detyrimit. Neglizhenca e debitorit për t'i përdorur këto mjete në kohë, mund duhet të çënojë inetresat e kreditorit gjatë ekzekutimit. Jo çdo shkak i ngjarë mbas dhënies së vendimit mund të shuaj të drejtën subjektive me fuqi

²⁹⁷ Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol ÇOMO, *Vështrim krahasues mbi procedure civile*, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë 2006;

²⁹⁸ Ibidem fq. 354;

²⁹⁹ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.16, datë 22.01.2008

³⁰⁰ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.580, datë 12.11.2014

³⁰¹ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.180, datë 02.04.2015

³⁰² Erjon Bani cit, faqe 74

³⁰³ Shihni për më tepër Vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.36, dt. 19.02.2009.

³⁰⁴ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.81, datë 22.02.2011

ekzekutuese. Nën një përcaktim dhe konkluzion përjashtues mund të themi se, nuk mund të jenë kurrësi ato fakte për shqyrtimin e të cilave janë ligjërisht janë kompetente gjykatat e apelit³⁰⁵ apo Gjykata e Lartë³⁰⁶ apo shkaqet që përlligjin ngritjen e një mjeti të jashzakonshëm ankimi sikur është kërkesa për rishikim³⁰⁷.

Nëse do të lejohej që të goditej titulli ekzekutiv, vendim gjykate edhe për rrethana apo fakte të cilat kanë ndodhur përpara se të marri formë të prerë vendimi, do të kishim një cënim të parimit të gjësë së gjykuar. Mendojmë se është i drejtë qëndrim i mbajtur nga Gjykata e Lartë në vendimin e dhënë: “duke arsyetuar se kërkimet dhe pretendimet e palës paditëse janë bazuar e parashtruar tërësisht mbi fakte, rrethana dhe shkaqe, të cilat nuk kanë ekzistuar përpara nxjerrjes së aktit, vendimit gjyqësor që përbën titullin ekzekutiv. Si shkak i pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv është vetë vendimi për plotësim për shkak se ka karakter detyrues për paditësit debitorë edhe pse është dhënë pa u thirrur në gjykim shtetasit R.M dhe F.M. Në të tilla rrethana ky vendim nuk sjell pasoja për ta, neni 313 i K.Pr.Civile.”³⁰⁸”

Debitori mund të kërkojë pavlefshmërinë e titullit duke parashtruar vetëm fakte dhe ngjarje me anën e së cilave kundërshtohet ekzekutimi i asaj që është shprehur me përpara në titullin ekzekutiv. Kjo ndikon mbi të drejtën procedurale të ekzekutimit të detyrueshëm, pra mbi vete titullin ekzekutiv³⁰⁹. Pretendimi se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, për shkak se mbas hyrjes në fuqi të një ligji, i cili përmban një të drejtë më të vogël në masë dhe në sasi, është i pabazuar në ligj, pasi cënon parimin e ndarjes së pushteteve atë të sigurinë juridike dhe cënon të drejtat e fituara dhe gëzimin e të tyre.

Çdo titull ekzekutiv që nuk është një “vendim gjyqësor” ose “ një vendim arbitrazhi”³¹⁰, mund të kundërshtohet si për fakte të ndodhura gjatë formësimit të titullit ashtu edhe për fakte shuese apo penguese të ngjara pas marrjes formë të prerë të këtyre vendimeve. Në thelb, një ndër shkaqet për kërkimin e pavlefshmërisë së titullit ekzekutive dhe nëse ai nuk është formësuar formalisht lidhet me atë situatë kur detyrimi që qëndron në bazë të tij e për shkak të të cilit po kryhen veprime përmbartimore nuk ekziston.

Shkaqet që mund të shkaktojnë pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv lidhen *me atë situatë* kur kemi paligjshmëri në objekt (kur titulli ekzekutiv është i paligjshëm), *në subjektet* (kur thirret si debitor një person që në fakt nuk është i tillë) apo *në përmbajtje*. Kjo e fundit ka të bëjë me faktin se detyrimet e përcaktuara në titullin e ekzekutimit janë në vetvete të paligjshme. Kur si shkak për goditjen e titullit ekzekutiv do të përdorim “shuarjen e detyrimit” duhet të mbajmë parasysh edhe

³⁰⁵ Shiko Nenin 467 të K.Pr.Civile.

³⁰⁶ Shiko Nenin 472 të K.Pr.Civile.

³⁰⁷ Shiko Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr.73, date 21.01.2013, në të cilin: *Gjykata vlerëson se shkak që paditësit evokojnë në thelb ka të bëjë me një vendim gjyqësor të formës së prerë, që deklaroi rishtazi se, një nga provat thelbësore, që është vënë në themel të titullit të pronësisë së kreditorit, është i fallifikuar, dhe ky fakt ka ngjarë në Nëntor 2012, fakt i qartë i ndodhur pas dhënies së vendimit titull ekzekutiv. Ky fakt ligjërisht dhe proceduralisht mund të krijojë premisat e ekzistencës së një shkak ligjor për të ndërmarrë iniciativën ligjore të nisjes së një procedure të jashzakonshme ankimi, sikur është kërkesa për rishikim, që regjohet nga neni 494 të Kodit të Procedurës Civile.*

³⁰⁸ Shihni vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.353, date 15.07.2015

³⁰⁹ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.297, datë 01.10.2009

³¹⁰ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.76, date 09.02.2012

legjislacionin e posaçëm që rregullon marrëdhënien juridike konkrete midis palëve që gjenden në titullin ekzekutiv³¹¹.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj kur ka asyrtuar se: “në bazë të nenin 236/3 të Kodit Doganor, duke qenë se pala paditëse ka marrë njoftim për borxhin doganor pas kalimit të afatit 3 vjeçar të parashikuar në këtë dispozitë. Në kuptim të dispozitës së sipërcituar, edhe nëse ka ekzistuar ky detyrim doganor, palës së paditur i ka humbur e drejta për t’a kërkuar atë. Pra, mjafton ekzistenca e këtij shkakut ligjor që të arrihet në përfundimin se detyrimi i palës paditëse ndaj Degës së Doganës Durrës nuk ekziston dhe për rrjedhojë çdo akt i nxjerrë nga ana e paditur në lidhje me këtë borxh doganor të pretenduar si të tillë, në kushtet kur cënon të drejtat dhe interesat e ligjshme të palës paditëse, duhet të konsiderohet i pavlefshëm.³¹²”

Kur titulli ekzekutiv është një akt administrativ, duhet të mbahen parasysh edhe veçantitë që burojnë nga natyra administrative e aktit³¹³, mënyra dhe procedura e nxjerrjes dhe kundërshtimit të aktit administrativ. Nëse akti administrativ që përbën titull ekzekutiv apo aktet administrative që i paraprijnë titullit ekzekutiv, janë formësuar, shqyrtuar dhe konfirmuar rregullisht, titulli ekzekutiv mund të kundërshtohet sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile vetëm për pavlefshmëri absolute të aktit. Po ashtu për mungesë apo pavlefshmëri të njoftimit të aktit subjektit debitor, për parashkrim të detyrimit, për identifikim të gabuar të subjektit debitor, për identifikim të gabuar të sendeve që i nënshtrohen ekzekutimit sepse nuk i përkasin subjektit tatimor. Titulli mund të kundërshtohet edhe për rastet kur masa e detyrimit (debisë) të caktuar në aktin administrativ që ekzekutohet, më pas është pakësuar ose shuar si pasojë e disponimeve përkatëse mbi atë detyrim që përmbahen në akte e vendime të tjera administrative apo gjyqësore.

Pra, aktet goditen vetëm për fakte të ngjara pas nxjerrjes së aktit. Në thelb padia e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, bazuar në nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të shërbejë për të anashkaluar juridiksionin administrativ. Pra, nëse shkaqet që ngrihen në këtë padi lidhen me fakte të ngjara para dhe gjatë nxjerrjes së aktit administrativ dhe mbi të cilat ky akt është bazuar, atëhere rruga e ankimit administrativ dhe pastaj gjyqësor të këtyre akteve nuk mund të anashkalohej. Ndryshe qëndron çështja nëse pasi akti administrativ është bërë titull ekzekutiv, kanë ndodhur fakte që e kanë pakësuar ose e kanë shuar atë. Në këtë rast padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv do të mund të ngrihet rregullisht. Përrjashtim bëhet vetëm në rastet kur padia motivohet mbi pavlefshmërinë absolute të aktit apo mbi mungesën apo pavlefshmërinë e njoftimit të aktit që kundërshtohet³¹⁴.

Padia e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv, bazuar në nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të shërbejë si mundësi për të anashkaluar rrugën e ankimit gjyqësor ndaj aktit administrativ. Nëse në gjykim kërkohet pavlefshmëria e aktit administrativ si titullit ekzekutiv, ky

³¹¹ Erjon Bani cit, faqe 75

³¹² Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.272, datë 10.06.2010

³¹³ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.285, date 04.02.2015

³¹⁴ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.76, date 09.02.2012

kërkim nuk mund të ngrihet mbi pretendime të bazuara në motive që i përkasin pavlefshmërisë relative të aktit administrativ.³¹⁵

Një akt noterial për pagimin e detyrimeve në të holla, ose një kambial apo titull tjetër ekzekutiv, mund të goditet për shkak se detyrimi i përmbajtur në to është i stimuluar, ose është marrë përsipër nën ndikimin e mashtrimit, kanosjes ose lajthimit apo nga nevoja e madhe, se për shkak se debitori nuk ka pasur zotësi për të vepruar.³¹⁶ Në praktikën e saj Gjykata e Lartë ka argumentuar pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv për shkak të mungesës së formës. Duke argumentuar se: “Mungesa e nënshkrimit të noterit përpara të cilit është deklaruar vullneti i lirë i paditësit E.M në deklaratën noteriale nr.247.rep, nr.35 kol., datë 14.01.2005, përbën një shkak ligjor i cili e bën nul atë deklaratë. Vetëm vendosja e vulës së noterit në këtë deklaratë noteriale nuk është e mjaftueshme për t’u cilësuar atë si akt noterial. Përmbajtja e gërmës “f” të nenit 49 të Ligjit nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë” kërkon domosdoshmërisht edhe nënshkrimin e noterit.³¹⁷ Kjo për faktin pasi forma në aktin noterial përbënë elementë të përmbajtjes së tij dhe nëse mungon forma atëherë mungon akti për rrjedhojë mungon titulli ekzekutiv. Në këtë mënyrë debitori legjitimohet të kërkoj pavlefshmërinë e titullit sipas nenit 609 të K.Pr.Civile.

5.2.5. Llojet e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv dhe dallimi midis tyre

Sipas kuptimit të nenit 609 të K.Pr.Civile, kemi të bëjmë me dy lloj pavlefshmëri, pavlefshmëri absolute ose relativ, në varësi të rrethanave që kanë ndodhur nga momenti i formimit të titullit ekzekutiv deri në momentin që kërkohet ekzekutimi. Si të tilla mund të përmendim rastet kur titulli nuk ka ekzistuar apo është absolutisht i pavlefshëm, ose kur titulli ka ekzistuar por më pas është shfuqizuar, ka humbur fuqinë ekzekutive apo është deklaruar relativisht i pavlefshëm në një procedim administrativ apo në një gjykim tjetër.

Duke iu referuar rastit të pavlefshmërisë së vendimit gjyqësor kur titulli nuk ka ekzistuar, praktika gjyqësore³¹⁸ ka arsyetuar se përjashtimisht, pavlefshmëria e vendimit gjyqësor mund të kërkohet si në rrugën e ankimit, ashtu edhe me kërkesëpadi, vetëm nëse pretendohet se vendimi gjyqësor është inekzistent. Pra, nuk mund të bëhet fjalë për vendim gjyqësor të pavlefshëm nëse ai vendim është dhënë nga një gjykatë e juridiksionit gjyqësor, por që nuk ishte kompetente nga pikëpamja lëndore apo tokësore. Cënimi i vendimit për këtë shkak nuk lidhet me pavlefshmërinë e tij, por me zbatim të gabuar të ligjit në përcaktimin e kompetencës lëndore e tokësore. Kjo, sepse dhënia e vendimeve prej gjykatës jo kompetente, i jep të drejtën palës që, në ankimin drejtuar gjykatës më të lartë kundër tij, vetëm të ngrejë pretendimin për prishjen e atij vendimi sepse është dhënë nga gjykata jo kompetente duke e dërguar çështjen për rishqyrtim pikërisht në gjykatën kompetente.

³¹⁵Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.169, datë 05.03.2013, I njëjti qëndrim është mbajtur edhe në Vendimin nr.544 datë 28.10.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr.550 datë 28.10.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

³¹⁶Alqivjadh Lamani, Proçedura Civile e Republikës Popullore Socialiste” Tiranë 1961 fq. 296-297

³¹⁷ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.170, datë 13.04.

³¹⁸Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.398, datë 27.09.2011

Kur vetë pala paditëse, ka pranuar ekzistencën e detyrimit në një masë me të vogël, në këtë rast konkret argumentojmë se kërkesa sipas 609 të K.Pr.Civile është për pavlefshmëri relative³¹⁹. Veprimet juridike relativisht të pavlefshme, janë të vlefshme derisa gjykata me kërkesën e të inetersuarit i shpall të pavlefshme. Duke qënë se pavlefshmëria relative e veprimeve juridike lidhet me afate parashkrimi, duhet të mbahet parasysh edhe afati i parashikuar në nenin 103 të Kodit Civil³²⁰.

5.2.6. Kërkesa për pezullim të veprimeve përmbaremore parashikuar në nenin 609 të K.Pr.Civile³²¹

Në vitin 2013 janë rikonceptuar paditë në dispozicion të kreditorit dhe debitorit gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, sidomos në lidhje me masat e veçanta të përkohshme procedurale, që pezullonin përkohësisht ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv vendime gjyqësore të formës së prerë. Në paragrafin e tretë të nenit 609 të K.Pr.Civile, përcaktohen rregulla dhe kriteret që duhet të mbahen parasysh nga palët për të kërkuar marrjen e masës së pezullimit të ekzekutimit të vendimit. Por si rregull formulimi i saktë do të rekomandonim që të ishte marrja e masës së pezullimit të titullit ekzekutiv. Marrja e masës së sigurimit në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, është parashikuar nga legjislatori me qëllim që “të mbahet gjendja ashtu siç është” apo “të ngrirë³²²”, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit. Për vetë natyrën e çështjes padia e pavlefshmërisë së titullit duhet të realizohet nëpërmjet një procedurë të shpejtë dhe relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur, gjithësesi, që të respektohet një standard i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor.

Me ndryshimet që pësoi ligji procedural, masat e përkohshme procedurale nuk kanë legjitimitet për të vijuar ekzekutimin kur gjykata me vendim të përfundimtar disponon rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj apo prova dhe kur gjykata me vendim jopërfundimtar disponon pushimin e gjykimit për një nga shkaqet që ligji liston. Ligji procedural sipas këtij ndryshimi shkon edhe më tej sa t’a konsiderojë rrëzimin e padisë apo vendimin jopërfundimtar si shkak për shuarjen *ipso legge* të masës së përkohshme e jo si shkak që i jep jetë vendimit të ndërmjetëm të gjykatës për heqjen e saj³²³. Në nenin 609 të K.Pr.Civile legjislatori nuk ka arritur t’a ruajë dallimin e institutit të rënies *ipso legge* të masës dhe heqjen e masës si disponim gjyqësor që

³¹⁹Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.1655, datë 25.06.2012

³²⁰Neni 103 i Kodit Civil parashikon se: “Padia për të kërkuar që një veprim juridik të shpallet i pavlefshëm parashkruhet brenda pesë vjetësh.”

³²¹ Neni 609 i K.Pr.Civile parashikon: *Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar më pas. Kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor ose vendim arbitrazhi, debitori mund të kundërshtojë ekzekutimin e titullit vetëm për fakte të ngjara pas dhënies së këtyre vendimeve. Në këto raste, gjykata shqyrton çështjen brenda 5 ditëve dhe mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.*

³²²Vendimi i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.10, datë 24.03.2004

³²³https://www.academia.edu/28882260/Kontroll_kushtetues_incidental_mbi_nenin_210_dhe_211_te_Kodit_te_Proc_edures_Civile, autor Florian Kalaja fq. 27

realizon gjykata rast pas rasti kur bie procesi apo dyshimi i arsyeshëm se e drejta subjektive dhe rreziku eminent që kanos atë.

Në një rast të praktikës së saj Gjykata e Lartë³²⁴ ka sqaruar nocionin e sigurimit të padisë në lidhje me nenin 609 të K.Pr.Civile. Kur ekzekutimi i vendimit mund të bëhet i vështirë dhe pala që e ka vënë në lëvizje gjykatën, ka përmbushur kriterëve që kërkohen për të lejuar marrjen e masës së sigurimit, atëherë me të drejtë gjykata ka vendosur për pranimin e kërkesës. Kjo pasi ligjvënësi në nenin 609 të K.Pr.Civile, nuk ka ndaluar mundësinë e marrjes së masës së sigurisë për këtë lloj padie. Për rrjedhojë janë të zbatueshem si për çdo padi dispozitat e Kreut të IV të K.Pr.Civile, që rregullojnë sigurimin e padisë.

Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare, gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit, vetëm me garanci dhe për një periudhë jo më shumë se 3 muaj. Përveç rasteve kur gjykata, brenda këtij afati, vendos me vendim përfundimtar pranimin e padisë. Me kalimin e afatit 3-mujor, ose kur gjykata, brenda këtij afati, vendos refuzimin e padisë ose pushimin e gjykimit të saj, masa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit konsiderohet e rënë nga fuqia. Gjykata shqyrton kërkesat, sipas këtij neni, brenda 5 ditëve. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë³²⁵.

Natyra e posaçme e gjykimit të padisë me objekt pavlefshmëri titulli ekzekutiv, reflektohet edhe në afatet e shpejta brenda të cilave duhet të përfundojë edhe vetë gjykimi i themelit të çështjes. Për sa kohë këto janë çështje që shtrohen për gjykim në fazën e ekzekutimit dhe mbartin një potencial të lartë gjasash për të cënuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së dhe neni 42 i Kushtetutës³²⁶.

Marrja e një mase të tillë nga gjykata duhet vetëm në ato raste kur ajo krijon bindjen e plotë se ekzekutimi i menjëherëshëm i titullit ekzekutiv, do t'i shkaktonte pasoja të rënda dhe të pariparueshme debitorit. Masa e përkohshme e pezullimit të ekzekutimit duhet të shoqërohet, si rregull, me detyrimin e palës tjetër për dhënien e një garancie pasurore, në masën dhe llojin që çmohet nga gjykata e përshtatshme, për të mbuluar dëmet që mund t'i shkaktohen të paditurit nga pezullimi i ekzekutimit. Duke gjykuar në këtë mënyrë, gjykata zgjedh atë masë sigurimi të objektit të padisë që ajo e gjykon të përshtatshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të së paditurit³²⁷. Garancia do të ishte një mjet që do t'i shërbente kreditorit, nëse padia e ngritur nga debitorit do të rezultonte e pabazuar në prova dhe ligj.

³²⁴ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.690, datë 22.05.2007 ku ka arsyetuar se: *kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit mund të bëhet i vështirë dhe, meqënëse padia dhe pala që e ka vënë në lëvizje gjykatën, ka rezultuar se ka përmbushur kërkesat e nenit 202/1, 2 e 203 të K.Pr.Civile, sa i takon kriterëve që kërkohen për të lejuar marrjen e masës së sigurimit, me të drejtë ka pranuar kërkesën e paraqitur. Kjo pasi në nenin 609 të K.Pr.Civile, baza ligjore mbi të cilën ngrihet padia, ndonëse është një dispozitë e posaçme, ligjvënësi nuk ka parashikuar në vetvete ndalimin për lejimin e masës së sigurisë për këtë lloj padie, në këtë kuptim, janë të zbatueshem si për çdo padi dispozitat e Kreut të IV të K.Pr.Civile, që rregullojnë sigurimin e padisë, siç edhe janë zbatuar nga gjykata.*

³²⁵Shihni nenin 44 të Ligjit 122/2013, I njëjti qëndrim është mbajtur edhe në Vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr.864 datë 15.04.2015

³²⁶ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.510, datë 25.11.2015

³²⁷ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.497, datë 27.11.2011

5.2.7. Afati i ankimit ndaj vendimit të gjykatës me objekt pavlefshmerinë e titullit ekzekutiv

Kodi i Procedurës Civile parashikon shprehimisht dhe rregullon mjetet e ankimit kundër vendimeve gjyqësore, afatet procedurale dhe mënyrën e llogaritjes së tyre³²⁸. Secili prej tyre, ka funksione, karakteristika dhe disiplinim të veçantë ligjor. Pra, ankimi si mjet juridik i zakonshëm i goditjes së vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, bazuar në afatin brenda të cilit duhet të ushtrohet, dallohet në: (i) *ankimin që duhet të bëhet brenda afatit 15 ditor e që shërben si mjet për të kundërshtuar vendimet përfundimtare dhe (ii) në ankimin e veçantë, që duhet ushtruar brenda afatit 5 ditor*³²⁹. Por gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, krahas vendimeve të tjera gjykata mund të marrë edhe vendim të ndërmjetëm ndaj kërkesave të palëve lidhur me sigurimin e padisë, për pezullimin ose jo të ekzekutimit të detyrueshëm, ndaj të cilëve *“mund të bëhet ankim i veçantë”*.

Padia për goditjen e titullit ekzekutiv është një padi e rregullt, e lidhur drejtëpërdrejtë me themelin e çështjes dhe si e tillë i nënshtrohet një gjykimi të zankoshëm dhe në fund të tij, gjykata shprehet me vendim përfundimtar. Në këtë kontekst afatet e ankimit të parashikuara nga neni 611 i K.Pr.Civile nuk aplikohen për shqyrtimin e një çështje me objekt pavlefshmëri të titullit ekzekutiv³³⁰. Nga përmbatja e nenit 609 dhe nga sa është interpretuar nga praktika e Gjykatës së Lartë arrijmë në konkluzionin se afatet e ankimit kundër vendimit përfundimtar i nënshtrohen afateve të përgjithshme të ankimit të parashikuara në nenin 443 të K.Pr.Civile, brenda 15 ditëve. Ndërsa ankimi i veçantë, sipas paragrafit të tretë të nenit 609 të K.Pr.Civile, lejohet vetëm kundër vendimit të ndërmjetëm që disponon mbi kërkesën e debitorit për pezullimin e vendimit, me ose pa garanci, dhe jo ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës. Mendojmë se afati i ankimit ndaj vendimi të gjyqësor për pavlefshëmërinë e titullit ekzekutiv duke zbatuar rregullin e përgjithshëm është ankimi i zakonshëm 15 ditor, të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata e Lartë në vendimin e saj nr.1210, datë 26.10.2006.³³¹

5.3. Padia për kundërshtimin e veprimeve përmbare si një mjet tjetër për mbrojtjen gjatë fazës së ekzekutimit

5.3.1. Vështrim i përgjithshëm

Për të mbrojtur intersat ligjorë të subjekteve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe për të shmangur dëmet që mund t’u vijnë subjekteve nga një ekzekutim jo në përputhje me ligjin, iu është njohur e drejta për të kundërshtuar aktet dhe veprimet e organeve që drejtojnë

³²⁸ Neni 442 K.Pr.Civile mjetet për t’u ankuar ndaj vendimeve të gjykatave janë: *Ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë, kërkesa për rishikim.*

³²⁹ Shihni Vendimi nr.256, datë 14.05.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

³³⁰ Shihni Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.347, datë 02.07.2015

³³¹ Shihni Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.1210, datë 26.10.2006, I njëjti qëndrim është mbajtur edhe në Vendimi nr.132, datë 05.03.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

proçesin e ekzekutimit. Kjo padi është një mjet që përdoret gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm dhe si e tillë është ndër paditë më të përdorura. Një mjet që parashikohet nga neni 610 e K.Pr.Civile dhe shërben si një garanci më shumë për zbatimin e proçesit të rregullt ligjor.

Padia për kundërshtimin e veprimeve të përmbauesit gjyqësor është një është mjet në duart e palëve, që ka për qëllim të kundërshtojë veprimet ose aktet procedurale që kryhen nga përmbauesi gjatë proçesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, ose kundër refuzimit të përmbauesit për të ekzekutuar një titull ekzekutiv. Në një proçedurë ekzekutimi të detyrueshëm organi përmbauesi vlerëson vetëm anën formale të titullit ekzekutiv dhe nuk i hyn vlefshmërisë së tij, aq më tepër kur titulli përbën një vendim gjyqësor të formës së prerë. Edhe gjykata në gjykime për kundërshtim të veprimeve përmbauesit shqyrton vetëm nëse veprimet e përmbauesit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv janë apo jo në përputhje me ligjin. Gjykata nuk mund t'i hyjë shqyrtimit të vlefshmërisë së titullit ekzekutiv kur nuk ka kërkesë sipas mënyrës së parashikuar në ligj. Kjo, për arsye se në një rast të tillë do të kishim cënim të parimit të sigurisë juridike dhe proçesit të rregullt ligjor³³².

Kjo padi shërben për të garantuar realizimin e ligjshmërisë të veprimtarisë përmbauesit dhe të mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës. Nëpërmjet këtij gjykimi nuk kontestohet e drejta e kreditorit, por kundërshtohet mënyra dhe ligjshmëria e zhvillimit të vetë proçesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, për shkak të mosrespektimit të ligjit në vendimmarrjen dhe veprimet e përmbauesit³³³. Në lidhje me dallimin e këtij mjeti nga padia e pavlefshmërisë, mendojmë se ndryshimi qëndron në atë çfarë palët synojnë të arrijnë me secilin mjet mbrojtës. Padia për goditjen e titullit ekzekutiv sipas nenit 609, të Kodit të Procedurës Civile ngrihet në fazën e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv. Me anë të kësaj padie mund të parashtrihen përpara gjykatës, në parim, shkaqe për të cilat titulli, pra e drejta e kreditorit, mund të kundërshtohet gjatë gjykimit të themelit apo për shkaqe që lidhen me shuarjen a pakësimin e detyrimit.

Nëse pretendimet e palës qëndrojnë në goditjen e titullit ekzekutiv për shkak të shuarjes apo pakësimit të tij duhet të ndrihet padia e pavlefshmërisë së titullit. Nëse pala pretendon se gjatë ekzekutimit të titullit ekzekutiv, përmbauesi gjyqësor nuk ka respektuar ligjin, duke vepruar në kapërcim të tij ose synon të mënjanoj cenimin e interesit të saj nga aktet e parregullta të përmbauesit kemi të bëjmë me padinë e kundërshtimit të veprimeve përmbauesit³³⁴. Në dallim nga padia për goditjen e titullit ekzekutiv, me padinë e kundërshtimit të veprimeve përmbauesit nuk kontestohet e drejta e kreditorit, por kundërshtohet mënyra e ligjshmëria e zhvillimit të vetë proçesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, për shkak të mosrespektimit të ligjit në vendimmarrjen dhe veprimet e përmbauesit.

³³² Shihni vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr.289, datë 15.04.2014

³³³ Shihni vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.580, date 12.11.2014

³³⁴ Shihni vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.609, date 20.11.2014 arsyeton se: *Në kërkesat e saj pala paditëse nuk ka qenë e qartë nëse kishte shkak për goditjen e titullit ekzekutiv, në bazë të nenit 609 të K.Pr.C, për shkak të shuarjes apo pakësimit të tij, apo nëse gjatë ekzekutimit të titullit ekzekutiv, përmbauesi gjyqësor nuk ka respektuar ligjin, në bazë të nenit 610 të K.Pr.C. Ndryshe, nga çfarë parashtrohet në rekurs, nuk mund të konsiderohet se është shuar detyrimi, në fazën e ekzekutimit, kur pretendohet se është sekuestruar pasuri me vlerë më të madhe, se vlera e detyrimit.*

5.3.2. Padia për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore

Padia e kundërshtimit deri para ndryshimeve ligjore të fundvitit 2008, nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është trajtuar si një ankim³³⁵, sikurse parashikojnë nenet 610/1 dhe 442/a të K.Pr.Civile. Ndryshimet e vitit 2008³³⁶, parashikuan se përmbaruesi gjyqësor thirret në këtë gjykim në cilësinë e palës së paditur dhe jo më si person i tretë, duke ndryshuar thelbësisht këtë mjet ligjor, gjë që u reflektua edhe në praktikën e gjyqësre³³⁷. Këtë fakt, e ka nënvizuar edhe Gjykata e Lartë në praktikën e saj, ku ajo arsyeton dallimin nga pikëpamja procedurale të mjetit të kundërshtimit të veprimeve përmbarimore prej palëve në proces, nga kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit prej të tretëve, kjo e fundit nuk bëhet me ankim në gjykatë, por me padi të rregullt, e cila në thelb është një padi rivendikimi (rei vindicatio), megjithëse e një lloji të veçantë³³⁸. Ndryshimet pasuan edhe me ligjin nr.122/2013³³⁹. Me këto ndryshime është e nevojshme që çdo dispozitë e veçantë, ku parashikohet ankimi ndaj veprimeve të përmbaruesit të interpretohet në mënyrë sistematike me nenin 610 të K.Pr.Civile, duke u bërë dallimi midis mjetit të ankimit dhe të drejtë së padisë.

Bazuar në kuptimin dhe ndarjen e padive sipas kriterit procedural, padia e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore, në varësi të kërimit në themel të saj, mund të përbushë elementet e një padie transformuese ose detyrimi. Kështu, kur kërkohet të kundërshtohen veprimet procedurale të përmbaruesit, paditësi nëpërmjet padisë, në thelb synon të ndryshojë një gjendje juridike, duke anuluar veprimet e paligjshme, të cilat prezumohen të ligjshme gjersa të ndërhyjë gjykata me vendim të formës së prerë. Ndërsa kur paditësi kundërshton refuzimin e përmbaruesit, në thelb synon që të merret një vendim detyrimi nga gjykata, ku kjo e fundit urdhëron përmbaruesin që të vijojë me ekzekutimin e titullit ekzekutiv³⁴⁰.

5.3.3. Legjitimi i palëve për të ngritur padinë e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore

Ligji ka ofruar një mjet procedural, padia e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore, e cila është në disponibilitet të kreditorit dhe debitorit, si subjektet kryesore të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, për t'u mbrojtur nga çdo tejkalim i veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor. Ligji i ka

³³⁵ Shihni Vendimin e Gjykatës së Lartë, Kolegjit Civil, Nr.204, datë 27.02.2007

³³⁶ Me ligjin nr. 10052, datë 29.12.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë. 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës"

³³⁷ Shihni vendimin e Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, Nr.214, datë 06.05.2010

³³⁸ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.366, date 30.09.2010

³³⁹ Neni 45 i ligjit nr.122, datë 18.04.2013 në të cilin parashikohet se : *Në fund të nenit 610 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje: "Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.*

³⁴⁰ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.1131, datë 17.02.2016

njohur gjykatës një vend të rëndësishëm gjatë kësaj faze në gjykimin e këtyre padive për të pasur një garanci më shumë për zbatimin e procesit të rregullt ligjor³⁴¹. Interesi për të ngritur padi rezulton nga marrëdhënia midis situatës së kundërligjshme që pretendohet dhe vendimit gjyqësor, që kërkohet të merret për të rregulluar këtë situatë nëpërmjet zbatimit të së drejtës në fuqi, marrëdhënie që domosdoshmërisht duhet të konsistojë në dobishmërinë e vendimit që kërkohet të merret³⁴².

Subjekte të marrëdhënies juridike procedurale janë debitori dhe kreditori, të cilët jo gjithmonë janë të pandryshueshëm. Më tepër rëndësi ka mos ndryshimi i identitetit të tyre juridik. Gjatë fazës së ekzekutimit mund të ketë edhe raste suksedimi në të drejta, si rastin e transferimit të të drejtave mbi pasurinë objekt ekzekutimi me trashëgimi ose me kontratë. Një rast të tillë ka trajtuar edhe praktika e Gjykatës së Lartë. Në vendimin e saj ka arsyetuar se në rastin kur kemi suksedim procedural, duhet mbajtur në konsideratë se Shoqëria tregtare I.T.T Kurbin është person juridik, e cila themelohet nga persona fizikë. Por ajo ka personalitetin e saj juridik dhe shfaqet si e tillë në qarkullimin civil. Pasuritë e saj të cilat i krijon, i fiton, kalon, transferon ose tjetërson gjatë ekzistencës së saj si shoqëri tregtare, janë në emër e për llogari të saj.

Ortakët apo përfaqësuesit ligjor nuk janë as pronarë dhe as bashkëpronar të pasurisë së shoqërisë. Pronar i pasurisë së shoqërisë së fituar në përputhje me ligjin nga të tretët është vetëm shoqëria. Duke mos trajtuar çështje të cilat kanë bëjnë me suksedimin procedural të të drejtave nga Shoqëria I.T.T Kurbin te përfaqësuesi ligjor i saj Sh.M. Nuk është analizuar drejtë pozita procedurale e palëve ndërgjyqëse, si në momentin e ngritjes së padisë, ashtu edhe në fazën e shqyrtimit gjyqësor të çështjes, për të përcaktuar legjitimitetin e tyre në këtë gjykim³⁴³. Për këtë arsye ka rëndësi përcaktimi i legjitimitetit aktiv dhe pasiv në ngritjen e padisë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore. Legjitimiteti konsiston jo vetëm në përcaktimin e personit të cilit i përket interesi për të ngritur padinë, por dhe në përcaktimin e personit kundrejt të cilit padia duhet të ngrihet në aspektin ligjor³⁴⁴.

Padia për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore ngrihet nga palët që janë kreditori e debitori, por edhe nga palë të tjera, që rast pas rasti pretendojnë se kanë interesa konkrete, efektive dhe aktuale me procesin e ekzekutimit, pra që me anë të kësaj padie synojnë të mënjanojnë cënimin e interesit të tyre nga aktet e parregullta të përmbaruesit³⁴⁵. Debitori, ka të drejtë të kundërshtojë çdo lloj veprimi të përmbaruesit, në momentin që ato kryhen dhe brenda afatit ligjor të parashikuar shprehimisht në ligj³⁴⁶. Në rast se nuk respektohet ky afat, atëherë padia duhet të rrëzohet pa i hyrë shqyrtimit të çështjes së ligjshmërisë ose jo të veprimit përmbarimore. Në një rast konkret të praktikës gjyqësore³⁴⁷ rezulton se pala paditëse, në cilësinë e debitorit, ka vepruar rast pas rasti nëpërmjet kërkesave periodike për saktësimin dhe shtimin e

³⁴¹ Shihni për më tepër Vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, Nr.00-2006-17 i Vendim (30), datë 11.01.2006

³⁴² Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.285, datë 08.07.2015

³⁴³ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.580, datë 12.11.2014 paditës: Këshilli i Qarkut Lezhë, i paditur: Sh.M, objekt: Pavlefshëmëri absolute e titullit ekzekutiv, vendim gjyqësor.

³⁴⁴ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.353, date 05.07.2011

³⁴⁵ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.609, datë 20.11.2014

³⁴⁶ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.136, datë 18.02.2016

³⁴⁷ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.658, datë 10.12.2014

objektit të kërkesë padisë, duke bërë objekt konflikti gjyqësor të gjitha veprimet e palës së paditur, Zyrës së Përmbarrimit. Gjykojmë të drejtë vendimin e Gjykata e Lartë, e cila ka kthyer çështjen për rigjykim duke arsyetuar se: “kërkesë padia nuk duhej rrëzuar nga gjykata e Apelit me argumentin se ajo është paraqitur tej afatit 5 ditor, duke analizuar dhe duke mbajtur në konsideratë vetëm veprimin përmbarrimor i cili konsistonte në vendosje e sekuestros konservative në Z.Rr.P.P, por duhet t’i ishte nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor për fakte të rëndësishme lidhur me afatin dhe procedurat mbi njoftimin e akteve dhe veprimeve të tjera përmbarrimore, objekt të këtij gjykimi.”

Kjo padi ngrihet jo vetëm në rastet kur parashikohet shprehimisht nga ligji, por edhe në ato raste kur palët dhe çdo subjekt i interesuar pretendon se nga zbatimi i gabuar i ligjit prej përmbauresit apo nga veprimet që ai po kryhen në rastin e rrethanat konkrete po i cënohen të drejta dhe interesa të ligjshme³⁴⁸. Kur faza e ekzekutimi të titullit ekzekutiv nuk kryhet midis palëve, debitorit apo kreditorit, por ndaj personave të tretë që nuk e kanë këtë cilësi, ata nuk mund të mbrohen ndryshe veçse duke kundërshtuar veprimet përmbarrimore, përndryshe mohohet e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Për këtë arsye koncepti i “palës” në kuptimin e nenit 610 të K.Pr.C duhet zgjeruar, pasi kundërshtimi i veprimeve përmbarrimore nuk është vetëm e drejtë e palëve pjesëmarrëse në konflikt.³⁴⁹ Si persona të tretë që gëzojnë legjitimitetin aktiv për të ngritur këtë padi, mund të paraqiten kreditorët e tjerë të debitorit, personat që janë bashkëpronarë me debitorin në sendin që sekuestrohet³⁵⁰, blerësi i sendit të sekuestruar³⁵¹, poseduesi i sendit të paluajshëm mbi të cilin kërkohet të vihet në posedim kreditori³⁵².

Gjykata e Lartë në vendimin e saj çmon se nuk duhet të ngatërrohet debitori, pra personi mbi të cilin rëndon detyrimi me personat të cilët mund të cënohen nga ekzekutimi i një detyrimi të tillë. Blerësit e sendit, në lidhje me pasojat e ekzekutimit të cilat do të rëndojnë edhe mbi ta, duhet të gjejnë mënyra të tjera mbrojtjeje për rivendosjen në vend të të drejtave të tyre të cilat faktikisht janë cënuar nga ish-pronari i pallatit K.A.³⁵³ Nga ana tjetër, legjitimitetin pasiv në padinë e kundërshtimit të veprimeve përmbarrimore e gëzon përmbarruesi gjyqësor shtetëror ose privat. Duke qenë se e drejta për të ngritur padi ushtrohet kundër një pale tjetër, ky duhet të jetë në mënyrë të saktë personi ndaj të cilit kjo padi duhet të ngrihet dhe ndaj të cilit vendimi gjyqësor do të shtrijë efektet e tij.

Legjitimiteti pasiv nuk është gjë tjetër veçse një aspekt i legjitimitetit për të vepruar, i cili i përket të paditurit, që në këtë padi është përmbarruesi gjyqësor, shtetëror ose privat, kundrejt të cilit ngrihet padia e parashikuar në neni 610 të K.Pr.Civile. Thirrja e përmbarruesit gjyqësor në cilësinë e të paditurit, ishte një ndryshim i drejtë dhe i bazuar, pasi pikërisht me këtë padi kundërshtohen veprimet ose mosveprimet e tij dhe thirrja e përmbarruesit si person i tretë do të ishte e gabuar dhe në kundërshtim me pozitën procedurale që duhet të marrin palët në këtë

³⁴⁸Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.81, datë 22.02.2011

³⁴⁹ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 73, datë 07.02.2002

³⁵⁰Neni 546 dhe 578 i K.Pr.Civile

³⁵¹Neni 559 dhe 575 i K.Pr.Civile

³⁵²Neni 603 i K.Pr.Civile

³⁵³ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.1, date 07.01.2010

gjykim. Kur ngrihet kjo padi, duhet të përcaktohet qartë se cili veprim konkret i përmbauesit gjyqësor, pretendohet se, nuk ka respektuar ligjin, duke respektuar afatin ligjor që parashikohet në dispozitë, brenda pesë ditësh nga dita e marrjes dijani.

5.3.4. Objekti dhe shkaku i padisë së kundërshtimit të veprimeve përmbaimore

Si një mjet procedural mbrojtje ku palët kundërshtojnë aktet e procesit të ekzekutimit që realizohen nëpërmjet kryerjes së veprimeve të përmbauesit gjyqësor. Objekt i padisë është ajo që kërkohet si efekt i padisë, d.m.th. zbatimi i ligjit dhe fitimi i asaj çfarë kërkohet e që vjen si pasojë e zbatimit të ligjit³⁵⁴. Objekti i padisë janë vetëm veprimet e përmbauesit gjyqësor ose refuzimi i tij për të kryer një veprim. Këto parregullësi formale ekzistojnë në ato raste kur aktet dhe sjelljet procedurale të përmbauesit përbëjnë zbatim të gabuar të ligjës procedurale civile, apo janë akte e sjellje të kryera nga përmbauesi duke zbatuar gabim ligjin procedural në çështjen konkrete që procedohet për ekzekutim³⁵⁵.

Në praktikën gjyqësore hasen formulime të objektit të kërimit të padive si kundërshtim i veprimeve përmbaimore në përgjithësi, pa specifikuar veprimin konkret dhe zgjidhjen konkrete të pasojës që kërkohet. Përcaktimi i saktë i objekti të padisë, pra identifikimi i veprimit përmbaimore konkret që kundërshtohet ka rëndësi, jo vetëm për sa i takon respektimit të afatit ligjor të kundërshtimit, por edhe në zgjidhjen konkrete të pasojës që do të vendoset nga gjykata.

Vetë dispozita 610 e K.Pr.Civile nuk liston se cilat janë veprimet e përmbauesit gjyqësor që mund të goditen me anë të këtij mjete ose që i referohen shprehimisht të drejte për ankim, por në disa dispozita procedurale përmendet shprehimisht e drejta për ankim³⁵⁶. Për këtë arsye bëhet edhe një ndarje midis ankimit që është parashikuar shprehimisht në dispozitat e ligjit dhe atij që nuk parashikohet shprehimisht. Kundërshtimi i veprimeve përmbaimore i referohet veprimeve të ekzekutimit të detyrueshëm të përmbauesit gjyqësor ose refuzimit për kryerjen e tyre, duke specifikuar konkretish veprimin që kundërshtohet dhe kërkimin shërues të situatës faktike që i kundërvihet së drejtës subjektive dhe që përbën shkakun ligjor të padisë.

Çdo veprim përmbaimore duke filluar nga vendimi për kalim në ekzekutim të detyrueshëm, që iu komunikohet palëve nga përmbauesi gjyqësor është objekt i kundërshtimit përmbaimore, brenda afatit 5 ditor nga nesërmja e komunikimit, përveç atyre veprimeve përmbaimore që ligji ka ndaluar shprehimisht ankimin. Mendojmë se veprimi i përmbauesit gjyqësor për lajmërim për ekzekutim vullnetar, hyn në ato veprime ndaj të cilave nuk mund të ngrihet padi sipas nenit 610 të K.Pr.Civile. Pasi ky veprim nuk është pjesë e fazës së ekzekutim të detyrueshëm dhe është një akt që e njofton palën debitore për fillimin e procedurës përmbaimore dhe nuk sjellë një pasojë të drejtëpërdrejtë siç është veprimi i vënies së sekuestros konservative.

Shkaku ligjor është arsyeja e kërimit gjyqësor, i cili ndahet në të drejtën dhe në një gjendje fakti që është kundër kësaj të drejte, d.m.th që e shkel, e cënon apo mohon të drejtën subjektive të

³⁵⁴Vendimi i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.9, datë 09.03.2006

³⁵⁵Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.81, datë 22.02.2011

³⁵⁶Neni 538, 544, 580, 606 i K.Pr.Civile

paditësit³⁵⁷. Shkaku për të cilin mund të kundërshtohen gjyqësisht veprimet e përmbaruesit lidhen kryesisht me parregullsitë procedurale që mund të vërehen gjatë kryerjes së tyre nga ana e përmbaruesit, ose me mungesën e kushteve që duhen për të proçeduar lidhur me ekzekutimin e një titulli ekzekutiv. Këto parregullsi formale ekzistojnë në ato raste kur aktet dhe sjelljet procedurale të përmbaruesit përbëjnë zbatim të gabuar të ligjit procedural civil, apo janë akte e sjellje të kryera nga përmbaruesi duke zbatuar gabim ligjin procedural në çështjen konkrete që proçedohet për ekzekutim³⁵⁸.

5.3.5. Gjykata kompetente për gjykimin e padisë së kundërshtimit të veprimeve përmbarimore

Kompetenca lëndore përcakton për çdo gjykatë të veçantë, se në çfarë rastesh dhe në lidhje me çfarë mosmarrëveshesh ajo ka pushtet për të gjykuar, duke përcaktuar qartë rrethin e mosmarrëveshjeve që i është njohur e dhënë asaj për ta gjykuar. Ajo është një kusht i domosdoshëm procedural që bën të vlefshëm procesin gjyqësor, si dhe të gjitha aktet e marra në administrim gjatë zhvillimit të tij, në kuptimin që një gjykatë jokompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale³⁵⁹. Në K.Pr.Civile³⁶⁰ është përcaktuar si gjykatë kompetente për shqyrtimin e paditë së kundërshtimit të veprimeve përmbarimore, gjykata e vendit të ekzekutimit dhe në gjykatën që ekzekuton vendimin³⁶¹.

Gjykata në përcaktimin e kompetencës lëndore i referohet pikërisht identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes që i shtrohet për gjykim, nëse ajo është e natyrës civile apo administrative. Për këtë qëllim gjykata i referohet shkakut ligjor të kërtimeve të paditësit të parashtruara, si në kërkesë padi ashtu dhe gjatë gjykimit si dhe bën lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cënuar.

Kur vihet në ekzekutim një titull ekzekutiv, që është një vendim gjyqësor i lëshuar nga Gjykata Administrative ose një vendim gjyqësor që ka zgjidhur një mosmarrëveshje të natyrës administrative³⁶², atëherë kjo gjykatë ka kompetencën të shqyrtojë mosmarrëveshjen në fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga një akt administrativ individual, duhet të jetë kompetente dhe për shqyrtimin e të gjitha

³⁵⁷Vendimi i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.9, datë 09.03.2006

³⁵⁸Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.658, datë 10.12.2014, i njëjti qëndrim mbahet në Vendimi nr.609, datë 20.11.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

³⁵⁹ Neni 61 K.Pr.Civile, neni 7 i Ligjit 49/2012

³⁶⁰ Neni 50 i K.Pr.Civile parashikon se paditë: "...që kanë për objekt kundërshtimin e veprimeve të kryera nga përmbaruesi për ekzekutimin e detyruar, ngrihen në gjykatën e vendit të ekzekutimit"

³⁶¹Vendimi i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.348, datë 04.06.2013

³⁶²Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-4160, datë 11.12.2014, i njëjti qëndrim Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-4260, datë 11.12.2014, i njëjti qëndrim është mbajtur në Vendimin: nr.308 datë 17.06.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

mosmarrëveshjeve që lindin gjatë fazës së ekzekutimit të tij³⁶³. Kjo situatë pasqyrohet edhe në praktikën e Kolegji Administrativ.³⁶⁴

Me “*vendi i ekzekutimit*” të detyrueshëm kuptohet vendi ku përmbushet diçka apo zbatohet një urdhërim ose një vendim, pra një titull ekzekutiv. Ky vend i përgjigjet vendit të banimit të debitorit kur ky është person fizik ose selisë së debitorit kur ky është person juridik ose vendit ku kryhen veprimtarinë e tij dhe ka pasuri të luajtshme apo të paluajtshme mbi të cilat do të shtrihen veprimet përbarimore gjatë procesit të ekzekutimit. Ndërsa *vendi i ekzekutimit të detyrueshëm* ka të bëjë me vendin ku do të zbatohet titulli ekzekutiv, pas lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit dhe vënies në lëvizje të shërbimit përbarimor; pra i përgjigjet një marrëdhënie procedurale të krijuar në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe jo marrëdhënies së detyrimit të krijuar nga kontrata apo ligji material³⁶⁵.

Kompetenca tokësore për gjykimin e këtyre mjeteve përcaktohet nga ligji, K.Pr.Civile. Në nenet 49 dhe 50 të këtij Kodi parashikohen rregullat e përgjithshme për përcaktimin e kompetencës tokësore gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë ka argumentuar se përcaktimit i kompetencës në pikëpamje territoriale në gjykimin e padisë për kundërshtim të veprimit përbarimor nuk varet nga vendi ku ushtron veprimtarinë përbaruesi gjyqësor privat. Ndryshe nga vendi ku ushtron veprimtarinë përbaruesi privat, vendi i ekzekutimit ka të bëjë me vendin ku do të zbatohet titulli ekzekutiv, pas lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit dhe vënies në lëvizje të shërbimit përbarimor, pra i përgjigjet një marrëdhënie procedurale të krijuar në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm³⁶⁶.

Sikurse është parashtruar më lart, kompetenca tokësore caktohet me ligj, por për raste përjashtimore ajo përcaktohet me marrëveshje të palëve dhe në rastin kur vendi i ekzekutimit nuk është i caktuar me ligj apo me marrëveshje ose kur nuk del nga vetë natyra e detyrimit që duhet përmbushur duhet të respektohen rregullimet e parashikuara në nenin 516 të K.Pr.Civile. Megjithatë, kjo kompetencë është e karakterit ekskluziv, sepse është vetë ligji që, në vartësi të llojit të ekzekutimit, përcakton edhe vendin se ku kryhen apo zbatohen urdhërimet e titullit ekzekutiv³⁶⁷.

Në rastin e kundërshtimit të titullit ekzekutiv që ka natyrë administrative, lënda është administrative dhe nuk mund të jetë e natyrës civile. Pasi vetë natyra e mosmarrëveshjes e cila shërben për të përcaktuar kompetencën nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e çështjes, është administrative. Në çdo rast, kur ndodhemi përpara gjykimit të një kërkesë me objekt kundërshtimi titulli ekzekutiv, nëse ai buron nga një mosmarrëveshje me natyrë administrative për pasojë edhe

³⁶³ Neni 66 i Ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

³⁶⁴ Shihni vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2015-2946, datë 16.07.2015, *me të drejtë arsyeton se: “nuk jemi para një konflikti civil mes personit fizik, A. M. dhe përbaruesit privat, sepse A. M. sipas përbaruesit gjyqësor i është vendosur gjoba prej 30,000 lekësh, pasi është person i ngarkuar me ligj, me cilësinë e titullarit të institucionit, Këshillit të Qarkut Durrës, për të ekzekutuar vendimin gjyqësor, për të rikthyer në punë D. L. dhe nuk e ka ekzekutuar. I njëjti qëndrim është mbajtur në Vendimin: nr.3704 datë 13.11.2014 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.*

³⁶⁵ Vendimi i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-3248, datë 19.11.2014

³⁶⁶ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.580, datë 22.10.2013

³⁶⁷ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.589, datë 24.10.2013

gjykimi i saj (padi së për kundërshtimin e titullit ekzekutiv) do të duhet të ndjekë të njëjtin fat³⁶⁸. Kjo dikton edhe gjykatën që duhet të shqyrtojë çështjen, e cila në rastin në shqyrtim është Gjykata Administrative³⁶⁹. Pasi rëndësi në përcaktimin e kompetencës ka natyra e titullit³⁷⁰. Padi të kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet³⁷¹. Kur kompetenca tokësore nuk mund të përcaktohet në këtë mënyrë, atëherë kompetente është gjykata, në territorin e së cilës ka qendrën organi publik i paditur³⁷².

Në këto lloj gjykimesh, gjykata vlerëson: (i) nga pikëpamja procedurale, nëse padia është ngritur brenda afatit ligjor të parashikuar shprehimisht në nenin 610 të K.Pr.Civile; dhe (ii) nëse veprimet e përmbaruesit gjyqësor janë kryer apo jo në përputhje me ligjin. Ajo e sheh të nevojshme mund të thërras edhe palë. Nevoja e thirrjes së palëve në këtë lloj gjykimi përcaktohet rast pas rasti dhe kontrollohet nga gjykatat më të larta. Si shkaqe dhe rrethana që e bëjnë të nevojshme thirrjen e palëve mund të përmendim rëndësinë e çështjes, faktin nëse kemi të bëjmë me kreditorë dhe debitorë të shumtë, faktin nëse debitori ose kreditori është një ndërmarrje ose institucion shtetëror, interesat e të cilit duhet të përfaqësohen nga avokatura e shtetit, llojin e veprimit të përmbaruesit gjyqësor që kundërshtohet³⁷³.

5.3.6. Kërkesa për pezullimin e veprimeve përmbarimore parashikuar në nenin 610 të K.Pr.Civile

Pezullimi i ekzekutimit është një masë paraprake, e cila synon të ngrijë procedurat e ekzekutimit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me qëllim garantimin e të drejtave të debitorit. Nëpërmjet pezullimit synohet të balancohet, sa është e mundur, pozita e pafavorshme e debitorit si pasojë e kufizimit të së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv dhe/ose për veprime përmbarimore është në funksion të padive, mjeteve juridike që mund të ushtrohen gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm³⁷⁴. Në gjykimet me objekt kundërshtimi veprimet përmbarimore, gjykata nuk gjykon thelbin e marrëdhënies juridiko-civile, por vetëm faktin nëse veprimet e përmbaruesit janë kryer ose jo në përputhje me ligjin.

Ankimi ndaj veprimeve ose refuzimit për kryerjen e veprimeve nga përmbaruesi gjyqësor nuk e pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata së cilës i paraqitet kërkesa, vendos ndryshe³⁷⁵.

³⁶⁸ Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr.1050, datë 19.02.2015

³⁶⁹ Shihni vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2015-3385, datë 16.07.2015 arsyeton se : *Kolegj Administrativ e çmon se nga pikëpamja tokësore kjo mosmarrëveshje është në kompetencën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për arsye se pretendimet e paditësit drejtohen kundër veprimit administrativ të palës së paditur, ILDKPKI e cila ka qendrën e saj në qytetin e Tiranës.*

³⁷⁰ Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2015-2266, datë 21.05.2015

³⁷¹ Neni 11 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

³⁷² Po aty në pikën 5

³⁷³ Vendim Unifikues i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.13, datë 23.03.2004

³⁷⁴ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.158, datë 19.03.2015

³⁷⁵ Neni 610 i K.Pr.Civile

Afati i ankimit fillon nga dita e marrjes dijeni³⁷⁶, për kryerjen e veprimit ose refuzimit të përmbaresit gjyqësor për të kryer veprimet e parashikuara në K.Pr.Civile për ekzekutimin e titujve ekzekutiv. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare nga institucionet financiare jo bankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit.

Në Gjykatën Kushtetuese është kërkuar të shfuqizohet si e papajtueshme me Kushtetutën, fjalia e dytë e paragrafit të pestë të nenit 610 të K.Pr. Civile, duke argumentuar se afatit 20-ditor i shqyrtimit gjyqësor, vetëm për rastet e titujve ekzekutiv që rrjedhin nga aktet e dhënies së kredive nga institute bankare ose jobankare ka sjellë regres në mbrojtjen e të drejtave të debitorit. Kjo bazuar në argumentin se debitorit nuk i sigurohet mbrojtje efektive dhe i është ashpërsuar kufizimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor në mënyrë të panevojshme. Rënia e masës së pezullimit pas kalimit të 20 ditëve, nuk ofron një mjet efektiv mbrojtjeje për debitorin ashtu sikundër do të ishte parashikimi se masa e pezullimit qëndron në fuqi deri sa gjykata vendos pranimin e padisë.

Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar kërkesën për shfuqizimi duke argumentuar se afati 20-ditor për këtë lloj gjykimi është vendosur me synim shmangien e vonesave në këtë fazë të ekzekutimit. Ky afati prezumohet t'i shërbejë përshpejtimit të procesit gjyqësor në funksion të përfundimit të fazës së ekzekutimit të titujve ekzekutiv në fushën kredive bankare dhe institucioneve jobankare³⁷⁷.

5.3.7. Afati i ankimit ndaj vendimit të gjykatës me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbare

Në kushtet kur në nenin 610 të K.Pr.Civile nuk është parashikuar afati i ankimit, sikurse është parashikuar për të gjitha rastet e tjera, kur si mjet ankimi lejohet të ushtrohet ankimi i veçantë, atëhere ankimi i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm, afatit 15 ditor. Në interpretim literal e logjik të kësaj dispozite, ankimi i veçantë i parashikuar në të mund të ushtrohet vetëm kundër vendimit të gjykatës që ka pranuar ose jo kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të veprimeve të përmbaresit gjyqësor dhe jo ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës, që ka shqyrtuar çështjen bazuar në nenin 610 të K.Pr.Civile³⁷⁸.

Në vështrim të dispozitave të Pjesës së Katërt të Kodit të Procedurës Civile, në të cilat janë përcaktuar rregullimet ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm dhe mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve, ankimi i veçantë kundër vendimeve të gjykatës është parashikuar shprehimisht në nenet 512, 516/3, 517/2, 539, 601 dhe 611 të këtij Kodi. Në referim të dispozitave të K.Pr.Civile, në të cilat janë parashikuar mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të detyrueshëm, jo për të gjitha rastet është parashikuar se personi i interesuar mund të kundërshtojë

³⁷⁶ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.1585, datë 25.06.2015

³⁷⁷ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 20.05.2015

³⁷⁸ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.289, datë 01.10.2009

vendimet në gjykatë me ankim të veçantë. Për rastet kur ligjbërësi e ka çmuar se duhet të ushtrohet ankimi i veçantë, e ka parashikuar këtë mjet ankimi në mënyrë të posaçme. Kjo haset në të gjitha dispozitat kur lejohet ushtrimi i këtij mjeti. Nga arsyetimi i mësipërm, mendojmë se përderisa në nenin 610 të K.Pr.Civile nuk është parashikuar afati i ankimit, sikurse është parashikuar për të gjitha rastet e tjera kur si mjet ankimi lejohet të ushtrohet ankimi i veçantë, atëhere ankimi duhet t'i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm, afatit 15 ditor³⁷⁹.

Ndër veprimet përmbarimore ndaj të cilave mund të bëhet ankim është edhe veprimi për caktimin e ekspertit. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se vendimi i përmbaruesit, për caktimin ekspertit është në kundërshtim me ligjin. Përmbaruesi gjyqësor duhej të ndërmerre fillimisht veprime ndaj debitorit në plotësim të urdhërimeve gjyqësore të vendimit të formës së prerë, dhe vetëm në rast të mosveprimit të debitorit në drejtim të rillogaritjes së pensionit të parakohshëm për kreditorin, përmbaruesi mund të vijonte me mjetet ligjore të parashikuara në K.Pr.Civile, në ekzekutim të detyrueshëm të vendimit gjyqësor³⁸⁰.

Në procedurën përmbarimore ka rëndësi njoftimi i palës debitore, pavarësisht pozitës së tij, nëse paraqitet si dorëzanës apo hipotekues duhet të njoftohet për çdo veprim përmbarimor, në mënyrë që të mbroj të drejtat e tij sipas nenit 610 të K.Pr.Civile. Kur veprimet përmbarimore për njoftimin e dorëzanësit janë bërë ndërkohë që ai rezultoi se ka vdekur përpara lëshimit të urdhërit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Rrjedhimisht kjo nuk passjell pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv si dhe të dorëzaniës. Titulli ekzekutiv dhe dorëzania janë të ligjshëm, por veprimet përmbarimore në lidhje me trashgimtaren M.B nuk janë kryer konform ligjit dhe shërbimit përmbarimor³⁸¹.

Sipas të dhënave statistikore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 pranë kësaj gjykate janë mbartur 237 çështje me objekt kundërshtim i veprimeve përmbarimore nga të cilat 9 kërkesë padi janë pranuar nga gjykata, 10 janë pushuar dhe 68 janë përfunduar. Afati përfundimit të shqyrtimit për 59 çështje ka qënë për një preiudhë mbi gjashtë muaj³⁸². Kjo nënkupton se pavarësisht se padia sipas 610 është një mjet procedural për t'u mbrojtur gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, për shkak të shtrirjes së gjatë në kohë, kthehet në një makth për vazhdimin e procedurave përmbarimore duke i zvarritur pafundësisht dhe duke e bërë procesin ekzekutiv joproduktiv dhe joeficient.

5.4. Padia për kërkimin e sendit nga personi i tretë

Për të garantuar respektimin e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të kreditorit, debitorit apo personave të tretë si dhe respektimin e procesit të rregullt ligjor edhe gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, ligji procedural ka paraparë mundësinë që e gjithë veprimtaria e përmbaruesit gjyqësor të zhvillohet nën kontrollin dhe mbikqyrjen e gjykatës. Me qëllim mbrojtjen e të drejtave subjektive materiale të subjekteve të përfshira në ekzekutimin e

³⁷⁹ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.289, datë 01.10.2009

³⁸⁰ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.119, datë 21.01.2016

³⁸¹ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.476, datë 10.11.2015

³⁸² <http://www.gjykatatirana.gov.al/#kerko> hyrë në datën 11.02.2016

detyrueshem ligji lejon mundësinë e kundërshtimit të këtij procesi, duke parashikuar mjetet mbrojtëse kundër ekzekutimit të vendimit të formës së prerë apo titullit ekzekutiv nga debitori, kreditori ose personat e tretë. Normat juridike të pjesës së katërt të Kodit të Procedurës Civile rregullojnë marrëdhëniet procedurale që krijohen gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv.

Në dispozitat e pjesës së katërt të Kodit të Procedurës Civile, ndër të tjera, parashikohen dhe mjetet e mbrojtjes gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm (Kreu IX), që në thelb dallohen në dy kategori kryesore: (i) paditë që ngrihen gjatë procesit përbarimor e që lidhen me mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga e drejta materiale (nenet 609, 612-614) dhe (ii) ankimi ose kundërshtimi ndaj veprimeve ose mosveprimeve të përbaruesit (nenet 610-611)³⁸³. Ngritja e padisë për kërkimin e sendit nga personi i tretë parashikohet në nenin 612 të K.Pr.Civile³⁸⁴. Padia bazuar në këtë dispozitë është një prej dy rasteve të goditjes/kundërshtimit të veprimeve të përbaruesit dhe konkretisht kundërshtimi i veprimeve të këtij të fundit prej personave të tretë.

Në dallim nga kundërshtimi i veprimeve përbarimore prej palëve në proces, kundërshtimi i veprimeve të përbaruesit prej të tretëve nuk bëhet me ankim në gjykatë por me padi të rregullt, e cila në thelb është një padi rivendikimi (*rei vindicatio*), megjithëse e një lloji të veçantë. Kjo padi është një mjet i ndryshëm mbrojtjeje nga padia e kundërshtimit të veprimeve përbarimore³⁸⁵. Padia bazuar në nenin 612 të K.Pr.Civile është një prej rasteve specifike të kundërshtimit të veprimeve të përbaruesit dhe konkretisht kundërshtimi i veprimeve të përbaruesit gjyqësor prej personave të tretë, të cilët pretendojnë pronësinë mbi sendin që do të bëhet pjesë, ose mbi të cilin do të bëhet ekzekutimi i detyrueshëm³⁸⁶. Kjo padi ngrihet kundër debitorit dhe kreditorit dhe në gjykimin e kësaj padie sqarimi i titullit të pronësisë ka vlerë thelbësore. Personi i tretë që kundërshton ekzekutimin, që të legjitimohet në këtë lloj padie, duhet të provojë se është pronar mbi sendin me anë të fitimit me titull origjinar apo te prejardhur (kontratë).

Për të provuar se është pronar, paditësi nuk duhet të mjaftohet duke treguar se si e ka fituar titullin, por duhet të vërtetojë që edhe personi që ia kaloi atë, kishte titull pronësie të vlefshëm. Pra në thelb, gjykata në shqyrtimin e kësaj lloj padie investohet në shqyrtimin e vlefshmërisë së titujve të pronësisë, që kanë palët ndërgjyqëse me pretendime pronësie mbi sendin. Kolegji Civil në vendimin e tij³⁸⁷ në lidhje me përjashtimin e sendit nga sekuestrimi ka argumentuar se për të përcaktuar pranimin ose jo të padisë duhet të verifikohet nga gjykata e Apelit nëse realisht kontrata e hipotekës së paditësit garanton detyrimet e marra përsipër prej të paditurit z.Y.Xh me

³⁸³ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.580, datë 12.11.2014

³⁸⁴Neni 612 i K.Pr.Civile ku parashikohet se: *Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja. Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit.Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci.*

³⁸⁵ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.343, datë 10.09.2015 arsyeton se: *Pala paditëse mund t'i kundërshtojë këto akte si me siper vetëm në mënyrën e parashikuar posaçërisht në ligj (ne rastin konkret me nenin 612 te K.Pr.Civile) por jo me padine ne gjykim.*

³⁸⁶ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.285, datë 08.07.2015

³⁸⁷ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.456, datë 09.12.2010

kontratën e kredisë datë 23.10.1996 apo nëse është lidhur për garantimin e ndonjë detyrimi tjetër. Në rast se hipoteka është lidhur për të garantuar këtë kredi, mjafton ajo për të shlyer tërësisht detyrimin e të paditurit z.Y.Xh, apo për këtë gjë nevojitet edhe hipoteka e vendosur prej këtij të fundit mbi pasurinë e tij. Në këtë rast vetëm pasi të sqarohet ekzistenca e hipotekës si mjet për sigurimin e detyrimit mund të vendoset për përjashtimin ose jo të sendit nga sekuestrimi, pra të kundërshohet veprimi përmbarimor.

Padia e ngritur bazuar në neni 612 të K.Pr.Civile ka karakterin e padisë së rivendikimit. Gjykata në shqyrtimin e kësaj lloji padie investohet në shqyrtimin e vlefshmërisë së titujve të pronësisë që kanë palët ndërgjyqëse. Në lidhje me pretendimet që palët kanë mbi pronësinë e sendin dhe për ta përjashtuar sendit nga ekzekutimi. Gjykata *de iure* i njeh dhe konfirmon titullin e pronësisë palës paditëse, titull i cili duke iu kundërvënë titullit të pronësisë së palës të paditur (në cilësinë e kreditorit në gjykimin në përfundim të së cilit është dhënë vendimi gjyqësor, titull ekzekutiv) e detyron palën e paditur që në fund të njohë pronësinë e paditesit mbi sendin³⁸⁸.

Pozita procedurale e palëve në proces përcaktohet nga interesin në gjykim, paditës, personi i cili pretendon se e drejta subjektive i takon atij, i drejtohet gjykatës për të kërkuar njohjen ose rivendosjen e kësaj të drejte të shkelur nga një person tjetër që e thërret në gjykim, me cilësinë e të paditurit duke pretenduar se është ky personi që ka shkelur, cënuar apo mohuar të drejtën³⁸⁹. Legjitimimi aktiv konsiderohet ndryshe si legjitimimi për të kërkuar, ndërsa legjitimimi pasiv, si legjitimimi për të kundërshtuar. Legjitimimi procedural është kusht për vazhdimin e gjykimit, ndërsa legjitimimi real i takon shqyrtimit gjyqësor të themelit të çështjes, për të cilin gjykata shprehet në vendimin përfundimtar³⁹⁰.

5.5. Rastet e pezullimit dhe pushimit të ekzekutimit

5.5.1. Rastet e pezullimit të ekzekutimit

Procesi i ekzekutimit të një vendimi përfundimtar, i filluar nga shërbimi përmbarimor, si rregull, duhet të vazhdojë pa ndërprerje deri në përfundimin e ekzekutimit. Por ekzekutimi mund të pezullohet kur ekzistojnë rrethana që i ndalojnë veprimet ekzekutive dhe ky pezullim vazhdon deri në zhdukjen e shkaqeve ose pengesave që rrjedhin nga këto rrethana. Pezullimi i procesit të ekzekutimit shënon vetëm një ndalim të përkohshëm të tij. Ekzekutimi pezullohet kur për këtë fakt shprehet gjykata me vendim gjyqësor, i cili është i detyrueshëm për palët. Kur gjykata sipas nenit 297/c/ç vendos pezullimin e gjykimit pasi njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik, ose rastin kur njëra nga palët nuk ka ose më vonë ka humbur zotësinë juridike për të vepruar si palë dhe shihet e nevojshme t'i emërohet një përfaqësues ligjor, këto të fundit përbëjnë shkak për pezullimin e ekzekutimit.

³⁸⁸Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.366, datë 30.09.2010

³⁸⁹ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.580, datë 12.11.2014

³⁹⁰ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.537, datë 23.10.2014

Një mënyrë mbrojtje kundër ekzekutimit të titullit ekzekutiv, ligjvënësi ka parashikuar edhe pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, ku një nga rastet është ai i parashikuar në pikën “a” të nenit 615, të K.Pr.Civile, përmes pezullimit të ekzekutimit nga një vendim gjykate, që në këtë rast vendimi është marrë bazuar në nenin 479/a të K.Pr.Civile), është një vendim i dhënë nga Gjykata e Lartë. Në këtë rast nga ana e përmbartuesit gjyqësor nuk mund të kryhet asnjë veprim procedural për ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Pra, ekzekutimi nuk kryhet deri sa nga Gjykata e Lartë të shqyrtohet çështja gjyqësore kundër vendimeve të gjykatave që janë bërë titull ekzekutiv³⁹¹. Një rast tjetër i parashikuar nga ligji është kur vetë kreditori si palë iniciuese e procesit të ekzekutimit, në bazë të së drejtës së disponibilitetit, bën kërkesë me shkrim për pezullimin e tij. Me vendim për pezullimin e ekzekutimit, përmbartuesi del edhe kur nuk gjen pasuri të debitorit brenda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit.

Ligji ka njohur si rast pezullimi edhe neglizhencën e kreditorit, kështu kur kreditori pa shkaqe të arsyeshme nuk paraqitet, brenda tre muajve nga njoftimi i dytë shkresor që i është bërë nga përmbartuesi gjyqësor. Meqë tagrin për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv, ligji ia ka njohur vetëm kreditorit, atëherë nëse ky i fundit e ka humbur interesin për vazhdimin e procedurave përmbartimore, ekzekutimi pezullohet. Në K.Pr.Civile janë listuar disa nga raste për të cilat vendoset pezullimi i ekzekutimit, por nuk janë përfshirë edhe rastet e tjera që janë parashikuar shprehimisht në ligj.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë sjell në vëmendje në vendimin e tij se instituti i masës së sigurimit të padisë është i ndryshëm nga ai i pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Sigurimi i padisë parashikohet nga nenet 202-212 të Kodit të Procedurës Civile, ndërsa pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv është një masë paraprake që merret nga gjykata në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe parashikohet në disa dispozita të veçanta të Pjesa e Katërt “Ekzekutimi i detyrueshëm” i po këtij Kodi. Sipas neneve 609, 610, 612 është parashikuar shprehimisht se gjykata që shqyrton çështjen, mbi kërkesën e palës, mund të vendosë pezullimin e vendimit, pra të titullit ekzekutiv, me ose pa garanci³⁹².

Rastet e pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv janë të parashikuara shprehimisht në nenin 615 të K.Pr.Civile dhe asnjë prej tyre nuk parashikon që ekzekutimi të pezullohet për shkak të paraqitjes së një vërtetimi të kancelarit se është paraqitur ankim kundër këtij vendimi gjyqësor. Por Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë me vendim ka arsyetuar se goditja e vendimit gjyqësor të vënë në ekzekutim të detyrueshëm nga palët ndërgjyqëse, duke ushtruar ankimi nga V.B kundër vendimit gjyqësor të sipërcituar dhe kalimi i dosjes gjyqësore gjykatës së apelit përbën pengesë ligjore për zhvillimin e mëtejshëm të veprimeve përmbartimore dhe njëkohësisht, shkak ligjor për pezullimin e tyre.³⁹³

Ligji procedural ka përcaktuar mënyrën sesi duhet të vepohet pas rënies së masës së pezullimit, në këtë rast përmbartuesi gjyqësor vazhdon ekzekutimin nga veprimi procedural i

³⁹¹ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.2999, datë 19.12.2012

³⁹² Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.157, datë 19.03.2015

³⁹³ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.495, datë 09.10.2014

mbetur në çastin e pezullimit. Rast tjetër nga praktika gjyqësore kur nuk është pranuar pezullimi i veprimeve përmbarimore³⁹⁴.

5.5.2. Rastet e pushimit të ekzekutimit

Pushimi i ekzekutimit shënon përfundimin e procesit përmbarimor. Në këtë mënyrë përmbaruesi gjyqësor me vendim të argumentuar vendos pushimin e ekzekutimit të urdhërit të ekzekutimit pasi vendimi është ekzekutuar tërësisht. Ky vendim merret vetëm në rastin kur debitori i paraqet përmbaruesit gjyqësor dëftesën me nënshkrimin e kreditorit, ose konfirmën bankare të vërtetuar rregullisht se ka paguar shumën që kërkohet në urdhrin e ekzekutimit.

Një rast tjetër kur ekzekutimi pushohet është kur vetë kreditori paraqet një kërkesë me shkrim pranë zyrës përmbarimore për të hequr dorë nga ekzekutimi. Në rast se rrethanat që kanë sjellë pezullimin e ekzekutimit pasojnë me prishjen apo ndryshimin e vendimit përfundimtar të vënë në ekzekutim të detyrueshëm, krahas rasteve të tjera të parashikuara në nenin 616 të Kodit të Procedurës Civile, vendoset pushimi i ekzekutimit.

Kolegji Civil ka arsyetuar në vendimin e tij se ngjarje të ndodhura pas dhënies së titullit ekzekutiv siç janë testamenti i përpiluar para noterit nga kreditori S.K dhe deklarata noteriale e përbashkët mes tyre me të cilën janë dakortësuar për mënyrën e përdorimit të banesës, nuk hyjnë në kuadrin e atyre veprimeve me të cilat kreditori heq dorë nga ekzekutimi i vendimit. Pasi deklarimi noterial mbetet thjesht deklarim i një detyrimi të marrë përsipër por ende të papërmbyshur sipas ligjit. Prandaj, nuk mund të bëhet fjalë as për titull ekzekutiv të ekzekutuar tërësisht në mënyrë vullnetare apo nëpërmjet procedurës së detyrueshme përmbarimore dhe as për heqje dorë prej kreditorit nga ekzekutimi i titullit ekzekutiv. Vendimi nuk është ekzekutuar prandaj kreditori S.K legjitimohet të paraqesë kërkesë të re për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, edhe pse është marrë vendim pushimi nga përmbaruesi³⁹⁵. Përmbaruesi gjyqësor duhet të njoftoj palët, si atë kreditorë ashtu edhe atë debitorë në lidhje me vendimin e pushimit. Secila prej palëve ka të drejtë e ankimit në gjykatë e shkallë së parë ndaj vendimit të pushimit sipas rregullimeve të nenit 611 të K.Pr.Civile, brenda pesë ditë nga dita e marrjes dijeni.

Në praktikën e tij Kolegji Civil ka mbajtur këtë qëndrim në lidhje me nenin 616 duke arsyetuar se vendimi i zyrës përmbarimore për pushimin e ekzekutimit ishte i pabazuar në ligj e në prova, pasi nuk rezulton të jenë plotësuar kriteret e nenit 616 të K.Pr.Civile. Nga ana e përmbaruesit gjyqësor rezulton se janë pranuar vetëm 8 dokumenta të dorëzuara vullnetarisht nga ana e të paditurit debitor, nuk ishte vijuar me veprime të mëtijshme për ekzekutimin e plotë të vendimit gjyqësor të vënë në ekzekutim, sipas urdhërimit të tij në pjesën e dispozitivit, përkatësisht për 25 dokumenta³⁹⁶.

Kur vendimi i pushimit të ekzekutimit merr formë të prerë, përmbaruesi gjyqësor heq sekuestron e vënë mbi sendet e luajshme ose të paluajshme dhe kur vendimi i pushimi është bërë

³⁹⁴ Vendimi i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë nr.691, datë 16.12.2014

³⁹⁵ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.478, datë 06.11.2012

³⁹⁶ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.280, datë 07.07.2015

me kërkesë të kreditorit, i kthen urdhrin e ekzekutimit kreditorit. Ky i fundit ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për ekzekutim brenda kohës së parashkrimit. Afati i parashkrimit të ri fillon nga dita që vendimi për pushimin e ekzekutimit ka marrë formë të prerë.

KAPITULLI I VI. ZBATIMI I MODELIT TË PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR NË KËRKIMIN GJYQËSISHT TË SË DREJTËS

6.1. Roli i Gjykatës Kushtetuese në mbrojtjen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në rastet që lidhen me ekzekutimin e detyrueshëm

Në ligjin themelor të shtetit shqiptar, janë garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Të drejtat dhe liritë e njeriut janë vlerë themelore e rregullimit kushtetues³⁹⁷. Kushtetuta liston një sërë të drejtash që duhet të garantohen, si të drejtat vetjake, liritë dhe të drejtat politike si dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Përveç një katalogu të gjerë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Kushtetuta i ka dhënë përparësi instrumentave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut përballe rendit juridik të brendshëm, në rast konflikti³⁹⁸.

Një nga të drejtat më themelore që është parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, është e drejta për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet të cilit individët kërkojnë realizimin e procedurave të drejta dhe të ndershme ligjore. Nga njëra anë kjo e drejtë kushtetuese paraqitet si një garanci për shtetasit kundër veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit shtetëror dhe, nga ana tjetër, ajo përbën një detyrim për këto të fundit që të mos çenojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve pa ua siguruar respektimin e procedurave të rregullta ligjore. Neni 42 i Kushtetutës sanksionon mbrojtjen e të gjitha të drejtave të njohura në Kushtetutë dhe me ligj, duke veçuar si të drejta kryesore lirinë, të drejtën e pronës, te cilat mund të kufizohen nëse zbatohet kushti i domosdoshëm i respektimi të procesit ligjor vetëm në këtë rast mund të lejohet ushtrimi i kufizimeve kushtetuese. Në përputhje me këtë dispozitë është edhe neni 142/3 i Kushtetutës³⁹⁹.

Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Gjykata ndërhyt në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme çenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke bërë një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj⁴⁰⁰.

Kushtetuta, e drejta ndërkombëtare dhe ligji procedural civil në Republikën e Shqipërisë kanë disiplinuar të gjithë rrjedhën e procesit gjyqësor civil. Të interpretuarit së bashku dhe në mënyrë integrale i këtyre dispozitave japin kuptimin se vendimet gjyqësore të gjykatës janë të detyrueshme për pushtetet shtetërore dhe askush nuk mund të mosrespektojë këtë

³⁹⁷Kushtetuta në preambulën e saj shpreh se: *për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzo, duke i bërë pjesë integrale të saj këto zotime.*

³⁹⁸Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj;

³⁹⁹Neni 142/3 i Kushtetutës³⁹⁹, sipas të cilit *Organet e shtetit janë të detyruara të zbatojnë vendimet gjyqësore*

⁴⁰⁰Shihni Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.3 datë 23.02.2016 paragrafi 12, shiko edhe vendimin nr.62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese

vendimmarrje⁴⁰¹. Faza e ekzekutimit të detyrueshëm është pjesë e së drejtës për proces të rregullt ligjor, ky fakt është afirmuar fillimisht nga jurisprudenca ndërkombëtare dhe më pas edhe nga ajo kombëtare⁴⁰². Në përputhje me neni 6 të Konventës Europiane të të drejtave të njeriut, e drejta për proces të rregullt ligjor do të ishte iluzionare, nëse një sistem i brendshëm i një shteti anëtar, do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet i paekzekutuar në dëm të palës, që ka fituar gjyqin.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një element i rëndësishëm i së drejtës për një proces të rregullt, sepse një e drejtë e fituar mbetet pa vlerë nëse nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit⁴⁰³. Ekzekutimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare të zbatimit të së drejtës të fituar juridikisht. Vetëm pas përfundimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vendin të drejtën e tij⁴⁰⁴. Kjo pasi ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë⁴⁰⁵.

Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore është përfshirë relativisht vonë në praktikën e Gjykatës Kushtetuese. Kjo çështje lidhet me praktikën e GJEDNJ, e cila detyroi Gjykatën Kushtetuese ta konsideronte mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore si pjesë e procesit të rregullt ligjor, gjë e cila deri në vitin 2005 nuk konsiderohej si e tillë prej Gjykatës Kushtetuese shqiptare⁴⁰⁶. Sot ka një praktikë të pasur lidhur me këto vendime. Problematike mbetet ende fakti se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që konstaton cenim të procesit të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, nuk shoqërohet me dëmshpërblim apo urdhërime të tjera. Kjo ka vënë në pikëpyetje efikasitetin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, gjë e cila është konstatuar edhe nga GJEDNJ në praktikën e saj me palë shtetin shqiptar.

⁴⁰¹ Referuar Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.42 datë 19.07.2012 ku thuhet se: *20. Në vijim të këtyre referimeve, Gjykata vlerëson se prej parashikimeve dhe urdhërimeve të këtyre dispozitave kushtetuese rezulton se, detyrimi i organeve të shtetit për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, buron drejtpërdrejt jo vetëm nga Kushtetuta, por edhe se dispozita kushtetuese (neni 142/3 i saj) në këtë aspekt është e vetëzbatueshme nga organet e shtetit.*

21. Si rrjedhim, organet e shtetit nuk mund t'i shmangen përmbushjes së këtij detyrimi të drejtpërdrejtë kushtetues me pretendimin se ekzekutimi i vendimit gjyqësor është bërë i pamundur ose/dhe është vonuar thjesht dhe vetëm për shkak të akteve të tjerave normative që në hierarkinë e akteve, të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, vijnë pas Kushtetutës sepse një gjë e tillë do të çonte në cenimin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës, të ndarjes dhe balancimit të pushtetit dhe të së drejtës kushtetuese për një gjykim të drejtë. Për pasojë, asnjë organ i administratës publike nuk mundet që duke ushtruar autoritetin e tij publik, qoftë edhe për realizimin e një qëllimi të ligjshëm publik, të pengojë apo vonojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, të dhënë në një gjykim në të cilin ai ka qenë palë. Përkundrazi, këto organe, si çdo subjekt tjetër palë e një gjykimi, kanë të drejtë që të kundërshtojnë në gjykatë ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi gjyqësor nëpërmjet ushtrimit të mjetëve mbrojtëse të parashikuara nga legjislacioni kombëtar në fuqi...

⁴⁰² *Raisa M. Shipping LLP kundër Romanisë*, Nr. 37576/05, Sektioni i tretë, 8 Janar 2013

⁴⁰³ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 49, datë 2011/11/21

⁴⁰⁴ Shihni vendimin nr.11, dt 03.02.2012, vendimin nr.43, dt 19.12.2007, vendimin nr.6, dt 06.03.2009, vendimin nr.2, dt 01.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

⁴⁰⁵ Florjan Kalaja, *vep.cit* fq. 403

⁴⁰⁶ Çështja “*Qufaj k. Shqipërisë*”, 18 shtator 2004

6.2. Efektiviteti i ankimit në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor

Me ratifikimin e K.E.D.Nj, shteti Shqiptar ka marrë përsipër dhe është zotuar ndërkombëtarisht për të organizuar sistemin e brendshëm ligjor, nënligjor dhe infrastrukturor në mënyrë të tillë që të përditësohen të gjithë elementet e së drejtës për proces të rregullt ligjor⁴⁰⁷. Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, renditet menjëherë pas Kushtetutës në hierarkinë e normave juridike. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore përfshirë këtu dhe gjykatat e çdo niveli si dhe organet që zbatojnë vendimet e tyre.

Garancitë e Konventës ndikojnë në interpretimin dhe mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të individit të shprehura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 17 i Kushtetutës⁴⁰⁸ arrin ta ngrejë KEDNj-në edhe mbi interpretimin e dispozitave të vetë Kushtetutës⁴⁰⁹. GJEDNj si autoritet interpretues i Konventës luan një rol vital në krijimin e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në përputhje me standartet e KEDNj-së. Në një farë mënyrë, në nivel kombëtar vendimet e GJEDNj-së kanë një lloj efekti *erga omnes*, sepse vërtet vendimi i GJEDNj-së është *inter partes*, por për raste të njëjta, jo domosdoshmërisht shteti shqiptar duhet të kalojë të njëjtin kalvar dhe çështja të përfundojë me gjobitjen e tij. Pra teksti i Konventës dhe jurisprudenca e GJEDNJ shërbejnë për të bërë interpretimin kushtetues dhe për të përcaktuar, rast pas rasti, kufijtë e të drejtave themelore kushtetuese. Ky pozicion i Konventës vjen si pasojë e angazhimeve të Shtetit Shqiptar për t'i dhënë një mbrojtje të garantuar të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Prandaj shteti nëpërmjet organeve të tij, qoft ato gjyqësore qoft ato ekzekutive duhet të ketë parasysh efektet e vendimit për raste të njëjta.

Në 10 vitet e fundit, Gjykata Kushtetuese Shqiptare ka interpretuar Kushtetutën gjerësisht dhe në mënyrë kreative, sidomos në rastet e mbrojtjes kushtetuese të të drejtave të njeriut. Vendimet e saj, jo vetëm që janë garanci të detajuara për Kushtetutën, por përbëjnë garanci edhe për elementet e rinj që afirmohen. Ne gjejmë shumë raste që në mënyrë të qartë tregojnë se si garancitë kushtetuese të të drejtave dhe lirive individuale të ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe marrin jetë me këtë ndërveprim⁴¹⁰. Për sa u përket, duke u bazuar në këto standarde kushtetuese. Kërkesa e kërkuarit me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një

⁴⁰⁷ Shihni çështjen “*Kudla v. Poland*”, Dhoma e Madhe e Gj.E.D.Nj., Ap. no. 30210/96, paragrafi 152, ECHR 2000-XI. Gjithashtu shiko çështjen “*Driza v. Albania*”, Seksioni IV i Gj.E.D.Nj., App no. 33771/02, paragrafi 68, Vendim dt. 13.11.2007.

⁴⁰⁸ Neni 17 i Kushtetutës parashikon: *Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë.*

⁴⁰⁹ Po aty paragrafi i dytë parashikon se: *Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.*

⁴¹⁰ Prof.Xhezair Zaganjori Prof.Aurela Anastasi dhe Dr.Eralda (Methasani) Cani, *Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*, shtëpia botuese Adelprint Tiranë 2011.

afati të arsyeshëm duhet pranuar edhe për një shkak tjetër, pasi moszbatimi i një vendimi të tillë cenon të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës.

Praktika e Gjykatës Kushtetuese, për çështjet që konstaton cenim të procesit të rregullt ligjor, është orientuar kryesisht nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe e disa gjykatave të tjera kushtetuese europiane. Gjykata Kushtetuese ka njohur kompetencën ekskluzive të Gj.E.D.Nj, në sistemin tonë juridik dhe efektin e drejtpërdrejt të vendimeve të saj, apo të drejtës ndërkombëtare në përgjithësi, në interpretimin e standarteve kushtetuese të të drejtve të njeriut, veçanërisht atyre që i referohen të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese është përpjekur në praktikën e saj gjyqësore të bëjë një dallim thelbësor të rolit të saj si autoritet që garanton respektimin e Kushtetutës, nga funksioni i dhënies së drejtësisë që mbetet atribut i organeve të pushtetit gjyqësor.

Çdo subjekt sipas nenit 131/f të Kushtetutës⁴¹¹, mund t'i drejtohet kësaj gjykate, për të kundërshtuar akte juridike, pasi janë ezauruar të gjitha mjetet ligjore të mundshme. Sipas ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, kërkesa mund t'i paraqitet gjykatës brenda dy viteve nga moment që vendimi përfundimtar dhe i formës së prerë i është njoftuar atij⁴¹². Detyrimi i subjekteve për shterimin e mjeteve juridike, kërkon që këto mjete duhet të jenë të pranishëm në sistemin juridik të vendit si dhe të përmbushin kriteret që kërkon KEDNJ-ja (neni 13)⁴¹³. Megjithatë, ekzistenca e këtyre mjeteve juridike duhet të jetë mjaftueshmërisht e qartë, jo vetëm në teori por edhe në praktikë, në të kundërtën atyre do t'u mungojë kushti i aksesit dhe i efektivitetit⁴¹⁴.

Fillimisht, Gjykata Kushtetuese ka pasur një qasje krejt të ndryshme ndaj kërkesave për cënim të procesit të rregullt, për shkak të mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë. Këto kërkesa nxirreshin jashtë juridiksionit pasi ekzekutimi i vendimeve, sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese nuk përbënte element të procesit gjyqësor. Kjo e drejtë nuk gëzonte mbrojtje nga neni 42 i Kushtetutës, në të cilin janë parashikuar shprehimisht vetëm shtyllat bazë të procesit të rregullt, pa i renditur elementet e saj. Për më tepër, Gjykata jonë Kushtetuese nuk kishte marrë parasysh as faktin se Gjykata Evropiane e ka interpretuar nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 1997, rasti *Horsbi kundër Greqisë*⁴¹⁵.

Në çështjen "*Cufaj & Co kundër Shqipërisë*"⁴¹⁶, GJEDNJ është shprehur se sistemi ligjor shqiptar ofron mjete juridike të brendshme, për të ankimuar një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, mundësi kjo që teorikisht ishte në dispozicion të shoqërisë ankuese. Shoqëria u

⁴¹¹ Nenin 131 pika f) të Kushtetutës së Shqipërisë parashikohet se: "Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve në lidhje me shkeljet e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave".

⁴¹² Shihni neni 29 të Ligjit nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"

⁴¹³ Shihni vendimin nr.12 date 05.03.2012 te GJK faqe 4

⁴¹⁴ Shihni vendimin e pranueshmërisë në çështjen "*Lehtinen v. Finland*", aplikimi nr. 39076/97, par.5. Të njëjtën gjë GJEDNJ-ja e ka konstatuar edhe në vendimin Marini kundër Shqipërisë, datë 7.7.2008, apl. Nr.3738/02, par. 154; në vendimin Hamzaraj kundër Shqipërisë, datë 3.2.2009, par.30, apl. nr.45264/04

⁴¹⁵ Rasti "*Horsbi kundër Greqisë*" në të cilën u theksua se, "Ekzekutimi i vendimit të gjykata, duhet të konsiderohet si pjesë e procesit gjyqësor në kuptim të nenit 6".

⁴¹⁶ Çështja "*Qufaj kundër Shqipërisë*", 18 Nëntor 2004 (Kërkesa nr. 54268/00)

përpoq pa sukses ta shfrytëzonte këtë mjet, por Gjykata Kushtetuese e rrëzoi kërkesën e saj. Në këtë kuadër Gjykata vlerëson se e drejta për një proces të rregullt ligjor në Shqipëri duhej të ishte interpretuar në mënyrë të tillë që të garantonte një mjet juridik efektiv për shkeljet e pretenduara për mosrespektimin e kritereve të nenit 6/1 të Konventës. Kështu në opinionin e GjEDNj-së, Gjykata Kushtetuese ishte kompetente të shqyrtonte kërkesën e shoqërisë ankuese në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, si pjesë të juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për proces të rregullt ligjor⁴¹⁷.

Pas këtij vendimi, GJK është përballur me mjaft raste të tjera, ku ajo e ka trajtuar më hollësisht çështjen e mosekzekutimit të vendimit. Ajo ka pranuar tashmë në praktikën e saj se e drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ⁴¹⁸. Kjo do të thotë se gjyqtari duhet të interpretojë të drejtën për një proces të rregullt, jo vetëm për elementet e sanksionuara shprehimisht nga Kushtetuta, por edhe më gjerë. Aftësia e gjyqtarëve për të interpretuar Kushtetutën në mënyrë krijuese nuk është vetëm i mirëpritur në ligjin kushtetues, por edhe e nevojshme.

Kjo bën të mundur që një Kushtetutë t'i rezistojnë kohës për shekuj me radhë. Gjykata Kushtetuese ka ndryshuar qëndrimin e saj ndaj kërkesave për cënim të procesit të rregullt për shkak të mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë me vendimin nr.6 datë 31.03.2006⁴¹⁹. Gjykata rithekson qëndrimin se në një rast që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga fillimi i procedurës, deri në ekzekutimin e vendimit të dhënë. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Pra, Gjykata Kushtetuese vendos nëse konstaton prekjen e një të drejte themelore nga organet që merren me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Pas kësaj, çdo organ që ka detyrime nga vendimi përkatës detyrohet të marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin në mënyrë të plotë e të përpiktë me dispozitat e K.Pr.Civile, kur objekt është konstatimi i një shkeljeje dhe detyrimi i organit për ta riparuar atë. Ky qëndrim duhet parë lidhur edhe me parimin e sigurisë juridike, i cili kërkon që vendimet gjyqësore të formës së prerë të gjykatave të mos vihen në diskutim për t'u zbatuar. Në këtë kuadër Gjykata Kushtetuese është fokusuar edhe tek afati kohor brenda të cilit është ose duhej të ishte ekzekutuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese ka analizuar edhe shkaqet që kanë çuar në vonesa të paarsyeshme të gëzimit të së drejtës së

⁴¹⁷ Rasti i parë që ndryshoi praktikën gjyqësore dhe mënyrën doktrinarë të të konceptuarit të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm në Shqipëri ishte çështja “*Qufaj v. Shqipërisë*” e Gj.E.D.Nj. Në këtë çështje Gj.E.D.Nj. në vazhden e jurisprudencës konstante të saj, afirmoi për Shqipërinë se faza e ekzekutimit të detyrueshëm është pjesa fundore dhe integrale e procesit gjyqësor civil dhe si e tillë meriton të gjitha garancitë dhe vemendjen e nenit 6 të K.E.D.Nj. para. 40-42

⁴¹⁸ Shihni vendimi nr.27, datë 20.06.2007 i Gjykatës Kushtetuese

⁴¹⁹ Shihni vendimin nr.6 datë 31.03.2006 të Gjykata Kushtetuese, e cila ka krijuar një praktikë të vetën duke sanksionuar se *ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të konceptit të sundimit të ligjit dhe se nuk ka autoritet shtetëror që mund të vë në dyshim vendimet gjyqësore. Çdo organ publik është i detyruar të marrë masat e duhura për zbatimin e tyre.*

fituar⁴²⁰.

Ajo që del në pah nga kjo tablo e evoluimit të jurisprudences së Gjykatës Kushtetuese dhe që shtrohet për diskutim është fakti nëse konsiderohet ankimi individual pranë kësaj gjykate, si mjet efektiv sa i takon elementëve që lidhen me disa të drejta themelore procedurale si: *e drejta ankimit, e mbrojtjes, parimi i gjykatës kompetente, kontradiktoriteti në gjykim* etj. Mjeti efektiv i ankimit duhet të jetë i tillë që jo vetëm të vendosë lidhur me të drejtat që parashikon KEDNJ por edhe të rivendosë sa të jetë e mundur të drejtën e shkelur⁴²¹. Praktikisht Gjykata Kushtetuese në këto raste jo vetëm konstaton shkeljen e bërë nga gjykatat ose organet e tjera të administratës publike, por edhe shfuqizon aktin e prodhuar prej tyre si rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, duke ia kthyer atyre për rishqyrtim. Megjithatë, duke iu referuar rasteve konkrete si dhe praktikës së GJEDNJ, ky ankim nuk rezulton të jetë efektiv sa i takon disa elementëve të veçantë të procesit të rregullt të tilla si p.sh: çështjet që lidhen me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore (bashkë me të drejtën për dëmshpërblim), çështjet që kanë të bëjnë me zgjatjen e procesit gjyqësor tej afatit të arsyeshëm si dhe me të drejta të tjera materiale⁴²².

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare, finale dhe hynë fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Të gjitha organet janë të detyruara ligjërisht të zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në fakt këto vendime për shkak të karakterit deklarativ të tyre nuk janë vënë në zbatim duke e shndërruar Gjykatën Kushtetuese thjesht në një shkallë të detyrueshme për tu kaluar, për të pasur më tej mundësinë për tu drejtuar Gjykatës së Strasburgut. Një fakt të tillë e dëshmon edhe numri i madh raste kur shteti shqiptar është dënuar pasi nuk ka ekzekutuar një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Në një numër vendimesh të dhëna nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Shqipërisë janë konstatuar shkelje të Konventës për shkak të mosekzekutimit të vendimeve të gjykatave të brendshme dhe atyre administrative, ku përfshihet edhe vendimi pilot për çështjen Manushaqe Puto dhe të tjerë. Vendimet e deritanishme të GjEDNJ, duhet të shërbejnë si nxitje për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, me objekt konstatimin e cënimit të një procesi të rregullt ligjor, me qëllim shmangien sa të jetë e mundur të ndëshkimit financiar të shtetit shqiptarë nga GjEDNJ.

Mosekzekutimi i vendimeve të gjykatave të brendshme dhe atyre administrative mbetet ende një problem shumë serioz që pengon eficiencën e sistemit gjyqësor dhe që godet sundimin e ligjit në Shqipëri⁴²³. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sanksionohet⁴²⁴ në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili rezulton me probleme në aspektin e zbatimit praktik të tij.

⁴²⁰ Shihni vendimin nr.1 datë 19.01.2009 i Gjykatës Kushtetuese parashikon : *Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme”.*

⁴²¹ Vendim për çështjen *Scordino kundër Italisë* i datës 29 mars 2006 i Gj.E.D.Nj

⁴²² Shihni për më tepër çështjet *Balliu, Beshiri, Marini, Qufaj k. Shqipërisë*

⁴²³ Raport i Nils Muižnieks Komisioner për të drejtat e njeriut i Këshillit të Europës, 16 Janar 2014

⁴²⁴ Në nenin 81 të ligjit Nr. 8577, i datës 10 shkurt 2000, ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë’

Në konkluzion të kësaj nën çështje për rastet me objekt konstatimin e cënimit të procesit të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, do të sugjerohet ndryshime në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese. Ndryshime që përcaktojnë rregulla më të plota dhe të qarta që i japin të drejtën asaj edhe për caktimin e dëmshpërblimeve për individët në raste të konstatimit të shkeljes së të drejtave të tyre. Këto ndryshime do të ofronin mundësi të qarta dhe të sigurt për rivënien në vend të së drejtës dhe duke dhënë zgjidhjen e duhur ligjore. Në këtë mënyrë ajo do të ketë në dorë të njëjtin mjet që përdor edhe GJEDNj në raste të njëjta. Krijimi e një organi të posaçëm monitories për ekzekutimin e vendimeve të kësaj natyre, por edhe të vendimeve të tjera që mund të shfaqin problem të mosekzekutimi.

6.3. Trajtime që i referohen fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese

Në realitetin shqiptar nuk janë të kufizuara raste, ku është shkelur e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, sidomos në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Një pjesë e madhe e kërkesave të paraqitura para Gjykatës Kushtetuese kanë qënë të lidhura me mosekzekutimin e vendimeve për rikthimin në punë të personave të pushuar pa të drejtë nga organet e administratës publike. Rastet e jurisprudencës kushtetuese tregojnë se në pesë vitet e fundit janë marrë mbi 10 vendime në favor të individëve, ku është konstatuar cënim i së të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt, si rezultat i mosekzekutimit të një vendimi të formës së prerë të gjykatës.

Problematika e procesit të ekzekutimit e paraqitur para Gjykatës Kushtetuese ka qënë e shumëllojshme, veçanërisht përsa i përket rasteve kur si debitorë shfaqen institucione të administratës publike. Sjella e këtyre të fundit është konsideruar në shkellje të nenit 42 të Kushtetutës, kur ato nuk kanë marrë asnjë masë për ekzekutimin vullnetar të vendimit. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.43, datë 19.12.2007 arsyeton se nuk ka gjetur arsye të bazuara që të kenë çuar në mosrealizimin e të drejtës së kërkuarit për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet refuzimit për moszbatim të vendimit të formës së prerë nga organet kompetente⁴²⁵”.

Gjatë shqyrtimit të çështjes që lidhen me moszbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, Gjykata Kushtetuese nuk ka pranuar argumentet e subjekteve të interesuara, në cilësinë e debitorëve, lidhur me faktin se kërkuar, që fillon një proces të tillë, duhet t’i drejtohet fillimisht gjykatave të zakonshme për të kërkuar këtë detyrim nga debitori dhe jo Gjykatës Kushtetuese⁴²⁶.

⁴²⁵ Referuar vendimit nr.43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese, e cila vlerëson se: *në çështjen në shqyrtim pala debitorë i kishte të gjitha mundësitë që gjatë gjithë periudhës nga dita e marrjes formë të prerë të vendimit e në vazhdim t’i paguante kërkuarit shumën që i detyrohej sipas këtij vendimi. Jo vetëm kaq, por gjatë shqyrtimit të çështjes Gjykata Kushtetuese nuk arriti të shohë asnjë veprim konkret të palës debitorë që do të tregonte sado pak vullnet për të ekzekutuar detyrimin që rrjedh nga një vendim gjyqësor i formës së prerë.*

⁴²⁶ Shihni vendim nr.2 datë 01.02.2011 i Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit ka theksuar se: *është i pabazë argumenti [i Ministrisë së Drejtësisë] se kërkuarja duhet t’i ishte drejtuar gjykatës së shkallë së parë për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor. Nuk është detyrimi i kreditorit që të hapë një proces të ri gjyqësor nga i cili rrjedhimisht do të dalë një vendim tjetër gjyqësor për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të dhënë më parë. Gjykata thekson se vendimi*

Ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese ka qenë edhe në linjën e GJEDNJ, e cila ka theksuar se autoritetet e brendshme duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet që individit ta gëzojë të drejtën e tij me sa më pak pengesa dhe jo të zgjasë procedurat për këtë qëllim. Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe të autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e aplikantit ⁴²⁷.

Nga praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese⁴²⁸ veçojmë rastin kur, kërkuesi ka pretenduar përveç konstatimit të shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor edhe dëmshpërblimin financiar dhe jofinanciar, të ardhur si rezultat i ekzekutimit tej një afati të arsyeshëm të vendimeve gjyqësore në favor të tij. Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 131, gërma “f”, ka theksuar se vetëm pas shterimit të këtyre mjeteve juridike, individit për mbrojtjen e kësaj të drejte mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Por kurdoherë që shkelja e të drejtës së tij kushtetuese të jetë e lidhur detyrimisht me një proces të parregullt ligjor. Pasi në sferën e gjykimit të Gjykatës Kushtetuese nuk përfshihet as mënyra e zbatimit të ligjit material, as mënyra e vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme⁴²⁹.

Në mënyrë që të jemi në përputhje me nenin 131 gërma f) të Kushtetutes, në lidhje me ezaurimin e të gjitha mjete juridike të mbrojtjes, mendojmë se duhet të parashikohet në K.Pr.Civile ose K.Pr.Penale një mjet, me anë të cilit pala e interesuar ka mundësinë për të ndikuar drejtpërdrejt në një përshpejtim të procesit. Me anë të kësaj padie, qytetari jo vetëm konstaton tejzgjatjen pa arsye të procesit, por mund të marrë dhe dëmshpërblim për vonesën e shkaktuar, nëse e kërkon këtë, në mënyrë që individit para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese të ketë të drejtë të ankohet fillimisht në gjykatat e zakonshme.

për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit ka në thelb të tij jo konfirmimin e detyrimit të debitorit, por fillimin e procesit të ekzekutimit dhe vënien në lëvizje të organit kompetent për këtë qëllim. Në këtë aspekt, nuk ka arsye që pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, i cili ka vënë në lëvizje përmbarrimin, kreditori t’i drejtohet përsëri gjykatës për të kërkuar detyrimin e debitorit për të shlyer detyrimin ndaj tij.

⁴²⁷ Vendimi nr.66, datë 22.04.2016 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 10, 17 , gjykata vlerëson se vetë kërkuesi, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka shkaktuar vonesa në realizimin e së drejtës për njohjen e pronësisë, pasi nga momenti i dhënies së vendimit të formës së prerë dhe deri në momentin e dhënies së vendimit për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, ka kaluar një periudhë prej më shumë se 10 vjetësh. Nga materialet e administruara në dosje rezulton se për të gjithë këtë periudhë kërkuesi ka ndenjur indiferent dhe nuk ka bërë asnjë përpjekje për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit gjyqësor të dhënë në favor të tij.

⁴²⁸ Shihni vendimin nr.8 date 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese ku arsyeton se: *Sa i përket kërkimit për kompensimin e dëmit si rezultat i ekzekutimit me vonesë të vendimeve gjyqësore, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky është një kërkim i ri, i cili mund të paraqitet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në bazë të dispozitave të Kodit Civil që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash (neni 450 i Kodit Civil). Vetëm pas ezaurimit të mbrojtjes juridiksionale, kërkuesi mund të vërë në lëvizje procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131, germa “f”, të Kushtetutës.*

⁴²⁹ Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në, vendimin nr.106 datë 01.08.2001, në vendimin nr.23, datë 17.05.2010 ka arsyetuar se: *Gjykata nuk e gjen të bazuar as pretendimin e kërkuesit për sa i përket detyrimit të Prefektit të Qarkut Berat për të paguar kostot dhe shpenzimet e përballuara prej tij pasi, edhe gjatë gjykimit, kërkuesi nuk specifikoi shkakun dhe burimin e tyre si dhe nuk paraqiti asnjë provë që të justifikojë shumën e kërkuar për to.” dhe vendimin nr.35 datë 27.10.2010 duke arsyetuar në këtë të fundit se: *Pas shterimit të këtyre mjeteve juridike individit, për mbrojtjen e kësaj të drejte, mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por kurdoherë që shkelja e të drejtës së tij kushtetuese të jetë e lidhur detyrimisht me një proces të parregullt ligjor.**

Siç u përmend edhe më lartë, vetëm konstatim i Gjykatës Kushtetuese pa një mundësi konkrete për individin për ta kompensuar, nëpërmjet rikthimit në punë ose dëmshpërblim material ose jomaterial, lidhur me pasojat negative të kësaj shkelje, do të ishte pa kuptim. Në ligji organik të Gjykatës Kushtetuese parashikohet vetëm një sanksion, në formën e gjobës në rast mosekzekutimi ndaj vendimeve të vetë Gjykatës Kushtetuese, e cila deri sot nuk është zbatuar⁴³⁰. Ekzistenca e kësaj dispozitë nuk është e përshtatshme dhe as e mjaftueshme për rastet kur konstatohet mosekzekutimi i vendimit gjyqësor në kuadër të procesit të rregullt⁴³¹. Mendojmë se mënyra më e mire e kompesimit duhet të jetë e tillë që të mund të kënaqë disi kërkuesin duke patur parasysh pasojat negative që i janë shkaktuar nga mosekzekutimi në kohë i të së drejtës së fituar gjyqësisht.

Sugjerojmë që në ndryshimet e ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, të përfshihet dhe e drejta e kërkuesve, që për kohëzgjatje të procesit tej afateve të arsyeshme të kenë mundësi të ankohen në Gjykatën Kushtetuese edhe pa ezauruar të gjitha mjetet e ankimit. Gjykata Kushtetuese dhe jurisprudenca e vet interpretative tashmë e ka realizuar edhe këtë mundësi, duke i dhënë zgjidhje pretenduesve. Ky parashikim duhet të pasohet nga e drejta e Gjykatës Kushtetuese për të urdhëruar organin administrativ/gjykatën e zakonshme për përshpejtimin e procesit, pasi ka konstatuar arsyet e tejzgjatjes dhe organin përgjegjes për shkeljen, si dhe dëmshpërblim ndaj individit.

Të gjitha çështjet e larpërmendura tregojnë përfaqshjen e kësaj gjykate ndaj shkelje konventore dhe kushtetuese, në kuadër të rregullimit ligjor të së drejtës⁴³². Duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese konstatojmë se duke filluar nga viti 1999 e deri në vitin 2013, numri i çështjeve që janë paraqitur për shqyrtimi nga individët pranë kësaj gjykate ka ardhur duke u rritur. Duke u rritur ka ardhur edhe numri i vendimeve në të cilat gjykata ka pranuar kërkesën për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor, kjo referuar statistikat që janë hartuar nga Drejtoria e Studimeve, Botimeve dhe Kërkimeve pranë Gjykatës Kushtetuese⁴³³. Megjithatë, edhe nëse konstaton shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të urdhërojë përshpejtimin e procedurave, ndërkohë që nuk ka kompetencë të vendosë asnjë lloj kompensimi financiar.

Gjykata Kushtetuese ndër vite e ka zgjeruar konceptin e të drejtave të individit dhe së drejtës së tij për t'u ankuar në përputhje me standardet e GJEDNJ-së, duke u përpjekur t'i përshtatet përmbajtjes dhe kërkesave të KEDNJ-së me jurisprudencën e saj. Megjithatë në këtë drejtim, ndryshimet e propozuara në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese me rregulla më të plota dhe të

⁴³⁰ Neni 81 pika 4 e ligjit për Gjykatës Kushtetuese shqiptare.

⁴³¹ Arta Vorpsi, Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Botime Maluka, Tiranë 2011, faqe 256

⁴³² Shihni vendimi nr.12, date 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, e cila ka vlerësuar se mund të merren në shqyrtim nga kjo gjykatë edhe kërkesat e individëve për cenimin e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Pavarësisht faktit se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre mund të mos ketë përfunduar në të gjitha shkallët e gjyqimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se, në të tilla raste individit duhet t'i drejtohet Gjykatës, sepse nuk ka mjete të tjera efektive në dispozicion për ta përshpejtuar procesin”.

⁴³³ Arta Vorpsi, *vep e cit* fq. 264

qarta, do ta bënin më efektiv ankimimin në Gjykatën Kushtetuese si mjet ankimi në këndvështrim të nenit 13 të KEDNJ-së.

6.4. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut është hartuar nga Këshilli i Evropës⁴³⁴ dhe ka hyrë në fuqi me 3 shtator 1953. Duke marrë si pikënisje Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948, hartuesit e Konventës u përpoqën të ndiqnin qëllimet e Këshillit të Evropës duke ruajtur dhe realizuar edhe më tej të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Përveç paraqitjes së një katalogu të të drejtave dhe lirive civile dhe politike, Konventa gjithashtu krijoi një mekanizëm për ekzekutimin e detyrimeve që kanë shtetet kontraktuese. Kjo përgjegjësi iu ishte caktuar tri institucioneve: Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut (themeluar me 1954), Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (e themeluar me 1959), dhe Këshilli i Ministrave i Këshillit të Evropës, ku ky i fundit përbëhet nga Ministrat e Punëve të Jashtme të shteteve anëtare apo përfaqësuesit e tyre.

Me hyrjen e vendeve të reja anëtare nga viti 1990, numri i rasteve është rritur në mënyre të konsiderueshme. Kjo ka qenë njëra ndër arsytet pse në vitin 1998 u miratua Protokollin 11 në KEDNJ. Qëllimi i këtij protokollin ishte të shkurtojë kohëzgjatjen e procedurave mirëpo duke fuqizuar në të njëjtën kohë karakterin gjyqësor të sistemit duke e bërë plotësisht të detyrueshëm dhe duke shfuqizuar përgjegjësinë gjyqësore të Këshillit të Ministrave. GjEDNJ⁴³⁵ si autoritet interpretues i Konventës luan një rol vital në krijimin e jurisprudences së brendshme, në veçanti për Gjykatën Kushtetuese, në përputhje me standartet e KEDNJ.

Në nivel kombëtar vendimet e GjEDNJ kanë një lloj efekti *erga omnes*, sepse vërtet vendimi i GjEDNJ është *inter partes*, por për raste të njëjta, jo domosdoshmërisht shteti shqiptar duhet të kalojë të njëjtin kalvar dhe çështja të përfundojë me gjobitjen e tij, prandaj ky i fundit duhet të marrë në konsideratë efektet e vendimit për rastet e njëjta. Standardet e konventës dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut duhet të udhëheqin veprimtarinë e gjithanshme të autoriteteve të brendshme, me qëllim shmangien në të ardhmen të kërkesave që ankuesit mund të paraqesin para gjykatës kundër shtetit shqiptar⁴³⁶.

⁴³⁴ Këshilli i Evropës (shih: www.coe.int)

⁴³⁵ GjEDNJ përbëhet nga një numër gjykatësish të barabartë të Shteteve Kontraktuese. Gjykatësit janë zgjedhur për një mandat prej 9 vitesh nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës dhe nuk mund të rizgjidhen. Gjatë mandatit të tyre Gjykatësit nuk do të angazhohen në asnjë aktivitet tjetër, i cili nuk është në përputhje me pavarësinë e tyre, paanshmërinë, apo me kërkesat për të punuar me orar të plotë.

⁴³⁶ Enkeledi Hajro "Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika gjyqësore e brendshme; detyrimet pozitive dhe negative në kuadrin e zbatimit të Konventës Europiane", Revista Juridike nr.1, Shkolla e magistraturës, Tiranë 2011

6.5. Sigurimi i ekzekutimit efikas dhe të efektshëm të vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, vetë ka pasur rastin që të deklarohet se e drejta e aksesit në një gjykatë do të ishte një iluzion nëse sistemi ligjor i brendshëm i një shteti do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar e detyruet të mbetet i pazbatueshëm në dëm të njëjës palë. Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e "gjykimit" për qëllimet e nenit 6⁴³⁷, pra e drejta e ekzekutimit rrjedh nga "parimi i sundimit të ligjit". Pra ekzekutimi i duhur i vendimeve të Gjykatës Evropiane është themeli dhe prova më themelore e efektivitetit të mekanizmit evropian për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nëpërmjet analizës së sistemit aktual të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane, synohet të dalin në pah detyrimet e shteteve për ekzekutimin e vendimeve dhe masat që ndërmarin këto të fundit në këtë kuadër.

Diskutimet mbi reformën në fushën e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Europiane kanë çuar në publikimin e shumë raporteve, deklarave, rezolutave, rekomandimeve dhe të paktën të një Protokollit të Konventës⁴³⁸. Proçesi ka marrë një hov të ri nga një konferencë ndër-qeveritare e nivelit të lartë, i cili u zhvillua në shkurt të vitit 2010 dhe çoi në miratimin e Deklaratës së Interlaken. Për këtë arsye 47 shtete anëtare të Këshillit të Evropës riafirmuan zyrtarisht angazhimin e tyre ndaj Konventës dhe Gjykatës. Në këtë kuadër miratuan një plan veprimi "si një instrument për të siguruar udhëzime politike për proçesin drejt efektivitetit afatgjatë të sistemit të Konventës", duke përfshirë edhe një afat kohor për zbatimin e saj.

Po aq i rëndësishëm është edhe mekanizmin i monitorimit që parashikohet nga GjEDNj për ekzekutimin e vendimeve të saj. Roli që luajnë organet e Bashkimit European dhe në veçanti Komiteti i Ministrave në monitorimin dhe zbatimin e vendimeve të kësaj gjykate. Shtetet janë kryesisht përgjegjëse për zbatimin e Konventës në juridiksionin e tyre, nën mbikqyrjen e Komitetit të Ministrave. Përveç kësaj, Gjykata dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës kanë aftësinë për të ndikuar në proçesin e ekzekutimit. Shtetet ndërmarrin detyrimin t'i binden një vendimi përfundimtar të GjEDNj në çdo çështje ku ata janë thirrur si palë. Vendimi përfundimtar i kalon Këshillit të Ministrave, i cili mbikqyr ekzekutimin e vendimit. Detyrimi i shtetit për ekzekutimin e vendimit përfundon vetëm kur Këshilli i Ministrave merr një rezolutë përfundimtare për mbylljen e çështjes.

Në zbatim të nenit 46/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut⁴³⁹, për shtetet lindin detyrime për të ekzekutuar vendimet e kësaj gjykate, kjo duke ndërprerë veprimin e paligjshëm, duke riparuar dhe parandaluar dëme të ngjashme në të ardhmen. Për të realizuar këto detyrime shtetet ndërmarrin dhe adoptojnë masa individuale dhe masa të përgjithshme. Nga analiza e mësipërme do të synojmë të nxjerrim në pah nevojën për reformim si në nivelin

⁴³⁷ Rasti "*Hornsby kunder Greqisë*" 19 Mars 1997, numër 107/1995/613/701

⁴³⁸ Protokoll nr.14 i Konventës Europiane

⁴³⁹ Neni 46/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në të cilën parashikohet detyrimi ligjor i shteteve për të ekzekutuar vendimin e GjEDNj

kombëtar, ashtu edhe në nivelin European duke propozuar një përmirësim në sistemin e Konventës në kuadër të procesit ekzekutiv.

6.5.1. Masat e përgjithshme që ndërmarrin shtetet për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të GjEDNj dhe praktika e shteteve në marrjen e këtyre masave

Masat e përgjithshme, të cilat konsistojnë në detyrimi e shtetit për të parandaluar shkelje të ngjashme të Konventës në të ardhmen. Masat të tilla janë nganjëherë të vështira për tu përkufizuar dhe zbatuar, pasi kanë kryesisht tendencë për të siguruar kushtet materiale dhe juridike konkrete për gëzimin e të drejtave që mbron konventa. Autoritetet kombëtare duhet së pari të bëjë një shqyrtim të hollësishëm të shkaqeve të shkeljes së Konventës. Marrja e këtyre masave arsyetohet me faktin se vendimet e Gjykatës janë të privuara nga efekti i drejtpërdrejtë.

Përsa i përket pasojave në rafshin më të përgjithshëm, ato kanë të bëjnë me gadishmërinë e shtetit për riparimin e situatës të shkaktuar nga shkelja e ndonjë prej të drejtave dhe lirive të parashikuara nga KEDNJ-ja. Këto shkelje të konstatuara përmes vendimit të GjEDNJ-së si dhe natyra e masave kërkojnë mos ndërhyrjen e shteti për parandalimin e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen, me qëllim garantimin e të drejtave dhe lirive themelore. Shkelja e konventës, në rastin e parë, do të rezultonte nga mosveprimi i autoriteteve vendase, nga qëndrimi pasiv i tyre dhe, në rastin e dytë, nga fakti se ato kanë penguar ose kufizuar ushtrimin e së drejtës me anë të një akti pozitiv.

Masat e përgjithshme që çmohen si të nevojshme përfshijnë ndryshime kushtetuese ose ligjore, ndryshime në jurisprudencën kombëtare, si dhe masa praktike si rekrutimi i gjyqtarëve ose rinovimi i mjediseve të vjetëruara të burgjeve⁴⁴⁰. Shtetet nuk janë të detyruara për të korigjuar situatën ekzistuese para gjykimit, por ato nuk mund të aplikojnë dispozitën që shkel Konventën dhe të marrin masa tranzitore për të bërë që rendi i tyre ligjor të jetë në përputhje me Konventën.

Gj.E.D.Nj shprehet se gjykatat kombëtare kanë juridiksion të plotë për të interpretuar të drejtën e brendshme, por ky interpretim duhet detyrimisht të bëhet në atë mënyrë që kontribon në zbatimin dhe respektimin e së drejtës komunitare. Shtetet antare të Bashkimit European kanë për detyrë për të krijuar mjete apo procedura të posaçme, për të rregulluar situatën kur akti administrativ⁴⁴¹, vendimi gjyqësor i formës së prerë⁴⁴² ose vendimi i arbitrazhit, pra ligji i

⁴⁴⁰ Për më tepër shih: <http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Presentation/About_en.asp>

⁴⁴¹ Shiko Vendimin dt 13.01.2004, çështja C-453/00, referuar si çështje paragjykimore *College van Beroep voor het bedrijfsleven- Hollandë Kuhne v. Heitz*. Duke vendosur detyrimin komunitar për shtetin anëtar e më pas edhe për organin administrativ kompetent që respektivisht të parashikojë mundësinë e më pas të veprjë për të realizuar rihapjen e procedurave administrative, në mënyrë që të merret parasysh dhe të respektohet interpretimi i drejtë i së drejtë komunitare.

⁴⁴² Shiko Vendimin e Gj.E.D.Nj, Dhoma e Madhe dt 14.09.2006 C-119/05 çështja *Ministero dell'Industria, dell' Commercio e dell' Artigianato v. Lucchini Spa*. Kompania Lucchini Spa i ishte akorduar një ndihmë shtetërore me vendim gjyqësor të formës së prerë. Por sipas vendimit të Komisionit European është kërkuar anulimi i i ndihmës së dhënë pasi është dhënë në kundërshtim me të drejtën komunitare, për këtë arsye duhet të kthehet mbrapsh çdo para e dhënë kompanisë duke e shhpalluar atë debitore. Për këtë arsye nga Gjykata Europiane u kërkuar që gjykata të interpretonte ligjin e brendshme në atë mënyrë që kontribon në zbatimin dhe respektimin e së drejtës Komunitare.

brendshëm, përplasat me të drejtën komunitare, duke synuar ribërjen e saj në përputhje me të drejtën komunitare.

Prandaj ekzistenca e mundësisë për të parashikuar në ligjin e brendshëm rishqyrtimin apo rihapjen e procedimeve është një mjet i rëndësishëm për të arritur restitutio in integrum⁴⁴³. Në këtë mënyrë mund të shmanget përgjegjësia ndërkombëtare e shtetit e diktuar kjo nga vendimi i Gj.E.D.Nj. Këtu përmendim rastet për Shqipërinë⁴⁴⁴, ku autoriteteve të brendshme u është kërkuar miratimi i legjislacionit të nevojshëm dhe marrja e të gjitha masave, që bëjnë të mundur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore apo administrative. Sikurse janë vendimet e ish-komisioneve për kthimin dhe kompensimin e pronave, vendimet gjyqësore të paekzekutuara, ndërmarrja e masave për të miratuar legjislacionin e duhur, ndryshimin e praktikave administrative apo gjyqësore, si dhe interpretimi⁴⁴⁵ i ligjit konform standardeve dhe jurisprudencës së gjykatës në raste të caktuara etj.

Kështu legjislacioni shqiptar ka ndryshuar neni 494 duke shtuar pikën e) të K.Pr.Civile duke parashikuar si shkak për rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, rasti kur Gj.E.D.Nj gjen shkelje të konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore ose e protokolleve të saj shtesë të ratifikuara nga shtetit Shqiptar. Një mjet i tillë nuk ekziston për sa i përket rihapjes së procedurave të brendshme gjyqësore lidhur me çështjet penale, pra një mundësi e tillë nuk është parashikuar shprehimisht në K.Pr.Penale. Kjo problematikë ka gjetur një zgjidhje nëpërmjet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁴⁴⁶, e cila ka bërë objekt të rishikimit edhe vendimet penale të formës së prerë sipas të njëjtave kushte me ato të parashikuara në procesin civil.

⁴⁴³Shihni Memorandumin shpjegues I Rekomandimit R (2000) 2, <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=334147>

⁴⁴⁴ Shihni rasti “Ramadhi kundër Shqipërisë”, 27 nëntor 2007, “Beshiri kundër Shqipërisë”, 22 gusht 2006, “Qufaj Co sh.p.k kundër Shqipërisë”, 30 mars 2005.

⁴⁴⁵ Shihni “Qufaj kundër Shqipërisë”, §41: *Në këtë kuadër, gjykata vlerëson se e drejta për proces të rregullt ligjor në Shqipëri duhet të ishte interpretuar në mënyrë që të garantonte një mjet juridik efektiv për shkeljet e pretenduara për mosrespektimin e kritereve të nenit 6§1 të konventës.*

⁴⁴⁶Shihni vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese paragrafi 20-22, Gjykata, ka arsyetuar se: *...në kërkesën për rishikim, kërkuesi F.M nuk parashtron asnjë nga shkaqet që parashikohen në dispozitën e nenit 450 të Kodit të Procedurës Penale, për të cilat mund të kërkohet rishikimi i vendimit penal të formës së prerë”. Këtë qëndrim të Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë në korrespondencën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese e konsideron si një situatë që ka krijuar “...në disa raste edhe precedentin negativ për shtetet e huaja, lidhur me imazhin e mosrespektimit të garancive të dhëna për rigjykimin e këtyre shtetasve.*

21. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesi ka pretenduar, se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos e vlerësuar garancinë për rigjykim që parashikohet nga Konventa për Ekstradimin, jo vetëm që ka shkelur një detyrim ligjor ndërkombëtar por, në të njëjtën kohë, nuk i ka krijuar as mundësinë për të qenë i pranishëm në seancë, me qëllim respektimin e parimit të barazisë së armëve. Pretendimin e kërkuetit për të qenë i pranishëm në seancë, në rastin në shqyrtim, Gjykata nuk e lidh me pjesëmarrjen e domosdoshme të kërkuetit në dhomën e këshillimit, por me mundësinë që iu duhet dhënë palëve për t’iu respektuar të drejtën për rigjykim, në kuptim të garancive që jepen nga Shteti Shqiptar, sipas Ligjit nr. 8322, datë 2.4.1998 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të Dy Protokolleve Shtesë”. Gjykata vlerëson, se interpretimi dhe zbatimi i legjislacionit penal dhe, në veçanti, shqyrtimi i ekzistencës ose jo të shkaqeve ligjore për rishikimin e vendimit, në çështjen konkrete, mbetet një atribut i vlerësimit për Gjykatën e Lartë.

22. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, në kuptim të rregullimeve të parashikuara në nenin 122 të Kushtetutës, interpretimi i konceptit kushtetues të vet-batueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të, është në vlerësimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili ka në juridiksionin e vet zgjidhjen përfundimisht të çështjes konkrete.

Ndonjëherë, Gjykata mund të përcaktoj në vendim një afat brenda të cilit duhet të adoptohen masat e kërkuara. Veçanërisht në rastet kur një problem strukturor është identifikuar, dhe gjykata ka lëshuar një vendim-pilot. Shtetet duhet të sigurojnë një zgjidhje të brendshme efektive për rastet e ngjashme që janë në pritje. Praktika e shteteve të ndryshme ka treguar se masat e përgjithshme janë kryesisht të natyrës legjislative, pasi ato kanë si qëllim parandalimin e shkeljeve të ngjashme që mund të ndodhin në të ardhmen. Ndërsa në rastin kur shkelja ka rezultuar nga praktika e gjykatave kombëtare që kanë interpretuar dispozitat ligjore në një mënyrë që ka shkelur Konventën, një modifikim në jurisprudencën gjyqësore mund të jetë një mjet i përshtatshëm për të respektuar vendimin. Informimi i autoriteteve përkatëse dhe të publikut në përgjithësi me vendimet e GjEDNj është provuar të jenë masa efikase për të parandaluar shkeljet në të ardhmen. Pas një rekomandim⁴⁴⁷ dhe një rezolutë⁴⁴⁸ e Komitetit të Ministrave për publikimin dhe shpërndarjen e vendimeve të Gjykatës, bënë që shtetet të inkurajohen për të siguruar se jurisprudenca përkatëse e Gjykatës është botuar shpejt dhe gjerësisht në gjuhën amtare duke ia shpërndarë organeve publike, me shënimet shpjeguese nëse është e nevojshme.

6.5.2. Masat individuale që ndërmarrin shtetet për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të GjEDNj

Këto detyrime ndaj shteteve për të marrë masa lindin nga neni 46/1 i Konventes Europiane të të drejtave të njeriut. Lloji tjetër i masave, janë detyrimet individuale që shtetet duhet të ndërmarrin në kuadër të ekzekutimit të vendimeve dhe ato janë: (a) detyrimi që të ndërpresë shkeljen apo vazhdimin e saj në lidhje me aplikuesin, (b) detyrimi për të siguruar aplikantin *restitutio in integrum*, që nënkupton rivendosjen e situatës përpara shkeljes dhe (c) së fundi detyrimi që të marrë masa për të parandaluar shkeljet në të ardhmen edhe në lidhje me individë të tjerë apo raste të ngjashëm të prekur nga shkelja, duke e bërë këtë nëpërmjet ndryshimit të ligjit.

Detyrimi që të ndërpresë menjëherë shkeljen bazohet në dy parashikime, njëri në Konventë në neni 46/1 dhe tjeri në nenin 1, i cili parashikon detyrimin e përgjithshëm për të respektuar të drejtat e njeriut ⁴⁴⁹. Shtetet e kanë aplikuar në forma të ndryshme këto lloj mase. Një praktikë e njohur është ai i revokimit të një akti ose urdhëri administrativ i brendshëm, i cili është në shkelje me Konventën, si për shembull revokimi i një urdhëri për ekstradim⁴⁵⁰. Një masë tjetër është përshpejtimi ose përfundimi i procedurave në pritje në rast të gjetjes së një shkelje të nenit 6 ⁴⁵¹. Detyrimi i dytë *restitution in integrum* ka të bëjë me detyrimin e shtetit për të riparuar dëmin e shkaktuar duke e vendosur të dëmtuarin ose aplikuesin në situatën ose pozitën e mëparshme në të cilën ai u ndodh për shkak të shkeljes së konstatuar⁴⁵². Në çdo rast, individi synon *restitutio in*

⁴⁴⁷ <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=331657&Sector=secCM&Language=lanEnglish&Ver=original>

⁴⁴⁸ [https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Rec\(2004\)4&Sector=secCM&Language=lanEnglish&Ver=original](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Rec(2004)4&Sector=secCM&Language=lanEnglish&Ver=original)

⁴⁴⁹ "Maestri kundër Italisë" 17 shkurt 2004

⁴⁵⁰ www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Documents/MIindex_en.asp). Këshilli i Evropës, Departamenti i ekzekutimit të vendimeve, lista e masave individuale

⁴⁵¹ Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Raporti i katert Vjetor, viti 2010

⁴⁵² *Brumarescu kundër Rumanisë* 23 Janar 2001

integrum përmes pagesës efektive të shpërblimit të drejtë dhe interesit në rast vonese të përcaktuar në vendim. Në rastin e detyrimit të shtetit për t'u kthyer në gjëndjen e mëparshme janë gjetur një sërë mënyrash për ta aplikuar këtë lloj mase. Shtetet mund të vendosin një procedurë që lejon rishikimin e procedurës penale si pasojë e një vendimi që ka gjetur shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

Komiteti i Ministrave në pajtim me Gjykatën thërret shtetet për të zbatuar rishikimin e procedurës, kur kushtet e Rekomandimit Rec (2000) janë plotësuar, apo të miratojë masa legjislative për të bërë të mundur rishikimin e procedurave, siç shprehet në rastin *Dorigo kundër Italisë*. Po ashtu si masë individuale shteteve mund t'i kërkohet edhe që të rishikojnë, revokojnë ose të lëshojnë urdhra administrative, si në rastin *Rodrigues Da Silva dhe Hoogkamer kundër Holandë*, ku shteti jep një leje qëndrimi pasi u gjet shkelje e nenit 8 të Konventës. Kjo zgjidhje është më e rëndësishme në situata ku nuk ka palë të treta që janë të përfshirë drejtpërdrejt, siç janë rastet e emigracionit.

Nëse kthimi në gjëndjen e mëparshme duket i paarritshëm, për shkak të natyrës së shkeljes. Kjo nuk nënkupton se shteti zhvishet nga detyrimi, por mund të aplikoj një masë tjetër që është ajo e pagimit të një shume të hollash, e cila në mënyrë të përafërt i korespondon dëmit të pësuar nga shkelja. Ky detyrim parashikohet në nenin 41 të Konventës. Nëse ligji i brendshëm i shtetit të thirrur njeh vetëm riparimin e pjesshëm, atëherë Gjykata Evropiane, kur konstaton shkelje mund të detyroj shtetin të dëmshpërblejë palën e dëmtuar. Gjykata ka diskrecion për të marrë një vendim të tillë⁴⁵³. Kjo masë, për të paguar një shumë të hollash është përdorur nga Gjykata edhe si një formë sanksioni ndaj shteteve që kanë kryer shkelje të Konventës.

Të gjitha këto masa kanë si qëllim sigurimin e një mbrojtje efektive e të drejtave dhe lirive themelore. Vendimet e GjEDNJ nuk e anullojnë automatikisht një veprim të një shteti që përbën shkelje të Konventës. Ato thjeshtë përmbajnë një deklaratë të detyrueshme të një shkeljeje⁴⁵⁴. Shtetet janë të detyruara që të sigurojnë dëmshpërblim, por kjo masë është lënë në diskrecionin e tyre se si të kryejnë këtë detyrim. Si masa individuale që janë aplikuar nga shtetet është edhe kthimi i shumave të parave ose të pronave. Raste të tilla mund të përmendim *Brumărescu dhe raste të tjera kundër Rumanisë*, ku shteti kishte detyrimin ose të kthejë pronat në favor të aplikantëve ose t'i paguajë një sasi parash që i korrespondon vlerës së pronave. Shteti mund të ndërmarrë si masë edhe ndryshimin e regjistrave të të dhënave kriminale ose regjistra të tjera zyrtare si në rastin *Mamère kundër Francës*.

6.5.3. Roli mbikqyrës i Komitetit të Ministrave në ekzekutimin e vendimeve të GjEDNJ

Ekzekutimi efektiv i vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përbën një nga angazhimet kryesore të Palëve të Larta Kontraktuese. Përmes ratifikimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe protokolleve shtesë të saj, shtete kanë

⁴⁵³ *Wildhaber*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut 2006, nr 31

⁴⁵⁴ Neni 44-46 i Konventës

marrë përsipër të respektojnë vendimet e GJEDNJ-së në çdo çështje ku ato janë palë. Ky angazhim buron nga neni 46 i KEDNJ-së, i cili parashikon fuqinë detyruese të vendimeve, procedurat për ekzekutimin e tyre, duke përcaktuar Këshillin e Ministrave si organin përgjegjës për mbikëqyrjen e këtij procesi. Parashikimi i Komitetit të Ministrave si mekanizmi mbikëqyrës i këtij procesi i shërben eliminimit të pengesave dhe vështirësive ashtu dhe ekzekutimit sa më efektiv të vendimeve të formës së prerë⁴⁵⁵.

Konstatimi i shkeljes së Konventës nga Gjykata krijon detyrimin për të ekzekutuar vendimin, përmes miratimit të masave individuale dhe atyre të përgjithshme. Parimi është që shtetet të mbeten të lirë të zgjedhin mjetet më të përshtatshme, për të respektuar vendimin nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave. Kapaciteti i brendshëm i shteteve për të ekzekutuar vendimet e Gjykatës është një element kyç për të siguruar të drejtat e Konventës. Komiteti i Ministrave mund të ushtrojë presione diplomatike gjatë takimeve të të Drejtave të Njeriut dhe përmes kontakteve të veçanta midis presidencës së Komitetit dhe autoriteteve shtetërore. Për këtë arsye, Komiteti i Ministrave nxit shtetet që të identifikojë një autoritet për të koordinuar procesin e ekzekutimit të vendimeve.

Në praktikë, shtetet kanë miratuar zgjidhje të ndryshme, ndërsa disa prej tyre ia kanë caktuar këtë rol një organi të nivelit të lartë qeveritar apo zyrtar ⁴⁵⁶, të tjerët këtë detyrë ia kanë caktuar Ministrisë së Drejtësisë apo trupit të saj përbërës ⁴⁵⁷, ose në Ministrinë e Punëve të Jashtme ⁴⁵⁸. Nga viti 2010 Komiteti i Ministrave ka përdorur një procedurë të dyfishtë, për të krijuar një sistem më transparent dhe efikas të mbikëqyrjes. Nga njëra anë, rastet në parim janë klasifikuar në rrugën e parë, që njihet si "procedurë standarde". Sipas kësaj procedure, Komiteti i Ministrave kufizon kontrollin e tij për të verifikuar nëse i është paraqitur ose jo nga shteti i paditur një plan veprimi ose raport. Nën këtë "procedurë standarde", Sekretariati i bën një vlerësim përfundimtar raportit të veprimit dhe propozon që Komisioni të miratoj një rezolutë përfundimtare për mbylljen e shqyrtimin të çështjes.

Nga ana tjetër, Komiteti i Ministrave mund të vendosë përjashtimisht të mbikëqyrë rastet që kërkojnë masa urgjente individuale, vendime pilote, rastet që paraqesin probleme të mëdha strukturore apo komplekse, dhe rastet ndërshtetërore nën rrugën e dytë, domethënë nën "procedurën e zgjeruara". Mbikëqyrës së këtyre rasteve iu është dhënë prioritet mbi rastet e "procedurës standarde". Sekretariatit i është besuar një rol më aktiv për të ndihmuar shtetet që të miratojnë dhe të zbatojnë planet e veprimit ⁴⁵⁹. Ideja kryesore e procedurës së dyfishtë është që të lehtësoj punën e Komitetit të Ministrave për ato raste kur nuk ka asnjë vështirësi të veçantë të paparashikuar. Në raportin vjetor të publikuar në vitin 2012, Komiteti i Ministrave përmendi se mbikëqyrja e ekzekutimit është bërë më efikase dhe transparente me miratimin e procedurës së dyfishtë. Në të vërtetë, numri i rasteve të përsëritura ka rënë në vitin 2011 për herë të parë në

⁴⁵⁵Në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës Komiteti i Ministrave mbështetet nga Departamenti për Ekzekutimin e Vendimeve, pjesë e Departamentit të Përgjithshëm për të Drejtat e Njeriut dhe Çështjet Ligjore. Procedura e mbikëqyrjes bazohet në "planet e veprimit" dhe "raportet e veprimit" të paraqitura nga shteti përkatës.

⁴⁵⁶ Itali, Austri

⁴⁵⁷ Britania e Madhe, Gjermani

⁴⁵⁸ Rumani, Turqi, Francë

⁴⁵⁹ Komiteti i Ministrave, "Modalitetet për një sistem të mbikëqyrjes së dyfishtë", (n 118) paragrafi 20

dhjetë vjet. Prandaj, reformat e miratuara tashmë kanë kontribuar për të zgjidhur çështjen e rasteve të përsëritura.

Efikasiteti i kësaj procedure varet nga vullneti politik i anëtarëve të Komitetit të Ministrave. Pra Komiteti mund të ndërmarrë këto masa: mund të ushtrojë presione diplomatike, mund të inkurajoj shtetet që të marrin masa aktive për ekzekutimin e vendimit duke lëshuar rezoluta të përkohshme kundër shteteve. Gjithashtu mund të përdorë si masë miratimin e vendimeve dhe njoftimeve për shtyp për të rritur ndërgjegjësimin e publikut kur problemet e ekzekutimit janë më pak serioze. Kështu Komiteti i Ministrave miratoi një deklaratë për shtyp në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të problemeve që lidhen me funksionimin e drejtësisë në Shqipëri dhe inkurajoi autoritetet të vazhdojnë përpjekjet e tyre.

Përveç masave të mësipërme Komiteti i Ministrave është i autorizuar sipas nenit 3 të Statutit të Këshillit të Europës për të pezulluar të drejtat e përfaqësimit të një shteti ose të kërkojë që shteti të tërhiqet nga organizimi. Kjo masë duhet të zbatohet në rrethana të jashtëzakonshme, kur shteti i paditur dhe Komiteti i Ministrave kanë dështuar të arrijnë një marrëveshje mbi masat e duhur për të siguruar ekzekutimin e vendimit, apo kur shteti nuk është i gatshëm ose është i paafte për të marrë masa të tilla.

6.5.4. Qëndrimi i mbajtur nga Komiteti i Ministrave në ekzekutimin e vendimeve të GjEDNj ndaj shtetit Shqiptar

Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka bërë publik në vitin 2009 një vendim në lidhje me progresin e arritur nga Shqipëria, në ekzekutimin e vendimeve të caktuara të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Vendimi i referohet procedimeve civile tepër të gjata dhe mungesës së zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke përmendur rastet e *Gjonboçari* dhe të *Marinit*. Komisioni vuri në dukje zhvillimet e fundit në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit kjo e fundit e konsideron veten kompetente për të shqyrtuar kërkesat për dëmshpërblim në lidhje me procedurat tepër të gjata të ekzekutimit. Ajo inkurajon zhvillimin e kësaj jurisprudence, në mënyrë që të sigurohet përsheptimi i procedurave, në të gjitha rastet kur palët nuk kanë marrë vendime përfundimtare brenda një kohe të arsyeshme. Komisioni megjithatë inkurajoi reflektim mbi masat e mëtejshme, sidomos në lidhje me nevojën për të ndryshuar legjislacionin që rregullon Gjykatën Kushtetuese.

Në rezolutën e ndërmjetme CM/ResDH(2013)115 e miratuar në qershor 2013, Komiteti i Ministrave u bëri thirrje autoriteteve shqiptare që të hartonin me prioritet maksimal një plan veprimi. Plan që do të mundësonte ngritjen brenda afateve të vendosura nga Gjykata të një mekanizmi kompensimi efektiv brenda një periudhe 18 mujore, duke mbajtur parasysh edhe masat e indentifikuara tashmë. Miratimi i kësaj rezolute të ndërmjetme erdhi si pasojë e mospërbushjes nga ana e autoriteteve shqiptare të detyrimit për paraqitjen e një plani veprimi të konsoliduar dhe të përditësuar në lidhje me ekzekutimin e vendimeve përkatëse. Komiteti i Ministrave arriti në përfundimin se finalizimi i hartës së vlerës së tokës ishte e vetmja masë e ndërmarrë nga qeveria. Autoritetet nuk kanë ndërmarrë ndonjë hap të rëndësishëm për

ekzekutimin e rreth gjysmës së këtyre vendimeve për një periudhë më shumë se tre-vjeçare, ku do të përfshihej edhe dorëzimi i një plani veprimi për ekzekutimin e vendimit.

Deri në tetor 2013 Komiteti i Ministrave ka përmbyllur mbikqyrjen e ekzekutimit të dy prej 32 vendimeve që Gjykata ka dhënë kundër Shqipërisë. Komiteti nuk kishte marrë asnjë informacion të saktë mbi numrin e vendimeve administrative dhe gjyqësore të formës së prerë që duhet të ekzekutohen, koston e ekzekutimit të tyre dhe burimet e nevojshme. Me ligjin nr.48 datë 07.05.2015 Shqipëria ratifikoi Protokollin e 16-të të Konventës “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, i cili paraqet një mekanizëm komunikimi ndërmjet gjykatave kombëtare dhe Gj.E.D.Nj. Ky mekanizëm do të përmirësonte ndërveprimin midis Gjykatës dhe autoriteteve kombëtare për zbatimin e Konventës, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Pra në hapësirën e Këshillit të Europës është prezantuar edhe një lloj gjykimi incidental tjetër, konkretisht marrja e opinionit këshillimor nga gjykatat e shteteve para Gj.E.D.Nj. në lidhje me dispozitat e K.E.D.Nj dhe protokolleve shtesë të saj.

Ligji që ratifikoi Protokollin duke e bërë pjesë të sistemit të brendshëm juridik shqiptar, nuk ka përcaktuar organin gjyqësor që legjitimohet për t’ju drejtuar Gj.E.D.NJ-ut me kërkesë për marrjen e opinionëve rekomanduese. Opinione mbi çështje parimore të lidhura me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë ose protokollet e saj, të cilat mund të kërkohen vetëm në kontekstin e një çështjeje të mbetur pezull para saj. Në mënyrë që protokollin të ishte sa më i qartë dhe i kuptueshëm për t’u zbatuar, duhet t’i ishte përcaktuar edhe organi që ka të drejtën për të kërkuar opion rekomandues.

Në kuadër të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, si element thelbësor në funksionimin e shtetit të së drejtës janë hartuar edhe projekte të ndryshme, si ai i “Eliminimi i pengesave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore vendase/Sigurimi i zbatimit efektiv të vendimeve të gjykatave vendase”⁴⁶⁰. Të gjitha këto projekte dhe aktivitete janë të lidhura ngushtë, dhe do të shërbejnë për të përforcuar punën e Komitetit të Ministrave në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ.

Shteti Shqiptar në kuadër të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ ka ndërmarë hapa të rëndësishëm, një fakt i tillë konstatohet edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, numri i madh i rasteve që janë në pritje pranë Gjykatës Europiane kundër Shqipërisë, për vitin 2013 ishin 106 raste, për vitin 2014 ishin 82 raste, dhe po ashtu, edhe për vitin 2015 reflekton për një sistem ekzekutiv jo efikas. Moszbatimi i këtyre vendimeve ka jo vetëm një kosto financiare ndaj individit që i është shkelur e drejta, por përbën një cenim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në shtetin tonë, pra një kosto për të gjithë shoqërinë.

Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore i atribuohet më tepër zvarritjes dhe zgjatjes në kohë. Përmirësimi i ekzekutimit jo vetëm të vendimeve të Gjykatës Europiane, por

⁴⁶⁰ Ky projekt u ndërmor nga Departamenti i Ekzekutimit të Vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Kohëzgjatja e tij ishte 36 muaj, duke filluar që nga Janari 2009. Vendet ku u zbatua ky projekt ishin gjashtë: Shqipëria, Azerbajxhani, Bosnje-Hercegovina, Moldavia, Serbia dhe Ukraina. Projekti u vu në zbatim në bashkëpunim me institucionet kombëtare respektive, ministritë e drejtësisë dhe financave, gjykatat e larta, gjyqtarët dhe përmbartësit, <http://www.coe.int/sq/web/tirana/excecution-of-echr-s-decisions>, aksesuar për here të fundit në datën 19.05.2016

edhe i vendimeve të gjykatave të brendshme përbënë një sfidë të rëndësishme të shtetit Shqiptar, me të cilën vazhdojmë të përballemi aktualisht. Kjo ishte arsyeja se, pse një nga masat e përgjithshme që autoritetet e brendshme ndërmorën, ishte privatizimi i shërbimit përmbarrimor gjyqësor duke e bërë një sistem miks, ku funksionojnë paralelisht përmbarrimit gjyqësor shtetëror edhe ai privat.

Problemet qëndrojnë në faktin se pavarësia e pushtetit gjyqësor duhet të respektohet, në veçanti në zbatimin e vendimeve gjyqësore. Kjo do të thotë të kuptosh, të respektohet dhe të zbatosh vendimet e gjykatave, pa vënë në dyshim asnjëherë pavarësinë dhe paanësinë e dhënies së tyre. Një ndër aspektet themelore të shtetit të së drejtës është edhe parimi i sigurisë juridike. Ky parim kërkon mbi të gjitha që kur gjykatat për një çështje të caktuar japin një vendim të formës së prerë, ky vendim nuk duhet të vihet në dyshim⁴⁶¹. Edhe pse me hyrjen në fuqi të ligjit për Gjykatën Administrative janë parashikuar dispozita⁴⁶² për marrjen e sanksioneve ligjore ndaj titullarit të institucionit nëse me veprimet, apo me mosveprimet e tij bëhet shkak për mos ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Përsëri rastet e aplikimit të këtij ligji në praktikë lënë për të dëshiruar. Kjo ndodh pasi mbështetja nga ana e gjyqësorit administrative në fushën ekzekutive është mjaft e dobët.

6.6. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjet që lidhen me aspekte të ekzekutimit të detyrueshëm

Të drejtat dhe liritë e njeriut janë të pandashme me rrugëtimin e tij gjatë gjithë jetës. Respektimi i tyre është një detyrim për një shtet që ai të jetë demokratik, në mënyrë që institucionet dhe e drejta të jetë më e konsoliduar. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë, si ligji më i lartë i vendit. Si pjesë e këtyre të drejtave është edhe gjykimi brenda një kohe të arsyeshme. Ky parim paraqet rëndësi për mos zvarritjen e proceseve gjyqësore pambarimisht, që e drejta e personit të vendoset brenda një afati të shkurtër, në mënyrë që të mos humbas efikasiteti dhe rëndësia e saj. Edhe e drejta për një proces të rregullt ligjor, është pjesë e të drejtave të njeriut dhe luan një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e tyre, e cila ka ndikim të drejtëpërdrejtë në veprimtarinë gjyqësore.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një gjykatë e cila shqyrton kërkesat për shkelje të dispozitave të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ajo e shtrinë autoritetin e saj, si për shtete anëtare të Bashkimit European, ashtu edhe për ato që nuk janë pjesë e bashkimit,

⁴⁶¹ Shih *Brumărescu v. Romania* [GC], nr. 28342/95, § 61, EHCR 1999-VII; *Ryabykh v. Russia*, nr. 52854/99, §§51-56, EHCR 2003-IX; *Roșca v. Moldova*, nr. 6267/02, §24,22 mars 2005.

⁴⁶² Neni 68 i Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikon se: *Përmbarruesi gjyqësor, në përfundim të afatit të ekzekutimit të detyrueshëm të caktuar nga gjyqtari, njofton me shkrim gjyqtarin për veprimet e kryera nga organi publik debitor. Në rast të moskryerjes me faj të detyrimeve, sipas vendimit apo urdhrave të gjykatës, pa shkaqe të përligjura, gjyqtari edhe kryesisht vendos gjobë ndaj titullarit të organit publik debitor. Masa e gjobës është e barabartë me 20 për qind të pagës minimale, në shkallë vendi, për çdo ditë vonesë në ekzekutim. Në rastet e konstatimit të moszekutimit të vendimeve, pa shkaqe të përligjura, gjyqtari kërkon marrjen e masave disiplinore dhe, kur është rasti, paraqet edhe kallëzim penal ndaj personave përgjegjës.*

por që kanë ratifikuar Konventën Europiane dhe Protokollet e saj. Proçesi ka karakter kontraditor duke u mbështur në provat që palët sjellin përpara kësaj gjykate. Që nga viti 1959 kur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka filluar veprimtarinë e saj, numri i vendime të dhëna ka ardhur duke u rritur. Kjo tregon për rolin që luan ky institucion, në mirëfunksionimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Jurisprudenca e kësaj Gjykate ka luajtur një rol të madh jo vetëm për shtetet antare, por edhe për shtetet e tjera jo anëtare, të cilët janë prekur nga vendimet e dhëna.

GJEDNJ udhëhiqet nga parimi i sundimit të ligjit. Ku përfshihet parimi i objektivitetit pra interpretimi i ligjit, pa privilegjuar asnjë palë. Gjykata është një institucion transparent në vendimarrje dhe ka parashikuar mekanizma të posaçëm për zbatimin e vendimeve, duke mos e lënë në arbitraritetin e shteteve. GJEDNJ mund të merret me çështjen vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike vendore, sipas rregullave në përgjithësi, të pranuar nga e drejta ndërkombëtare, dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data kur është marrë vendimi final. Sipas saj, rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme ligjore nuk është absolut dhe as nuk mund të zbatohet automatikisht⁴⁶³.

Gjatë vlerësimit nëse janë ezauruar të gjitha mundësitë ligjore efektive nga gjykata, gjithmonë ka qënë e rëndësishme të përcaktohet së çfare mjeteve sipas rastit kanë qënë në dispozicion të të dëmtuarit. Ajo që është më e rëndësishme fakti nëse këto mjete i kanë krijuar atij mundësi reale për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyre efektive⁴⁶⁴. Një aplikim mund të paraqitet qoftë nga Shteti kontraktues apo nga ndonjë individ, i cili deklaron të jetë viktimë e shkeljes nga njëra prej palëve Kontraktuese të Larta të të drejtave të paraqitura në Konventa dhe Protokolle.

Një kërkesë individuale konsiderohet e papranueshme me dispozitat e Konventës, apo të Protokolleve të saj, kur ajo është qartazi e pabazuar, kur është keqpërdor e drejta e aplikimit individual, apo kur aplikuesi nuk ka pësuar ndonjë shkelje të konsiderueshme. Në rast se gjykatësi nuk e shpall një kërkesë papranueshëm apo nuk e hedhë poshtë, kërkesa do t'i dërgohet Këshilli apo Dhomës për shqyrtim të mëtejshëm. Këshilli mund të vendos me vota unanime, për të shpallur të papranueshëm, apo për ta hedhur poshtë një aplikim dhe këtë mund ta bëjë pa e shqyrtuar më tej. Në rastin e pranueshmërisë Këshilli mund të marr vendim në bazë të meritave, nëse çështja e parashtruar ka të bëjë me interpretimin apo aplikimin e Konventës ose Protokolleve të saj.

Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ-së është i një rëndësie thelbësore jo vetëm për rritjen e besueshmërisë dhe të efektivitetit të sistemit të Konventës, si faktor përcaktues për uljen e ngarkesës së GJEDNJ-së⁴⁶⁵, por edhe për pasojat që sjell në dy drejtime kryesore: *së pari*, në rrafshin individual dhe *së dyti*, në atë më të përgjithshëm dhe abstrakt, në rrafshin shtetëror. Pasojat, në rrafshin individual lidhen me masën e përmirësimit të pozitës juridike të individit, i

⁴⁶³ *Akdivar dhe te tjere kunder Turqise*, vendim i datës 16.09.1996

⁴⁶⁴ *Ugurlukoci kunder Republikës Federale Gjermane*, vendim i datës 12.03.1987

⁴⁶⁵ Komiteti i Ministrave ka riafirmuar këtë qëndrim në sesionin e 120-të mbajtur në Maj 2010, në vazhdim të Konferencës së Nivelit të Lartë të Interlaken (shkurt 2010). i disponueshëm në: <<http://hub.coe.int/event-files/sessions-committee-of-ministers/session-11-may-2010>>

cili ka tashmë një vendim të GJEDNJ-së në favor, ashtu edhe me kompensimin real të dëmit që ka pësuar nga shkelja. Duke u referuar vendimeve të Gjykatës Europiane, marrim një informacion për mënyrën se si koncetohet në jurisprndencën europiane ekzekutimi i vendimit gjyqësor. Për këtë arsye, pjesë e këtij punimi është shqyrtimi i disa vendimeve të Gjykatës Europiane, dhe mënyrës së arsyetimit të tyre. Me qëllim implementimin e këtyre nocioneve të nevojshme në kuadrit e brendshëm ligjor, duke synuar transformimin e sistemit aktual për t'a bërë atë me eficient dhe produktiv.

6.6.1. Precedentët e vendosur nga jurisprudenca e GJEDNJ për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

Në 1997, në çështjen e njohur si *Hornsby kundër Greqisë*, GJEDNJ mori vendim se ka pasur shkelje të Nenit 6 paragrafi i parë të KEDNJ-së, nga ana e autoriteteve administrative të Greqisë⁴⁶⁶. Neni 6/1 nuk mund të përshkruaj në detaje garancitë procedurale të siguruar për palët në gjyq, prandaj ekzekutimi i vendimit të dhënë nga gjykata me këtë rast duhet të shikohet si pjesë përbërëse e “gjykimit” për qëllime të nenit 6. Për më tepër Gjykata tashmë e kishte pranuar këtë parimin në rastet e kohëzgjatjeve të gjykimeve.⁴⁶⁷

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore si pjesë e elementëve të procesit të rregullt gjyqësor, vendos detyrime pozitive mbi shtetet në mënyrë që ata të organizojnë instrumente efikase, për ekzekutimin dhe krijimin e strukturave të specializuara në këtë fushë. Megjithatë, kjo e drejtë do të ishte iluzion nëse sistemi gjyqësor i Shteteve Kontraktuese do të lejonte që një vendim gjyqësor final dhe i detyrueshëm të mbetet i pazbatueshëm në dëm të palës tjetër⁴⁶⁸. Pra çdo palë gjyqësore e një shteti mund të kërkojë mundësinë e marrjes së përgjegjësisë europiane të autoriteteve publike, por që ka të bëjë vetëm me gjykimet e dhëna në një shtet të caktuar dhe gjykimet zbatuese brenda këtij shteti⁴⁶⁹.

Gjykata Europiane vepron gjithmonë me një kontroll të rreptë lidhur me proporcionalitetin e drejtë, ndërmjet qëllimit legjitim të ndjekur nga shteti dhe të drejtës për ekzekutim të kreditorëve. Kështu, ajo konsideron se ky ekuilibër i drejtë nuk mund të mbështetet vetëm mbi situatën financiare të shtetit. Në këtë kuptim, interesi i përgjithshëm krejtësisht buxhetor nuk lejon përjashtimin e të drejtës për ekzekutim⁴⁷⁰.

Shteti si debitor, për shembull, në rastin *Burdov kundër Ruisë*⁴⁷¹ GJEDNJ nxori përfundimin se mungesa e fondeve nuk është një arsye për mos respektimin e borxhit. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e vendimit mund të arsyetohet në disa raste të caktuara. Mirëpo vonesa nuk mund të jetë aq e madhe sa të dëmtojë plotësisht thelbin e të drejtës nga dispozita e nenit 6/1. Në rastin në fjalë, parashtruesi i kërkesës nuk duhet të pengohet për të përfituar nga

⁴⁶⁶ Duke iu referuar: sipas praktikës së *Akdivar dhe te tjere kunder Turqise*, vendim i dates 16.09.1996

⁴⁶⁷ *Hornsby kundër Greqisë*; GJEDNJ Mars 19, 1997; numër 107/1995/613/701

⁴⁶⁸ *Burdov kundër Ruisë*, vendim i GJEDNJ-së i 7 majit 2002, paragrafët 33-38.

⁴⁶⁹ Natalie Fricero, Cilësia e vendimeve të drejtësisë në kuptim të nenit 6§ 1 të Konventës Europiane të të drejtave të njeriut, Revista Juridike nr.3 Shator 2015, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë

⁴⁷⁰ E drejta dhe Procedurat, 2002, f. 290, komentetet/vërejtjet e N. FRICERO.

⁴⁷¹ Po aty § 34- 35 I

kompensimi i dëmit të shkaktuar ndaj shëndetit, duke u justifikuar me vështirësitë e supozuara financiare që po kalonte Shteti.”

Roli thelbësor i përmbauesve gjyqësor në efektivitetin e zbatimit të vendimeve është vënë në dukje nga Gjykata Evropiane duke përfuruar detyrimet pozitive të shteteve. Për rrjedhojë është detyrë e shteteve që t’u vijnë në ndihmë agjentëve të kualifikuar për ekzekutimin. Në çështjen *Pini, Bertani, Maqnera dhe Atripaldi kundër Rumanisë* më 22 qershor 2004, Gjykata vëren se, lidhur me përpjekjet e zbatimit të drejtuar nga një përmbaues gjyqësor, ata “veprojnë në interesin e një administrimi të mirë të drejtësisë, gjë që bën që ata të jenë një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Prandaj shteti duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që ata ta kryejnë mirë detyrën për të cilën ata janë investuar. Shteti duhet t’i siguroj atyre ndihmën efektive të autoriteteve të tjera të cilët mund t’i japin një dorë ekzekutimit aty ku situata imponohet, në mungesë të kësaj, garancitë që kanë përfituar palët gjyqësore gjatë fazës gjyqësore humbasin çdo lloj arsye së qenuri”. Arsyetimi i Gjykatës nxjerr në pah domsdodshërinë e mirëfunksionit të shërbimit përmbaues në administrimin e drejtësisë, pasi pa këtë shërbim vetë sistemi i drejtësisë nuk do të kishte kuptim.

6.6.2. Rastet e Shqipërisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Shqipëria si anëtare e Këshillit të Evropës e ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 2 tetor 1996. Prej atëherë, Shqipëria është thirrur palë në çështje të shumta para GJEDNJ, e cila ka gjetur shkelje të Konventës dhe protokolleve, në një numër rastesh. Së paku, tri nga këto raste kanë qenë në bazë të asaj se shteti ka dështuar të ekzekutojë një vendim të formës së prerë.

Kohët e fundit është shtruar para profesionistëve shqiptarë çështja lidhur me mjetet e brendshme të ankimit, cilat prej tyre ofrojnë mbrojtje efektive për individët dhe deri ku shkon kjo mbrojtje. Një nga arsyet e këtij debati është edhe fakti se vitet e fundit janë shtuar kërkesat e shtetasve shqiptarë para GJEDNJ lidhur me vendosjen në vend të së drejtës së tyre të cenuar nga institucionet e brendshme shqiptare. Ankimi në GJEDNJ është një mjet subsidiar, pra mund të ushtrohet vetëm pasi të jenë shterruar të gjitha mjetet e brendshme juridike që sistemi i një vendi ka parashikuar për garantimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në KEDNJ⁴⁷².

Prandaj GJEDNJ ka theksuar se, shtetet duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet të garantojnë brenda sistemit të brendshëm mundësitë për të riparuar shkeljet, që administrata publike i bën individit. Si pjesë e përpjekjeve janë pa dyshim iniciativat dhe reformat legislative, por nuk ngelet pa rëndësi edhe praktika e vetë institucioneve që janë të ngarkuara drejtpërdrejt me mbrojtjen e të drejtave themelore. Të dyja këto të ndërthurura së bashku i shërbejnë një mbrojtjeje sa më të mirë të individit brenda sistemit kombëtar⁴⁷³

⁴⁷² Çështja *Z dhe të tjerë k. Britanisë së Madhe*, 10 maj 2001.

⁴⁷³ Shiko vendimin *Bankovic dhe të tjerë k. Belgjikës* dhe 16 shtete të tjera anëtare, 19 dhjetor 2001.

Gjykata Evropiane, me vendimin e datës 18 nëntor 2004 *Qufaj Co Sh.P.K. kundër Shqipërisë*⁴⁷⁴, ka trajtuar për herë të parë problematikën e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri. Në rastin në fjalë, Bashkia e Tiranës i kishte akorduar një shoqërie tregtare lejen për shesh ndërtimi, por jo lejen e ndërtimit për disa apartamente banimi. Si pasojë e humbjeve të konsiderueshme në aktivitetin e saj tregtar, shoqëria paditi Bashkinë e Tiranës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë duke kërkuar një dëmshpërblim. Pas hedhjes poshtë të kërkesës nga kjo gjykatë, shoqëria u ankua në Gjykatën e Apelit Tiranë e cila urdhëroi Bashkinë e Tiranës t'i paguante shoqërisë shumën 60.000.000 Lekë. Si rrjedhojë e mosparaqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, vendimi i lartpërmendur mori formë të prerë. Meqënëse ky vendim nuk u ekzekutua, shoqëria u ankua në Gjykatën Kushtetuese e cila e hodhi poshtë kërkesën me arsyen se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore ishte jashtë kompetencës së saj. Vonesa në ekzekutimin e një vendimi nuk mund të justifikohet në rast se ajo është në dëm të thelbit të së drejtës së mbrojtur në sensin e nenit 6 § 1 të Konventës.

Ky vendim është i rëndësishëm, jo vetëm për faktin se shteti shqiptar është dënuar për herë të parë në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut, por edhe se një shoqëri tregtare shqiptare ka mundur të marrë një dëmshpërblim të konsiderueshëm që përfshin dëmet materiale dhe jo materiale, për shkak të mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor në Shqipëri. Gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë⁴⁷⁵. Shqipëria vihej para detyrimit ligjor që të zbatonte vendimin e Gj.E.D.Nj. Kjo e fundit nuk mjaftohej vetëm me dëmshpërblimin që i akordonte ankuesit gjyqësor, por i vinte shtetit të gjetur me shkelje edhe detyrimin e rivendosjes së ligjshmërisë të së drejtës së shkelur. Pra një dështim tërësor ose i pjesshëm i ekzekutimit të vendimit të Gj.E.D.Nj, lindi përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit.

Në rastin *Driza kundër Shqipërisë*⁴⁷⁶, GJEDNJ-së iu desh të vendos për një rast ku vendimi përfundimtar i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë nuk ishte ekzekutuar për më tepër se gjashtë vite. Gjykata deklaroi se Qeveria nuk kishte ofruar asnjë shpjegim se pse vendim, që bazohen në të ashtuquajturin "Ligj për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës", nuk ishte ekzekutuar. Ekzekutimi i vendimeve në këto raste është njëra nga çështjet më urgjente të qeverisë së Shqipërisë. Mungesa e fondeve shtetërore nuk është argument që justifikon situatën. Për më tepër, autoritetet kombëtare e kanë lënë parashtruesit e kërkesës në një gjendje të paqartë për rastet e kthimit të pronës, për një kohë të konsiderueshme, duke bërë të pamundur marrjen e kompensimit dhe shfrytëzimin tyre. Dështimi për të ekzekutuar vendimet nga ana e autoritetet shtetërore nuk ndihmon në përmirësimin e sundimin të ligjit, përkundrazi nxit palët për të kërkuar ndihmë në zgjidhje jo të drejta.

⁴⁷⁴ *Qufaj Co. sh.p.k kundër Shqipërisë*, 18 nëntor 2004, kërkesa nr. 54268/00

⁴⁷⁵ Vendimi nr.6, datë 31.03.2006 i Gjykatës Kushtetuese.

⁴⁷⁶ Shih vendimin e GJEDNJ të datës 13 Nëntor 2007; kërkesa nr. 3371/02 paragrafi 91.

Gjykata e Strasburgut e ka përmendur Shqipërinë disa herë në lidhje me dështimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë⁴⁷⁷. Në veçanti për të drejtën e kthimit dhe kompensimit të pronës⁴⁷⁸, e cila përbën një ndërhyrje në të drejtën për një gëzim të qetë të pronës në kuptimin e nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës. Gjykata nxjerr në pah se sistemit i mungojnë instrumentet për t'i materializuar këto të drejta, që sigurisht meritojnë mbrojtje, siç është e drejta për ekzekutimin e vendimit. Konstatimi i këtij fakti nga GJEDNJ shtron nevojën për të reflektuar një zgjidhje më të mirë se ato ekzistuese, ndoshta zgjidhja që u ndërmor për liberalizimin e shërbimit përmbarimor duke e privatizuar atë, ishte e pamjaftueshme. Mendojmë se është i nevojshëm një reformim i sistemit të drejtësisë në përgjithësi dhe i shërbimit përmbarimor në veçanti.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur GJEDNJ edhe në një rast më të vonshëm, atë të *Nuri kundër Shqipërisë*⁴⁷⁹, ku u konstatua se aplikuesit i ishte cënuar e drejta e pronës, edhe pse aplikuesi nuk kishte shteruar të gjitha mjete e brendshme. Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës, ajo argumentoi se shteti kishte dështuar të sigurojë instrumente të autoriteteve që të organizojnë kthimin e duhur, duke iu referua edhe rasteve relevante nga e kaluara: *Driza kundër Shqipërisë* apo *Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*. Në këto kushte shtetit Shqiptar i linden detyrime që jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale, ose nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor. Me anë të këtyre masave synohet që t'i jepet fund shkeljes së gjetur nga Gjykata dhe të rregullojë pasojat e shkeljes. Kështu kërkuesi mund të rikthehet për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja. Shqipëria si shtet palë i Konventës gëzon diskrecionin për të zgjedhur se cila masë është më e përshtatshme.

Në rastin *Bajrami kundër Shqipërisë*⁴⁸⁰, vajza e parashtruesit të kërkesës ishte marrë nga nëna e saj në Greqi pa pëlqimin e tij. Me 22 Shkurt, 2004 Gjykata e Qarkut Vlorë, ka miratuar zgjidhjen e martesës së e parashtruesit dhe i ka dhënë atij kujdestarinë e fëmijës. Edhe pse parashtruesi i kërkesës ka marrë hapa për të siguruar kthimin e vajzës, vendimi asnjëherë nuk është ekzekutuar. Sipas zyrës së përmbarimit, ishte e pamundur të zbatohet vendimi pasi fëmija nuk ishte në Shqipëri. GJEDNJ vërejt se Shqipëria nuk i kishte ratifikuar instrumentet e rëndësishme për ribashkimin e prindërve me fëmijët e tyre, duke përfshirë edhe Konventën e Hagës të vitit 1980 për Aspektet civile të kidnapimit ndërkombëtar të fëmijëve.

Nga rasti Barjami del në pah se mjetet juridike të brendshme nuk janë efikase, pasi ato nuk kanë ofruar aksesin dhe efikasitetin e duhur në ribashkimin e prindërve me fëmijët. Mos ratifikimi i instrumentave përkatës ndërkombëtar dhe mungesa e një kuadri alternativ, që të siguroj mbrojtjen e duhur sipas dipozitave të Konventës, bëjnë të nevojshme që sistemi ligjor

⁴⁷⁷Shihni *Qufaj Co. sh.p.k.*, të cituar më lart, § 54-59, dhe *Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, 22 gusht 2006, Kërkesa nr. 7352/03 § 109 “ si çështje urgjente, për të marrë të gjitha masat ligjore, administrative dhe buxhetore, për të siguruar që pala parashtruese e kërkesës “në mënyrë të shpejtë” të marrë kompensimin apo tu jepet toka. Këto çështje duhet të përfshijnë krijimin e një fondi adekuat për të paguar aplikuesit të cilëve ju takon kompensimi financiar.”

⁴⁷⁸ Nenit 6§1 KEDNJ dhe Nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ

⁴⁷⁹ *Nuri kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 12306/04 datë 03.02.2009, par 38

⁴⁸⁰ *Bajrami kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 35853/04, 18 dhjetor 2007, par.65 dhe 66

shqiptar të riorganizohet. Riorganizimi duhet të bëhet në mënyrë të tillë që shtetit të njoh dhe zbatoj detyrimet positive që i lindin nga Konventa. GJEDNJ, në një sërë vendimesh të saj, ka vënë në dukje se përgjegjësia kryesore për zbatimin dhe vënien në jetë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të garantuara nga Konventa, është e autoriteteve kombëtare. Sistemi i KEDNj-së është, kështu, plotësues i sistemeve kombëtare, të cilat mbartin detyrimin parësor për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij. Shqipëria iu bashkua Konventës së Hagës, e cila hyri në fuqi me 1 gusht 2007.

Në çështjen *Gjyli kundër Shqipërisë*⁴⁸¹ GJEDNJ u shpreh se, çështja e shterimit të mjeteve të brendshme ligjore është e lidhur ngushtë dhe kryesisht me çështjen e efektivitetit të ankimit kushtetues në lidhje me moszbatimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar. GJEDNJ vërejtë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese njohën se ka shkelje të së drejtës së ankuesit për qasje në gjykatë lidhur me moszbatimin e vendimeve të gjykatave të brendshme. Gjithsesi konstatimet e tyre ishin deklaruese, prandaj Gjykata Kushtetuese nuk ofroi ndonjë ndreqje të përshtatshme. Veçanërisht ajo nuk akordoi ndonjë dëmshpërblim për dëme materiale dhe jo materiale, dhe as që mundi të ofrojë një perspektivë të qartë për parandalimin e shkeljes të pretenduar ose vazhdueshmërinë e saj⁴⁸².

Në vendimin pilot për çështjen *Mamushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë*⁴⁸³, Gjykata vuri në dukje se për këtë çështje iu desh të aplikonte procedurën për vendimet pilot, për shkak se autoritetet kanë dështuar në ekzekutimin e një numri vendimesh që lidhen me këtë problem. Qëllimi i procedurës së gjykimit –pilot është nxitja e Shtetit të paditur për të zgjidhur një numër të madh çështjesh individuale që lindin nga i njëjti problem strukturor në nivel të brendshëm, duke zbatuar kështu parimin e subsidiaritetit që fuqizon sistemin e Konventës⁴⁸⁴. Gjykata është shprehur se: “duke pasur parasysh numrin e çështjeve të ngjashme në pritje të shqyrtimit nga Gjykata si dhe statistikën e dhëna nga qeveria, Gjykata është tepër e shqetësuar se numri i regjistrimeve të aplikimeve të bazuara mund të rritet, duke krijuar kështu, një rrezik të madh për efektshmërinë e makinerisë së Konventës në të ardhmen”. Gjykata mori në shqyrtim të gjitha masat që kishin ndërmarrë autoritetet shqiptare për ekzekutimin e këtyre vendimeve dhe renditi masat që duhet të merreshin në një kontekst të tillë. Kjo duke patur parasysh barrën e konsiderueshme që do të sillte kompensimi financiar në buxhetin e shtetit. Gjykata i nxiti autoritetet të fillonin të përdornin forma alternative të “kompensimit”, të parashikuara në ligjin përkatës, çka do të ulte trysinë në buxhet dhe/ose do të sillte edhe metoda të tjera të kompensimit.

⁴⁸¹ *Gjyli kundër Shqipërisë*, kërkesa nr.32907/07, 29 shtator 2009, par.39

⁴⁸² Të njëjtën gjë GJEDNJ-ja e ka konstatuar edhe në vendimin *Marini kundër Shqipërisë*, datë 7.7.2008, apl. Nr.3738/02, par. 154; në vendimin *Hamzaraj kundër Shqipërisë*, datë 3.2.2009, par.30, apl. nr.45264/04, në të cilin shprehet se Gjykata rikujton konstatimin në vendimin e saj datë 23.10.2007, *Gjonboçari kundër Shqipërisë*, apl. Nr.10508/02, par.77, ku ka konstatuar se në sistemin e brendshëm juridik nuk ka pasur mjete juridike efektive lidhur me te zgjatjen e procesit; për pasojë, aplikanti shkarkohet nga shterimi i mjeteve të brendshme.

⁴⁸³ Vendimi *Mamushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 31 korrik 2012, ankimi nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, §108, <http://www.avokaturashetit.gov.al/vendimet-e-strasburgut/vendimet-e-gjykes-evropiane-per-te-drejtave-te-njeriut-strasburg>, hyrë për herë të fundit 20.07.2016

⁴⁸⁴ Shihni *Maria Attanasu dhe të tjerë kundër Rumanisë*, nr.30767/05 dhe 33800/06, vendim i datës 12.10.2010, bërë përfundimtar më 12.01.2011, § 212

Vendimet e GjEDNj janë deklarative në natyrën e tyre, pra deklarojnë shkejen e dispozitave të KEDNj. Megjithatë kjo gjykatë i jep rëndësi parimit *restitution in integrum*, sepse pasi shprehet se Konventa është shkelur, bazuar në nenin 1 të saj, ajo ka të drejten e shpërblimit të drejtë të palës së dëmtuar. Kur e drejta e brendshme mundëson vetëm ndreqjen e pjeshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, atëherë analizimi i saktë i vendimeve të kësaj gjykate, do të na ndihmonte për të bërë refomimin dhe përmirësimin mëse të nevojshëm në aktualitetin shqiptarë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka rreth 58 kërkesa kundër Shqipërisë, të komunikuar dhe 50 në pritje komunikimi, nga të cilat përmendim shkeljen e supozuar të të drejtave të pronësisë dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

Në shumicën e rasteve pretendohet çënim i së drejtës së pronës sipas nenit 1, Protokollit 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me pretendimet për të drejtën për gjykim të drejtë sipas nenit 6 dhe të drejtën për mjete efektive sipas nenit 13 të KEDNJ. Gjatë 2000-2012 janë ekzekutuar njëzet raste të tilla kundër Shqipërisë, në 16 raste të shkeljes së të drejtave të njeriut, është aplikuar sanksioni në shumën 6.571.876 euro dhe 1650 m² trualli. Shqipëria ka ekzekutuar tërësisht 11 vendime, ka dy vendime në procesin e zbatimit dhe 3 vendime në procesin e negocimit për kompensim.

Megjithëse numri i aplikimeve në pritje nuk është domethënës në krahasim me shtetet e tjera, anëtare të Këshillit të Evropës, mosekzekutimi i shpejtë i vendimeve të Gjykatës mund të sjellë si pasojë një numër më të madh aplikimesh në Strasburg. Numri i rasteve të paekzekutuara tregon se Shqipëria për momentin nuk ka vetëm probleme tipike të ekzekutimit, të shkaktuara nga mungesa e efikasitetit, injorimi i të drejtave pronësore, apo mosfinancimi i shërbimeve ekzistuese, por gjithashtu i mungojnë edhe mjetet financiare në mënyrë që të respektojnë detyrimet, të cilat dalin nga vendimet kundër shtetit.

Rritja e numrit të çështjeve gjyqësore kundër shtetit Shqiptar dëshmon për rëndësinë që legjislatori i brendshëm duhet ti kushtoj forcimit jo vetëm të kuadrit ligjor, por edhe atij institucional. Në hartimin dhe miratimin e procedurave dhe rregulloreve të duhura në nivel kombëtar, të cilat do të siguronin një zbatim më të mirë të vendimeve të gjykatave të brendshme. Përmirësimin e më tejshëm do t'a nxiste dhe zbatimi i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane në nivel kombëtar.

Konkluzione

Bazuar në të gjithë analizën e realizuar gjatë këtij punimi, në mënyrë të përmbledhur, e gjejmë të arsyeshme të parashtrojmë disa përfundime, në të cilat kemi arritur.

➤ Shteti shqiptar me evoluimin e tij ka zhvilluar paralelisht të drejtën dhe rendin juridik, që e ka disiplinuar atë. Legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ka njohur rrugën e vet të zhvillimit dhe të transformimit në varësi të zhvillimeve ekonomike, shoqërore, politiko-ideologjike. Një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, është detyrimi i autoriteteve publike për të vënë në zbatim urdhërimet e vendimet gjyqësore të formës së prerë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar.

➤ Në ndryshim nga ligji procedural civil, në ligjin e gjykatës administrative ligjvënësi ka parashikuar figurën e posaçme të gjyqtarit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Gjyqtari që ka dhënë vendimin, vazhdon vendimmarrjen e tij edhe gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit. Kjo, pasi gjyqtari i gjykatës administrative me kërkesën e palëve, ose të përmbartës gjyqësor edhe gjatë fazës që çështja është duke u ekzekutuar nga shërbimi përmbartës, mund të urdhëroj kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e kryerjes së tyre. Një risi mjaft e mirëpritur për efektet positive që duhet të sillte në praktikën ekzekutive, por për shkak të mbi ngarkesës së gjykatës administrative, nuk i është dhënë rëndësia e duhur.

➤ Në ligjin për Gjykatën Administrative janë parashikuar dispozita për marrjen e sanksioneve ligjore ndaj titullarit të institucionit, nëse ky i fundit me veprimet apo me mosveprimet e tij bëhet shkak për mos ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Në praktikë rastet e aplikimit të këtyre sanksioneve lënë shumë për të dëshiruar, pasi mbështetja nga ana e gjyqësorit administrative është e dobët.

➤ Në Kodin Civil dhe atë të Procedurës Civile, aktualisht në fuqi, nuk gjejmë një parashikim, i cili në mënyrë qartë të përcaktojë një afat parashkrimi për kërkimin e vënies në ekzekutim të një titulli ekzekutiv. Mendojmë se e drejta e kreditorit për të kërkuar vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv nuk mund të jetë e pakufizuar në kohë, pasi do të krijonte një pasiguri të vazhdueshme për marrëdhënien juridike. Disiplinimi i institutit të parashkrimit është i rëndësishëm për respektimin e parimit të sigurisë juridike, pasi i siguron marrëdhënies juridike qëndrueshmëri e nevojshme. Parashkrimi i ekzekutimit të një titulli ekzekutiv nuk hyn në ato fakte, ose ngjarje, që pas sjellin pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Ky argument bazohet në nenin 113/b të Kodit Civil, pasi kjo padi përmban elementet e një padie njohje negative dhe si e tillë nuk i nënshtrohet afateve të parashkrimit. Mendojmë se çasti kur duhet të filloj të eci afati i parashkrimit do të konsiderohet momenti kur kërkesa për ekzekutim të detyrueshëm i drejtohet zyrës së përmbartimit, dhe jo momenti kur individi i drejtohet gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhërin e ekzekutimit.

➤ Rasti i Procedurës Civile Shqiptare është pak i veçantë pasi i jep vendimit gjyqësor formë të prerë kur përfundon gjykimi në shkallën e dytë të gjyqësorit, ose siç njihet ndryshe në gjykatën e Apelit. Vendimi i formës së prerë apo që përbenë “gjë të gjykuar”, përjashton mundësinë e aktivizimit të juridiksionit rishikues të gjykatave më të larta për të rishqyrtuar sërish çka është vendosur për këtë çështje. Përsa më sipër, duhet të bëhen ndryshimet e nevojshme në legjislacion, në mënyrë që vendimi gjyqësor të përbëjë “gjë të gjykuar” vetëm pasi përfundon shqyrtimi në Gjykatën e Lartë. Këto ndryshime janë të nevojshme dhe përputhen me organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Mendojmë se më shumë se një rregullim që duhet të bëjë praktika gjyqësore, kjo çështje duhet rregulluar nga pikëpamja e ligjit duke saktësuar momentin se kur vendimi merr formë të prerë dhe përben *res judicata*.

➤ Shërbimi përmbartimor gjyqësor është një shërbim i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë. Ky shërbim është i pajisur me të gjithë mekanizmin institucional dhe praktik. Ai luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e ekuilibrave të sistemit të një shteti. Aktualisht vepron një shërbim miks ku kombinohet si shërbimi përmbartimor shtetëror ashtu edhe ai privat, duke sjellë si avantazh liberalizimin e tregut dhe rritjen e cilësisë së tij. Megjithatë janë evidentuar një sërë mangësish në shërbimin përmbartimor shtetëror dhe privat. Vështirësi kanë të bëjnë me: zgjatjen e pajustificuara në ekzekutimin e titujve ekzekutiv, mungesën e transparencës, paanshmërisë dhe përkushtimit në ushtrimin e detyrave, si dhe vonesa të mëdha në ekzekutim. Për këtë arsye, është thelbësore reformimi i mëtejshëm nëpërmjet ndryshimeve legjislative, për plotësimin e vakumit ligjor dhe nxitjes së bashkëpunimit korrekt ndërmjet institucioneve, në funksion të përmirësimit të situatës.

➤ Me ndryshimet e fundit që i janë bërë K.Pr.Civile, kryesisht nenit 511/a të tij, është suprimuar kërkesa për lëshimin e urdhërave të ekzekutimit për një vendim gjyqësor të formës së prerë. Nëpërmjet këtij ndryshimi, lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për një vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk është një proces më vete. Urdhëri lëshohet së bashku me vendimin përfundimtar nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin. Në këtë rast, kancelari konfirmon urdhërin e ekzekutimit, brenda pesë ditëve nga marrja formë të prerë e vendimit gjyqësor. Këto ndryshime i gjejmë në nenin 39 të Ligjit nr.122/2013 datë 18.04.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, ndryshime që kanë hyrë në fuqi në datën 01.09.2013 dhe ligji 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

➤ Neni 517 i K.Pr.Civile parashikon veprimin procedural të njoftimit të ekzekutimit vullnetar të titullit ekzekutiv. Mendojmë se, në këtë moment ende nuk kanë filluar ato veprime të përmbartuesit gjyqësor që përbëjnë shprehje të ekzekutimit të detyrueshëm dhe që sjellin pasoja për debitorin. Lajmërimi për ekzekutim vullnetar është një parakusht për nisjen e ekzekutimit të detyrueshëm. Ky veprim nuk sjell ende si pasojë cënimin e intesave të debitorit. Për këtë arsye debitori nuk mund të kërkojë me padi themeli të kundërshtoj lajmërimin për ekzekutim vullnetar duke përdorur neni 610 të K.Pr.Civile, i cili është një mjet mbrojtës gjatë fazës së ekzekutimit të

detyrueshëm. Përmbaruesi ende nuk ka filluar kryerjen e veprimeve të ekzekutim të detyrueshëm dhe mungon vetë kërkimi i zgjidhjes së pasojë së supozuar.

➤ Në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile përmbaruesi duhet të fillojë menjëherë me ekzekutimin e detyrueshëm duke e përjashtuar afatin e ekzekutimit vullnetar. Nëse përmbaruesi e ka filluar procedurën në bazë të nenit 517, nuk mund të ndërpresë këtë afat për të filluar ekzekutimin e detyrueshëm. Në këtë rast pala kreditore mund të kërkojë me një mjet tjetër procedural, siç është ai i masës së sigurimit, duke vendosur masë e sekuestros konservative në llogaritë e palës debitore, nëse arrin të vërtetojë ekzistencën e rrezikut dhe pamundësisë së ekzekutimit. Por në këtë rast vendimmarrja i takon Gjykatës dhe jo përmbaruesit gjyqësor, i cili vetëm zbaton titullin ekzekutiv pasi nuk ka tagër që të interpretoj titullin ekzekutiv.

➤ Legjislacioni shqiptar ka ndryshuar neni 494 duke shtuar pikën e) të K.Pr.Civile. Në Kod është parashikuar si shkak për rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, rasti kur Gj.E.D.Nj gjen shkelje të konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore ose e protokolleve të saj shtesë, të ratifikuara nga shtetit Shqiptar. Ndërkoh që një mjet i tillë nuk ekziston për sa i përket rihapjes së procedurave të brendshme gjyqësore lidhur me çështjet penale, pra një mundësi e tillë nuk është parashikuar shprehimisht në K.Pr.Penale. Kjo problematikë ka gjetur një zgjidhje nëpërmjet jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e cila i ka bërë objekt të rishikimit edhe vendimet penale të formës së prerë sipas të njëjtave kushte me ato të parashikuara në procesin civil.

➤ Referuar statistikave të hartuar nga Drejtoria e Studimeve, Botimeve dhe Kërkimeve pranë Gjykatës Kushtetuese, del në pah se numri i çështjeve që janë paraqitur për shqyrtimi nga individët pranë kësaj gjykate ka ardhur duke u rritur po ashtu edhe numri i vendimeve, në të cilat gjykata ka pranuar kërkesën për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor⁴⁸⁵. Gjykata Kushtetuese nëse konstaton shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm, mundet vetëm të urdhërojë përshpejtimin e procedurave. Ajo nuk ka kompetencë të vendosë asnjë lloj kompensimi financiar, kjo vendos në pikëpyetje efektivitetin e ankimit pranë kësaj gjykate.

➤ Ajo që shtrohet për diskutim, është fakti nëse konsiderohet ankimi individual pranë kësaj gjykate, si mjet efektiv sa i takon elementëve që lidhen me disa të drejta themelore procedurale si: *e drejta ankimit, e mbrojtjes, parimi i gjykatës kompetente, kontradiktoriteti në gjykim etj.* Mjeti efektiv i ankimit duhet të jetë i tillë, që jo vetëm të vendosë lidhur me të drejtat që parashikon KEDNJ, por edhe të rivendosë sa të jetë e mundur të drejtën e shkelur⁴⁸⁶. Gjykata Kushtetuese jo vetëm konstaton shkeljen e bërë nga gjykatat ose organet e tjera të administratës publike, por edhe shfuqizon aktin e prodhuar prej tyre si rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, duke ia kthyer atyre për rishqyrtim. Megjithatë, duke iu referuar rasteve konkrete, si dhe praktikës së GJEDNJ, ky ankim nuk rezulton të jetë efektiv sa i takon disa elementëve të veçantë të procesit të rregullt të tilla si p.sh: *çështjet që lidhen me të drejtën për dëmshpërblim,*

⁴⁸⁵ Arta Vorpsi, Procesi i rregullt ligjor ne praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Botime Maluka, Tiranë 2011, faqe 264

⁴⁸⁶ Vendim per çështjen *Scordino kundër Italisë* i datës 29 mars 2006 i Gj.E.D.Nj

çështjet që kanë të bëjnë me zgjatjen e procesit gjyqësor tej afatit të arsyeshëm si dhe me të drejta të tjera material.

➤ Standardet e konventës dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut duhet të udhëheqin veprimtarinë e gjithanshme të autoriteteve të brendshme, me qëllim shmangien në të ardhmen të kërkesave që ankuesit mund të paraqesin para gjykatës kundër shtetit shqiptar⁴⁸⁷. Prandaj ekzistenca e mundësisë për të parashikuar në ligjin e brendshëm rishqyrtimin apo rihapjen e procedimeve është një mjet i rëndësishëm për të arritur *restitutio in integrum*⁴⁸⁸. Në këtë mënyrë mund të shmanget përgjegjësia ndërkombëtare e shtetit e diktuar kjo nga vendimi i Gj.E.D.Nj.

➤ Me ligjin nr.48 datë 07.05.2015 Shqipëria ratifikoi protokollin e 16-të të konventës “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, i cili paraqet një mekanizëm komunikimi ndërmjet gjykatave kombëtare dhe Gj.E.D.Nj. Në hapësirën evropiane është prezantuar një tjetër lloj gjykimi incidental, konkretisht marrja e opinionit këshillimor nga gjykatat e shteteve para Gj.E.D.Nj. Në këtë mënyrë do të përmirësohet zbatimi i Konventës në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

➤ Ligji që ratifikoi Protokollin duke e bërë pjesë të sistemit të brendshëm juridik nuk ka përcaktuar organin gjyqësor që legjitimohet për t’ju drejtuar Gj.E.D.NJ-ut. Ky organ legjitimohet për marrjen e opinione rekomanduese mbi çështje parimore të lidhura me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë ose protokollin e saj. Në mënyrë, që protokollin të ishte sa më i qartë dhe i kuptueshëm për t’u zbatuar, duhet t’i ishte përcaktuar nga ligji që e ratifikoi dhe gjykata që ka të drejtën për të kërkuar opion rekomandues.

➤ Në çështjet kundër Shqipërisë⁴⁸⁹ Gj.E.D.Nj-ut ka kërkuar marrjen e të gjitha masave, që bëjnë të mundur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore apo administrative. Sikurse janë vendimet e ish-komisioneve për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe vendimet gjyqësore të paekzekutuara. Masa që konsistojnë në miratimin e legjislacionit të duhur, në ndryshimin e praktikave administrative apo gjyqësore, si dhe në interpretimin⁴⁹⁰ e ligjit konform standardeve dhe jurisprudencës së gjykatës në raste të caktuara.

➤ Padia e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv është një padi e rregullt njohjeje. Ajo është e lidhur drejtpërdrejtë me themelin e çështjes dhe si e tillë i nënshtrohet një gjykimi të zakonshëm kontradiktor. Kjo padi nuk i nënshtrohet afateve të parashkrimit. Legjimitetin aktiv i përket debitorit, ndërsa legjimiteti pasiv i takon kreditori. Këto subjekte jo gjithmonë janë të pandryshueshmë, përjashtim bëjnë rastet e suksedimit të të drejtave, por me kusht që identiteti i

⁴⁸⁷ Enkeledi Hajro *Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika gjyqësore e brendshme; detyrimet pozitive dhe negative në kuadrin e zbatimit të Konventës Europiane*, Revista Juridike nr.1 2011, Shkolla e magistraturës, Tiranë

⁴⁸⁸Shiko Memorandumin shpjegues i Rekomandimit R (2000) 2, <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=334147&Site=CM>

⁴⁸⁹ Shih *Ramadhi kundër Shqipërisë*, 27 nëntor 2007, *Beshiri kundër Shqipërisë*, 22 gusht 2006, *Qufaj Co sh.p.k kundër Shqipërisë*, 30 mars 2005.

⁴⁹⁰ Shih *Qufaj kundër Shqipërisë*, vendim i datës 30.03.2005, §41: “Në këtë kuadër, gjykata vlerëson se e drejta për proces të rregullt ligjor në Shqipëri duhet të ishte interpretuar në mënyrë që të garantonte një mjet juridik efektiv për shkeljet e pretenduara për mosrespektimin e kritereve të nenit 6§1 të konventës.

tyre juridik nuk ndryshon. Kompetente për gjykimin e padisë për pavlefshmërinë e titullit është gjykata e vendit ku bëhet ekzekutimi i titullit ekzekutiv.

➤ Shkaku ligjor i padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv qëndron, në të drejtën e debitorit për t'u çliruar nga një detyrim, i cili rrjedh nga titulli ekzekutiv. Kjo për shkak të mospërputhjes ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutiv, me realitetin që ekziston efektivisht, kur e drejta e kreditorit nuk ka ekzistuar si e tillë që në origjinë, ose për fakte shues ose të ngjara pas formimit të titullit. Në varësi të llojit të titullit ekzekutiv që do të zbatohet, ligji bënë një dallimi edhe të shkaqeve të kundërshtimit të tij.

➤ Në varësi të rrethanave që kanë ndodhur nga momenti i formimit të titullit ekzekutiv, deri në momentin që kërkohet ekzekutimi, kemi të bëjmë me dy lloj pavlefshmërie, pavlefshmëri absolute ose relative. Si të tilla mund të përmendim rastet kur titulli nuk ka ekzistuar ose është absolutisht i pavlefshëm. Rasti kur titulli ka ekzistuar, por më pas është shfuqizuar dhe në këtë mënyrë ka humbur fuqinë ekzekutive pra është deklaruar relativisht i pavlefshëm. Në rastin kur titulli ekzekutiv është një vendim i formës së prerë, ky mund të goditet vetëm për fakte shuese apo penguese të ngjara pas marrjes formë të prerë të këtyre vendimeve. Në rast të kundërt, pretendimi mund t'i paraqitet gjykatës vetëm nëpërmjet kërkesës për rishikim të vendimit.

➤ Njohja e mirë e elementëve të padisë së pavlefshmërisë së titullit do t'i ndihmojë palët, në veçanti debitorin për të mbrojtur më mirë të drejtat gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Risitë e sjella nga ndryshimet në K.Pr.Civile kanë prekur edhe këtë padi, ndryshime të cilat praktika gjyqësore i ka trajtuar me së miri duke i dhënë zgjidhje e duhur.

➤ Padia për kundërshtimin e veprimeve përmbareme është një tjetër mjete mbrojtës gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Studimi i elementëve të saj na ndihmon në njohjen më të mirë të subjekteve që gëzojnë të drejtën për ta përdorur këtë mjet, të gjykatës që gëzon kompetencën lëndore dhe territoriale për shqyrtimin e kësaj padie. Njohja e karakteristikave procedurale na mundëson të bëjmë dallimin midis kësaj padie dhe mjeteve të tjera mbrojtës. Në këtë mënyrë do të bëhet zgjedhja e mjetit të duhur për mbrojtjen dhe rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Shqyrtimi i kësaj padie brenda afati 20-ditor jo vetëm që do të përmbushë kriterin ligjor, por do t'i sigurojë një proces ekzekutiv eficient.

Rekomandime

Bazuar në konkluzionet e mësipërme parashtrihen disa sugjerime të cilat finalizojnë këtë punim me qëllim përmirësimit të legjislacionit. Rekomandohet që në të ardhën të trajtohen me prioritet çështjet e mëposhtme

➤ Propozojmë që nëneni 511 i K.Pr.Civile të ndryshohet në mënyrë të tillë që të parashikohet mundësia që të gjitha paditë dhe kërkesat që ngrihen gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të një titulli ekzekutiv, të shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar që është kompetentë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.

➤ Në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile përmbaruesi duhet të fillojë menjëherë me ekzekutimin e detyrueshëm duke e përjashtuar afatin e ekzekutimit vullnetar. Në mënyrë që përmbaruesi si palë mbi palët në procesin e ekzekutimit, të respektoj të drejtën e debitorit dhe situatën e tij, por pa cënuar të drejtën e kreditorit. Propozojmë se nëse do të duhet të kalohej menjëherë në ekzekutim të detyrueshëm sipas nenit 519, kundrejt këtij veprimi kreditori duhet të ofrojë një garanci, kundrejt çdo dëmi të mundshëm që mund ti vij debitorit. Ky ndryshim duhet bërë duke marrë si model rastin e ngjashëm që parashikohet në K.Pr.Civile Italian, nenin 482 të tij. Ndryshim që do të qartësonte pozitën e përmbaruesit karshi palëve në proces.

➤ Ndodh shpesh që përmbaruesit gjyqësor gjatë punës së tyre të hasin vështirësi në vërtetimin e faktit të ekzistencës së kredisë së debitorit tek personi i tretë, pasi informacioni refuzohet që të jepet i saktë. Për këtë arsye mendojmë se një formulim i ri i dispozitës 581 i K.Pr.Civile do ta bënte aplikimin në praktikë më efektiv.

➤ Në lidhje me lehtësimin dhe përshpejtimin e procedurave përmbarimore, rekomandojmë që të bëhen ndryshime në dispozitat e K.Civil dhe K.Pr.Civile, në lidhje me institutin e parashkrimit. Në kod duhet të parashikohet shprehimisht parashkrimi i së drejtës për të vënë në ekzekutim një titull ekzekutiv. Jo vetëm kaq, por të disiplinohet momenti i fillimit të afatit të parashkrimit, kohëzgjatja e tij dhe rastet përjashtimore. Një ndryshim i tillë do të ndihmonte palët për të mbrojtur më mirë të drejtat e tyre, si dhe zbatuesit e së drejtës për të qenë më të saktë në aplikimin e institutit të parashkrimit të së drejtës për të vënë në ekzekutim një titull ekzekutiv.

➤ Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor për ekzekutimin, në përputhje me standardet e vendeve anëtare të BE-së, mbetet ende një sfidë që duhet përmbushur. Për këtë duhen shqyrtuar mundësitë për hartimin e një ligji të ri për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, ndoshta kjo në formën e një Kodi në fushën e ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Kod i cili do të ndihmonte në unifikimin e praktikës përmbarimore gjyqësore dhe plotësimin e evakumit ligjor në këtë fushë.

➤ Trajnimi i juristëve përmbarimorë është e vetmja rrugë drejt suksesit dhe konsolidimit të këtij profesioni në Shqipëri. Për këtë arsye duhet të inkurajohet ngritja e një shkollë për këtë qëllim. Një praktikë e tillë ndiqet nga shumë vende europiane të cilët e kanë pjesë të detyrueshme trajnimin fillestar për profesionin e përmbaruesit. Propozojmë që kjo strukturë të jetë organ i Dhomës Kombëtare të përmbaruesve gjyqësor privatë me objekt formimin teorik dhe trajnimin rigoroz të përmbaruesve gjyqësor për rregullat e etikës dhe standardeve profesionale.

➤ Në kuadër të reformit të shërbimit përbarimor propozojmë krijimin e një mekanizmi të veçantë kontrolli dhe monitorimi për vlerësimin e ekzekutimit në aspektin e legjitimitetit. Për këtë nuk mjafton vetëm trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm, i kësaj trupe juristësh përbarimor, por po aq i rëndësishëm është edhe implementimi i sistemit të vlerësimit individual të përbaruesve gjyqësor. Në këtë mënyrë i gjithë shërbimi përbarimor do të fuqizonte aftësitë e tij në këndvështrimin profesional, funksional dhe financiar, si një shërbim konkurrues.

➤ Për bërë të mundur këtë të fundit propozojmë krijimin e një *database* publike për të përmirësuar sistemin e menaxhimit të çështjeve përbarimore. Sistemi ALBIS duhet të rivendoset në funksionim dhe të sigurohen mekanizma mbrojtës ndaj çdo sulmi kibernetik. Të dhënat e mbledhura do të shërbenin për të marrë informacion në kohë reale për çdo çështje përbarimore. Një kontribut të veçantë do sillni të dhënat statistikore në fushën ekzekutive. Të dhënat do të pasqyroni situatën reale dhe domosdoshmërinë se ku duhet të ndërhyj legjislatori për të përmirësuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

➤ Në kuadër të dixhitalizimi të informacioni ka ardhur koha që edhe në praktikën përbarimore shqiptare të bëhet i mundur marrja e informacionit elektronik në lidhje me llogaritë bankare të debitorëve. Informacion që merret drejtëpërdrejtë nga bankat pa qënë e nevojshme dërgimi i shkresave pafund. Një akses i tillë në sistemin e të dhënave të bankave kërkon një investim të madh, që sigurisht kërkon mbështetjen e padiskutueshme të shtetit për t'u materializuar.

➤ Rekomandojmë që të përcaktohet një mekanizëm i qartë ligjor për numrin e përbaruesve gjyqësor privatë, bazuar kjo në një vlerësim të rregullave ekzistues për numrin e licensave dhe praktikave më të mira evropiane. Puna e Dhomës Kombëtare, si përfaqësuese profesionale e përbaruesve gjyqësor, duhet të intesifikohet më tepër në planin e mbrojtjes së të drejtave të përbaruesve gjyqësor gjatë punës së përditshme. Kështu në situatën e krijuar me hyrjen në fuqi të VKM-së nr.37, datë 21.01.2016⁴⁹¹ qëndrimin i trupës përbarimore, duhet të ishte më aktiv, pasi prekej drejtëpërdrejtë interesin ekonomik i secilit përbarues gjyqësor gjatë ushtrimit të profesionit të tij.

➤ Në K.Pr.Civile duhet të shtohet një mjet i ri mbrojtës gjatë fazës së ekzekutimit krahas mjete ekzistuese. Propozojmë që të parashikohet një mjet që të siguroj të drejtën e kreditorit për t'iu drejtuar gjykatës së vendit të ekzekutimit, për të shqyrtuar pretendimet e tij për personat dhe veprimet që kanë shkaktuar mosekzekutimin e titullit ekzekutiv. Nëpërmjet këtij ndryshimi bëhet e mundur që në rast vonesash të pajustificuara në ekzekutimin, gjykata të vendoset mënyrë ose veprimin konkret që duhet ndërmarrë, përbaruesi për ekzekutimin e sukseshëm. Nëse është i nevojshëm të përcaktohet një afat i prerë për ekzekutimin apo edhe mundësia e aplikimit të gjoba që do të duhet të kalojnë në favor të kreditorit si kompensim, për vonesat e shkaktuara.

➤ Një mjet, me anë të të cilit pala e interesuar ka mundësinë për të ndikuar drejtëpërdrejtë në një përshpejtim të procesit. Me anë të kësaj padie, qytetari jo vetëm konstaton tejzgjatjen pa arsye

⁴⁹¹ Vendimi të Këshillit të Ministrave nr.37, datë 21.01.2016 "Për përcaktimin e pagës mujore për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personat e regjistruar si të vetëpunësuar, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike profesionale dhe punonjësit e papaguar të familjes që punojnë dhe bashkëjetojnë me të"

të procesit, por mund të marrë dhe dëmshpërblim për vonesën e shkaktuar, nëse e kërkon këtë, në mënyrë që individi para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese të ketë të drejtë të ankohet fillimisht në gjykatat e zakonshme.

➤ Në K.Pr.Civile duhet të parashikohet gjithashtu një mjet që i jep mundësi përmbaruesit gjyqësor për t'iu drejtuar gjykatës kompetente, në rastet e pamundësisë të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore deklarative, apo të vendimeve që objektivisht nuk mund të zbatohen. Për këtë arsye përmbaruesi i kërkon gjykatës saktësimin dhe mënyrën se si duhet të vijoj procedurën e ekzekutimit. Gjyqtari që ka dhënë vendimin e themelit duhet të saktësoj mënyrën e ekzekutimit që duhet të ndjek përmbaruesi, për të përmbushur detyrën e tij në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

➤ Udhezimi nr.1 i datë 04.06.2014 i Këshillit të Ministrave duket se i ka dhënë një zgjidhje me të mirë problemit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore ndaj institucioneve debitore. Propozojmë që në udhëzim të parashikohet përgjegjësia ligjore e titullarëve të njësive të përgjithshme ose vendore, në rastet kur ata me veprimet ose mosveprimet e tyre bëhen shkak për zvarritjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

➤ Për rastet me objekt konstatimin e cënimit të procesit të rregullt ligjor, për shkak të moszekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, do të sugjeronim ndryshime në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese. Ndryshimet duhet të përcaktojnë rregulla më të plota dhe të qarta, që i japin të drejtën gjykatës edhe për caktimin e dëmshpërblimeve për individët, në raste të konstatimit të shkeljes së të drejtave të tyre. Në këtë mënyrë ajo do të ketë në dorë të njëjtin mjet që përdor edhe GJEDNj në raste analoge.

➤ Sugjerojmë që në ndryshimet e ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, të përfshihet dhe e drejta e kërkesve, që për kohëzgjatje të procesit tej afateve të arsyeshme të kenë mundësi të ankohen në Gjykatën Kushtetuese edhe pa ezauruar të gjitha mjetet e ankimit. Ky parashikim duhet të pasohet nga e drejta e Gjykatës Kushtetuese për të urdhëruar organin administrativ/gjykatën e zakonshme për përshpejtimin e procesit, pasi ka konstatuar arsyet e tejzgjatjes dhe organin përgjegjes për shkeljen.

BIBLIOGRAFIA

Doktrinë:

- Alqivjadh Lamani, “Procedura Civile e Republikës Popullore Socialiste” Tiranë 1961;
- Arta Vorpsi, Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Botime Maluka, Tiranë 2011;
- Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol ÇOMO, “Vështrim krahasues mbi procedure civile”, Shkolla e Magjistraturës, Tiranë 2006;
- A.Drzemczewski & J. Meyer-Ladewig, “Principal characteristics of the new ECHR control mechanism as established by Protocol No.11, Human Rights Law Journal 1994;
- Barkhuysen Tom and Van Emmerik Michiel, ‘A comparative view on the execution of the judgments of the European Court of Human Rights’;
- Christou Theodora A., Raymond Juan Pablo (ed.), *European Court of Human Rights, remedies, execution of judgments* (British Institute of International and Comparative Law 2003);
- Christou Theodora A. and Raymond Juan Pablo (eds.), *European Court of Human Rights, Remedies and execution of judgments* (British Institute of International and Comparative Law) 2005;
- Deborah Forst, The execution of judgment of the european court of human rights, ICL Journal;
- Elisabeth Lambert-Abdelgawad, “The execution of judgments of the European court of human rights, Council of Europe Publishing, Concil of Europe, 2002;
- Enkeledi Hajro "Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika gjyqësore e brendshme; detyrimet pozitive dhe negative në kuadrin e zbatimit të Konventës Europiane", Revista Juridike nr.1 2011, Shkolla e magjistraturës, Tiranë;
- Erjon Bani “Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të titujve ekzekutiv”, Tiranë 2012;
- Eriol Roshi “ Titujt ekzekutiv dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile” viti 2005;
- Helen Keller, Andreas Fischer and Daniela Kuhne, “ Debating the future of European Court of human rights after the Interlaken conference: two innovative propoasals, The European Journal of international law vol.21, no 4 EJIL 2011;
- Faik Brestovci, “ E drejta Procedurale Civile II”, Ribotim 4, shtepia botuese “Grafo Beni” Prishtine 2006;
- Florjan Kalaja, Dilema Kushtetuese I, botuar nga shtepia botuese Fan Noli, Tirane 2016;
- Grup autoresh, “Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri” pjesa e II-të, botim i vitit 1994;
- Greer Steven, The European Convention on Human Rights: achievements, problems and prospects (Cambridge University Press) 2006;
- Ismet Elezi “E drejta zakonore e labërisë...” botim i sipërcituar, fq 41;

- Irakli Nocka “Gjyqtarët e Shqipërisë gjatë gjysmëshekullit” Drejtësia Popullore Nr 5, botim i vitit 1962;
- Kanuni i Lek Dukagjinit;
- Keller Ellen, Fischer Andreas and Kühne Daniela, ‘Debating the future of the European Court of Human Rights after the Interlaken Conference: two proposals’, 21 *The European Journal of International Law* 4 (2010) 1025-1048;
- Koço Nova “Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri”, Botim i UT Fakulteti i shkencave politike e juridike, viti 1982;
- Koço Nova “E drejta zakonore shqiptare” pjesa I, botim i vitit 1989;
- Nonda Papuli “Organizimi i shtetit të parë shqiptar” Drejtësia Popullore, Nr 5, botim i vitit 1962;
- Nuni A (2012) “Edrejta, drejtësia dhe ne, ne 20 vjet refleksione” Konferenca “Reforma gjyqësore si një ndër 12 prioritetet e sfidës së integritetit të Shqipërisë në BE Tirana Albania;
- Revista juridike nr.1 Marsela Dervishi “Parashkrimi i vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, efekti i tij në paditë që ngrihen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm”, botuar nga Shkolla e Magjistraturës, Tiranë Mars 2013;
- Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë autorit Prof.Xhezair Zaganjori Prof.Aurela Anastasi dhe Dr.Eralda (Methasani) Cani botuese Adelprint shtëpi 2011;
- Tom Barkhuysen & Michiel L. van Emmerik “Legal protection against violations of the European Convention on human rights: improving (Co-)operation of Strasbourg and Domestic Institutions, *Leiden Journal of international Law* 833-85(1999);
- Barkhuysen Tom and Van Emmerik Michiel, ‘A comparative view on the execution of the judgments of the European Court of Human Rights’, in Christou Theodora A., Raymond Juan Pablo (ed.), *European Court of Human Rights, remedies, execution of judgments* (British Institute of International and Comparative Law 2003) 1-23;
- Toska.E “Albanian Constitutional Court as an effective remedy under the European Convention on Human Rights in relation to non-execution of judicial decisions final "Albanian magazine for legal studies, Vol 1 2011;
- Vahid Lama “E drejta Procedurale Shqiptare”, Pjesa I, Dispenca II, Tiranë 1974;
- Valentina Kondili, “E drejta Civile I” Pjesa e përgjithshme, Ribotim, Geer 2008;

Legjislacion i brendshëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994.
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8166, datë 29.03.1996.

- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003.
- Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare, i cili hyri në fuqi në 1 Prill të vitit 1929 (i njohur si Kodi Civil i Zogut).
- Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 6340, datë 26.06.1981, ka hyrë në fuqi në 1 Janar të vitit 1982.
- Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Ligji nr.7895, datë 27.01.1995
- Kodi i Procedurës Penale, miratuar me Ligji nr.7905, datë 21.03.1995,
- Kodi i Etikës së Përmbardësve Gjyqësorë Privatë dhe Shtetëror, miratuar me urdhërin nr. 3852, datë 08.05.2009, të Ministrit të Drejtësisë
- Ligji nr 8730 datë 18.1 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbardësor gjyqësor " Fletore Zyrtare nr.1
- Ligji nr. 10031 date 11.12.2008 "Për shërbimit përmbardësor gjyqësor privat"
- Projekti Binjakëzimit të BE-së Nr. AL/12/IB/JH/02 ``Përmirësimi i sistemit përmbardësor në Shqipëri`` 29 Prill 2015- 30 Tetor 2016, përditësuar në dhjetor 2015, faqe 2
- Ligji nr.9901dt.14.4.2008" Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " Fletore Zyrtare nr.60 ,fq. 2631
- Ligji nr.9121 dt.28.7.2003"Për mbrojtjen e konkurrencës " Fletore Zyrtare nr.71, fq.3189
- Ligji nr. 10031/2008 "Per procedurat tatimore" ka ndryshuar 3 herë: ligji nr. 10137, datë 11.05.2009, ligji nr. 36/2012, datë 29.03.2012 dhe ligji nr. 80/2013, datë 14.02.2013
- Ligjit nr. 9284, datë 30/09/2004, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar".
- Ligjit 8331, datë 21/04/1998, "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale"
- Ligji nr.10385, datë 24.02.2011 "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve"
- Ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";
- Statusit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare
- Dekret ligjin mbreteror te dates 09.08.1937 "Mbi Permiresimin e disa dispozitave te Procedurave dhe Ligjes se Permbarimit ne Fuqite"
- ligjit nr.7829, datë 01.06.1994 "Për noterinë"
- ligjit nr.9879 datë 21.02.2008 "Për Titujt"
- Ligji Nr.8077 datë 22.02.1996 "Për kambialin dhe premtim-pagesën"
- Ligjit 8662, datë 18/09/2000 "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës se konsumit të energjisë elektrike"
- Ligjit Nr.4406 datë 24.06.1968 "Mbi organizimin gjyqësor"
- Ligjit nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"
- Ligjit nr. 8322, datë 2.4.1998 "Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për Ekstradimin dhe të Dy Protokolleve Shtesë".
- Kontratës Tip e Shërbimit Përmbardësor Gjyqësor Privat

- Udhëzimit të përbashkët Nr.1240/5, datë 15.09.2009 “Për caktimin e tarifave për shërbimin e ofruar nga shërbimi përbarimor gjyqësor privat”, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Financave
- Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014 i Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit”
- Udhëzimi nr. 2, datë 24.09.2003 i Bankës së Shqipërisë “Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë” miratuar me vendimin nr.43, datë 11.06.2003 të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë.
- Udhëzimi nr. 2, datë 27.03.2015 i Bankës së Shqipërisë “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”
- Vendim Nr. 787, datë 14.12.2005 i Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e Kritereve, të Procedurave dhe të Masës së Ndihmës Ekonomike”
- Vendimin Nr. 573, datë 3.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”
- Rregullorja “Për përbërjen e komisionit vlerësues, rregullave të funksionimit të tij, procesi i përzgjedhjes, kritereve dhe procedurave të organizimit dhe të shpalljes së rezultateve të provimit për përbarues gjyqësor privat”, është miratuar me urdherin nr. 3851, datë 08.05.2009, të Ministrit të Drejtësisë
- Dikrektivën nr.46 datë 19.01.2015 “Për unifikimin dhe zbatimin e përkohshëm të masës së sekuestros konservative mbi pagën e debitorit”
- Udhëzimi nr.5, datë 12.12.2012 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e anakndit nga përbarues gjyqësor”
- “Sqaruese për qëllime tatimore mbi veprimtarinë e përbaruesve gjyqësor privatë” e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr.759/2.prot datë 24.03.2015

Aktet ligjore të organizatave ndërkombtare dhe evropiane:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- Kodi Global mbi Ekzekutimin e Detyrueshëm;
- Rregullorja e Këshillit nr.1346/2000 e 29 Majit 2000 mbi procedurat e paaftësisë paguese.
- Rregullorja nr.44/2001, 22 dhjetor 2000 mbi juridiksionin dhe njohjen e zbatimit e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare e njohur si Rregullorja I e Brukselit;
- Rregullorja e Këshillit (EC) nr.2201/2003 e 27 nëntorit 2003 lidhur me juridiksionin dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve në çështjet martesore dhe çështjet e përgjegjësisë prindërore, e njohur si Rregullorja II e Brukselit;
- Rregullorja e BE-së nr. 805/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 prillit 2004 që krijon një Urdhër Ekzekutimi European për pretendimet e pakundërshtuara

- Konventa e Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”, bërë në Hagë më 23 nëntor 2007, ratifikuar me ligjin nr.63 datë 31.05.2012,
- Komisioni Europian, progres Raporti 2104 për Shqipërinë Bruksel
- Raport i Nils Muižnieks Komisioner për të drejtat e njeriut i Këshillit të Europës, 16 Janar 2014
- Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Raporti i katert Vjetor, viti 2010
- Asambleja Parlamentare, “Impelementimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të drejta të njeriut, progres raport, 31 gusht 2009
- High Level Conference on the Future of the European Court of Human Rights, Interlaken Declaration, 19 February 2009
- Committee of Ministers, Human rights working methods – Improved effectiveness of the Committee of Ministers’ supervision of execution of judgments, CM/Inf(2004)8 Final, 7 April 2004, paragraph 1.3
- Committee of Ministers, 8th Annual Report 2014, Supervision of the execution of judgments and decisions of the European court of human rights.
- Committee of Ministers, ‘Resolution CM/ResDH(2011)173’, 14 September 2011.
- Committee of Ministers, ‘Resolution CM/ResDH(2011)189’, 2 December 2011.
- Committee of Ministers, ‘Resolution CM/ResDH(2012)28’, 8 March 2012.
- Council of Europe “European Court of Human rights: summaries of selected decisions restitution / compensation of properties” , 10 February 2011
- USAID Agency for International Development, System Enforcing Agreements and Decisions, Training Manual: Civil Permbarimit,

Jurisprudencë

Vendime të Gjykatës Kushtetuese:

- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.106 datë 01.08.2001
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.11, datë 10.03.2003
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 9, datë 02.04.2003
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.6, datë 31.03.2006
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.27, datë 20.06.2007
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.39, datë 16.10.2007
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.43, datë 19.12.2007
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.1 datë 19.01.2009
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.6, dt 06.03.2009,
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.8 date 23.03.2010

- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 21, datë 29.04.2010
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.23, datë 17.05.2010
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.35 datë 27.10.2010
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.2 datë 01.02.2011
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 49, datë 21.11.2011
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.6 date 17.02.2012
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.11,dt 03.02.2012,
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.12, date 05.03.2012
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.34, datë 28.05.2012
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.42 datë 19.07.2012
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 52, datë 05.12.2012
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë Nr.12, date 16.04.2013
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.30, datë 20.05.2015
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.62, datë 23.09.2015
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.66, datë 22.04.2016
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.3 datë 23.02.2016
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë Nr.28, date 19.05.2016
- Vendimet të Gjykatës Kushtetuese nr.31/2005, nr.7/2009 nr.23/2009 dhe nr.16/2012.

Vendime të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë:

- Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 980, datë 29.09.2000
- Vendimi Unifikues i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.4, datë 29.01.2003
- Vendim Unifikues i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.13, datë 23.03.2004
- Vendimi Unifikues i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.10, datë 24.03.2004
- Vendimi i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.9, datë 09.03.2006
- Vendimi Unifikues i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.272, datë 10.06.2010
- Vendimi i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.1, date 17.01.2011
- Vendimi i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.348, datë 04.06.2013
- Vendimi i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë nr.00-2014-3248, datë 19.11.2014

Vendime të Gjykatës së Lartë:

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 73, datë 07.02.2002
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.403, date 01.03.2005
- Vendim i Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë, Nr.30, dt. 11.01.2006
- Vendimin i Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nr.427, datë 11.04.2006
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.506, datë 25.04.2006
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.1210, datë 26.10.2006

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.690, datë 22.05.2007
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Nr.204, datë 27.02.2007
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.16, datë 22.01.2008
- Vendimi i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë Nr.36, datë 19.02.2009
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.160, datë 28.04.2009
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.297, datë 01.10.2009
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.289, datë 01.10.2009
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartënr.1, date 07.01.2010
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartënr.170, datë 13.04.2010
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Nr.214, datë 06.05.2010
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.221, date 11.05.2010
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.272, datë 10.06.2010
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.333, datë 13.07.2010
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.366, date 30.09.2010
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.456, datë 09.12.2010
- Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në Nr.25, datë 25.01.2011
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr.1, datë 11.01.2011
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.81, datë 22.02.2011
- Vendimin i Kolegjit Civil te Gjykatës së Lartë Nr.222 datë 03.05.2011
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.353, date 05.07.2011
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.398, datë 27.09.2011
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.509, datë 15.11.2011
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.497, datë 27.11.2011
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.6, datë 10.01.2012
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.76, date 09.02.2012
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr.227 datë 08.05.2012
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.478, datë 06.11.2012
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Tiranë nr.568 datë 11.12.2012
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.169, datë 05.03.2013
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.256, datë 11.04.2013
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.348, datë 04.06.2013
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.442, datë 11.07.2013
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.589, datë 24.10.2013
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.580, datë 22.10.2013
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.589, datë 24.10.2013
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartënr.304, datë 16.05.2013
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.458, datë 11.09.2014
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 495, datë 09.10.2014

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.537, datë 23.10.2014
- Vendimi i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë nr.544 datë 28.10.2014
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.558, datë 30.10.2014
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.580, date 12.11.2014
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.609, date 20.11.2014
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.658, datë 10.12.2014
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.00-2014-3886,datë 29.12.2014
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.77, datë 12.02.2015
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.134, datë 05.03.2015
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.132, datë 05.03.2015
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.147, datë 12.03.2015
- Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.157, datë 19.03.2015
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.158, datë 19.03.2015
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.174, datë 01.04.2015
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.180, datë 02.04.2015,
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.256, datë 14.05.2015
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.308 datë 17.06.2015
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.347, datë 02.07.2015
- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.353, date 15.07.2015
- Vendimi i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë nr.289, datë 15.04.2014
- Vendimin i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë nr.550 datë 28.10.2014
- Vendimin i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr.3704 datë 13.11.2014
- Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr.00-2014-3308, datë 25.11.2014
- Vendimi i Kolegjit Adminitrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-4052, date 11.12.2014
- Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-4160, datë 11.12.2014
- Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2014-4260, datë 11.12.2014
- Vendimi i Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë nr.691, datë 16.12.2014
- Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr.1050, datë 19.02.2015
- Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2015-2266, datë 21.05.2015
- Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr.00-2015-3336, datë 09.07.2015
- Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2015-2946, datë 16.07.2015
- Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nr. 00-2015-3385, datë 16.07.2015
- Vendimin Nr.7, datë 18.06.2014 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë
- Vendimin i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr.404, date 28.02.2012
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.1655, datë 25.06.2012
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 2999, datë 19.12.2012
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.285, date 04.02.2015
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.375, datë 12.02.2015

- Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 758 datë 07.04.2015
- Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.864 datë 15.04.2015
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.1585, datë 25.06.2015
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.280, datë 07.07.2015
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.285, datë 08.07.2015
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.343, datë 10.09.2015
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.476, datë 10.11.2015
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.510, datë 25.11.2015
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.522 datë 01.12.2015
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.574 datë 16.12.2015
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.119, datë 21.01.2016
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.109, datë 11.02.2016
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.102, datë 11.02.2016
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.350, datë 18.02.2016
- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.136, datë 18.02.2016

Vendime të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore:

- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.1131, datë 17.02.2016
- Vendimin Nr.1326 datë 25.07.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr.1622, date 16.10.2014, i cili është lene ne fuqi me vendimin nr. 1194, date 28.10.2015 te Gjykates se Apelit Vlore
- Vendimi Nr.1236, date 13.05.2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore
- Vendimi e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr.73, date 21.01.2013
- Vendimin Nr.62-2012-4687 (1435), datë 09.07.2012 të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi me vendimin Nr.673, datë 12.03.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë
- Vendimi Nr. , datë 09.12.2015 dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë
- Vendimi Nr.62-2015-2453 (810), date 15.06.2015 dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
- Vendimin nr. 116/539 Akti, datë 29.12.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat

Vendime të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut:

- Vendimi *Raisa M. Shipping LLP kundër Romanisë*, Sektioni i tretë, i datës 8 Janar 2013, Nr. 37576/05
- Vendimi *Kudla v. Poland* , Dhoma e Madhe e Gj.E.D.Nj., Ap. no. 30210/96, ECHR 2000-XI.
- Vendimi *Lehtinen v. Finland* ", aplikimi nr. 39076/97
- Vendimi *Scordino kundër Italisë*, i datës 29 mars 2006 i Gj.E.D.Nj

- Vendimin *College van Beroep voor het bedrijfsleven- Hollandë Kuhne v. Heitz*, i datës 13.01.2004, çështja C-453/00, referuar si çështje paragjykimore
- Vendimi *Ministero dell'Industria, dell' Commercio e dell' Artigianato v. Lucchini Spa*, Dhoma e Madhe dt 14.09.2006 C-119/05
- Vendimi *Maestri kundër Italisë*, Nr. 39748/98 i datës 17 shkurt 2004
- Vendimi *Brumarescu kundër Rumanisë*, nr. 28342/95, GJEDNJ 1999-VII i datës 23 Janar 2001
- Vendimi *Ryabykh v. Russia*, nr. 52854/99, GJEDNJ 2003,
- Vendimi *Rosca v. Moldava*, nr. 6267/02, GJEDNJ 22 mars 2005,
- Vendimi *Akdivar dhe te tjere kunder Turqisë*, GJEDNJ i datës 16.09.1996,
- Vendimi *Ugurlukoci kunder Republikës Federale Gjermane*, GJEDNJ i datës 12.03.1987
- vendimi *Scordino (No. 1) v Italy*, Nr. 36813/97, 26 Mars 2006, GJEDNJ 2006-V
- Vendimi *Hornsby kundër Greqisë*, GJEDNJ Mars 19, 1997; numër 107/1995/613/701
- Vendimi *Burdov kundër Rusisë*, 7 maj 2002, kërkesa nr. 59498/00 § 34- 35 GJEDNJ 2002-III,
- Vendimi “Çështja Z dhe të tjerë k. Britanisë së Madhe”, GJEDNJ i datës 10 maj 2001,
- Vendimi *Bankovic dhe të tjerë k.Belgjikës dhe 16 shtete të tjera anëtare*, i datës 19 dhjetor 2001,
- Çështja *Qufaj kundër Shqipërisë*, 18 Nëntor 2004, Kërkesa nr. 54268/00,
- Vendimi *Ramadhi kundër Shqipërisë*, 27 nëntor 2007,
- Vendimi *Beshiri kundër Shqipërisë*, 22 gusht 2006,
- Vendimi *Driza v. Albani*, Seksioni IV i Gj.E.D.Nj, Kërkesa nr.33771/02,dt. 13.11.2007.
- Vendimi *Bajrami kundër Shqipërisë*, i GJEDNJ i datës 18 dhjetor 2007, kërkesa nr. 35853/04
- Vendimi *Marini kundër Shqipërisë*, i GJEDNJ i datës 7.7.2008, kërkesa nr.3738/02, par. 154
- Vendimi *Hamzaraj kundër Shqipërisë*, i GJEDNJ i datës 3.2.2009, kërkesa nr.45264/04
- Vendimi *Gjonboçari kundër Shqipërisë*, i GJEDNJ i datës 23.10.2007, kërkesa nr.10508/02

Web Faqe:

- <http://www.nchb.al>
- <http://www.gjykataelarte.gov.al>
- <http://www.gjk.gov.al>
- www.coe.int
- <http://www.nchb.al/historiku-2/2/> aksesuar për herë të fundit 21.02.2016
- http://reformatredrejtise.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf faqe 239 aksesuar për herë të fundit 24.02.2016

- http://www.uihj.com/en/ressources/21650/91/bulgaria_-_en.pdf aksesuar për herë të fundit 01.03.2016
- <http://www.gjykataeapelittirane.gov.al>
- <http://dpp.gov.al/struktura/> aksesuar për herë të fundit në datën 30.03.2016
- http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Dokumenta/REGJISTRI_I_PERMBARUESVE_GJYQESORE_PRIVATE_AKTIVE_08.03.2016.pdf aksesuar për herë të fundit 01.04.2016
- <http://dpp.gov.al/historiku/> aksesuar për herë të fundit në datën 01.04.2016
- <http://dpp.gov.al/aktivitete/> aksesuar në datën 02.04.2016
- <http://www.nchb.al/blog/2015/07/01/perambarimi-gjyqesor-shqiptar-drejt-rruges-se-standardeve-te-se-projekti-binjakezimit-si-ndihme-dhe-mision-drejtperdrejte-bashkimit-evropian-per-permiresimin-e-sherbimit/>
- <http://dpp.gov.al/aktivitete/> aksesuar në datën 02.04.2016
- <http://www.nchb.al/blog/2015/06/21/filozofia-praktike-e-reformes-per-drejttesi-dhe-vemendja-e-re-ndaj-institutit-te-ekzekutimit-te-detyrueshem-perambaruesi-privat-si-predikues-gjyqesor-shtetit-te-se-drejtjes/> për herë të fundit 01.03.2016
- <http://www.nchb.al/blog/2015/01/20/njofitim-> aksesuar për herë të fundit në date 20.01.2016
- http://www.uihj.com/en/global-code-of-enforcement_2165010.html aksesuar për herë të fundit në datë 15.03.2016
- http://www.uihj.com/en/ressources/21493/84/presentation_bcpea_eng.pdf
- <http://www.uihj.com/en/ressources/10148/54/france-en.pdf>
- <http://www.uihj.com/en/ressources/10148/72/allemande-en.pdf>
- http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Presentation/About_en.asp
- <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=331657&Sector=secCM&Language=lanEnglish&Ver=original>
- [https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Rec\(2004\)4&Sector=secCM&Language=lanEnglish&Ver=original](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Rec(2004)4&Sector=secCM&Language=lanEnglish&Ver=original)
- www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Documents/MIindex_en.asp). Këshilli i Evropës, Departamenti i ekzekutimit të vendimeve, lista e masave individuale
- <http://www.coe.int/sq/web/tirana/excecution-of-echr-s-decisions>,
- <http://hub.coe.int/event-files/sessions-committee-of-ministers/session-11-may-2010>
- Bashim Dede, Gjykata Kushtetuese- Mjet ankimi efektiv sipas KEDNJ, 5 tetor 2012 aksesuar ne faqen http://www.gjk.gov.al/web/4_cc_as_effectiveremedy_1191.pdf , ne daten 14.05.2016
- <http://www.cehj.eu/organisation/edito/>
- Human Rights Web, Directorate of Human Rights: <http://www.humanrights.coe.int/>
- European Court of Human Rights; <http://www.echr.coe.int/>
- Committee of Ministers of Concil of Europe: <http://www.coe.int/cm/>

- Shiko Memorandum in shpjegues i Rekomandimit R (2000) 2, <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=334147&Site=CM>
- Këshilli i Europës, Departamenti i ekzekutimit të vendimeve, lista e masave individuale www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Documents/MIindex_en.asp)
- Committee of Ministers of the Council of Europe, *Supervision of the execution of judgments and decisions of the European Court of Human Rights, Annual Report 2011* (Council of Europe 2012) available at http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Source/Publications/CM_annreport2011_en.pdf
- Committee of Ministers of the Council of Europe, 'Supervision of the execution of judgments and decisions of the European Court of Human Rights: implementation of the Interlaken Action Plan – Modalities for a twin-track supervision system', CM/Inf/DH(2010)37, 6 September 2010, available at [https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CM/Inf/DH\(2010\)37&Language=lanEnglish&Ver=original&Site=CM&BackColorInternet=C3C3C3&BackColorIntranet=EDB021&BackColorLogged=F5D383](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CM/Inf/DH(2010)37&Language=lanEnglish&Ver=original&Site=CM&BackColorInternet=C3C3C3&BackColorIntranet=EDB021&BackColorLogged=F5D383)
- Committee of Ministers of the Council of Europe, Press Release 'Albania : Progress in the execution of judgments of the European Court of Human Rights concerning problems relating to the functioning of justice', 934(2009), 8 December 2009, available at <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1555757&Site=CM&BackColorInternet=C3C3C3&BackColorIntranet=EDB021&BackColorLogged=F5D383>
- Rules of the Committee of Ministers for the supervision of the execution of judgments and the terms of friendly settlements, available at: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution/Documents/CMrules2006_en.asp.
- Human rights working methods - Improved effectiveness of the Committee of Ministers' supervision of execution of judgments, available at: [https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CM/Inf\(2004\)8&Language=lanEnglish&Ver=final](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CM/Inf(2004)8&Language=lanEnglish&Ver=final)

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij punimi është studimi i fazës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore duke sjellë një tablo sa më aktuale të tij. E drejta për ekzekutimin e vendimit është pjesë integrale e së drejtës për proces të rregullt gjyqësor. Ekzekutimi është padyshim një element bazë i jurisprudencës për sa kohë që sistemi gjyqësor ka nxjerrë vendime, një pjesë e këtij të fundit është edhe ekzekutimi i tyre. Me dimensionin e ri që ka marrë koncepti i ekzekutimit, studimi i këtij procesi paraqet një interes të madh për mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë. Punimi është realizuar në kuadër të reformimit dhe ndryshimeve që kanë ndodhur në shërbimin përmbartimor gjyqësor, si një nga aktorët kryesor për mbarëvajtjen e procesit ekzekutiv. Ndryshime që ka qënë të rëndësishme për përmirësimin e tij, por të pamjaftueshme për të patur një proces eficient. Punimi analizon problem të tilla si: marrëdhënien ekzekutive dhe elementët e saj përbërës, parashkrimi i së drejtës për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi gjyqësor, titull ekzekutiv sipas ligjit shqiptar dhe raste të praktikës gjyqësore, modeli i shërbimit përmbartimor gjyqësor në sistemet e ndryshme europiane dhe mundësia për të përmirësuar modelin Shqiptar, llojet e ekzekutimit të detyrueshëm, mjetet procedurale të mbrojtjes gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve gjyqësore. Për këtë arsye synohet që përmes analizës dhe përmirësimit të legjislacionit të brendshëm në këtë fushë, të silltet një kontribut në përforsimin dhe rritjen e statusit të përmbartuesit gjyqësor dhe gjetjen e zgjidhjeve alternative për një proces ekzekutiv efektiv. Nga përfundimet e arritura gjatë analizës së problemeve të mësipëme janë propozuar edhe disa rekomandime, për të përmirësuar mëtej legjislacionin në fushën ekzekutive, duke shpresuar që ky punim të jetë një ndihmesë jo vetëm për studiuesit e së drejtës, por edhe për profesionistët e fushës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Fjalët kyçe: Ekzekutim i vendimit gjyqësor, titull ekzekutiv, urdhër ekzekutimi, reformë, parashkrim i së drejtës për vënien në ekzekutim, mjetet e mbrojtjes në fazën e ekzekutimit, ekzekutimi si e drejtë për proces të rregullt gjyqësor.

ABSTRACT

The purpose of this paper is the study of the execution phase of the judicial decision bringing a current picture of it. The right to enforce the judgment is an integral part of the right to a fair trial. Execution is definitely a basic element of the jurisprudence as long as the judicial system has issued decisions, a part of this is their execution. With the new dimension that has taken the concept of execution, the study of this process represents a great interest for the proper functioning of the justice system. The paper is realised as part of the reforms and changes that occurred in the bailiff service, as one of the main subjects of the executive process. Changes have been important for its improvement, but not enough to have an efficient process. The paper analyzes these problem such as: the executive relationship and its constituent elements, the prescription of the right to request compulsory execution of a judicial decision, executive title under Albanian law and cases of judicial practice, bailiff service model in various European systems and the possibility to improve the Albanian model, types of compulsory execution, procedural means of defense during the compulsory execution of judicial decisions. For this reason we entended that through the analysis and improvement of national legislation in this field, to bring a contribution to strengthening and enhancing the status of the bailiff and finding an alternative solutions for an effective executive process. Conclusions reached by the analysis of each of the above problems have been proposed several recommendations, to further improve legislation on executive, hoping that this paper is a contribution not only to scholars of law, but also for professionals in the field of execution of court decisions.

Key words: Execution of court decision, executive title, execution order, reform, the prescription of right for executing, means of protection in the phase of execution.